

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

ORGANIZATA XHEMIJETI
DHE REZISTENCA E SAJ KUNDËR
KOLONIZIMIT

(Konferencë shkencore mbajtur më 17.12.2017, Shkup)

20



Boton:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

Vëllimi 20 – 2018

Biblioteka: **SCUPI**

Botues dhe kryeredaktor:

Dr. Skender Asani

Këshilli redaktues:

Akad. Marenglen Verli

Dr. Zeqirija Ibrahim

Dr. Naim Halimi

Dr. Sevdail Demiri

Mr. Murtezan Idrizi

ISBN: 978–608–4653–68–4

Copyright©ITSHKSH, 2018

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin.

www.itsh.edu.mk

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

ORGANIZATA XHEMIJETI
DHE REZISTENCA E SAJ KUNDËR
KOLONIZIMIT

(Konferencë shkencore mbajtur më 17.12.2017, Shkup)

20

SCUPI

Shkup, 2018

TRYEZA E LËNDËS:

PARATHËNIE.....	7
NË VEND TË HYRJES	9
PROMOVIMI I LIBRAVE PËR XHEMIJETIN.....	13
NURIDIN AHMETI: “XHEMIJETI”-VËSHTRUAR NDRYSHE ...	15
SEVDAIL DEMIRI: RISI DOKUMENTARE PËR XHEMIJETIN...	19
MARENGLEN VERLI: PROFILI I FERHAT DRAGËS NË DOKUMENTACIONIN SHQIPTAR DHE SERB.....	23
QERIM LITA: FERHAT BEJ DRAGA, PRIJËS I LËVIZJES KOMBËTARE SHQIPTARE NË VITET E TRIDHJETA TË SHEKULLIT TË KALUAR.....	35
JUSUF OSMANI: REZISTENCA E XHEMIJETIT KUNDËR ZBATIMIT TË REFORMËS AGRARE DHE KOLONIZIMIT TË KOSOVËS	65
HAKIF BAJRAMI: PARTIA POLITIKE “XHEMIJET-I” (BASHKIM) NË SHQIPËRINË KONTINENTALE KRIJON HISTORI KOMBTARE.....	87
HALIM PURELLKU: XHEMIJETI NE ZGJEDHJET PARLAMENTARE NË RRETHIN E KERÇOVËS (1920, 1923, 1925).....	115
NEBI DER VISHI: VEPRIMTARIA E QENAN ZIJA – MANASTIRLIUT (1863–1935).....	123
ZEQIRJA IDRIZI: HALIM BEJ DERALLA – URË LIDHËSE MIDIS XHEMIJETIT DHE KOMITETIT TË KOSOVËS	133
ISMET AZIZI: AQIF BLYTA – FIGURË KRYESORE E ORGANIZATËS XHEMIJETI.....	145
NAIM HALIMI: XHEMIJETI NË DITARIN E ATDHETARIT KUMANOVAR, AZEM HOXHA	155
ZEQIRJA IBRAHIMI: IDENTITETI POLITIK I XHEMIJETIT ...	158

JORINA VERLI: PROCESI I SHPRONËSIMIT DHE SHPËRNGULJES SË SHQIPTARËVE NGA JUGOSLLAVIA PAS SHUARJES SË XHEMIJETIT.....	170
NATASHA DIDENKO: JETA KULTURORE DHE POLITIKE E MYSLIMANËVE, SIPAS GLISHA ELEZOVIT (1918–1925)	178
ALBAN DOBRUNA: PJESËMARRJA E XHEMIJETIT NË ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË VITIT 1923 NË MBRETËRINË SKS	197
NURIDIN AHMETI: XHEMIJETI NË HISTORIOGRAFINË SHQIPTARE	203
MURTEZAN IDRIZI: DISA BURIME ARKIVORE NË LIDHJE ME THEMELIMIN DHE VEPRIMTARINË POLITIKE TË ORGANIZATËS XHEMIJETI	211

PARATHËNIE

Në historinë kombëtare shqiptare ka shumë ngjarje, personalitete apo lëvizje politike, të cilat në një kohë të caktuar janë luftuar dhe stigmatizuar egërsisht, kurse në një kohë tjetër janë rikualifikuar dhe rivlerësuar objektivisht. Një lëvizje politike e cila lindi, nisi zhvillimin, por shumë shpejtë u ngulfat në një nga periudhat më të errëta të së kaluarës sonë, pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, ishte organizata Xhemijeti (1919–1925).

E vërteta shkencore historike për këtë organizatë politike vonoi shumë, dhe u deshtë të kalojnë tetë dekada, e tani po bëhen gati se një shekull, që kur kjo e vërtetë po shpërfaqet lirshëm.

Realisht, janë të paktë studiuesit që janë marrë në mënyrë serioze me historikun e organizatës politike Xhemijeti. Gjatë periudhës së ndërmjet dy luftërave botërore, pas shuarjes së aktivitetit të saj, nuk u përmend fare, kurse pas Luftës së Dytë Botërore (periudha e komunizmit), për të u bënë disa hulumtime me prapavijë thellësisht politike dhe ideologjike, duke fshehur një mllef të papërmbytur ndaj gjithëçkaje që identifikohet me shqiptarët dhe fenë islame. Kjo qasje joshkencore u ndryshua pak në këto vitet e fundit të pluralizmit demokratik, dhe për Xhemijetin kemi disa qasje të reja hulumtuese – shkencore.

Për ne shqiptarët që jetojmë në Maqedoni, historia e organizatës politike Xhemijeti është e rëndësishme edhe për një fakt shumë të rëndësishëm – selia qendrore e Xhemijetit dhe e gazetës “Hak”, ishte në Shkup, pikërisht në këtë qendër politike të Ballkanit, ku ndërthuret një pjesë shumë e rëndësishme edhe e historisë ilire–shqiptare.

Këto që thamë më sipër, ishin arsye të njaftueshme që në Shkup të organizojmë një konferencë shkencore, për të zbardhur të vërtetat e

pathëna rreth Xhemijetit. Kështu, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, i mbështetur nga Shtëpia Botuese “Logos–A” – Shkup, më 17 dhjetor 2017, pikërisht në ditëlindjen e Xhemijetit organizoi konferencën shkencore me temë “Xhemijeti dhe rezistenca e saj kundër kolonizimit”. Konferenca që u mbajt në hapësirat e hotelit “Bushi” në Shkup, mbledhi një numër të madh të studiuesve shqiptarë dhe të tjerë, nga institute shkencore e universitete të ndryshme vendore e ballkanike, të cilët me qasjet e tyre komparative, ndriçuan aspekte të shumta të veprimtarisë së kësaj organizate politike, me të cilën identifikohet rezistenca jonë kundër pushtuesit serbë dhe përpjekja për ruajtjen e gjuhës, kulturës, traditës fetare e kombëtare.

Në kuadër të kësaj konference, u promovuan edhe dy tituj të rëndësishëm të studiuesit Skender Asani: “Veprimtaria e organizatës Xhemijeti në trevat lindore (1919–1925)” dhe “Dokumente për veprimtarinë politike të Xhemijetit”, botime të përbashkëta të Institutit dhe Shtëpisë Botuese “Logos–A” nga Shkupi. Botimi i këtyre veprave solli para publikut të gjerë edhe një produkt konkret rreth temës boshte të konferencës. Kurse, botimi i të gjitha materialeve relevante të konferencës në këtë edicion të veçantë të SCUPI-t, përbën një kurorëzim shembullor të punës sonë për ndriçimin e veprimtarisë së organizatës Xhemijeti.

Redaksia

NË VEND TË HYRJES

(Fjalë rasti e drejtorit të ITSHKSH-së, dr. Skender Asani)



Kam kënaqësi që sot t'ju drejtohem në hapjen e kësaj konference dhe para së gjithash t'ju falënderoj që sot jeni këtu.

Sot është dita kur e shënojmë përvjetorin e themelimit të Xhemijetit dhe për neve kjo është një ditë feste. Por, ne kemi festë jo vetëm për këtë arsye, por edhe sepse kjo është hera e parë që një institucion shkencor shqiptar në hapësirën shqiptare, kudo qoftë ajo, organizon një konferencë për organizatën politike Xhemijeti.

Në të vërtetë, ashtu siç e kemi thënë shumë herë, Instituti i Trashëgimisë Kulturore e Shpirtërore të Shqiptarëve po dëshmon edhe në vepër se e ka me gjithë mend dhe seriozisht studimin e historisë kombëtare shqiptare të shqiptarëve të Maqedonisë. Me tendencë ose me neglizhencë, tashmë nuk është e rëndësishme kjo, por e vërteta është se historia e shqiptarëve të Maqedonisë është mjaft e fragmentuar dhe me plot pika të errëta, që në jo pak raste kanë lënë

hapësirë edhe për keqinterpretime dhe interpretime joshkencore, që shpesh edhe e kanë dëmtuar identitetin e vërtetë të shqiptarëve të Maqedonisë. Për këtë arsye, sot kur po e organizojmë këtë konferencë shkencore dhe kur po i promovojmë këto dy libra modestë, kam shpresë se kemi bërë sado pak që ta rilidhim historinë tonë kombëtare në trevat lindore shqiptare dhe t'i plotësojmë hallkat e shkëputura të historiografisë sonë. Për këtë, natyrisht, ju falënderoj juve – të nderuar studiues – që gjetët kohë dhe mundësi të jeni sot këtu për të ndriçuar aspekte të kësaj historie, ndërsa përveç studiuesve, do të më lejoni ta falënderoj edhe SHB “Logos-A”, që si bashkorganizatore e kësaj konference, ka ndihmuar, përveç rreth konferencës, veçmas me librat që sot do të prezantohen. Për këtë i detyrohem me falënderim të veçantë drejtorit të saj, prof. Adnan Ismaili, i cili tashmë është identiteti i librit shqip në Maqedoni.

Të nderuar, më lejoni të them edhe dy–tri fjalë edhe për organizatën “Xhemijeti”, që për mua është gati se një vokacion shkencor jetësor.

Që ta kuptojmë Xhemijetin, para së gjithash, duhet ta kuptojmë kontekstin historik kur u paraqit kjo organizatë dhe kur e zhvilloi ajo aktivitetin e saj. Pasi që kishin përfunduar luftërat ballkanike dhe Lufta e Parë Botërore, pra pas Konferencës së Versajës, shqiptarët e mbetur jashtë kufijve të Shqipërisë e kishin kuptuar përfundimisht se ata tashmë do të mbeteshin nën Mbretërinë Serbo–Kroato–Sllovene dhe se do të duhej t'i pranonin rregullat e atij shteti, në mënyrë që të mund të mbijetonin. Në këso rrethana, kur pushteti serb po përgatiste planet më ogurzeza për shfarosjen e shqiptarëve, qoftë përmes shpërnguljes, reformës agrare ose kolonizimit, ishte familja Draga – e dëshmuar edhe si pjesëmarrëse në shpalljen e pavarësisë më 28 nëntor në Vlorë – që iu përvesh punës për të gjetur modalitetet për përfaqësimin politik të shqiptarëve. Dhe, në pamundësi që të ndërtojë parti politike etnike, sepse në atë shtet ajo e drejtë u njihej vetëm serbëve, kroatëve dhe sllovenëve, ata themeluan një parti me emblemë religjioze islame, por e cila u bë mburojë e vërtetë e qenies shqiptare në Kosovë dhe, përgjithësisht, në trevat lindore.

Sado që për dikë mund të duket si organizatë fetare, madje disa mund të nguten ta cilësojnë me epitete të papërshtatshme, duke u nisur nga premisa të aktualitetit tonë shoqëror, e vërteta është se Xhemijeti, gjatë viteve 1919–1925, ia doli me sukses që, me punën e vet, ta pengojë seriozisht shpërnguljen e shqiptarëve, që ishte ndër prioritetet e pushtetit serb, por edhe reformën agrare, që synonte shpronësimin e shqiptarëve të këtyre trojeve, si dhe kolonizimin, që synonte popullimin e dhunshëm të trojeve autoktone shqiptare. Këtu, sigurisht duhet të shtohet edhe kërkesa për arsim në gjuhën amtare, që ishte një kërkesë që nënkuptonte emancipimin e kombit. Të gjitha këto përbëjnë strumbullarin e angazhimit të kësaj organizate dhe ato janë pikat mbase të rëndësishme të asaj kohe që të mund të shpëtohej qenia shqiptare.

Që ta kuptojmë më saktë se çfarë do të ndodhte sikur mos të ishte Xhemijeti, njafton të kujtohem se çfarë ndodhi pasi që u ndalua kjo organizatë më 1925, kur filloi eksodi masiv dhe kur trevat lindore gati sa nuk u shfityruan tërësisht nga shpërngulja e dhunshme, kolonizimi dhe reforma agrare.

Një dimension tjetër që duhet të theksohet me këtë rast është edhe fakti se Xhemijeti është një hallkë tjetër e lëvizjes kombëtare shqiptare. Për këtë dëshmojnë një varg dokumentesh të ndryshme – disa nga të cilat besoj se do të prezantohen edhe në këtë konferencë – që flasin për kontaktet që drejtuesit e Xhemijetit i kishin me çetat kaçake të kryengritësve shqiptarë, por edhe me Komitetin e Kosovës, që – në një mënyrë – janë pjesë të mozaikut të njëjtë, por me role të ndryshme, që e mbronin interesin shqiptar në këto troje. Këtu duhet ta kujtojmë edhe atë se ishte pikërisht familja Draga ajo që investoi për zhvillimin e infrastrukturës ndërshtetërore, siç ishte hekurudha Shkup–Mitrovicë, që paraqiste një arterie të rëndësishme për komunikimin ndërshtetëror dhe zhvillimin ekonomik të këtyre hapësirave shqiptare. Andaj, ne sot – edhe me këtë aktivitet – thjesht po e rilidhim këtë hallkë të munguar të historiografisë

sonë dhe kështu lëvizja kombëtare shqiptare merr trajtën e plotë të zhvillimit të saj në këto troje.

Në këtë kontekst, kur merret në konsideratë edhe formimi edukativ në shkollat më prestigjioze perëndimore të drejtuesve të Xhemijetit, madje jo vetëm kjo, por edhe komunikimi i tyre me kancelaritë perëndimore, për çka po ashtu dëshmojnë mjaft dokumente, një dimension tjetër i Xhemijetit detyrimisht del edhe përcaktimi i properëndimor i kësaj organizate, që do të ishte një paralajmërim për përcaktimet e mëvonshme të trajektores së shqiptarëve të Ballkanit. Madje, në këtë drejtim, Xhemijeti ishte një kasnec i frymës properëndimore, që te shqiptarët do të gjejë vend vetëm pas rënies së Murit të Berlinit, kur shqiptarët e Shqipërisë dhe të Jugosllavisë socialiste do ta kuptojnë dëmin e madh që ua solli shkëputja gati gjysmëshekullore nga Perëndimi.

Pa dashur ta zgjas më shumë, do të më lejoni të përfundoj se Xhemijeti mbetet në memorien kolektive të popullit shqiptar si një përpjekje solide për ndërtimin e identitetit dhe përfaqësimit të tyre politik, ndërsa kjo konferencë është freskim i memories kolektive shqiptare për historinë tonë kombëtare në këto treva dhe plotësim i historisë sonë me hallkat më pak të studiuara ose të munguara.

Në fund, edhe një herë dua t'ju falënderoj të gjithëve për kontributin tuaj për këtë konferencë dhe për gatishmërinë që keni për të ndihmuar Institutin për avancimin e studimeve historike të kësaj pjese të kombit.

Po e përfundoj fjalën time me uratën që punimet e kësaj konference të jenë një uverturë në studimet edhe më të thella që do të vijojnë për historinë kombëtar të shqiptarëve të kësaj ane.

Shkup, 17.12.2017

PROMOVIMI I LIBRAVE PËR XHEMIJETIN

Autor: Skender Asani

*“Veprimtaria e organizatës Xhemijeti në trevat lindore
(1919–1925)”*

“Dokumente për veprimtarinë politike të Xhemijetit”



Skender Asani – autor, Nuridin Ahmeti dhe Sevdail Demiri – recensues

NURIDIN AHMETI

Instituti Albanologjik–Prishtinë

“XHEMIJETI” – VËSHTRUAR NDRYSHE

“Ideali për një historian mbetet që të mos idealizojë, por vetëm të përpiqet të kuptoj qëndrimet dhe vlerat e paraardhësve tanë”, – kështu do të shprehëj historiani britanik Peter Burke në njërin nga studimet e tij.¹ Këtë përpjekje, në fakt, do ta shohim edhe në studimin e studiuesit dr. Skender Asani: “*Veprimtaria e organizatës politike Xhemijeti në trevat lindore (1919 – 1925)*”, të cilin po e promovojmë sot.

Në dhjetëvjetorin e funksionimit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, Dr. Skender Asani, përveç barrës kryesore si bashkëdrejtues dhe bashkëmenaxhues në vëllimin e punëve që ka ky institucion, asnjëherë nuk e ndali punën kërkimore profesionale. Dr. Asani, këto ditë, në kudër të angazhimeve profesionale, studiuesve dhe dashamirëve të historiografisë shqiptare dhe të tjerëve të interesuar, ua ka sjellë librin studimor së bashku me një vëllim dokumentesh “*Veprimtaria e organizatës politike Xhemijeti në trevat lindore (1919 – 1925)*”. Si rezultat i punës kërkimore disavjeçare në disa arkiva të vendit, të rajonit dhe më gjerë, autori ka arritur t’ia dalë mbanë dhe ta argumentojë veprimtarinë e kësaj organizate në trevat lindore gjatë viteve 1919–1925.

Po që se u hedhim një shikim shkrimeve të autorëve shqiptarë para viteve të ‘90–ta, që kanë shkruar për Xhemjetin dhe veprimtarinë e tij, nuk është e vështirë të konstatojmë se ndaj kësaj lëvizjeje ka pasur mjaftë paragjykime, të cilat me një intensitet me të ulët fatkeqësisht vazhdojnë të jenë prezentë edhe në ditët e sotme. Pas

¹ Peter Burke, *Kultura popullore në Evropë në fillimet e kohës së re*, (Përkthue Serzh Qesteri), Arbëri, Tiranë, 1998, f. 15.

viteve të '90-ta kontributet shkrimore të derisotme për Xhemijetin kanë mbetur në nivelin e artikujve të ndonjë reviste apo vështirimi në kuadër të ndonjë monografie. Pikërisht, kjo është edhe një arsye pse studimi monografik i dr. Asanit, i shoqëruar edhe me një vëllim dokumentesh, është i një rëndësie të veçantë, sepse është studimi i parë që publikohet për Xhemijetin nga një studiues shqiptarë dhe pa ndikime ideologjike, krahinore e politike.

Duke lexuar librin e dr. Asanit, lexuesi nuk e ka të vështirë ta kuptoj se tri ishin shtyllat kryesore të funksionimit të Xhemijetit:

1. Mbështetja intelektuale e kohës, siç ishin Nexhip e Ferhat Draga, Nazim Gafurri, etj.
2. Organi i saj "Hak", i cili po i përhapte idetë dhe shqetësimet e artikuluar nga drejtuesit e Xhemijetit, dhe
3. Programi i saj, i cili u ideua brenda mundësive dhe rrethanave politike që lejnin.

Dhe, për të gjitha këto, studiuesi dr. Asani ka nga një mendim të argumentuar.

Për mbështetjen intelektuale, studiuesi dr. Asani konstaton se "Xhemijeti dinjitetshëm përmes disa deputetëve të saj në Parlamentin e Mbretërisë SKS, i përfaqësoi interesat e myslimanëve (shqiptarëve dhe turqve) në këtë shtet, duke kundërshtuar në radhë të parë kolonizimin dhe reformën agrare, si dhe ndërprerjen e shpërnguljes së tyre për në Turqi dhe Shqipëri".

Për organin e Xhemijetit, gazetën "Hak" ("E drejta"), që dilte në gjuhën osmane dhe serbe, në Shkup, pra aty ku gjendej edhe selia e organizatës, autori Asani konstaton se kjo gazetë ka luajtur rol të rëndësishëm për propagandimin e programit të Xhemijetit dhe demaskimin e politikës shoviniste serbomadhe ndaj shqiptarëve.

Ndërsa për sa i takon programit të Xhemijetit, autori Asani thotë se: "Qëllimet kryesore të programit të kësaj organizate politike ishin: sigurimi i të drejtave qytetare-politike, liria e përdorimit të

gjuhës amtare, liria e besimit, etj., dhe se Xhemijeti me programin e tij, në fillim ishte i pranuar nga shteti, por në momentin kur i shprehi pretendimet të paraqesë program nacional nën ndikimin e Komitetit të Kosovës me seli në Shkodër, kjo u vlerësua si shkatërruese për shtetin”, – përfundon Asani.

Si përfundim mund të themi se librat të cilat po i promovojmë sot, janë mirë të argumentuara nga autori, se organizata Xhemijeti është angazhuar për përmirësimin e jetës politike, arsimore, fetare, ekonomike, kulturore, në zbutjen e implementimit të reformës agrare dhe kolonizimit në trevat lindore dhe se kjo organizatë me gjithë potencialin e saj të veprimit bëri përpjekje që t’i rezistonte planeve të mirëpërpiluara për zbatimin e reformës agrare dhe kolonizimit. Xhemijeti luftoi shpërnguljen dhe punoi për faktorizimin e elementit politik shqiptar.

Studimi i dr. Asanit “*Veprimtaria e organizatës politike Xhemijeti në trevat lindore (1919 – 1925)*”, i shoqëruar edhe me një vëllim dokumentesh që lidhen me Xhemijetin, janë përgjigja më e mirë që mund t’ju jepet gjithë atyre që ende vazhdojnë ta shohin këtë organizatë njëanshëm, pa analizuar rrethanat politike dhe shoqërore të kohës. Mendimit të njohur të dijetarit Isiaha Berlin se “Historiani nuk është gjykatës, por hetues: ai paraqet provat, kurse lexuesi i cili është i lirë nga përgjegjësitë profesionale të specialistit, mund të nxjerrë çfarëdo konkluzioni moral që t’i vijë për mbarë”,² në këtë rast do i përshtatej mjaftë studimit dhe botimit njëvëllimësh me dokumente të historianit dr. Skender Asanit, sepse autori me këto botime që sot po i promovojmë e ka kryer punën e hetuesit, duke mbledhur fakte për një ngjarje të caktuar dhe ato fakte ia ka dorëzuar gjykatësit, në këtë rast lexuesit. Nga ky i fundit besoj se autori duhet edhe të pres vendime, në këtë rast kritika, lëvdata e sugjerime.

² Isiaha Berlin, *Idetë filozofike të shekullit XX dhe katër ese për lirinë*, (Përktheu nga origjinali: Bashkim Shehu), Onufri, Tiranë, 2003, f. 177.

Dhe krejt në fund, autorit dr. Skender Asanit i dëshirojmë punë edhe më të frytshme në të ardhmen, ndërsa Shtëpisë Botuese “Logos–A” me seli në Shkup dhe drejtorit të saj dr. Adnan Ismailit e kryeredaktorit Husamedin Abazit përgëzimet me të sinqerta për botimin, sepse me këtë botim, por edhe botimet më vëllime dokumentare që kanë botuar deri me sot, tanimë janë bërë model të cilin duhet ndjekur edhe shtëpitë tjera botuese.

SEVDAIL DEMIRI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të
Shqiptarëve – Shkup*

RISI DOKUMENTARE PËR XHEMIJETIN

Sot kemi nderin që para jush të promovojmë një punë të përbashkët dhe shumë me vlerë të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup dhe Shtëpisë Botuese Logos–A, po ashtu nga Shkupi.

Bëhet fjalë për dy vepra me karakter historik të autorit Skender Asani, i cili gjatë gjithë punës së tij hulumtuese shkencore, si pikë kryesore preokupimi e ka pasur dhe vazhdon ta ketë Shkupin dhe shqiptarët e Shkupit.

Edhe në rastin e dy veprave që sot po i promovojmë për veprimtarinë e Xhemijetit, në 98 vjetorin e themelimit, referenca kryesore është Shkupi, pikërisht aty ku e pati çerdhen e veprimit kjo organizatë politike.

Pa dyshim, kjo monografi është një nga studimet më të plota, në mos e vetmja ndër shqiptarët, lidhur me veprimtarinë politike të organizatës Xhemijeti (1919–1925). Studiuesi Skender Asani i tejkalon vështirësitë e kohës dhe paragjykimet e një klase historianësh, duke e thelluar hulumtimin mbi këtë organizatë politike. Autori argumenton se Xhemijeti nuk kishte për qëllim vetëm ruajtjen e pronave dhe privilegjeve të klasës së ish–bejlerëve, por shkonte edhe më tej. Në fakt, edhe pse në programin e saj kryesisht artikulonte interesat e myslimanëve të mbetur nën Mbretërinë Serbo–Kroato–Sllovene, Xhemijeti ishte një zë i fuqishëm i popujve të shtypur, të cilët luftonin për mbijetesë. Xhemijeti ishte një bërthamë e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, një vijimësi ideologjike e Rilindjes, që kishte për qëllim lirinë dhe pavarësinë e popullit.

Gjatë veprimtarisë politike pesëvjeçare të organizatës Xhemijeti, ajo forcërisht i rezistoi projektit famëkeq jugosllav për reformën agrare dhe kolonizimin e viseve shqiptare me serbë e malazezë, luftoi shpërnguljen e shqiptarëve dhe punoi për faktorizimin e elementit politik shqiptar brenda sistemit shtetëror, në kushte kur nuk kishte asnjë mundësi tjetër të organizimit legal.

Lidhjet e ngushta të udhëheqësve të Xhemijetit me Komitetin e Kosovës dhe Lëvizjen Kaçake, i jepnin veprimtarisë së saj karakter progresiv kombëtar, gjë që do t'i pengonte tejmasë regjimit antidemokratik jugosllav të kohës, i dominuar nga serbët. Prandaj, edhe shuarja e Xhemijetit ishte një porosi kobzeze për interesat e shqiptarëve dhe popujve tjerë me shumicë myslimane nën Mbretërinë SKS.

Në librin e parë monografik, autori shpjegon të gjitha etapat e zhvillimit të veprimtarisë së Xhemijetit brenda harkut kohor 1919 – 1925, siç janë: rrethanat politike pas formimit të shtetit të ri – Mbretërisë SKS dhe çështja shqiptare në trevat verilindore, reforma agrare dhe kolonizimi në trevat lindore, formimi i Xhemijetit, programi dhe përpjekjet e Xhemijetit në çeljen e shkollave në gjuhën shqipe, aktiviteti politik i deputetëve të Xhemijetit në Kuvendin e Beogradit, etj.

Me mjaft interes është edhe historia e organit të shtypur të kësaj organizate, gazeta „Hak“, me qendër në Shkup, e cila pasqyronte gjithë idetë dhe veprimtarinë e Xhemijetit. Prandaj, autori e mbështetë një pjesë të konsiderueshme të lëndës së tij pikërisht në informacionet e plasura të gazetës “Hak”, e cila duke mbrojtur hapur interesat e shqiptarëve dhe myslimanëve, për çdo ditë ballafaqohej dhe kundërshtohej me gazetat tjera proserbe. Fatkeqësisht, edhe kjo gazetë bëhet viktimë e regjimit antidemokratik dhe shuhet bashkë me Xhemijetin.

Më tej, autori Skender Asani, një hapësirë të konsiderueshme i jep aktivitetit politik të Xhemijetit në kohë zgjedhjesh, sidomos ato të viteve 1923 dhe 1925, kur Xhemijeti arriti shkëlqimin dhe rënien e saj.

Në gjithë veprimtarinë e Xhemijetit, spikat figura e Nexhip dhe Ferat Dragës, të cilët ishin shtyllat kryesore të Xhemijetit.

Në shtojcën që gjendet në fund të librit, kemi një pasqyrë më të qartë lidhur me zgjedhjet në rrethe e vendbanime, kandidatët, votat dhe mandatet e fituara të deputetëve.

Ndërsa, libri me dokumente për veprimtarinë politike të organizatës Xhemijeti në trevat lindore, është një plotësim dhe mbështetje argumentuese lidhur me tezat e paraqitura në monografi. Dokumentet arkivore janë autentike dhe flasin për hollësi të shumta për ngjarje dhe procese të rëndësishme politike nëpër të cilat kaloi populli shqiptar i këtyre trojeve.

Prandaj, botimi i këtyre dy librave tematik shkencor, është një lajm shumë i mirë për historiografinë shqiptare, dhe është një adresë ekzakte për shumë studiues që në të ardhmen do të thellojnë hulumtimet e tyre historike dhe politike të kësaj periudhe.

Urime autorit dhe botuesve.

Faleminderit!

PUNIMET E KONFERENCËS SHKENCORE



MARENGLLEN VERLI

Akademia e Studimeve Albanologjike – Tiranë

PROFILI I FERHAT DRAGËS NË DOKUMENTACIONIN SHQIPTAR DHE SERB

Një biografi e shkurtër

Ferhat Draga bën pjesë ndër politikanët më të njohur të Kosovës, me veprimtari intensive, veçanërisht në vitet 20–40 të shek. XX.

U lind në Mitrovicë në vitin 1880 në familjen e Ali Pashë Dragës. Origjina e familjes sipas disa të dhënave ishte nga Plavë–Gucia, përkatësisht lagjja Qosaj e Vuthajt. I ati bënte pjesë në parinë e Kosovës dhe ishte anëtar i Komitetit Qendror të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ferhati i përfundoi studimet në Stamboll dhe me një kulturë solide për kohën (njihnte 5 gjuhë të huaja, turqishten, serbishten, gjermanishten, frëngjishten dhe italishten) u fut në politikë qysh në moshë të re. Veprimtaria e tij zë fill në dekadën e parë të shek. XX, kur përkrah të vëllait, veçanërisht nga viti 1908, punoi për ngritjen e klubeve e shkollave shqipe dhe u rreshtua ndër përkrahësit e alfabetit latin, por u bë tepër i njohur pas vitit 1919, kur ndihmoi vëllain e tij, Nexhipin, të krijonte organizatën, apo partinë politike legale, Xhemijet (Bashkimi, 18.12.1919), me degë nga Struga deri në Tregun e Ri, dhe veçanërisht dy vjet më vonë (1921), kur, pas vdekjes së vëllait, e drejtoi vetë këtë organizatë.

Nën drejtimin e tij, Xhemijeti pati rezultate të dukshme në zgjedhjet parlamentare të vitit 1921, por, për shkak të terrorit, Ferhati u detyrua të mërgonte në Vjenë. Terrori u përsërit në zgjedhjet komunale e bashkiake të vitit 1923, megjithatë në zgjedhjet parlamentare të po atij viti Xhemijeti siguroi 14 mandate

deputetësh. Është vërtetuar se për të penguar dhunën shtetërore serbe në Kosovë e më gjerë, Ferhati bashkëpunoi ilegalisht, përmes vëllait tjetër të tij, Hajdinit, edhe me forcat më radikale të rezistencës të grupuara në Komitetin “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”, të cilat deklarorin hapur synimin e tyre për çlirimin e Kosovës dhe bashkimin e saj me shtetin kombëtar, Shqipërinë e pavarur³.

Si përfaqësues i Xhemijetit në Skupshtinën (Parlamentin) e Shtetit Serbo–Kroato–Slloven (Mbretëria e Jugosllavisë u quajt zyrtarisht në vitin 1929), F. Draga gjatë viteve 1921–1925 denoncoi vazhdimisht politikën antishqiptare të qarqeve drejtuese të Beogradit. Për këtë arsye në disa raste u përpoqën ta likuidonin, kurse më 30 janar 1925, në prag të zgjedhjeve parlamentare të atij viti, e arrestuan në shtëpinë e tij në Shkup dhe e burgosën në Mitrovicë, çka çoi edhe në shkatërrimin e Xhemijetit.⁴

Gjithsesi, në vitet 30, F. Draga mbetej gjithnjë një figurë potente me ndikim të padiskutueshëm në rininë intelektuale kosovare dhe mbi deputetët shqiptarë të çdo partie politike të Jugosllavisë. Në vitet 1935 dhe 1938, përmes promemorieve, dërguar kryeministrit Stojadinoviç, ai insistoi për t’u siguruar shqiptarëve liri politike e kulturore, si edhe kundërshtoi shpronësimin agrar dhe shpërnguljen e tyre me dhunë drejt Turqisë. Për këtë qëllim ai bashkëpunoi edhe me Tiranën zyrtare, që gjithashtu e shikonte me shqetësim dhe përpiqej ta pengonte politikën jugosllave të spastrimit etnik në Kosovë dhe në vise të tjera shqiptare.

F.Draga diti të shfrytëzonte lëkundjen e pozitive të Stojadinoviçit në vitin 1938 dhe i ofroi mbështetje në zgjedhjet parlamentare të

³ *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, vëll.I, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: Kristalina, 2007, artikulli *Ferhat Draga*; vëll.III, artikulli *Xhemijeti*; *Gazeta Kosova*, 18 korrik 1941. Artikulli i Ibrahim Lutfiut për Ferhat Dragën; shih edhe Hakif Bajramin, *Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë më 1918-1941*, Prishtinë, 1981.

⁴ Gjyqi e dënoi me 20 vjet burg, kreu 3 vjet

dhjetorit të atij viti, kundrejt koncesionit për të siguruar sa më shumë mandate për kandidatë shqiptarë. Dhe arriti të fuste në parlament 6 deputetë shqiptarë.

Rezultati më i rëndësishëm i marrëveshjes ndërkohë ishte kufizimi i grabitjes së tokave të shqiptarëve dhe ndalimi i zbatimit të Konventës jugosllavo–turke të 11 korrikut 1938 për shpërnguljen e 40 mijë familjeve shqiptare⁵.

Në vitet e Luftës së Dytë Botërore, F. Draga, për të realizuar synimin themelor të jetës së tij, bashkimin e të gjithë trevave shqiptare në një shtet të vetëm, nuk nguroi të bashkëpunojë dhe me pushtuesit italianë. Gjatë muajve maj–qershor 1941, ai qëndroi në Romë duke u përpjekur të ndikojë në caktimin e kufijve të rinj të zonave italiane, gjermane dhe bullgare të pushtimit, që bashkonin pjesën më të madhe të Kosovës me Shqipërinë. Më pas, pushtuesit gjermanë e mënjanuan nga strukturat politike si italoofil, por ai, gjithsesi, ishte në lidhje me krerët e organizatës “Lidhja e Dytë e Prizrenit” dhe nga fundi i vitit 1944, me çetat nacionaliste.

Vdiq në rrethana të errëta në fshatin Krelan, pranë Gjakovës, më 2 dhjetor 1944, kur Kosova po binte nën kontrollin e forcave komuniste.

Në vitin 1993 me dekret presidencial nr. 435, dt. 26.01.1993, Ferhat Draga është dekoruar me *Urdhrin për veprimtari patriotike të klasit të parë*.

Profili i Ferhat Dragës sipas dokumenteve

Në Arkivin e Republikës së Shqipërisë (AQSH) ndeshen mjaft dokumente të burimeve shqiptare e serbe për Ferhat Dragën dhe

⁵ Arkivi Qendror Shtetëror (më tej: AQSH), Fondi 251, viti 1938, dos. 107/1, dok. 426-431; Gazeta Kosova, 18 korrik 1941; E vërteta për Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi, Tiranë 1990, f. 334-340.

bashkëpunëtorët e tij. Nga një sondazh pa shumë pretendime, rezultoi se në vitet 1919–1924 dokumentet, që kanë si burim kanalet diplomatike të shtetit shqiptar, fokusohen në veprimet politike të Ferhat Dragës dhe figurave të tjera të njohura të Xhemijetit.

Diplomatët shqiptarë të akredituar në Jugosllavi, përkatësisht në legatën në Beograd dhe në konsullatën në Shkup, përcjellin në Tiranë tekste të debateve të zhvilluara në interpelancat parlamentare në Skupshtinën jugosllave, midis F. Dragës, njeriut të tij, edhe ai deputet, Aqif Blutës, përfaqësues i Novi Pazarit⁶, si edhe informata për qëndrimet politike të kandidatëve që figuronin në listat e partive⁷. Gjithashtu, raportet e dërguara në Tiranë përmbajnë të dhëna për kandidatët e Xhemijetit fitues në zgjedhjet parlamentare dhe komunale e bashkiake⁸.

Me interes të veçantë janë njoftimet për kombinacionet politike dhe aleancat që F. Draga realizonte me partitë e tjera politike në Mbretërinë e Jugosllavisë me atributet e kryetarit të Xhemijetit. Në këtë kuadër vlejnë të përmenden disa pika të marrëveshjes së F. Dragës me ministrin e Drejtësisë së Partisë Radikale të Nikolla Pashiqit, të arritur më 11 shkurt të vitit 1923, marrëveshje që u pranua nga Këshilli i Ministrave, si edhe nga organet drejtuese të Xhemijetit me qendër në Shkup⁹.

Në pikën tre, thuhej tekstualisht: “Rregullimi i çështjes agrare [bëhet] mbi bazën që çdo pronari t’i lihen 30 ha tokë dhe të largohen nga kjo tokë tërë bujqit (lexo: kolonët sllavë) e instaluar gjer tashti padrejtësisht”. Në këtë mënyrë, F. Draga synonte të shmangej shpronësimi i masës dërmuese të pronarëve shqiptarë dhe të prapësohej kolonizimi me elementë sllavë i viseve shqiptare, i cili kishte filluar që në vitin 1913–1914. Pika katër siguronte shpërblim

⁶ AQSH, F.251, viti 1924, dos. 101, dok. 81.

⁷ Po aty, viti 1923, dos. 185, dok.37, 54.

⁸ Po aty, viti 1938, dos. 107/1, dok. 426 - 431.

⁹ Po aty, viti 1923, dos. 185, dok. 200.

monetar për tokën që sipas ligjit u merrej pronarëve. Në këtë pikë nënvizohej se duhej “T’u paguhej pronarëve të vjetër vlera e tokës, që është ndarë sipas ligjit agrar, me çmimin e caktuar”, kurse pika pesë, me formulimin “të hiqen tërë sekuestrot nga pronat e atyre personave që ndodhen brenda shtetit, si edhe atyre që vërtetojnë me dokumente mosarratisjen e tyre”, synonte të shpëtonte nga goditja e autoriteteve agrare të gjithë atë kategori të popullsisë, që prekej me pretekstin se ishte kundërshtarë politike e regjimit dhe luftonte për përmbysjen e tij. Interesant ishte edhe pika gjashtë, ku pranohej “të çelen shkolla në gjuhën turqishte dhe shqipe, sipas nacionalitetit të myslimanëve”.

Me këmbënguljen e F. Dragës, në marrëveshjen e 11 shkurtit 1923 shënohej se duhej “të ndalej kolonizimi me elementë të huaj në Kosovë dhe Metohi”, çka, nëse zbatohet, i priste rrugën transformimit etnik dhe sllavizmit të viseve shqiptare. Kurse në pikën tetë, F. Draga kishte insistuar edhe për dënimin e fajtorëve, përkatësisht funksionarëve dhe civilëve serbë që kishin organizuar para pak kohe terror e gjakderdhje në Mitrovicë gjatë fushatës zgjedhore, për të penguar zgjedhjen e kandidatëve të Xhemijetit¹⁰.

Krahas dokumenteve, ekzistojnë të ruajtura në Arkivin Shtetëror edhe kopje të gazetave që bëjnë fjalë për F. Dragën. Një numër i gazetës “Liria Kombëtare” që dilte në Gjenevë, për shembull, njoftonte më 1 janar 1928, për lirin e F. Dragës nga burgju ku ishte mbajtur për tre vjet. Ai ishte dënuar me 20 vjet, shkruhej në gazetë, por “duke parë përshtypjen e keqe që ky dënim kishte bërë në popullin shqiptar të Kosovës, “gjyqi i diktimit e kishte nxjerrë të pafajshëm”.¹¹

Në vitet 30—të në informacionin e përcjellë në Tiranë nga stafi diplomatik i Shqipërisë i akredituar në Jugosllavi, shfaqen, krahas emrave të figurave politike shqiptare anëtarë të partive politike

¹⁰ Po aty.

¹¹ *Liria Kombëtare*, Gjenevë, 1 janar 1928, f. 4.

jugosllave të kohës (parti që u krijuan pas riorganizimit të jetës parlamentare, që pasoi diktaturën e mbretit Aleksandër, realizuar nga gjenerali Zhivkoviç),¹² edhe përpjekjet e F. Dragës për t'i bërë presion qeverisë jugosllave, veçanërisht asaj të M. Stojadinoviçit (në pushtet që nga viti 1935), duke aktivizuar politikanë shqiptarë të kohës me anëtarësi në partitë ekzistuese jugosllave, ose me detyra në administratën vendore, komunale e bashkiake, si edhe duke akorduar me grupinin politik boshnjak të Mehmet Spahos etj.¹³

Përmes presioneve të llojllojshme, veçanërisht përmes promemorieve, sikurse ishin promemoret e rëndësishme të viteve 1935, 1938 dhe 1939, F. Draga doli përsëri në mbrojtje të interesave të popullsisë shqiptare¹⁴. Është me interes të perifrashojmë disa pasazhe nga promemoret që iu dërguan, natyrisht në gjuhën serbe, M.Stojadinoviçit.

Në promemorien e 17 tetorit 1935, F. Draga theksonte se reforma agrare kolonizuese në “viset e jugut” kishte krijuar për myslimanët e atjeshëm një “gjendje fare të padurueshme”, se aty u “merrej padrejtësisht krejt pasuria e paluajtshme”, se gjykimet ishin krejtësisht arbitrare, se gjeometrat vepronin kundër pronarëve myslimanë dhe se shpërblimet që iu premtoheshin këtyre ishin qesharake. Dhe nuk kishte si të ndodhte ndryshe, shkruante F. Draga, përderisa të gjithë nëpunësit e zyrave agrare e “proklamojnë çdo mysliman si të dëmshëm dhe që ‘nevojitet thjesht me e vra’”. Madje, shprehej ai, “as vakëfet fetare myslimane dhe varrezat nuk janë të përjashtuara prej reformës së mbrapshtë agrare”. “Nën pretekstin se janë mbjellë kullota shtetërore, vijonte akuzat F. Draga, autoritetet agrare iu kanë marrë banorëve në shumë katunde edhe gjithë korryen e vitit”, të cilën pastaj sekserët serbë ua shesin shtrenjtë ndonjëherë të zotëve të mëparshëm”¹⁵.

¹² *AQSH*, F. 251, viti 1938, dos. 107/1, dok. 284.

¹³ *Po aty*, dok. 259-299.

¹⁴ *Po aty*.

¹⁵ *AQSH*, F.251, viti 1935, dos. 108.

Së fundi, F. Draga kërkonte ndaljen e procesit që, “nën pretekstin e zbatimit të Ligjit agrar dhe të kolonizimit, ka marrë formën e një gjuetie të vërtetë kundër myslimanëve të viseve të Jugut ...” si dhe dënimin e të gjithë nëpunësve agrarë që shpërdoruan detyrën dhe gjithë atyre personave që do t’u vërtetohej se bënë dëshmi të rreme¹⁶.

Afrimi i zgjedhjeve të 30 majit 1937, sipas njoftimit të legatës shqiptare në Beograd, e gjeti shumë aktiv F. Dragën. “Elementi intelektual i shqiptarëve të Kosovës, thuhet në këtë njoftim, i shtrënguar rreth z. Ferhat Dragës, po punon me të gjithë fuqinë e tij, natyrisht në krye të studentëve të ditur (për të cilët ka dijeni – M.V.) nga MPJ, të cilët me radhë po vizitojnë qendrat e ndryshme të krahinave të tyre, me qëllim që të bëjnë propagandë për listën e F. Dragës, që mban emrat e shqiptarëve më të kulluar të Kosovës”. Sipas njoftimit të legatës, F. Draga dhe bashkëpunëtorët e tij mendonin se mund të konkurrohej me sukses lista qeveritare e të fitoheshin nga 15 vende, nga 27 vende, që ishin në konkurrim¹⁷.

Një vit më pas, F. Draga ishte më aktiv se kurrë. Kryediplomati shqiptar në Beograd, Tahir Shtylla, njoftonte më 10 korrik 1938 MPJ në Tiranë, se F. Draga kishte takuar në Turqi Hasan Rizanë, Sekretarin e Përgjithshëm të Kryesisë së Republikës Turke¹⁸. Sipas T. Shtyllës, “ky zotëri ishte i lindur në Kosovë dhe që mik i të ndjerit Nexhip Dragës [vëllait të Ferhatit] dhe gjithë familjes së Dragajve”.

T. Shtylla theksonte se Ferhati u takua dy herë me H. Rizanë dhe e informoi se si qëndronte e vërteta për minoritetin turk dhe shqiptarët në Jugosllavi. Në takimin e dytë Hasani i kishte treguar F. Dragës se “ia kish thënë Ataturkut një nga një dhe me të gjitha hollësitë fjalët e tij, të cilat kryetari i shtetit turk, i kish dëgjuar me kujdes të veçantë”. Ataturku kishte thënë se e njilhte personalisht

¹⁶ *Po aty*.

¹⁷ *AQSH*, F. 251, viti 1937, dos. 126, dok. 194.

¹⁸ *Po aty*, f. 234 – 235.

Nexhip Dragën, dhe se, kur kish qenë në detyrë në Maqedoni, “kishte ngrënë bukë në shtëpinë e tij”.

Më tej, ai, përmes Hasanit, i kishte dërguar përshëndetje N. Dragës, duke e ftuar të rrinte i qetë, sepse do t’ia plotësonte dëshirën. Atatyrku qe shprehur se “vërtet u përgatit Konventa [Jugosllavo-Turke për shpërnguljen e 11 korrikut 1938],¹⁹ por ajo kërkonte ratifikimin e Guvernës dhe kjo nuk do të bënte kurrë një gjë që ishte në kundërshtim me realitetin dhe me dëshirat e shfaqura nga ana e tij”.

Memorandumi i dytë i rëndësishëm i F. Dragës, adresuar ministrit Mehmet Spaho, mban datën 23 gusht 1938²⁰. Ky dokument mjaft i argumentuar kundër veprimeve të jashtëligjshme që ndërmerrnin autoritetet agrare jugosllave ndaj pronarëve shqiptarë në Kosovë e më gjerë, dëshmon për angazhimin serioz të Dragës për të penguar shpronësimin e popullsisë shqiptare.

Duke shfrytëzuar koniunkturat politike dhe konfigurimin e kabinetit, memorandum i jo rastësisht iu paraqit politikanit potencial boshnjak, Mehmet Spahos. Është interesant të përmendet se, përveç fakteve të shumta që përmenden për të treguar se shpronësimi bëhej duke shkelur çdo ligj, me tendencën për të shpronësuar tërësisht pronarët shqiptarë, në memorandum ceket edhe ndalimi i paprecedent i arsinit në gjuhën shqipe. “Shteti ynë për pakicat hungareze e gjermane ka bërë diçka, shprehet F. Draga, por për shqiptarët nuk ka bërë asgjë ... nuk ka asnjë shkollë fillore, asnjë gazetë ... Në qoftë se këtij inferioriteti kulturor, vijon F. Draga, i

¹⁹ Po aty. Konventa Jugosllavo-Turke për shpërnguljen e 40.000 familjeve brenda 6 vjetëve (1939-1944) u nënshkrua më 11 korrik 1939 në Stamboll pas një muaji bisedimesh (9 qershor - 13 korrik 1935) nga Milan Ristiç e Vojislav Magovçević për palën jugosllave (i pari shef i Seksionit Ballkanik në MP të Jashtme dhe i dyti, inspektor në Ministrinë e Bujqësisë). Për palën turke delegatë ishin Hasan Saka dhe Xhevdet Alasagon (i pari kryetar i Seksionit turk të Këshillit të Antantës Ballkanike dhe i dyti, drejtor i Përgjithshëm për popullsinë e shpërngulur pranë Ministrisë së Higjienës dhe Asistencës Sociale).

²⁰ Po aty, dok. 259-299.

shtohet edhe shkatërrimi ekonomik, ... atëherë vendet e banuara nga shqiptarët do të paraqisnin oaze të çuditshme në zemër të Evropës, një pakicë unike të zhveshur prej të drejtave elementare ...”.²¹

Rezultati i intervenimit të nxitur nga F. Draga nuk mungoi. M. Spaho i bëri presion kryeministrit Stojadinoviç dhe ky ngarkoi ministrin pa portofol, Xhafer Bej Kulenoviçin, të bënte një raport të argumentuar mbi padrejtësitë që u ishin bërë shqiptarëve myslimanë nga zbatimi arbitrar i ligjit të reformës agrare dhe ligjit për kolonizimin e “Serbisë Jugore”. Sikurse njoftonte Legata shqiptare në Beograd Ministrinë e Punëve të Jashtme në Tiranë, se ajo, me anën e F. Dragës, i kishte vënë në dispozicion Kulenoviçit “një material gjerësisht të dokumentuar mbi grabitje të tokave të shqiptarëve”.²²

Për Tiranën zyrtare, F. Draga ishte shqiptari më i vlerësuar brenda Mbretërisë Jugosllave. Tahir Shtylla, më 24 gusht 1938, i shkruante konsullit shqiptar në Manastir: “... në Jugosllavi bashkëpunojmë me dy kategori njerëzish: – Me ata që nuk kanë pozita qeveritare dhe janë shqiptarë të flaktë, e hidhen në zjarr kurdoherë që ta kërkojë nevoja dhe me ata që kanë pozita qeveritare dhe bëjnë një politikë oportuniste gjithandej ... për të shpëtuar vëllezërit e tyre. Nga kategoria e parë, për fat të keq, kemi pak vetë që shquhen, si bie fjala Ferhat Bej Draga, Xhevat Begolli, Iliaz Prishtina etj. ...”.²³

Por, shprehej diplomati Shtylla, midis bashkëpunëtorëve tanë ka grindje të mëdha. Duke cekur këtë plagë të hershme, ai rekomandonte që Tirana të mos përzihej në këto grindje, dhe nëse do të ishte e shtrënguar ta bënte, ndërhyrja duhej të synonte pajtimin e bashkimit dhe “jo të dëgjojmë akuzat e njërit dhe të tjetrit”.

²¹ Po aty.

²² Po aty.

²³ Po aty, dok. 284.

Problemët politike të Jugosllavisë, të rritura pas presioneve, që gjithë shtetet multinacionale të Evropës patën nga agresiviteti i Rajhut Gjerman, të artikuluar fort edhe në Mbledhjen e njohur të Munihut, ndikuan në rritjen e peshës së faktorit shqiptar dhe elitës së tij politike. Më 27 tetor 1938 F. Draga u prit nga M. Stojadinoviçi, që kërkonte vota për zgjedhjet e ardhshme parlamentare, i vënë nën presionin e opozitës, e cila kërkonte nga Qeveria respektimin e detyrimeve të Jugosllavisë në kuadrin e “Antantës së Vogël”, në rast se Çekosllovakia kërcënohej nga kufiri i Hungarisë.²⁴

Më 1 dhjetor F. Dragës i dha audiencë, regjenti i Jugosllavisë, princi Pavle Karageorgjeviç, i cili u shpreh i paditur e i çuditur për mjerimet e shqiptarëve, për dhunën e shtuar gjatë nëntorit dhe për rrezikun e spastrimit etnik që sillte zbatimi i Konventës me Turqinë. Ai premtoi se do të ndalonte shpronësimin dhe shpërnguljen e shqiptarëve dhe i kërkoi Dragës të mbështeste qeverinë, duke i ofruar hapur një vend në senat.

Në rrethanat e krijuara në Jugosllavi në periudhën dhjetor 1938 – mars 1939, Tirana zyrtare u kujdes posaçërisht për çështjen e shqiptarëve atje, duke u mbështetur forcat të F. Draga. “Të mbledhim në Belgrad dhe, sa të jetë e mundur në Shkup, udhëzonte legatën, përmes një promemorie, Ministria e P. të Jashtme e Shqipërisë, Ferhat Beun me shokët e tij, deputetët, senatorët, parësinë e Kosovës, fetarët muhamedanë dhe të gjithë bashkëpunëtorët tanë, të cilëve t’u trajtojmë situatën e vërtetë ...”²⁵, si edhe t’i informojmë për përpjekjet që bëhen nga shteti shqiptar pranë autoriteteve në Turqi dhe pranë Fuqive të Mëdha e qeverive nuke, për të mbrojtur shqiptarët në Jugosllavi.²⁶ “Ferhat Draga, vijonte udhëzimi, sipas urdhrit të Naltmadhërisë së Tij, Mbretit, të vejë në Turqi dhe po të jetë që nuk e gjykon të rrezikshme për kthimin e tij në Jugosllavi,

²⁴ Po aty, dok. 363.

²⁵ Po aty, dos. 107/2, dok. 763-766.

²⁶ Po aty.

të kthehet këtu në Shqipëri për disa ditë ..., duhet që ne dhe shqiptarët e Kosovës të punojmë që ta ngrehim prestigjin e tij në Kosovë, sepse ... personi i tij është më i dobishmi për të mbajtur lart kurajën e kosovarëve ...”.²⁷

Edhe në promemorien e fundit, që nxori MPJ e Shqipërisë disa ditë para pushtimit të vendit nga Italia, F. Draga dëshmohej si figura e parë ndër shqiptarët në Jugosllavi. Në këtë promemorie, e cila mban datën 20 mars 1939, kohë kur rotacioni politik kishte larguar Stojadinoviçin, duke e zëvendësuar me qeverinë e Cvetkoviçit, kërkohet të krijohet një Komitet, nën kryesinë e F. Dragës. Programi i tij do të duhej të ishte ndalimi i shpronësimit dhe i shpërnguljes së shqiptarëve drejt Turqisë, mandej të drejtonte Komitetin Muhamedan të Shkupit, të organizonte elementin fetar muhamedan e të krishterë, të organizonte propagandë kombëtare në Kosovë, të afronte brezin e ri etj. Promemoria trajtonte edhe mënyrat si duhej vepruar konkretisht.²⁸

F. Draga do të shfaqej në mbrojtje të interesave të shqiptarëve të Kosovës edhe pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia. Më 6 tetor 1939, ai i dërgonte ministrit jugosllav të Drejtësisë, Lazar Markoviçit, një promemorie të re, shumë të argumentuar, për padrejtësitë që bëheshin mbi shqiptarët e Kosovës në emër të reformës agrare nga autoritetet jugosllave.²⁹

Mbrojtja që F. Draga i kishte bërë gjithnjë kauzës shqiptare, dëshmohej edhe nga një informacion rezervat, të cilin Ministria e Tokave të Lirume ia dërgonte, më 17 dhjetor 1941, mëkëmbësit të Mbretit të Italisë në Shqipëri, F. Jakomonit.³⁰ F. Draga thuhet në të “ka qenë sistematikisht i persekutuar nga të gjitha regjimet e

²⁷ Po aty, dok. 796-797.

²⁸ Po aty.

²⁹ Po aty.

³⁰ Po aty, viti 1941, dos. 94, dok. 1-2.

Beogradit, në çfarëdo mënyrë shtypjeje, që nga burgimi deri te sekuestrimi i pasurive të tij ...”.³¹

Sigurisht, “fronti” që krijoi Nexhipi e më pas F. Draga, që nga viti 1919 nuk ishte në unitet, grupet që u përfshinë në Xhemijet, nuk ishin në akord për çdo gjë e gjithnjë. Përpjekjet e cedimet që F. Draga bënte për të ruajtur kompakte organizatën, apo partinë e Xhemijetit dhe njëherësh lëshimet e reduktimi i kërkesave përballë politikës së partive e qeverive serbe, që me rotacion dominonin pushtetin në Beograd, e dobësuan forcën e Xhemijetit dhe mundësinë e F. Dragës për të pasur rezultate më të dukshme në interes të mbrojtjes së popullsisë shqiptare. Lëshimet politike të diktuar nga mozaiku nacional i myslimanëve në trevat ku u shtri veprimtaria e Xhemijetit, mbështetja e kësaj organizate në linjën fetare etj. sigurisht kishin kosto jo të pakët ...

Por, ç’mund të bëhej më shumë në rrethanat e atëhershme, ose ç’mund të bëhej ndryshe ? ...

Promemoriet e Tiranës zyrtare, në janar–mars 1939 e ndonjë dokument tjetër, dëshmojnë se F. Draga ishte personi më influent në Kosovë, e padyshim vlerësohej si numri një aty nga Tirana zyrtare, e cila e mbështeste atë. Dokumenti i sipërcituar, i 17 dhjetorit të vitit 1941, konfirmon peshën e F. Dragës dhe shqiptarizmin e tij të padiskutueshëm.

³¹ Po aty.

QERIM LITA

Shkup

FERHAT BEJ DRAGA, PRIJËS I LËVIZJES KOMBËTARE SHQIPTARE NË VITET E TRIDHJETA TË SHEKULLIT TË KALUAR

Me shpërbërjen e organizatës Xhemijeti, e cila zyrtarisht njihej si parti politike e “Myslimanëve të jugut”, shqiptarëve ju ndalua e drejta e përfaqësimit në parlament nëpërmjet ndonjë partie të veçantë të tyre. Kjo e drejtë atyre u mundësohej vetëm nëpërmjet partive të ndryshme serbe, siç ishin Partia Radikale, Partia Demokratike etj.³² Si rrjedhojë e politikës diskriminuese ndaj shqiptarëve nga ana e pushtuesit të atëhershëm serbo–madh, një pjesë e parisë shqiptare, nën udhëheqjen e Ferhat bej Dragës, në fillim të viteve tridhjeta të shekullit të kaluar, ndërmorën një sërë aktiviteteve politike dhe organizative, të cilat kishin për qëllim ndërgjegjësimin e shqiptarëve. I tërë aktiviteti zhvillohej përmes Bashkësisë Fetare Islame, përkatësisht, Mexhllisit të Ulemasë së Shkupit, në kuadër të të cilit përfshiheshin tërë territoret shqiptare nën Mbretërinë jugosllave.

Burimet ushtarake, policore dhe diplomatike jugosllave hedhin dritë për një aktivitet të dendur të Ferhat bej Dragës e të bashkëpunëtorëve të tij midis harkut kohor 1935–1940. Gjithnjë në mbështetje të këtyre burimeve, shohim se ky aktivitet ishte përqendruar në dy çështje thelbësore për kohën: e para, ngritja e vetëdijes kombëtare, dhe e dyta, ndërprerja e tërësishme e shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi. Aktiviteti i parisë kombëtare e fetare shqiptare erdhi në shprehje veçmas pas Konventës turko–jugosllave,

³²Државен Архив на Република Македонија (мë tej ДАРМ), Фонд ОЗНА, кутија 2, док. 2/II/II, бр. 13 б. Податоци са пратениците од бивша Југославија.

e cila më 11 korrik të vitit 1938 u parafua nga ana e të dy qeverive përkatëse. Kjo marrëveshje erdhi si rrjedhojë e negociatave të gjata midis diplomacisë jugosllave e asaj turke, të cilat zgjatën rreth tre vjet. Autoritetet jugosllave, të frymëzuar nga Ligji për kolonizim, të cilin Parlamenti turk e solli më 14 korrik të vitit 1934, i cili, veç tjerash, parashihte shpërnguljen e të gjithë turqve të Ballkanit për në Turqi³³, e panë si momentin kyç për shpërnguljen e tërësishme të popullsisë shqiptare e turke nga vatrat e tyre për në Turqi dhe në tokat e tyre të vendoseshin kolonët sllave. Për këtë qëllim, Qeveria e Stojadinoviqit, në shtator të vitit 1935 themeloi Komitetit ndërmnistror, i cili në tetor të atij viti hartoi “Projektin” për, siç thuhej, “shpërnguljen e elementeve josllave nga Serbia jugore”. Në të, veç tjerash, thuhej se çështja e shpërnguljes “duhet rregulluar sa më parë përmes konventës speciale” midis Jugosllavisë dhe Turqisë, si dhe midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë, ashtu sikurse “kjo çështje është zgjidhur midis Turqisë dhe Rumanisë”. Në rast se me Shqipërinë – thuhej në vazhdim – nuk do të mund të arrihet marrëveshje për shpërnguljen e shqiptarëve në Shqipëri, ose nëse shqiptarët nuk dëshirojnë të shpërngulen në Turqi, menjëherë duhet shkuar në dispozitat ligjore ekzistuese për shpërnguljen e këtij elementi nga zonat kufitare në brendi të vendit dhe popullzimin e zonave të njëjta me popullsi të kombësisë jugosllave....”³⁴. Projekti, për të gjithë ata persona që “shprehnin dëshirën për shpërngulje”, përkatësisht jepnin deklaratë se tërhiqeshin nga shtetësia jugosllave, parashikonte t’u ofrohen këto lehtësime: “a/ t’u jepet falas pasaporta e shpërnguljes, sipas rrethanave të kolektivit; b/ të lirohen nga të gjitha tatimet e vjetruara /tatim i tokës, nëntatimet, ushtarët etj/; c/ në rast se persona të cilët shpërngulen, kanë borxhe kreditore ose borxhe private /kambialet, obligime dhe shkresa të ngjashme/, ta kryejnë deri më 1 shtator të vitit 1936, që i kanë me huadhënësit /shpenzuesit/ të paguhet nga vlера e llogaritur nga pasuria e tyre e patundshme; ç/ t’u jepet transport falas deri në

³³ Архив Југославије (në vazhdim AJ) 370-9 – 630.

³⁴ 370-9-642-643.

Selanik dhe, nëse deklarojnë se tërë pasurinë e tyre të patundshme ia lënë shtetit. Njëloj kjo u përket edhe të shpërngulurve me gjendje të varfër; d/ t'u jepet lirim prej 75% për transport hekurudhor personave të cilët janë të siguar materialisht ose të cilët pronën e tyre e kanë shitur më herët; dh/ të lirohen nga të gjitha të dhënat për bartjen e inventarit lëvizës dhe të hollave; e/ nga momenti i dhënies së deklarates për shpërngulje të lirohen nga rekrutimi, dërgimi në shërbim, kryerja e shërbimit, thirrja për stërvitje dhe marrja në institucion dhe mjeteve transportuese për shkak kryerjes së stërvitjes..."³⁵. Për një shpërngulje sa më e suksesshme e sa më të shpejtë të popullsisë jo-sllave, përkatësisht shqiptare e turke, projekti parashikonte edhe marrjen e masave të domosdoshme: "a/ me të gjitha mjetet të thuhet e të pamundësohet çfarëdolloj propagande e cila nga Shqipëria zhvillohet në mesin e mbarë elementeve kundër shpërnguljes; b/ nga popullsia jo-sllave të cilët vijnë parasysh për t'u shpërngulur, të kërkohet plotësimi i të gjitha ligjeve e dispozitave, e sidomos ndaj atyre që u përkasin pagesave fiskale /tatimet, nëntatimet, kambialet etj./; c/ në territorin e Serbisë jugore, sidomos në rrethet kufitare të ftohen sa më shpesh për stërvitje ushtarake të obliguarit e ushtrisë operative e rezervë me prejardhje jo-sllave, qoftë për stërvitje dhe manovra, qoftë për shkak ndërtimit të rrugëve strategjike ose objekteve fortifikuese; ç/ në parim të mos pranohen në shërbim shtetëror /ose vetëshërbim/ persona të cilët vijnë parasysh për shpërngulje, ndërsa ata të cilët tash më janë në shërbim shtetëror /vetëshërbim/, të sistemohen në krahinat ku jeton popullsia nacionale e jonë; d/ të zbatohet rreptësishtë parimi për shkollimin e obligueshëm të fëmijëve nga të gjitha trevat në shkollat fillore tona; dh/ të zbatohen rreptësishtë të gjitha dispozitat për popullzimin e krahinave jugore në pikëpamjen e organizimit të kompleksit të nevojshëm për popullzim, në radhë të parë në rrethet kufitare; e/ të filloj menjëherë emërtimi i objekteve gjeografike /vendbanimet, lumenjtë, malet etj./ dhe mbiemrat e njerëzve. Kjo u përket edhe mbishkrimeve

³⁵ Po aty.

publike, sipërmarrjeve, reklamave etj.; dhe, ë/ të gjitha masat e shtruara më lartë të implementohen para se gjithash dhe menjëherë duke filluar nga linja kufitare me Shqipërinë kah brendia e vendit”³⁶.

Për rrjedhojë, Ministria jugosllave e Punëve të Jashtme, më 11 dhjetor 1935, urdhëronte Legatën e saj në Ankara, që sa më shpejtë që është e mundur, të inicioj arritjen e një Konvente me Qeverinë e Republikës së Turqisë, për “shpërnguljen e popullsisë myslimane nga viset jugore për në Turqi”. Kjo çështje, thuhej në urdhëresë, “është e një rëndësie të shkallës së parë për vendin tonë”, prandaj kësaj “t’i kushtoni vëmendje sa më të madhe”, dhe të bëni çmos që “me Qeverinë turke të arrihet sa më parë marrëveshja e propozuar...”³⁷. Burimet diplomatike jugosllave nxjerrin në pah se përkundër përpjekjeve të shumta nga Beogradi zyrtar për ta bindur Ankarën të nënshkruaj sa më parë një Konventë të tillë edhe me Jugosllavinë, kjo çështje për Qeverinë turke nuk ishte me prioritet, për arsye se, sipas tyre, numri i popullsisë turke në këtë shtet arrinte shifrën prej rreth 50.000 banorëve, që për dallim nga shtetet tjera ballkanike, si p.sh. në Bullgari, numri i të cilëve ishte 400.000, Greqi 300.000 dhe Rumani 450.000, përbënte një pakicë e parëndësishme³⁸. Këto të dhëna, edhe pse ishin reale, binin ndesh me planet dhe projektet serbo-madhe, të cilat parashikonin të shpërngulnin rreth 750.000 myslimanë (550.000 i konsideronin shqiptarë dhe 200.000 turq)³⁹ nga tokat shqiptare të cilat gjatë vitit 1913 iu aneksuan Serbisë. “Për ne është shumë me rëndësi – i shkruante më 18 tetor 1935 Stojadinoviq përfaqësuesit diplomatik jugosllav në Ankara – që Ligji turk për kolonizim, parasheh emigrimin në Turqi jo vetëm të turqve, por edhe popullsisë të kulturës turke”, për arsye se, siç do të shprehet, “në këtë mënyrë për ne ekziston mundësia, që krahas turqve, të cilët do t’i shpërngulim nga

³⁶ Po aty.

³⁷ AJ, 370-9-662.

³⁸ AJ, 370-9-632.

³⁹ Po aty, 630-631.

vendi ynë për në Turqi, të fusim edhe një numër më të madh të shqiptarëve”⁴⁰.

Për mosgatishmërinë e Ankarasë rreth arritjes së Konventës me Beogradin, jugosllavët fajësonin parinë e atëhershme shqiptare në krye me Ferhat Dragën, si dhe aktivitetin e shtuar propagandistik të konsullit të Përgjithshëm shqiptar në Shkup, Sheremet Xhuxhuli. I deleguari jugosllav në Tiranë, J. Gjonoviq, më 13 nëntor 1935 njoftonte MPJ-së, se nga biseda e zhvilluar me të deleguarin turk, Jakup Kadri, është informuar se “Shqipëria për përfaqësues të vetin diplomatik në Ankara, e dërgon konsullin e tyre të Përgjithshëm në Shkup, z. Xhuxhulin”, i cili njihet si përkrahës i fuqishëm “i popullsisë sonë myslimane të Jugut”, dhe se “mesiguri se edhe atje do të veprojë që Turqia të mos i pranojë të gjithë këta njerëz...”⁴¹. Dy ditë më vonë, Legata jugosllave në Vjenë, informonte MPJ-në, për një letër të Mbretit Zog, dërguar kryetarit të Republikës së Turqisë, Qemal Atatürkut: “Nga një burim i besueshëm – thuhej në shkresë – njoftohemi se para pak kohësh Zogu personalisht i ka dërguar një letër Qemalit, duke e lutur t’i kthejë në Shqipëri të gjithë shqiptarët, të cilët janë shpërngulur nga Kosova e Maqedonia”. Kërkesa e mësipërme e Mbretit Zog, thuhej në vazhdim të shkresës, “për ne është shumë me rëndësi, sepse si duket, Mbreti Zog, çështjes së pakicës shqiptare tek ne, i ka kushtuar vëmendje të posaçme. Mbreti Zog tash përpiqet dhe dëshiron që shqiptarët të cilët jetojnë në Kosovë e Maqedoni ta ruajnë gjuhën e tyre, të ngelin të vetëdijshëm për kombësinë e tyre, t’ua sigurojë ekzistencën nacionale, me atë që në rast të ndryshimit eventual historik të ngelin si shqiptarë të vetëdijshëm. Që kjo aspiratë të arrihej, Zogu do të përpiqet që te ne të ndërpritet Reforma agrare, të kthehet prona e konfiskuar dhe të hapen shkolla shqipe. Nëse jo shkollë, atëherë së paku nxënësve t’u ligjërohet nga një orë në ditë gjuha shqipe...”. Kjo dëshirë e Mbretit Zog, thuhej në fund të shkresës,

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ Po aty, 660.

“edhe pse mund të ngelet vetëm si dëshirë”, mirëpo ekziston rrezi-ku, sepse nuk duhet harruar se “të gjithë shqiptarët në Kosovë janë kompaktë” dhe nëse një ditë do të shtrohej çështja e mësipërme, “do të jetë më e rrezikshme se problemi i Maqedonisë”⁴².

E një rëndësie të veçantë është për t’u theksuar fakti se, gjatë vitit 1935, diplomati i shquar shqiptar, Sheremet Xhuxhuli, së bashku me Rauf Fiçon, i cili asaj kohe përfaqësonte Legatën shqiptare në Beograd, themeluan organizatën studentore shqiptare “BESA”, në të cilën u përfshinë numri më i madh i studentëve shqiptar nga Universiteti i Beogradit dhe i Zagrebit, disa prej të cilëve më vonë luajtën rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin e çështjes kombëtare, si: Shuaip Kamberi, Ibrahim Lutfiu, Nexhmedin Besimi, Esad Doko, Shaip Mustafa, Sokol Dobroshi, Tahir Ismaili, Esad Berisha, Qazim Bllaca e shumë e shumë të tjerë. Kjo organizatë, së shpejti vendosi lidhje me krahun opozitar shqiptar të BFI-së.

Gjatë atij viti ndodhën trazira të shumta edhe brenda organeve të Mexhllisit të Ulemasë së Shkupit, të cilat erdhën si rrjedhojë e kërkesave të vazhdueshme të krahut opozitar shqiptar, që me këtë bashkësi të udhëheqin vendorët, përkatësisht shqiptarët, e jo klika serbomadhe e instaluar nga Bosnja e Hercegovina. Në anën tjetër, edhe shumica dërmuese e popullsisë boshnjake-myslimane ishte e pakënaqur me politikën e organeve të atëhershme supreme të BFI-së. Me insistimin e kryetarit të “Organizatës së Myslimanëve të Jugosllavisë”, Mehmet Spaho, Qeveria e Stojadinoviqit, pranoi të bëhen ndryshime radikale në organizimin e brendshëm të kësaj Bashkësie Fetare. Ndër pikat kryesore të marrëveshjes midis Spahos dhe Stojadinoviqit ishin: miratimi i Kushtetutës së re, kalimi i selisë së Reis-ul-Ulemasë nga Beogradi në Sarajevë, hapja e një medrese në Shkup (Medreseja Gazi Isa Beu) dhe organizimi i zgjedhjeve të lira⁴³.

⁴² Po ata, 657-658.

⁴³ Qerim Lita, Zgjedhjet e vitit 1937 konform Kushtetutës së BFI-së të vitit 1936 në Mexhllisin e Ulemasë së Shkupit, tryezë shkencore nga Bashkësia Fetare

Pas këtyre kërkesave qëndronte edhe opozita shqiptare e Mexhllisit të Ulemasë së Shkupit, e cila autorizoi Ferhat bej Dragën, që të mbajë kontakte me Spahon. Për rrjedhojë, më 25 mars të vitit 1936, organet supreme të BFI-së, sollën Kushtetutën e re e cila hyri në fuqi me 5 nëntor të atij viti, pasi u publikua në gazetën zyrtare⁴⁴.

Themelimi i organizatës studentore BESA si dhe ndryshimet brenda BFI-së, gjithsesi se sollën risi pozitive në skenën politike shqiptare. Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë Jugosllave i shkruante konsullit të përgjithshëm në Stamboll se shpërngulja e shqiptarëve në kohë të fundit po hasë në vështirësi të mëdha, për arsye se “ata (shqiptarët – Q. L) dëshirojnë të shpërngulen për në Shqipëri”, mirëpo Qeveria shqiptare, këtë shpërngulje është duke e penguar, duke i porositur përfaqësuesit e tyre diplomatik në Beograd e Shkup që të “mos lëshojnë viza” për popullsinë shqiptare⁴⁵. Vështirësi rreth shpërnguljes së popullsisë shqiptare, autoritetet serbo-madhe hasën edhe me Turqinë. Legata turke në Beograd, më 12 tetor të vitit 1935, përmes një note njoftonte MPJ-ë jugosllave se “gjatë këtij viti, Turqia nuk do të pranojë më emigrantë, pasi janë shterur të gjitha kreditë për vendosjen e tyre”. Ky vendim i Ankarasë, shkaktoi huti te jugosllavët, të cilët tashmë kishin filluar një fushatë të gjerë për pastrimin e fshatrave të tëra shqiptare. Sa për ilustrim, po i referohemi shkresës së MPJ-së jugosllave me nr. 24350/IV, dërguar Legatës së saj në Ankara, përmbajtja e së cilës është me sa vijon: “Popullsia myslimane e fshatrave Drenogllavë dhe Kërbliq, rrethi i Gjilanit, Banovina e Vardarit, ka vendosur të shpërngulet nga Mbretëria jonë për në Turqi. Një pjesë më e madhe tashmë është shpërngul, ndërsa pjesa tjetër më e vogël, rreth 110 persona, është vonuar për shkak të pengesave rreth shitjes së pronës dhe rregullimit të sendeve tjera. Për çdo rast, Konsullata

Islame në RM “80 vjet të Kushtetutshmërisë së BFI-së”, Riaseti i BFI-së, Shkup 2017, fq. 15-28.

⁴⁴ ДАПМ. 1. 613. 1. 1/1-55; Qerim Lita, po aty.

⁴⁵ AJ. 370-9-590.

turke në Shkup atyre u pat premtuar t'u jep viza për t'u shpërngulur në Turqi, prandaj ata, duke u bazuar në këtë, i rregulluan sendet e tyre dhe u përgatitën për në rrugë. Mirëpo, më 19 tetor 1935, Legata turke në Beograd, në mënyrë plotësuese njoftoi Ministrinë, se qeveritarët turk nuk janë më në gjendje t'i pranojnë as ata 110 persona nga Drenogllava dhe Kërbliqi dhe se Konsullatës së Shkupit i është lëshuar urdhëresë plotësuese që të mos lëshojë viza...⁴⁶.

Më 19 nëntor 1935, ministri për Punë të Brendshme i R. Turqisë, Shukri Kaja, para deputetëve të Kuvendit Popullor të Turqisë, paraqiti Propozim–ligjin plotësues për kolonizim. Në ekspozenë e tij të gjatë, ndër të tjera, vuri në dukje se ligji ishte i ndarë në dy pjesë, përkatësisht në atë “politike dhe kulturore”, për arsye se për “të parën duhet të themelohet resor i veçantë”, ndërsa pjesa e dytë “do t'i besohet Ministrisë së Shëndetësisë”. Përveç kësaj, ai u shpreh se parashikohet “themelimi i një institucioni autonom”, i cili do të merret me emigrantët dhe i cili do të ketë buxhet të veçantë. Më tej ministri theksoi se numri i përgjithshëm i refugjatëve të vendosur në Turqi arrinte shifrën prej rreth 600.000 banorëve, prej të cilëve “mbi 400.000 janë ata të cilët kanë ardhur përmes shkëmbimit të popullsisë, ndërsa pjesa të tjetër ka ardhur me vetëdëshirë...”⁴⁷. Nëse këto të dhëna janë të sakta dhe nëse kësaj i shtohet se Turqia deri në atë periudhë kohore kishte arritur marrëveshje për shkëmbim të popullatës me Greqinë dhe Rumaninë, atëherë mund të arrijmë deri te konkluzioni se autoritetet jugosllave, midis harkut kohor 1918–1935, kishin arritur të shpërngulin rreth 200.000 banorë myslimanë (shqiptarë, turq e boshnjak) për në Republikën e Turqisë.

Ky numër nuk i kënaqte apetitet serbomadhe, prandaj ata bënin çmos që sa më parë të arrijnë marrëveshje me qeverinë turke, që këta të fundit, si duket, këtë çështje nuk e kishin në plan të parë. Kjo u pa kur në pranverë të vitit 1936, u përhap lajmi për arritjen e

⁴⁶ Po aty, 627-628.

⁴⁷ Po aty, 629.

një marrëveshjeje midis Turqisë dhe Bullgarisë, sipas së cilës autoritetet turke kishin rënë dakord që brenda atij viti të pranonin 10.000 banorë turq nga Bullgaria. Ky lajm shqetësoi tej mase kryeministrin jugosllav, Stojadinoviq, i cili më 24 prill 1936 përmes një letre të shifruar, kërkonte nga i deleguari i tij në Stamboll, të merr informata të detajuara përse Qeveria turke “për çështjen e njëjtë, vetëm me ne e shtynë arritjen e marrëveshjes”. “Po ua përkujtoj – thuhej në vazhdim të letrës – se i deleguari turk i këtushëm ka premtuar se kjo çështje do të rregullohet menjëherë pas një qershori. Ruzhdi Arasit t’ia shprehni qëndrimin tonë skajshmërisht miqësor ndaj Turqisë për të gjitha çështjet, ndërsa kjo nuk shprehet nga ana e Turqisë ndaj nesh...” Stojadinoviq, nga i deleguari kërkonte që kësaj çështjeje t’i kushtojë vëmendjen më të madhe të mundshme, për arsye se, siç do të shprehet, “aksioni italian përmes Shqipërisë, na imponon të shpërngulim numër sa më të madh të popullsisë myslimane nga Jugu...”⁴⁸.

Presioni i vazhdueshëm i diplomacisë jugosllave, si duket ishte shkak kryesor që Qeveria turke të shpall fillimin e negociatave me Beogradin . Kjo informatë doli nga MPJ–ë jugosllave, e cila më 22 maj të vitit 1936, Legatës së saj në Stamboll i shkruante: “Ministria për Punë të Jashtme ka nderin t’ju njoftojë se ndihmës ministri turk për Punë të Jashtme z. Numan, me rastin e qëndrimit të paradokohshëm të tij në Beograd, e autorizoi të deleguarin e këtushëm turk se mund t’i fillojë negociatat me ne për arritjen e marrëveshjes për shpërnguljen e popullsisë myslimane nga viset tona jugore. Mbi bazën e kësaj, nga ana jonë, të deleguarit të këtushëm turk, z. Hajdar, i janë dorëzuar edhe propozimet formale se në cilat baza të arrihet kjo marrëveshje...”⁴⁹.

Mirëpo, siç do të shohim në vazhdim, çështjet nuk rrodhën ashtu siç dëshironin qarqet e atëhershme qeveritare serbomadhe, të cilët fajësonin të deleguarin turk në Beograd, z. Hajdar, i cili, siç bëhej

⁴⁸ Po aty, 679.

⁴⁹ Po aty, 694.

me dije, “nën ndikimin e disa qarqeve të këtushme”, po e zvarrit fillimin e negociatave⁵⁰. Lidhur me këtë, kryeministri jugosllav, Stojadinović, më 21 shtator 1936, urdhëronte Legatën në Stamboll që përmes telegramit të njoftohet se “si qëndron çështja e arritjes së konventës për shpërnguljen” dhe përse “Qeveria turke po e zvarritë atë përkundër premtimit të cilën na e ka dhënë”⁵¹. Të njëjtën ditë, Legata jugosllave në Ankara, me telegramin nr. 26769, njoftonte Stojadinovićin me sa vijon: “z. Hajdar Qeverisë turke ia ka dorëzuar propozimin tonë për shpërnguljen e myslimanëve nga Jugu. I është thënë se për shkak të mungesës së kredive, arritja e Konventës duhet të shtyhet për një kohë tjetër. Qeveria turke këtë vit nuk mund të pranojë as numrin minimal e të shpërngulurve dhe prandaj e ka urdhëruar të deleguarin e tij që të mos lëshoj viza”⁵². Po kjo legatë, më 28 dhjetor të atij viti, njoftonte MPJ-në se kohëve të fundit, një numër i madh i familjeve të shpërngulur në Turqi, përmes parashtrësive, kërkojnë që Legata në fjalë t’ua mundësojë kthimin e tyre në vendlindje. “Thuajse për çdo ditë – thuhej në njoftim – vijnë të shpërngulurit dhe lusin për kthim... Legata mbretërore edhe këtyre të shpërngulurve ua ka bërë me dije se nuk munden më të kthehen në Jugosllavi”⁵³.

Pas përpjekjeve thuajse dyvjeçare, autoritetet jugosllave, duke e shfrytëzuar Konferencën e Marrëveshjes Ballkanike, punimet e së cilës u mbajtën gjatë muajit shkurt 1938 në Stamboll, arritën ta bindin Qeverinë turke për fillimin e negociatave rreth Konventës. Për rrjedhojë, më 9 qershor të vitit 1938 në Stamboll filluan punimet e Konferencës së “Komisionit turko-jugosllav për shpërngulje”, që zgjati më shumë se një muaj, përkatesisht deri më 11 korrik 1938, kur dy palët negociuese paraqitën tekstin përfundimtar të Konventës. Teksti i saj ishte në gjuhën frënge, ndërsa pikat më të rëndësishme të saj ishin:

⁵⁰ Po aty, 698.

⁵¹ Po aty, 709.

⁵² Po aty, 710.

⁵³ Po aty, 717.

“1. Nga Jugosllavia për në Turqi do të shpërngulen 40.000 familje myslimane /nga Serbia Jugore, përkatësisht nga territori i cili pas luftërave të viteve 1912–1913 i ka takuar Serbisë dhe Malit të Zi/;

2. Shpërngulja do të kryhet gjatë gjashtë viteve të ardhshme (1939–1944), me atë që mund të vazhdohet edhe për një vit jashtë atij afati;

3. Jugosllavia për çdo familje të shpërngulur Turqisë do t'i paguaj nga 500 lira turke, prej tyre 30% në deviza, ndërsa pjesa tjetër prej 70% do të deponohet në dinarë te Banka Popullore në llogari të Qeverisë turke. Nga kjo shumë e parasë së deponuar, Qeveria turke mund të blejë pajisje në Jugosllavi;

4. Pagesa e mësipërme do të kryhet dy herë në vjet, muajin prill dhe tetor;

5. Kjo konventë i përket vetëm popullsisë fshatare, këtu shteti jugosllav shpërnguljen mund ta kryej me detyrim, pa marrë parasysh dëshirën e popullsisë. Për popullsinë qytetare shpërngulja është fakultative, përkatësisht nëse këtë e dëshiron popullsia myslimane e qyteteve;

6. Konventa është përpiluar në mënyrë që mund të zbatohet jo vetëm për turqit, por edhe për popullsinë shqiptare; shpërngulja e shqiptarëve përbën pjesën e kuptimit të fshehtë të saj;

7. Pronësia e patundshme e popullsisë fshatare të shpërngulur kalon në pronësi të shtetit jugosllav. Përveç pagesës prej 500 lirave shtetit turk, shteti jugosllav të shpërngulurve nuk do t'u paguajë asgjë për pronësinë e tyre bujqësore /arat, kullotat, shtëpitë etj./;

8. Të shpërngulurit kanë të drejtë me vete të bartin edhe një pjesë të mallit të tyre; transportin hekurudhor deri në Selanik e siguron Qeveria jugosllave, më tej Qeveria turke;

9. Konventa në këtë mënyrë e bënë radhitjen e shpërnguljes dhe të pagesës:

<i>Viti</i>	<i>numri i familjeve</i>	<i>pagesa në lira turke</i>
1939	4.000	2.000.000
1940	6.000	3.000.000
1941	7.000	3.500.000
1942	7.000	3.500.000
1943	8.000	4.000.000
1944	8.000	4.000.000

Legalizimi dhe ratifikimi i Konventës: Konventa fillimisht duhet të nënshkruhet, për arsye se e njëjta vetëm është parafuar. Konventa duhet të legalizohet dhe ratifikohet. Nuk rekomandohet procedurë e rregullt për legalizim për shkaqe politike të brendshme e të jashtme. Më mirë do të ishte Konventa të jetësohet përmes rregullores, ndërsa më pas të legalizohet përmes ligjit të ardhshëm financiar”⁵⁴.

Gjatë periudhës përderisa zhvilloheshin negociatat, Ferhat bej Draga dhe bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë, zhvilluan një aktivitet të gjerë politik e diplomatik. Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë jugosllave, më 5 gusht të vitit 1938, përmes një shkrese, njoftonte Legatën e vet në Ankara, se para pak kohësh, një delegacion shqiptar, i udhëhequr nga Ferhat bej Draga dhe Maliq Pehlivani, ka udhëtuar për në Stamboll. “Nga të dhënat e marra – thuhej në njoftim – si duket të gjithë ata kanë udhëtuar për në Turqi për të vepruar te Qeveria turke, me qëllim që mos të nënshkruhet Konventa rreth shpërnguljes së myslimanëve nga viset tona jugore ose së paku në të, të mos përfshihen shqiptarët të cilët jetojnë në mbretërinë tonë. Si duket ata, deputetëve të Parlamentit turk u kanë dorëzuar një memorandum, me të cilin i kanë paraqitur pikëpamjet e veta për atë çështje....”⁵⁵. Tre ditë më vonë,

⁵⁴ Po aty, 921-922.

⁵⁵ Po aty, 212.

përkatësisht më 8 gusht, MPJ–jugosllave Legatës në Ankara ia përcolli një letër, që deputeti turk Sabri Beu nga Stambolli, ia kishte dërguar një mikut të tij në Beograd, ku veç tjerash në të shkruante: “...Nga Jugosllavia kanë arritur protesta të shumta. Njerëz të caktuar, të cilët kanë ardhur këtu, posa kanë arritur janë parë me ministrat e këtushëm, ndërsa në mënyrë të veçantë kanë dorëzuar një promemorie të gjatë, në të cilën thonë se në Kosovë dhe në rrethinën e saj, edhe pse zyrtarisht ende nuk është themeluar këshilli për shpërngulje, organet e pushtetit kryejnë terror të madh dhe se ka pasur raste që njerëzit janë maltretuar. Qeveria (mendohet për atë turke – Q. L.) këto ankesa do t’i merr parasysh. Parashtresa të ngjashme u janë dorëzuar edhe anëtarëve të Kuvendit të Lartë Kombëtar...”⁵⁶. Po kjo ministri, më 19 shtator 1938, njoftonte se Qeveria e Mbretërisë shqiptare, kishte vendosur që brenda disa ditëve ta dërgojë Mehmet bej Konicën për në Ankara, me qëllim të ndërmarrjes së “një aksioni të Qeveria turke kundër shpërnguljes së shqiptarëve nga Jugosllavia për në Turqi”⁵⁷.

Ndërkohë, i deleguari bullgar në Tiranë, Peev, më 14 tetor të vitit 1938, i raportonte Sofjes për një takim të tij me ministrin e Punëve të Brendshme të Turqisë. Gjatë bisedës së zhvilluar, ministri turk ia kishte përcjell shqetësimet e Ankarasë rreth akuzave të Tiranës zyrtare “kundër Qeverisë turke sa i përket çështjes për arritjen e Konventës turko–jugosllave për shpërnguljen e 250.000 myslimanëve nga Jugosllavia për në Turqi...”. Kjo marrëveshje, thuhej më tej në raport, “nuk niset nga një bazë solide, sepse Turqia nuk ka kërkuar nga ajo konventë ta keqpërdorë elementin shqiptar në Jugosllavi, por ka zbatuar politikë në grumbullimin e popullsisë së vet – turke, sepse konsiderohej se në Jugosllavi së paku ka 150.000 /në vend të maksimumit 50.000, siç dëshmojnë faktorët relevant shqiptar/, dhe nëse ato parashikime tregohen si të pabaza, nuk përputhen me realitetin, nuk do të pranohen 250.000 vetë, por

⁵⁶ AJ. 370-9-813-814.

⁵⁷ Po aty, 370-9-831.

më pak. Në vazhdim, Peev shkruante për pakënaqësinë e Ankarasë rreth alarmit në Tiranë, “i cili alarm dhe pakënaqësi e ka tejkaluar edhe mirësinë turke, në radhë të parë nga personalitete gjysmë-përgjegjëse shqiptare”, të cilët për të njëjtën çështje “kanë prezantuar memoare dhe kanë vënë në pah ndërkëmbëza dhe akuza kundër Turqisë, që e ka dëshpëruar Ankaranë...”. Lidhur me udhëtimin e Mehmet Konicës për në Ankara, Peevi shkruante se bashkëbiseduesi i tij ishte i bindur “për një pritje të mirë të Konicës”, mirëpo me siguri se “personalisht ai, do të përmbahet nga përpjekjet publike kundër konventës së njëjtë turko-jugosllave”. Në fund të raportit Peevi informonte edhe për takimin e një dite më parë të tij “me deputetë të shquar shqiptarë”, të cilët e kishin informuar se për marrëveshjen e njëjtë “disa deputet kosovarë /për shembull Jashar Erebara/ kanë për qëllim të diskutojnë në komisionet përkatëse parlamentare ose të bëjnë interpelancë rreth këtij rreziku për elementin shqiptar në Jugosllavi...”⁵⁸.

Fushëveprimi i parisë shqiptare, krahas atij diplomatik, u përqendrua edhe në aktivitetin e brendshëm, i cili zhvillohej përmes mbledhjeve dhe tubimeve të ndryshme të organizuara anembanë trevave shqiptare nën pushtimin jugosllav. Tema boshte e këtyre takimeve, siç bënin të ditur raportet ushtarake e policore jugosllave, ishte ndërprerja e shpërnguljes së popullsisë shqiptare nga vatrata e tyre. Armata e III në Shkup, në janar të vitit 1938, i raportonte Komandës së Shtatmadhorisë në Beograd, për një propagandë të fuqishme që po zhvillohej në Dibër të Madhe kundër shpërnguljes. “Shqiptarët nga Dibra të cilët kanë farefis në Shqipëri – thuhej në raport – kanë marrë nga ata letra nëpërmjet të cilave i këshillojnë që bagëtinë dhe pronat në asnjë mënyrë të mos i shesin dhe të mos shpërngulen për Turqi ose Shqipëri, sepse patjetër duhet të ngelin në qytet që të gjithë, ashtu që për ta parë faktori ndërkombëtar se ato vise janë të banuara kryesisht me shqiptarë, ndërsa në Shqipëri për këtë çështje punohet me një intensitet të lartë dhe se ekziston

⁵⁸ ДАРМ. 1. 1313 (1178), Бугарско трговско агенство во Тирана 1928-1938.

shpresa e arsyeshme se për këtë do të ketë sukses”⁵⁹. Në referatin e hartuar në qershor të vitit 1938 nga Departamenti Informativ pranë Shtabit të Përgjithshëm në Beograd, kushtuar aktivitetit të Komitetit të Kosovës, thuhej se anëtarët e dikurshëm të këtij komiteti: Maxhun Limani nga Krasniqja, Sali Mani nga Malësia e Gjakovës dhe Mehmet Alia nga fshati Vllahnje, në kohët e fundit kanë mbajtur disa mbledhje, në të cilat “i kanë bindur rrethet e veta, se së shpejti viset në Kosovë, me ndihmën e Fuqive të Mëdha, do të bashkohen me Shqipërinë”. Në qoftë se Fuqitë e Mëdha – vazhdonte referati, “nuk do të arrijnë ta bindin Jugosllavinë që këto vise t’i jepen Shqipërisë, do të mbahet plebishit ku kërkesa e popullit do të realizohet në ngjyrën e saj të vërtetë...”⁶⁰.

Lidhur me aktivitetet e bujshme, që zhvilloheshin nga krerët e Komitetit për Mbrojtjen e Kosovës, të organizatës Besa, të Bashkësisë Islame dhe Kishës Katolike Shqiptare, gjatë vitit 1938 shërbimi sekret i Armatës jugosllave bënte të ditur se: “Në kohë të fundit po vërehet një lëvizje të shqiptarët për shkak të aktiviteteve të pushtetit në konfiskimin e tokës. Shqiptarët shkojnë në Shkup deri të konsulli shqiptar dhe kërkojnë nga ai mbrojtje, ndërsa katolikët ju drejtohen klerikëve të tyre. Në përgjithësi gjendja është e alarmuar.”⁶¹

Ndërkohë, komandanti i Armatës së III-të, Millan S. Jekmeniç nga Shkupi, e vinte në dijeni Shtabin e Përgjithshëm të Armatës, se Ferhat Draga kishte filluar një aksion në mbarë hapësirën shqiptare. Sipas vlerësimit të tij, nën ndikimin e aksionit të Ferhat bej Dragës dhe zhvillimeve politike ndërkombëtare, propaganda shqiptare në Jug asnjëherë nuk kishte qenë më e gjallë. Ai më tej e përshkruan gjendjen “jo të sigurt” të elementit serb në trojet e pushtuara shqiptare, për shkak, siç thuhej në dokument, se: “Në mesin e serbëve në Serbinë e Jugut përhapet informacioni se shqiptarët

⁵⁹ ДАРМ, Ф. ВИИ, М. 346, Пов. Ц. Об. Бр. 934/39. 28. I. 1938. год., Скопље.

⁶⁰ По ату, Пов. 1802/38.

⁶¹ ДАРМ. М. 346. Пов Ц, бр. 438, Beograd, 15 janar viti 1938.

përgatiteshin për kryengritje, të cilët do të kryenin një kasaphane të vërtetë mbi popullsinë serbe, veçanërisht mbi kolonët...”⁶².

Qeveria jugosllave e pakënaqur me dinamikën e shpërnguljes, në tetor të vitit 1938 kërkoi plotësimin e Konventës, t’i shtojë edhe shkëmbimi i popullsisë, përkatësisht dëbimi i 100.000 shqiptarëve e turqve për në Turqi dhe vendosjen e elementit ortodoksë nga Turqia në Jugosllavi. Mirëpo, këto shifra nuk i kënaqnin apetitet e pushtetarëve serbo-mëdhenj, sepse sipas tyre, dëbimi i 400.000 shqiptarëve nuk i plotësonte “interesat e tyre shtetërore e nacionale serbe”, e që ishte “dëbimi deri në shqiptarin e fundit” nga tokat e tyre etnike dhe kolonizimi i tyre me elemente serbe e malazeze. Nisur nga kjo, ata planifikonin që në pjesën e parë të vitit 1939, të nënshkruajnë një konventë të ngjashme sikurse me Republikën e Turqisë, edhe me Qeverinë Mbretërore të Shqipërisë, për shkëmbim të popullsisë, përkatësisht dëbimin e 100.000 shqiptarëve myslimanë në Shqipëri dhe sjelljen e 100.000 shqiptarëve krishterë në Jugosllavi, që ata i konsideronin për “serb”. Për realizimin e këtyre planeve antishqiptare, Qeveria jugosllave parashikonte themelimin e Inspektoratit Suprem, me qendër në Shkup dhe me dy qendra rajonale në Prishtinë e Pejë. Themelimi i këtij inspektorati u iniciua nga Ministria e Punëve të Brendshme, e cila në elaboratin me titull “Problemet dhe metodat e shpërnguljes së shqiptarëve dhe turqve nga Serbia e Jugut për në Turqi”, hartuar më 23 tetor 1938, ndër të tjera shkruante: “Që të mund të zbatohet me trazira sa më të vogla kjo punë e rëndë e delikate për interesin shtetëror e kombëtar, nevojitet sa më parë, që në muajin janar, të themelohet Inspektorati Suprem për shpërnguljen e shqiptarëve e turqve për në Azi, me qendër në Shkup, i cili do të ketë dy qendra të veta rajonale, në Prishtinë dhe Pejë”⁶³.

Është me interes të vihet në pah fakti se ndër metodat më të shpeshta që përdoreshin ndaj popullsisë shqiptare për t’i detyruar të

⁶² ДАРМ, по ату, Пов. Бр. 3530/38.

⁶³ ДАРМ. I. 613. I. 68/1243-1244.

lënë vatrat e tyre, ishte konfiskimi i tokave pjellore, duke u lënë atyre nga 0,40 hektarë për anëtarë familje, ndërsa pjesa tjetër u shpërndahej kolonëve serbë. Kjo shpërndarje sipas elaboratit të mësipërm bëhej si vijon: familjeve të nëpunësve u ndahej nga 5 hektarë; për çdo fëmijë mashkull deri më 16 vjet nga 1 hektarë; për çdo fëmijë mashkull mbi 16 vjet nga 2 hektarë; çdo mashkull mbi 20 vjet i pa martuar 3 hektarë, ndërsa i martuar 4 hektarë; luftëtarëve vullnetarë nga 5 hektarë, ndërsa jo vullnetarëve 3 hektarë. Përveç kësaj, u jepej edhe nga 2 hektarë për pyllëzim dhe sasi të konsiderueshëm të tokës jo kualitative, si dhe tërë inventari i nevojshëm për përpunimin e tokës⁶⁴.

Qëllimi i kësaj politike, siç theksohet në raportet e ndryshme të organeve policore dhe ushtarake serbe, ishte “dëshpërimi i banorëve shqiptarë”, sidomos i fshatarësisë “që shtriheshin buzë Malit Sharr, e deri në linjën Kumanovë – Prishtinë”, ku, sipas tyre, “fshatrat shqiptare janë tepër kompakte”⁶⁵. Pushtetarët e Beogradit shpresonin se nëpërmjet këtij presioni do të mund t’i detyrojnë shqiptarët t’i shesin pronat dhe shtëpitë e tyre, për t’u shpërngulur në Turqi apo Shqipëri. Parashikimet serbe nuk do të realizohen, sepse udhëheqja kombëtare e fetare shqiptare, në bashkëpunim me Konsullatën shqiptare në Shkup, morën një sërë aktivitetesh, kryesisht informative, në mbarë hapësirën shqiptare nën Jugosllavi, ku veç tjerash, apelonin te fshatarësia shqiptare, që të mos e shesin tokën e tyre, sepse, sipas tyre, pushtetarët: “mund t’u konfiskojnë gjithçka, por shtëpitë nuk mund t’ua marrin”, dhe se kjo politikë “është afatshkurtre dhe do të vijë dita kur Shqipëria do t’i çliroj të gjitha viset e robëruara shqiptare, edhe atë nga Shkupi e deri në Prishtinë.”⁶⁶. Kështu, sipas burimeve policore serbe: “Shqiptarët

⁶⁴ По ату.

⁶⁵ ДАРМ. Ф. МНРЈ, Д. Прилике у Јужној Србији, 1938 године.

⁶⁶ По-ату

janë tepër të dëgjueshëm ndaj kërkesave të parisë së tyre” dhe “ka rreth tre vjet që nuk shesin asnjë pëllëmbë tokë.”⁶⁷.

Veprimtaria atdhetare e Ferhat bej Dragës dhe bashkëveprimtarëve të tij, më së miri përshkruhet në Analizën me titull “Propaganda shqiptare”, hartuar më 12 mars të vitit 1939 nga kryeshefi i njësisë administrativ në Shkup, Nik Dimitrijeviq. Në të, ndër të tjera, thuhej se pas vrasjes së Hasan Prishtinës, irredentizmit shqiptar i prinë Ferhat bej Draga, veprimtaria e të cilit “zbatohet përmes rrugës konspirative”. Shenja të dukshme të veprimit të Dragës dhe miqve të tij, ishin “përpjekjet që shqiptarët të tubohen në radhët e ngushta, të zgjedhin njerëzit e tyre, të cilët do t’i përfaqësojnë në Kuvendin Kombëtar si dhe njerëzit e tyre në krye të administratave komunale”. Ndër bashkëpunëtorët më të ngushtë të tij ishin mësuesit e mësim-besimit fetar, hoxhallarët dhe zyrtarët e vakëfeve. Me qëllim “që kompaktësia të jetë sa më e madhe –thuhej më tej në analizë – ka ardhur edhe deri te pajtimi i gjaqeve e të kontesteve tjera nga ana e parisë shqiptare”. Aktiviteti politik i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare përfshinte dy pika më të rëndësishme:

1. Shpërndarja në popull e literaturës shqiptare, e cila depërtonte ilegalisht përmes kufirit; dhe,

2. Ndërprerja e tërësishme e shpërnguljes së shqiptarëve, qoftë për Turqi, qoftë për Shqipëri.

Sipas Dimitrijiviqit, ky aktivitet i parisë shqiptare, mësuesve fetarë si dhe të përfaqësive diplomatike shqiptare në Shkup, Manastir e Beograd, pati ndikim vendimtar që “lëvizja për shpërnguljen, e cila qe përfshirë te popullsia e jonë shqiptare deri në vitin 1936, sot të ngulfatet”, përkundër faktit se deri në atë periudhë kohore, fshatra të tëra ishin të gatshme t’i lëshojnë vatrat e tyre dhe t’i lënë pasurit e tyre pa asfare dëmshpërblimi “vetëm se shteti t’i lirojë nga tatimi i tokës, t’u jep pasaporta pa para dhe t’ua paguajë rrugën deri në kufirin tonë”. Nuk patën sukses “as masat e rrepta agrare, as

⁶⁷ Po-aty

konfiskimi i armatimit”, prandaj rruga e vetme që kjo çështje të fillojë nga pika fillestare është “shpërngulja përmes rrugës së caktuar diplomatike sipas Konventës së nënshkruar me Turqinë, edhe pse shqiptarët flasin publikisht se në asnjë mënyrë nuk do t’i lëshojnë vatrat e tyre...”⁶⁸.

Pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste (7 prill 1939), qeveritarët e Beogradit, duke e shfrytëzuar fatkeqësinë e shtetit shqiptar, ndërmorën masa edhe më radikale, me qëllim, siç theksonin: “që njëherë e përgjithmonë ta heqin nga rendi i ditës çështjen shqiptare..”. Në kuadër të këtyre planeve, Komanda e Shtatmadhorisë së Armatës hartoi një memorandum, në të cilin fillimisht përshkruhej disponimi i shqiptarëve nën sundimin jugosllav, pas pushtimit të Shqipërisë, ku, sipas tyre, gjithnjë e më tepër po e mbështesin politikën italiane. “Shqiptarët – thuhej në memorandum – janë të pakënaqur me gjendjen e tyre aktuale në Jugosllavi. Ky është një fakt të cilin nuk mund ta mbulojmë. Konfiskimin e tokës bujqësore shqiptarëve, si edhe të kuptuarit se ato në territorin tonë janë vërtetë elemente të padëshiruara, gjithsesi se ka ndikuar pozitivisht në zgjerimin e propagandës në favor të Italisë.” Kjo gjendje, sipas kësaj komande, mund të paralizohet në dy mënyra: “ose sa më parë t’i shpërngulim nga territoret tona, ose t’ua plotësojmë kërkesat e tyre në pikëpamje materiale dhe kulturore.” Lidhur me këto dy mënyra, në memorandum thuhej: “Është e qartë se kjo e fundit ndoshta vetëm përkohësisht do t’i kënaqte dhe që pastaj, në një kohë sa më të afërt dhe në një moment për ne shumë të pafavorshëm, përsëri të kërkojnë bashkimin me Shqipërinë. Për këtë arsye është nevojë e patjetërsueshme, që me shpërnguljen e shqiptarëve nga këto troje të filloj sa më parë. Kjo sa më parë, sepse në këtë moment shqiptarët janë të dezorientuar, ndërsa marrëdhëniet tona të politikës së jashtme përball shqiptarëve aq shumë kanë përparësi sa që mundemi të punojmë ashtu siç dëshirojmë ne”⁶⁹.

⁶⁸ ДАРМ, 885. Пов стр. пов. бр. 75/39.

⁶⁹ ДАРМ.Ф.ВИИ.М.344.Пов.Ц.ОБ.Бр..760, 1939 год., Скопље.

Planet e mësipërme të pushtuesit serb nuk do të realizohen, falë aktivitetit politiko–organizativ të parisë intelektuale dhe nacionale shqiptare, që njihet si grupi opozitar i “Bojali Hanit”, ku si udhëheqës shpirtëror i tyre qarqet qeveritare serbomadhe e kishin shpallur Ferhat bej Dragën. Në kuadër të këtyre aktiviteteve duhet përmendur takimin e Zenel Strazimirit, Shaban Efendiut dhe Iliaz Agushit me konsullin shqiptar në Shkup, Hamit Kokolarin, i cili u kishte garantuar atyre se Qeveria shqiptare nuk do të lejojë në asnjë mënyrë të bëhet depërtimi i dhunshëm i shqiptarëve nga këto treva. Rreth këtij takimi, shërbimet informative jugosllave nga Shkupi njoftonin: “Nga paria shqiptare me ndikim ndërmerren masa që shqiptarët në vendin tonë (Jugosllavi–Q.L..) të solidarizohen me gjendjen e re të krijuar në Shqipëri. Propagandohet se për shqiptarët tanë kanë ardhur ditë më të mira”⁷⁰. Gjithashtu, në informatë theksohej se: “Konsulli shqiptar në Shkup, gjatë ardhjes së trupave italiane në Shqipëri, ju ka thënë deputetëve të popullit, Zenel Strazimirit dhe Iliaz Agushit, se tash për shqiptarët në Jugosllavi do të jetë më lehtë.”⁷¹.

Po këto shërbime, vazhdimisht njoftonin për takime dhe mbledhje të shpeshta që organizoheshin nga Ferhat bej Draga me grupin e tij në mbarë territoret shqiptare, në të cilat temë debati ishin pengimi i shpërnguljes së dhunshme si dhe e ardhmja e çështjes shqiptare. Sipas njoftimit të shërbimit sekret të Armatës jugosllave, merret vesh të se: “më 4 gusht të vitit 1939 në Prizren kishin qëndruar deputetët shqiptarë: Kadri Saliu nga Gostivari, Ilaz Agushi nga rrethi i Nerodimes, Asim Murtezi Luzha nga rrethi i Drenicës, Mustafa Dërguti nga rrethi i Podrimës dhe Zenel bej Strazimiri nga rrethi i Kaçanikut⁷². Ky delegacion shqiptar, përveç rrethit të Prizrenit, “vizitoi edhe shumicën e rretheve tjera në Kosovë”, gjë që kjo te kreu më i lartë i Armatës jugosllave krijoi përshtypja se këto vizita kanë “prapavijë politike”, aq më tepër që sipas burimeve të tyre:

⁷⁰ ДАРМ.Ф.ВИИ.М.344.Пов.Бр.4603/39 –Скопље.

⁷¹ Po-aty

⁷² ДАРМ.Ф.ВИИ.М.346.Пов.Ц.ОБ.Бр.11570/1939 –Београд.

“se nga muaji qershor të këtij viti, në mesin e shqiptarëve tanë vërehet një gjallërim dhe takime të shpeshta të parisë së tyre. Të gjitha këto takime mbahen gjithmonë në mbërme dhe vetëm nëpër fshatra”⁷³, theksohet në fillim të këtij njoftimi, për të shtuar: “Agjentët e Italisë, nëpërmjet lidhjeve të tyre në Shkup, ju kanë parashtruar parisë shqiptare pyetjen: a dëshirojnë ata që Italia, me kërkesën e tyre, në një moment të përshtatshëm dhe në një afat sa më të shkurtë të filloj veprimin, që këto vise t’u bashkëngjiten Shqipërisë.” “Shqiptarët – vazhdon informata – nuk kanë dhënë përgjigje, por menjëherë fillojnë konsultimet dhe studimin e mendimeve të personaliteteve të shquara shqiptare.”. Në kuadër të kësaj, gjithnjë sipas këtyre burimeve, Ferhat bej Draga menjëherë kishte udhëtuar për në Stamboll, me ç’rast është takuar edhe me Mbretin Zog, ndërsa nëpërmjet “disa turqve më me ndikim ka arritur të lidhet edhe me disa personalitete të afërta me Qeverinë turke”. Ferhat Draga gjatë bisedës “i paska premtuar Mbretit Zog, se ai dhe shqiptarët në Kosovë do të ngelin edhe më tutje besnik ndaj tij dhe se do t’i refuzojnë propozimet italiane. Por, për këtë Mbreti Zog duhet të veprojë te Qeveria turke, që të prishet Konventa e nënshkruar ndërmjet Jugosllavisë dhe Turqisë, lidhur me çështjen e shpërnguljes së shqiptarëve nga Jugosllavia.”⁷⁴. Veç kësaj, dy bashkëbiseduesit kanë rënë në ujdë që: “Mbreti Zog të veprojë me Qeverinë turke dhe demokracisë përëndimore për rikthimin e tij në Shqipëri, që pas kësaj nga ana e shqiptarëve të Jugosllavisë do të iniciohet bashkimi me Shqipërinë”. Në fund të këtij njoftimi thuhet se: “vizita e fundit në Kosovë nga ana e deputetëve shqiptarë ka qenë gjoja për qëllim që sa i përket çështjes së bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, e iniciuar nga Italia, tash për tash t’i jepet përgjigje negative...”⁷⁵.

Rreth qëndrimit të deputetëve shqiptarë në Kosovë, njoftonte edhe shërbimi sekret i Ministrisë së Punëve të Brendshme, sipas së cilit:

⁷³ Po-aty

⁷⁴ Po-aty

⁷⁵ Po-aty

“më 5 gusht 1939, për Gjakovë kanë udhëtuar deputetët e popullit: Asim Luzha nga Drenica, Adem Marmullaku nga Istogu dhe Zenel Strazimiri nga Kaçaniku”. Këta në Gjakovë paskan pasur takim me kryetarin e Komunës Sulejman Kryeziun dhe me anëtarin e Këshillit ekzekutiv të Gjakovës, Ramiz Rizën. Qëllimi i vizitës kishte qenë: “ngritja e vetëdijes kombëtare te elementi mysliman dhe grumbullimi i të dhënave për çështjen agrare”. Deputetët para miqve të tyre kanë deklaruar: “se ata do të kërkojnë te pushtetarët, që të gjithë shqiptarët që ju është marrë toka të dëmshpërblehen në para.”⁷⁶. Po ky shërbim njoftonte për një mbledhje të krerëve udhëheqës shqiptarë, mbajtur në pjesën e parë të shtatorit, ku kishte marrë pjesë edhe Ferhat Draga. Në fjalimin e mbajtur, Draga paska deklaruar se: “Shqipërisë do t’i bashkëngjiten të gjitha krahinat shqiptare deri në Nish.”⁷⁷. Ndërkohë, Ministria për Punë të Brendshme, përmes shkresës me nr. 13228, njoftonte se kryetari i Mexhlisit të Ulemasë në Shkup, Sherif Osmani (Langu) “para një kohe qëndroi në Manastir” me ç’rast “ka agjiturar në mesin e popullsisë shqiptare të mos shpërngulen për në Turqi...”⁷⁸.

Gjatë kësaj periudhe kohore, strukturat policore e ushtarake jugosllave nga Shkupi, pandërprerë njoftonin për aktivitete të bujshme të krerëve shqiptarë në Kosovë e në viset tjera shqiptare nën Jugosllavi, të cilat si synim primar kishin ndërprerjen e tërësishme të shpërnguljes së popullsisë shqiptare nga vatrata e tyre për në Turqi. Në kuadër të kësaj, Komanda e Armatës së III në Shkup, njoftonte Shtabin e Përgjithshëm në Beograd, se paria shqiptare kohë të fundit po zhvillon një aktivitet të dendur në mesin e popullsisë shqiptare, duke bashkëbiseduar në lidhje me Konventën e arritur midis Jugosllavisë dhe Turqisë: “Nga ato biseda – vinte në dukje Komanda e Armatës së III – shihet se shqiptarët janë shumë të brengosur për shkak të Konventës për shpërnguljen në Turqi. Udhëheqësit e tyre, në krye me Ferhat bej Dragën, u sugjerojnë që

⁷⁶ ДАРМ.Ф.ВИИ.М.346, Пов.Бр.12851/39-Београд.

⁷⁷ ДАРМ.Ф.ВИИ.М.346.Пов.Бр.13501/39-Београд.

⁷⁸ По ату, Пов. Бр. 13228/39, Београд.

në asnjë mënyrë të mos i lëshojnë vatrat e tyre, sepse pushteti nuk ka rrugë dhe metodë që me forcë t'i shpërngulë....”⁷⁹. Më 2 shtator të vitit 1939, Shtabi i Përgjithshëm njoftonte Ministrinë e Ushtrisë, atë të Punëve të Jashtme, komandantin e Armatës së III dhe komandantin e trupave kufitare, për një raport që i kishte arritur nga ana e Ministrisë për Punë të Brendshme, në lidhje me aktivitetin politik e propagandistik që kohë të fundit po zhvillohej në Kosovë. Në të vihej në dukje se në ballë të atij aktiviteti qëndronte “Ferhat bej Draga, ish-deputet nga Mitrovica e Kosovës”, i cili, siç thuhej, “është udhëheqësi ideor i mbarë popullsisë nga këto vise”. Ai, theksohej në vazhdim të dokumentit, “para pak kohësh, i ka porositur miqtë e tij, se beson që Italia në një kohë sa më të shkurtër do t'i marrë këto vise, që deri atëherë shqiptarët duhet të kenë durim dhe të presin momentin e përshtatshëm për realizimin e qëllimeve të veta...”⁸⁰.

Gjatë muajve shtator–tetor 1939, një aktivitet të dendur pati edhe Mexhlisi i Ulemasë së Shkupit, ku një delegacion i lartë i udhëhequr nga Bedri Hamidi, vizitoi të gjitha qendrat më të rëndësishme që i përkisnin këtij mexhlisi, si: Prishtinën, Prizrenin, Gjilanin, Ferizajin, Pejën, Mitrovicën, Gjakovën, Preshevën, Kumanovën, Tetovën, Gostivarin, Dibrën, Kërçovën, Strugën, Ohrin, Manastirin, Ulqinin, Novi Pazarin etj., me ç’rast u mbajtën ligjërata me karakter fetar, kombëtar e politik nëpër xhamitë kryesore të këtyre qendrave. Nga tërë ky aktivitet, përmes një raporti të detajuar prej 59 faqesh, Mexhlisi i Ulemasë njoftonte udhëheqësin supreme të BFI–së në Sarajevë, Reis–ul–Ulemanë Fehim ef. Spahon, për gjendjen e mjerueshme të popullsisë shqiptare–myslimane, për shkak, siç vihej në pah, politikës diskriminuese të pushtetit serbomadh. “Reforma agrare – thuhej në raport – e cila përbënte shkakun kryesor për varfërimin e të gjitha shtresave myslimane dhe i detyronte për t’u shpërngulur, në

⁷⁹ Politika e Mbretërisë Jugosllave ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë 1929-1941..., dok. nr. 98, fq. 253.

⁸⁰ Po aty, dok. nr. 120, fq. 281-283.

përgjithësi pati pasoja shumë të rënda. Përveç asaj që pati një zgjidhje fatkeqe, zbatimi i saj ishte edhe më ogurzi, prandaj pjesa shumë e madhe e elementit mysliman thuajse u proletarizua, ndërsa shumë familje ranë në një varfëri të skajshme. Kjo erdhi për arsye se toka nuk u morr vetëm nga pronarët e mëdhenj, por edhe nga poseduesit e vegjël, që për ta përbënte pasurinë të vetme, ndërsa bujqësia, profesioni dhe burimi i vetëm për ekzistencë. Me një plan aq drastik shumë familje myslimane falimentuan ekonomikisht, kurse kjo shkaktoi pasoja të rënda edhe në sferat tjera të jetës, sepse pa mbështetje materiale nuk mund të ketë asfale përparimi. Për këtë arsye, te bota myslimane, edhe nëse do të kishte kuptim, vullnet e dëshirë për ngritje kulturore e arsimore, u mungonin mjetet materiale, prandaj kjo mund të konsiderohet si pengesa më kryesore....”⁸¹, thuhej ndër të tjera në raport.

Ishin pikërisht këto arsyt kryesore që Këshilli i Kuvendit Mearif të Vakëfit, rëndësi të madhe t’i kushtojë ndarjes së bursave si për nxënësit e shkollave të mesme, po ashtu edhe për studentët të cilët studionin në Universitetin e Beogradit e atë të Zagrebit. Këtë e shohim në buxhetet e viteve 1937/38, 1938/39 dhe 1939/40, ku një shumë e madhe ishte caktuar për këtë lëmi. Buxheti i vitit 1937/38 arrinte shifrën prej 11.385.500 dinarë, prej saj 650.000 ishin paraparë për bursa të studentëve⁸². Shuma e njëjtë ishte në buxhetin e vitit 1938/39, ndërsa në vitin 1939/40 kjo shumë u rritë në 800.000 dinarë⁸³. Nga kjo shumë përfituan bursa mbi 150 studentë shqiptarë, turq e boshnjak. Në mesin e bursistëve pati edhe disa personalitete të cilët kanë lënë gjurmë në historiografinë shqiptare: Esad Doko, Dr. Zyrap Sejfullau, akademik Esad Mekuli, Mexhid Esadi, Nexhmedin Besimi, Xhevdet Pallaska, Jahja Osmani, akademik Idriz Ajeti, Sokol Dobroshi, Tahir Ismaili,

⁸¹ Qerim Lita – Avni Halimi, Bedri Hamidi atdhetar dhe udhëheqës shpirtëror mysliman, Dosier, BFI, Shkup 2016, fq. 15-19.

⁸² ДАРМ. I. 616. I. 7/114-119.

⁸³ По аты, 8/122-129.

Ibrahim Lutfiu, Shaip Kamberi, Shaip Mustafa, Kurtesh Agushi, etj.⁸⁴.

Veprimtaria atdhetare e kreut të BFI-së në Shkup, e cila erdhi pas zgjedhjeve të mbajtura më 30 maj 1937, ku siç dihet fitoi krahu opozitar shqiptar me në krye Ferhat bej Dragën, i prishi të gjitha planet e projektet antishqiptare, të parapara nga ana e udhëheqjes së atëhershme jugosllave, në radhë të parë, atë të shpërnguljes. Në këto rrethana, Qeveria Cvetković-Maçek, urdhëroi ministrin e Drejtësisë, L. Marković, të ndërmerr masa ndëshkuese ndaj BFI-së në Shkup. Ky i fundit, me vendimin nr. 42554/40-IV, të nënshkruar më 17 maj 1940, suspendoi të gjitha organet e Bashkësisë Fetare Islame në territorin e Mexhllisit të Ulemasë në Shkup dhe në vend të organeve legjitime, emëroi një komisariat shtetëror, i përbërë prej tre vetash: Mehmet Zeki, Dervish Sheqerkadiq dhe Murat Sheqeragiq, që të tre, njerëz në të besueshëm të politikës serbomadhe. Një vendim i tillë, siç u mundua ta arsyetojë ministri, kishte ardhur për shkak se gjoja Ministrisë së Drejtësisë, i kishin arritur “ankesa nga një numër i konsiderueshëm i myslimanëve” nga territori i Mexhllisit të Ulemasë në Shkup, “nga të cilat vihet në dukje se në Bashkësinë Fetare Islame në atë territor që nga zgjedhjet e Kuvendit Mearif të Vakëfit në Shkup të kryera në vitin 1937, mbisundon një situatë e jashtëzakonshme....”⁸⁵.

Emërimin e komisariatit shtetëror, rëndësi të veçanti i kushtoi shtypi i atëhershëm ditor e periodik. Fletushka për gjoja “ngritjen” kulturore dhe ekonomike të myslimanëve, “Nash Dom”, redaktor i së cilës ishte përkrahësi i politikës serbomadhe, Zyfer Musiq, në numrin e jashtëzakonshëm të datës 21 maj 1940, në faqen e parë me shkronja të mëdha shkruante: “U vendos komisariati në Bashkësinë Fetare Islame në Jug”, ndërsa si nëntitull: “I erdhi fundi

⁸⁴ По ату, Спсак Стипентиста високошколаца за годину 1937/38; 1938/39; 1939/40.

⁸⁵ АЈ. Фонд 63, фасц. Бр. 135. Пов. бр. 42554/40-XIV, 17 маја 1940 год., Београд..

i arbitrarizmit dhe shkeljes së ligjit në Bashkësinë Fetare Islame”. Duke e përkrahur pa asnjë rezervë vendimin, në të thuhej: “Nuk mund të paramendohet, e ku më të përshkruhet, ajo veprimtari arbitrarë e joligjore, të cilin e ka zbatuar grupi i z. Ferhat Dragës në Bashkësinë Fetare Islame në Jug. Këtë më së miri e ka të qartë pasuria e Vakëfit, e cila është shpenzuar në mënyrë të paskrupullt. Ky grup i njerëzve kanë harruar se ajo është institucion i të gjithë myslimanëve, e jo vetëm i bejlerëve, të cilët përbëjnë lungun e rrezikshëm në trupin e myslimanëve mbarë, e me këtë edhe të botës punëtore shqiptare në vendin tonë....”⁸⁶.

Ndërkohë, Ferhat bej Draga më 20 qershor 1940, në cilësinë e kryetarit të Kuvendit Mearif të Vakëfit në Shkup, Këshillit Shtetëror në Beograd i dorëzoi një padi prej 17 faqesh kundër vendimit të lartpërmendur. Në vazhdim po e paraqesim një pjesë të asaj padie: “....Me këtë urdhëresë, si individualisht po ashtu edhe në tërësi, është shkelë hiç më pak se autonomia e Bashkësisë Fetare Islame, e garantuar me Ligjin për Bashkësinë Fetare Islame të Mbretërisë Jugosllave, ndërsa me ato masa arbitrarë është suspenduar thuajse flet për fletë Kushtetuta e Bashkësisë Fetare Islame....Bashkësia Fetare Islame administrohet sipas ligjeve dhe Kushtetutës së saj, të cilat, në këndvështrimin juridik, është identike, për shembull, me Ligjin për Kishën Ortodokse Serbe dhe me Kushtetutën e Kishës Ortodokse Serbe. Ligjvënësi është kujdesur me vëmendje, që gjatë përpilimit të Ligjit fetar të mos ketë as dyshimin më të vogël të diskriminimit apo padrejtësisë. Ja, për shembull, ne nuk mund ta paramendojmë që në Shtetin tonë mund të gjendet ndonjë ministër i drejtësisë, madje edhe nëse nuk do të ishte serb i besimit ortodoks, por jashtë atij besimi – të themi kroat, slloven ose, madje edhe shqiptar – i cili do të merrte guximin qoftë kjo edhe teorike për ta plotësuar qëllimin që autonomisë së Kishës Ortodokse Serbe t’ia hartojë kësulën në mënyrën, siç tash praktikisht vepron ministri i Drejtësisë ndaj autonomisë së Bashkë-

⁸⁶ Po aty, Наш Дом, Shkup, 21 maj viti 1940.

sisë Fetare Islame. Në atë rast mund të paramendohet se askush nuk mund t'iu shmangej pasojave të rënda, sepse ne ende e kemi të freskët furtunën e paradokohshme....Theksuam se vendimi i sjellë as që mund të kuptohet e ku më të vlerësohet mbi bazën e kriterit të drejtësisë. I njëjti vendim nuk përmban asfare arsytimi të dokumentuar, me çka do të mund të hulumtoheshin reagimet e arsyeshme, me të cilat zoti ministër i Drejtësisë mbështetet gjatë sjelljes së tij. Në atë hamendje do të ngeleshim edhe më tutje, po që se zoti Reis—ul—ulema në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit Mearif të Vakëfit në Sarajevë, të mbajtur më 14 qershor të vitit 1940 (sipas informatave të gazetës zagrebase “Obzor” nr. 138 nga 15 qershori 1940), duke protestuar për shkak të sjelljes së vendimit kundërligjor, veç tjerash, konstatoi: ‘Kur gjatë debatit me ministrin e Drejtësisë biseduam për këto çështje, ai më deklaroi se kjo nuk është çështje juridike, por politike’. Nëse ky konstatim është i këtillë (ndërsa nuk kemi arsye të dyshojmë në fjalët e zotëri Reis—ul—ulemasë), atëherë sjellja e zotit ministër të Drejtësisë mund të jetë e kuptueshme vetëm në disa këndvështrime të papërcaktuara dhe të pakuptueshme për ne, mirëpo me këtë ky veprim ende nuk është arsyetuar nga këndvështrimi i Ligjit, rregullimit juridik, sigurisë juridike e të moralit publik. Për këtë arsye lus Këshillin Shtetëror që ta miratojë këtë padi nga arsyet e lartpërmendura dhe ta hedhë poshtë në tërësi vendimin e zotit ministër të Drejtësisë të datës 17 maj të vitit 1940”⁸⁷.

Një ditë më pas, pasoi padia edhe e Mexhlisit të Ulemasë, drejtuar të njëjtit institucion, në të cilën veç tjerash thuhej: “...Duke e pasur parasysh se akti për suspendimin e Kuvendit Mearif të Vakëfit në Shkup ashiqare është JOLIGJOR, sepse zoti ministër i Drejtësisë kontrollin e nevojshëm ka mund ta kryejë paralelisht me ekzistimin e Kuvendit, meqenëse Reis—ul—ulemaja e Bashkësisë Fetare Islame

⁸⁷ По ату, Државном Савету Београд – Тужба Драга А. Ферхада из Скопља, као претседника Вакуфског-Меарифског Сабора у Скопљу против одлуке Министарства Правде од 17 маја 1940 год. Бр. 42554/40-XIV, Београд 20 қершор 1940.

nuk e pranon e as që do ta pranojë aktin për vendosjen e Komisarariatit Shtetëror në Drejtorinë e Vakëfit në Shkup, prandaj me të njëjtin nuk pranon bashkëpunim, meqenëse Mexhlisi i Ulemasë në frymën e Kushtetutës e të Ligjit për Bashkësinë Fetare Islame është i obliguar t'i përmbahet urdhëresave dhe instruksioneve të Reis-ul-ulemasë si udhëheqësin e tij suprem, prandaj Mexhlisi i Ulemasë nuk ka mundësi ligjore të veprojë sipas urdhëresës së z. ministër të Drejtësisë në vendimin e bashkangjitur, për çka pason padia jonë deri te Këshilli Shtetëror me lutje që ky vendim i z. ministër të Drejtësisë të hidhet poshtë si antiligjor.”⁸⁸.

Duke u munduar t'u kundërvihet dy padive të mësipërme, ish kryeshefi i Ministrisë së Drejtësisë – dhoma për fe në Shkup, Hasan Rebac, i shkruante Këshillit Shtetëror në Beograd, se udhëheqja e Bashkësisë Fetare Islame në Shkup, po zbaton një politikë “nacional-shoviniste”. Sipas tij, “Ferhat bej Draga, këtë e ka shtruar në mënyrë të qartë në mbledhjen e datës 19 prill 1939, duke i ndarë myslimanët e jugut në shqiptarë e joshqiptarë”. Në këtë frymë të re të imponuar, theksonte në vazhdim Rebac, “sikurse tërë kryesia, po ashtu edhe i tërë këshilli kuvendor dhe i tërë këshilli i kontrollit, i ashtuquajturi këshilli i punës përbëhen vetëm nga shqiptarët”, e nëse merret parasysh se edhe të gjithë anëtarët e Mexhllisit të Ulemasë janë shqiptarë, “atëherë mund të paramendohet se në çfarë gjendje nënçmuese janë myslimanët – joshqiptarë, përkatësisht, myslimanët-serb...”⁸⁹.

Për dallim nga Hasan Rebac, udhëheqësi suprem i BFI-së në Sarajevë, Reis-ul-ulemaja Fehim ef. Spaho, në mënyrë kategorike

⁸⁸ Po aty, Државном Савету Београд – Тужба Улема Меџлиса у Скопљу против Министарства Правде Бр. 45638 од 25 маја 1940 године, ПРЕДМЕТ: Решење Министарства Правде којим се наређује Улема Меџлису да сарацује са постављеним Комесаријатом у Вакуфској Дирекцији у Скопљу у вези са распуштањем Вакуфског-Меарифског Сабора при поменутој дирекцији, Shkup, 21 qershor 1940, Nr. 7160/40.

⁸⁹ Po aty, Државном Савету у Београд, Хасан Ребац, шлан Вакуфског-Меарифског Сабора у Скопљу и началник Министарства Правде у пензии.

e hodhi poshtë vendimin e ministrit, të cilin ai e quante antiligjor dhe arbitrar, duke kërkuar nga Mexhlisi i Ulemasë në Shkup, t'i ndërpret çdo lloj bashkëpunimi me Komisariatit Shtetëror. Këtë e shohim në urdhëresën me numër 98/40, të datës 21 gusht 1940, përmbajtja e së cilës është si vijon: “Me rastin e vendosjes së Komisariatit Shtetëror në Drejtorinë e Vakëfit në Shkup, aktin e ministrit të Drejtësisë numër 42554/40 nga data 17 maj 1940, me aktin e këtushëm Proc. nr. 67/40 nga 6 qershori k.v., ia kam bërë me dije Mexhlisit të Ulemasë t'i ndërpret të gjitha shkresat me këtë komisariat të vendosur në mënyrë loligjore, pasi ai, sipas Kushtetutës dhe Ligjit të BFI-së, nuk ka legjitimitet legal për ekzistimin e vet, prandaj tërë veprimtaria e tij nga pikëpamja e Kushtetutës dhe Ligjit të BFI-së është joligjor dhe pa bazë morale. Në lidhje me këtë, lutet Mexhlisi i Ulemasë, që përmes një qarkore t'ua bëj me dije të gjithë imamëve të rretheve e të xhematit, që edhe ata të mos mbajnë asfare korrespondence me këtë komisariat, sepse të gjitha vendimet e këtij trupi janë të pavlefshme juridikisht, ndërsa për të njëjtat duhet të prononcohet edhe Drejtoria e Vakëfit në Shkup”⁹⁰.

Në anën tjetër, Ferhat bej Draga, më 18 nëntor 1940, i dërgoi një letër nënkryetarit të Qeverisë së Mbretërisë jugosllave, Vlatko Mačekut, ku veç tjerash shkruante: “Meqenëse me vendimin e 17 majit të këtij viti të ministrit të Drejtësisë, në mënyrë joligjore e ka suspenduar Kushtetutën e Bashkësisë Fetare Islame në territorin e Mexhlisit të Ulemasë në Shkup, dhe në mënyrë arbitrare ka emëruar komisariat, tërë popullsia myslimane këtë e ka parë si një grusht ndaj institucioneve të veta fetare dhe si një atentat të ri ndaj të drejtave elementare të myslimanëve në trevat jugore. Pas rrugës plot me ferra, përmes së cilës myslimanët e viseve jugore, e sidomos ata të kombësisë shqiptare ishin të detyruar të kalojnë në mbrojtjen e pasurisë së tyre fshatare nga grabitqarët zullumqarë, e cila zbatohet përmes të ashtuquajturës reformë agrare dhe kolonizim, e cila edhe

⁹⁰ По ату, Исламска Веска Заједница – Улема Мецлис у Скопљу Пов. бр. 41/40, Shkup., 24 gusht 1940.

pse gjoja është ndërprerë përkohësisht, ende u kërcënohet si shpatë mbi kokë, tash atyre u kërcënohet edhe në të drejtën e vetme, të cilën ata e kanë gëzuar në këtë shtet, në autonominë e tyre fetare. Përndryshe, Juve, Zotëri Kryetar, U janë të njohura rrethanat se në çfarë përmasash janë zhvilluar përndjekjet e myslimanëve tanë, për arsye se herë pas here edhe vet kam pasur nderin për tërë këto t’ju informoj...”⁹¹.

Për sa u tha më sipër, mund të konkludojmë se Lëvizja Kombëtare Shqiptare, të cilës gjatë viteve tridhjeta të shekullit të kaluar i printe atdhetari dhe veprimtari i shquar shqiptar, Ferhat bej Draga, luajti një rol të rëndësishëm dhe vendimtar në pengimin e shpërnguljes së popullsisë shqiptare nga vatrën e tyre për në Turqi. Ky rol erdhi në shprehje, veçmas gjatë periudhës kohore 1938–1941, përkatësisht pas Konventës së parafuar turko–jugosllave, e cila, siç u tha më sipër, parashihte që brenda periudhës kohore 1939–1944, nga trevat shqiptare nën Jugosllavi të shpërnguleshin 40.000 familje shqiptare. Deri te kjo nuk u arrit falë veprimtarisë së palodhshme e sakrifikuese të Ferhat bej Dragës e të bashkëveprimtarëve të tij, siç ishin: Ibrahim Lutfiu, Kadri Saliu, Sherif ef. Langu, mulla Idriz Gjilani, Ataullah ef. Kurtishi, Bedri ef. Hamidi, Iliaz ef. Agushi, Shaban ef. Jashari, Azem Hoxha, Abdullah Musliu, Shaip Kamberi, Shaip Mustafa, Asim Luzha, Mustafa Dërguti e shumë të tjerë.

⁹¹ По ату, Ферхад Драга – Београд, Таковска 9, Београд, 18 нентор 1940.

JUSUF OSMANI

Arkivi i Kosovës – Prishtinë

REZISTENCA E XHEMIJETIT KUNDËR ZBATIMIT TË REFORMËS AGRARE DHE KOLONIZIMIT TË KOSOVËS

Një ndër metodat e spastrimit etnik, shkombëtarizimit dhe sllavizimit të Kosovës, ishte edhe kolonizimi i Kosovës me elementin sllav dhe shpërngulja e shqiptarëve nga vendlindja e tyre që kishte filluar që nga viti 1912, kur Kosova u pushtua nga serbët dhe malazezët. Ky kolonizim u ndërpre gjatë Luftës së Parë Botërore dhe vazhdoi menjëherë pas mbarimit të saj. Për realizimin e tij, filloi menjëherë dhuna e terrori ndaj popullatës shqiptare.

Kolonizimi si metodë perfide mistifikohej dhe kamuflohej me zbatimin e njëres nga metodat borgjeze, me reformë agrare, e cila propagandohej si masë përparimtare e që në të vërtetë fshehë qëllimin e borgjezisë serbomadhe – kolonizimin e Kosovës dhe shkombëtarizimin e popullsisë shqiptare, e cila ishte në shumicë absolute. Pra, borgjezia bënte përpjekje që ta rrallojë sa më tepër popullsinë shqiptare, sidomos në ato treva ku shqiptarët jetonin në numër të madh dhe Kosova ishte rajoni me popullsi më të dendur në tërë Jugosllavinë. Ekzistonte një program i gjerë i kolonizimit, i vendosjes së folësve të sllavishtes në viset e banuara me shqiptarë.

Kolonizimi dhe reforma agrare në Kosovë kanë pasur qëllim kryesisht nacional-politik dhe karakter eksploatues. Qëllimi kryesor i kolonizimit ishte thyerja e kompaktësisë nacionale të popullsisë shqiptare dhe ndërrimi i strukturës nacionale në dëm të shqiptarëve. Veçanërisht, synimi ishte që të kolonizohej dhe të forcohej elementi kolonist në pjesët rreth kufirit me Shqipërinë, sepse mendonin se me atë kufiri do të jetë më i sigurt dhe do të ndërpritet vazhdimësia e popullatës autoktone shqiptare nga territori i Shqipërisë, Kosovës

dhe Maqedonisë, siç thuhej në dokumente me qëllim sigurimi dhe në përputhje me planin e tyre strategjik. Përveç kësaj, ajo politikë bënte përpjekje që ta rrallojë sa më tepër popullsinë shqiptare dhe në ato treva homogjene dhe vendbanime të banuara plotësisht me popullatë shqiptare të vendoste kolonë, pra në ato krahina, ku shqiptarët jetonin në numër të madh, si dhe synohej të kolonizohen ato treva të pastra etnike shqiptare siç ishin: Drenica, Llapi, Llapusha, pjesë të Rrafshit të Dukagjinit, të Kosovës etj, dhe të thyhej homogjeniteti nacional i atyre vendbanimeve e trevave në fjalë.⁹²

Kolonët të ashtuquajtur vullnetarë, çetnikë, optantë, etj., kishin ardhur gati nga të gjitha viset e Jugosllavisë borgjeze, si nga Mali i Zi, Hercegovina, Bosnja, Dalmacia, Lika, Korduni, Bania, Serbia Jugore, Vojvodina, etj. Mirëpo, kishte kolonë të ardhur edhe nga disa shtete të jashtme, si nga Rusia, Italia, Hungaria, Shqipëria, Amerika, etj. Atyre pushteti u jepte prona të mëdha të tokës, sipërfaqja më e madhe e marrë nga pronarët shqiptarë, duke i detyruar ata që të shpërngulen ose të bëhen shërbëtorë “të agallarëve” të rinj, duke ua punuar tokën dhe duke e paguar edhe tatimin për atë tokë. Pushteti, kolonët i vendoste edhe në shtëpitë e fshatarëve vendas shqiptarë dhe të atyre të shpërngulur. Kolonëve, përveç tokës së dhënë falas, pushteti disave ua ndërtonte edhe shtëpitë, si dhe u jepte ndihmë në material ndërtimor, vegla pune, kredi, i lironte nga tatimet shtetërore për 10 vjet dhe nga ato komunale për 5 vjet, kurse të drejtën e plotë si pronarë – me të drejtë për të shitur atë – do ta merrni pas dhjetë vjetësh, transportin falas të tyre, të materialit ndërtimor, veglave të punës, bagëtive etj. deri të vendi i vendosjes etj. U formuan kooperativat agrare nga të cilat kolonët merrnin kredi pa kamatë, material ndërtimor dhe ndihma të tjera.

Në mesin e kolonëve të ardhur, që shteti u kishte dhënë tokë, përveç fshatarëve bujq kishte edhe tregtarë, pensionistë, oficerë, xhandarë, nëpunës etj. Për t’i nxitur dhe për t’i tërhequr kolonët që

⁹² Më gjerësisht shih: dr. Jusuf Osmani, Kolonizimi serb i Kosovës, Prishtinë, 2010.

të vijnë dhe të vendosen në Kosovë, makineria propaganduese serbe përdorte në forma të ndryshme propagandën se në Kosovë ka tokë më bollëk, shtëpi të lira etj.

Kolonëve të ardhur sllavë, pushteti, përveç tokës “utrinë”, kullota e të tjerë, u ndante posaçërisht tokë të punueshme pjellore të marrë nga pronarët shqiptarë, të cilët ishin të detyruar të shpërngulen jashtë vendit ose të marrin nga kolonët e të punojnë tokën e vet përgjysmë ose me qesim dhe për të edhe të paguajnë më tutje tatimin. Tokën pronarëve shqiptarë pushteti ua merrte edhe me motivacion se është përfshirë në kompleksin agrar dhe për atë shpesh nuk jepte kurrfarë kompensimi, ose nëse jepte atë tokë e jepte të cilësisë së dobët.

Në zbatimin e kolonizimit ishin të angazhuara të gjitha organet e pushtetit, duke filluar nga ato më të ulëtat lokale e deri tek ato më të lartat shtetërore. Pra, ishte angazhuar tërë makineria shtetërore. Ata kurrnjëherë nuk kishin marrë parasysh pozitën e fshatarit shqiptar. Përkundrazi, në aksionet e marrjes së tokës, përdorshin metoda të llojllojshme, kështu që kishte raste kur toka iu ishte marrë deri në prag të shtëpisë, e që për të hyrë shqiptarë në shtëpi do të detyrohej të kalojë tani nëpër “pronën” e kolonit.

Në veprimtarinë e organizuar për nxitjen e vazhdueshme të shpërnguljes shqiptare dhe të kolonizimit me kolonë sllavë, në vend të tyre, administrata shtetërore i kishte lënë vend të veçantë propagandës, sidomos shtypit, i cili duhej të kontribuonte në përgatitjen psikologjike të opinionit brenda vendit për ta përkrahur shpërnguljen dhe për ta justifikuar këtë para opinionit të huaj. Ndërsa, nga kolonët, nga tërë shteti dhe jashtë t'i nxitë dhe t'i tërheqë të vendosen në Kosovë, duke u premtuar tokë më bollëk, shtëpi, vegla bujqësore, lehtësi tatimore, kredi etj. Me këtë shtypi borgjez synonte që në radhët e popullsisë shqiptare të krijojë një gjendje tensioni të vazhdueshëm, i cili duhej të ndikonte në shtimin e mëtejshëm të shpërnguljes. Në shumicën e gazetave, sidomos në ato beogradase, botoheshin artikuj shpifës, tendenciozë, duke e

paraqitur shpërnguljen si “dëshirë” të popullatës “myslimane”, ndërsa kolonizimi arsyetohej për tokën e lirë dhe interesat që kishte shteti për t’i kolonizuar këto treva me elementin e krishterë nga aspekti i mbrojtjes.

Të bazuar në shënimet statistikore, Qeveria arriti që në Kosovë, në periudhën midis dy luftërave, siç thuhej për nevoja të reformës agrare t’i kufizojë rreth 129.212,94 ha tokë.⁹³ Ndërsa, gjatë kësaj periudhe janë vendosur 13.482 familje me rreth 67.410 anëtarë në 594 vendbanime.⁹⁴ Mirëpo, numri i kolonëve të vendosur në Kosovë është më i madh, sesa e jep statistika zyrtare serbe, sepse ky numër ka të bëjë vetëm për familjet, të cilëve zyrtarisht u është ndarë toka. Kanë mbetur anash familjet, që e kanë rrëmbyer tokën në forma të ndryshme, ato në qytet – të ardhur si nëpunës, xhandarë, tregtarë dhe të profesioneve të tjera. Secila familje mesatarisht i kishte marrë nga 8,45 ha tokë, por kishte shumë raste kur një familje kishte marrë edhe deri 45 ha tokë. Ndërsa, familjeve shqiptare kishte raste kur toka i merrej në tërësi deri në prag të shtëpisë, kështu që nuk zbatohej edhe ai dekretligji famëkeq, i cili parashihte se familjeve shqiptare t’i mbetej 0,40 ha tokë për një anëtar të familjes.

Përkitazi me kolonizimin dhe reformën agrare në trevat shqiptare ekzistojnë shumë dokumente arkivore që kryesisht ruhen në Arkivin e Jugosllavisë në Beograd, fondet Ministarstvo za agrarnu reformu i kolonizaciju, Ministarstvo Poljoprivrede, Press Biro, Ministarstvo unutrašnjih Poslova etj., Në Arkivin e Institutit Historik Ushtarak në Beograd, Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Arkivin e Maqedonisë, Arkivin e Kosovës, Arkivin Nacional në Londër e aty këtu edhe në ndonjë tjetër. Të dhëna ka edhe në shumë artikuj të gazetave të kohës. Përveç të dhënave rreth zbatimit të kolonizimit dhe të reformës agrare në Kosovës dhe në viset tjera shqiptare në periudhën ndërmjet dy

⁹³ AJ B, Ministarstvo Agrarne Reforme Kraljevine Jugoslavije, 96-15-51; 96-15-55.

⁹⁴ AJ B, MAR, 96-21-69, Regjistri i kolonive më 8.IV.1940.

luftërave botërore, ka edhe të dhëna rreth rezistencës së popullatës shqiptare, personaliteteve të njohura, por edhe të organizatës Xhemijeti.

Xhemijeti punoi në mbrojtje të popullsisë shqiptare, duke kërkuar më shumë të drejta, duke dënuar dhunën e terrorin mbi shqiptarët, shpërnguljet e dhunshme dhe kolonizimin serb. *Xhemijeti* shtroi edhe kërkesa për çlirimin nacional, tregoi qëndrimin politik të borgjezisë, prej së cilës kjo parti ishte krijuar. Kjo parti, megjithatë, nuk ishte në gjendje që të ruante autonominë e vet, meqë ajo ndodhej në gërshtimin e ashpër të dy partive rivale serbe në Kosovë: asaj Radikale dhe Demokratike, të cilat ishin të interesuara për elektoratin e Kosovës, por që këtë ta bëjnë disi, duke ruajtur edhe "*Xhemijetin*", jo si partner koalicioni, por si një vasal, të cilit i caktoheshin detyrat dhe i jepej ndonjë shpërblim për këtë.

Në Kongresin themelues organizata Xhemijeti i mori dy emra. Emri i saj i vërtetë ishte "*Shoqëria e Mbrojtjes së të drejtave shqiptare*", ndërsa në opinion, për t'u maskuar, u paraqit me emrin: "*Shoqata Islame Muhafazi Hukuk*" ose "*Xhemijeti*". Ky maskim ishte i domosdoshëm, sepse Mbretëria SKS nuk njihte kombësinë shqiptare, ndërsa lejonte atë turke, dhe pranonte "identitetin islam", të cilit i lejohej pasqyrimi në planin shoqëror, kulturor, por edhe politik. Kjo ishte njëherë edhe partia e parë politike.

Sa i përket qëndrimit të Xhemijetit për reformën agrare dhe kolonizimin, nuk ishte gjithmonë i njëjtë, për shkak se shpesh edhe më herët e shihte interesin personal të disa funksionarë të vetë, të cilët ishin pronarë të mëdhenj, derisa shumë pak e shihte interesin e përgjithshëm të myslimanëve, diçka që negativisht u reflektua në popull.⁹⁵

Në Kongresin themelues më 17 dhjetor 1919, është miratuar platforma programore, ku janë përcaktuar qëllimet dhe detyrat e

⁹⁵ Skender Asani, Xhemijeti, Veprimtaria e organizatës politike Xhemijeti në trevat lindore (1919-1925), Shkup, Prishtinë/ Tiranë, 2017, fq. 39.

organizatës, që ishin të përfshirë edhe çështjet rreth zbatimit të kolonizimit dhe të reformës agrare, në pikën 7 thuhej *Përjashtimi i vakëfeve nga shqyrtimi ose kompensimi për të mirat e marra; Në pikën 8. Përjashtimi nga reforma agrare tokat e bejlerëve në aspektin e zgjidhjes së përgjithshme të reformës agrare; Në pikën 9. Kompensimi për të hyrat e papaguara bejlerëve nga çipçinjët; Në pikën 10. Kthimi i pronave në gjendjen para vitit 1912, d.m.th. që mos të llogariten çipçinj ata të cilët prej vitit 1912, ishin nën administrimin serb ose të armikut me dhunë, pa pëlqimin e pronarëve janë vendosur në tokat e bejlerëve*⁹⁶.

Në jetësimin e programit dhe ngritjen e organizatës politike Xhemijeti, rol të rëndësishëm kishte lideri i saj shpirtëror Nexhib Draga, e pastaj edhe Ferhat bej Draga. Xhemijeti dinjitetshëm përmes disa deputetëve të saj në Parlamentin e Mbretërisë SKS, i përfaqësoi interesat e myslimanëve (shqiptarëve dhe turqve) në këtë shtet, duke kundërshtuar në radhë të parë kolonizimin dhe reformën agrare, si dhe ndërprerjen e depërtimit të tyre në Turqi dhe Shqipëri.⁹⁷

Gazeta e kohës „Epoka”, 5. IV. 1921, boton artikullin „Kërkesat e myslimanëve”, në shtojën nr. 1, nga z. Alban Youngs, nr.195, dat. 14.IV.1921. Ky dokument gjendet në Arkivin Nacional të Londrës.⁹⁸ Shkruan për përgatitjen e disa kërkesave nga myslimanët radikalë e demokratë nga Serbia jugore në klubet e tyre përkitazi me çështjen e reformës agrare. Kërkojmë që të jepet pëlqimi për kërkesa që kanë të bëjnë me Serbinë jugore, Sanxhakun dhe Maqedoninë si vijon: 1. Tapitë e tokave të mos konsiderohen si pronë në baza feudale, që kjo tokë të mbetet në pronësi të pronarëve të tanishëm dhe që mos të jenë subjekt i provizioneve të reformës agrare; 2. Të përcaktohet se çka është minimumi i

⁹⁶ “Misao”, Beograd, lib. II, fl. 1, 1920, 461; Bogomil Hrabak, Dzemijet Organizacija muslimana Makedonije, Kosova, Metohije i Sandžaka 1919-1928, Beograd, 2002, fq. 81.

⁹⁷ Skender Asani, Xhemijeti, v. e c., fq. 52.

⁹⁸ PRO, L. FO, 371 – 6194.

sipërfaqes së tokës, e cila do të mbetet jashtë përfshirjes së reformës agrare si pronë e pronarëve të tanishëm; 3. E drejta e kompensimit t'u njihet pronarëve të tokës të krahinave përkatëse të viteve 1918–1920; 4. Pronarët e tanishëm të tokave të gëzojnë të drejtën në ato prona të veta të marra me reformën agrare, pasi që ata nuk kanë marrë kompensim; 5. Vlera e kompensimit të kalkulohet nga Këshilli i ministrave, sepse Qeveria në këtë rast duhet t'i revidojë nenet përkatëse të Kushtetutës së miratuar nga Komiteti Kushtetues.

Gazeta “Pravda” nr. 115, datë 28 prill 1921, njofton se myslimanet e Serbisë jugore ia kanë dërguar kërkesat e fundit Pashqit në lidhje me çështjen e agrarit. Në ato kërkesa kërkohej: Që të lihet në dispozicion të lirë tokë deri në 30 ha (sipas kësaj $\frac{3}{4}$ e çifçinjve do të largoheshin nga pronat; që prona mbi 30 ha ndahet kështu që çifçinjtë e marrin në 75 për qind, ndërsa pronarët 25 për qind (këso prona ka shumë pakë); që beglukëve deri në 300 dylym t'i u njihen se pronë e lirë, ndërsa mbi atë që të blihet me dëmshtëpërlim. Në emër të dëmit ata kërkojnë ndonjë avans, siç iu ishte dhënë myslimanëve të Bosnjës.

Qëndrimi i Xhemijetit për çështjen e reformës agrare u paraqit në Kongresin e Tretë të mbajtur në Shkup, më 14 prill 1922. Deputetet e Xhemijetit para Kongresit e paraqitën qëndrimin e tyre se pronat nuk kanë asgjë të përbashkët me pronat e çiflig-sajbive, për shkak se marrëdhëniet feudale u ndërprejnë në vitet e 40-ta të shekullit të 19-të.⁹⁹

Revista „Južna Srbija”, Nr.9–10, Shkup, 6.VII dhe 1.VIII.1922, boton një fejtון me titull „Çështja e reformës agrare – „Mendimet dhe kërkesat e myslimanëve nga Serbia jugore”. Në të paraqiten këto çështje: moszgjidhja e çështjes agrare, politika e parregulluar agrare, pakënaqësia ekonomike dhe politike, formimi i një komisioni në Shkup për zgjidhjen e çështjes agrare. Boton referatin

⁹⁹ Pitanje agrarne reforme “Juzna Srbija”, knj. 11, br. 9, Skoplje, 16.07.1922, fq. 32; Skender Asani, Xhemijeti, v. e c., fq. 39.

e Seksionit agrar Xhemijeti, i cili është lexuar dhe miratuar në Kongresin vjetor të organizatave myslimane në Serbinë jugore.

Gazeta “Pravda” e Beogradit, nr. 8, 1 janar 1923, shkruan se z. Pashiqi e ka ftuar Xhemijetin nga Serbia jugore që së bashku të marrin pjesë në zgjedhje me partinë radikale.

E njëjtë gazetë, “Pravda”, nr. me 5 janar 1923, njofton se Xhemijeti ka vendosur që radikalëve t’iu parashtron kushtet më të vështira. Ajo, në mes tjerash, do të kërkojë që pronat e beglerëve t’iu kthehen ose t’iu paguhen.

Gazeta “Politika”, në artikullin “Xhemijeti para shkatërrimit”, thekson se: Organizata e Myslimanëve të Serbisë jugore me emrin Xhemijet, ka punuar nën maskën për tendenca arsimore–kulturore, andaj është lejuar veprimi i saj në tërë popullatën myslimane në viset jugore.¹⁰⁰

Ambasada e Mbretërisë së Shqipërisë në Beograd, me shkresën nr. 1061/2, datë 7 gusht 1923 në informatën dërguar Ahmet Zogut, e informon për gjendjen e shqiptarëve në Kosovë, organizimin e tyre politik dhe formimin e grupit politik “Xhemijeti”, për veprimet makabre të qeverisë serbe, duke theksuar se në vitin 1912 serbët i kanë përgatitur dhe armatosur shqiptarët në luftë kundër Turqisë, dhe më pastaj për t’i vrarë në kohën e luftës dhe më vonë, duke ua kërkuar armët.¹⁰¹

Gazeta “Politika” e datës 21.VIII.1923, Beograd, në artikullin “Shpërngulja e shqiptarëve”, në mes tjerash shkruan: “... *interesat tona nacionale janë serbizimi dhe sllavizimi në përgjithësi i Kosovës, Luginës së Vardarit. Ne do të ndihemi si sundimtar kur të na lëshojnë kolonët e dikurshëm turq të sjellë duke e ndrydhë elementin tonë i rënë në Maricë, të tronditur në Kosovë, ndërsa i mposhtur në Smederevë. Ata njerëz nuk mund të asimilohen dhe atë punë asnjë i mençur nuk duhet edhe ta mendojë. Ata nuk mund*

¹⁰⁰ “Politika”, 20.III.1923, Beograd.

¹⁰¹ Arkivi i MPJSH, viti 1923, dosja 206.

të fitohen edhe në ndjenjat morale ndaj shtetit, sepse nuk ka intelektualë në këtë shtet, të cilët besojnë se si Xhemijeti është një organizatë patriotike. E tëra nga ajo që mund të kërkojmë nga ata, është që të mos gjenden më këtu.”. ...”

Artikullshkruesi Jeliq propozon që "Ministrisë Agrare duhet t'i merret detyra e kolonizimit dhe t'i besohet Shtatmadhorisë, ku duhej të themelohet sektori për kolonizim, shef të emërohej një oficer i vjetër i Shtatmadhorisë, ndërsa për ndihmës njerëz të rinj ambiciozë. Detyrat e sektorit do të ishin vendosja në vitin 1924 e një divizioni të likasëve në Kosovë ose kolonizimi i fiseve Bratonoziq në Luginën e Drinit, në mes të Gjakovës dhe Prizrenit”.

Jeliq thekson, “se këtu mund të jemi zot vetëm atëherë kur t'i dërgojmë kolonët e dikurshëm turq, dhe këtu qëndron interesi i shtetit”. Jeliq shkruan edhe për organizatën “Xhemijet” (Bashkimi).¹⁰²

Duke bërë polemikë me “Politika” e Beogradit (me Milisav Jeliq), për shpërnguljet nga Kosova, “Hak” theksonte: “Askund tragjedia e pjesëve jugore nuk shihet më mirë se në rreshtat e Jeliqit, sepse ai bashkimin e myslimanëve (shqiptarëve, J. O.) rreth “Xhemietit” e sheh si tentativë të gabuar, sepse në të, thotë ai, janë tubuar tre popuj: turq, shqiptarë dhe serbë, se ata synojnë kah grupi nacional i tyre”. Rreth “Xhemijetit” “Hak” shkruan se nuk është organizatë që është themeluar nga bejlerët dhe politikanët, por atë e krijuan rrethanat. “Neve na kanë bashkuar metodat humane të “të problematorëve”, prej të cilëve shihet qëllim që të na zhveshin prej çdo gjëje që është nacionale”.

“Hak” pastaj flet për problemin e atyre familjeve shqiptare që detyroheshin të shpërngulen dhe njëherazi i qorton të gjithë ata që largoheshin. Në vazhdim bën fjalë për mënyrën e shpërnguljes.¹⁰³

¹⁰²“Pravda”, nr.81, Sarajevë, 1923.

Në një dokument të kohës me titull “Bejlerët e rinj serb”, në mes tjerash shkruan: “*Numër i madh i kolonëve që u jepnin tokën përgjysmë shqiptarëve, kështu që shqiptarët i quajnë bejlerët e rinj*” . . .”.. deri sa fshatarëve të varfër, Drejtoria agrare ua merr parcelën e fundit të tokës, ndërsa agallarët dhe bejlerët nëpërmjet korrupsionit dhe lidhjeve me partitë politike, kanë arrit që t’i ruajnë komplekset e mëdha të tokës...”¹⁰⁴.

Në shkresën tjetër nr. 1270/2, të datës 18 gusht 1923, Ambasada e Shqipërisë në Beograd, informon për emigrimin e shqiptarëve nëpër Bullgari për në Turqi. Shumë prej emigrantëve, për mungesë të të hollave, kanë mbetur rrugës. Emigrimi nga trevat e Prishtinës, Mitrovicës, Sanxhakut dhe Shkupit, nuk mund të thuhet se po bëhet me dëshirën e popullit, por për shkak të shtypjes, që ata i ka detyruar të lënë arat dhe pasurinë e vet për të shpëtuar jetën. Sado që autoritetet serbe theksojnë se po bëjnë lehtësira të emigrimit për shitjen e pasurisë, kjo është vetëm reklamë dhe se e vërteta e qëllimit të tyre është që të shtinë në dorë pasurinë e të ikurve pa pagesë ose me një çmim të vogël.

Përveç kolonëve sllavë, të vendosur deri më tani në Kosovë, janë duke u bërë përgatitje për të vendosur në tokat e marra edhe elementin tjetër sllav. Qeveria serbe dhe opinioni publik vazhdojnë të qëndrojnë në parimin e kolonizimit të Kosovës, deri te krijimi i një shumice serbe ndaj elementit mysliman. Në këto treva duhet sjellë edhe elementin sllav, duke filluar nga malazeztë, hercegovasit, dalmatinët, likasit, krajinasit e deri të sllavët që ikin nga Rumania dhe Hungaria. Të gjithë këtyre u jepet tokë në Kosovë, u ngrihen shtëpi dhe u jepet një shumë e të hollave për vitin e parë.

Duhet theksuar edhe angazhimi i deputetëve të “Xhemijetit” që të ndikojnë te elementi mysliman që të mos shesin pasurinë dhe të

¹⁰³ “Hak”, 649, nr. 656, nr. 689, nr. 699/1923; Marrë nga libri: Dr. Hakif Bajrami, Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918-1941, Prishtinë, 1981, fq. 222-224.

¹⁰⁴ Institut za Medjunarodni Radnički Pokret u Beograd, dok. Nr. 3774)

heqin dorë nga emigrimi. Shpreson për një intervenim të deputetëve pranë Qeverisë që myslimanëve t'u sigurohet jeta dhe pasuria e tyre.¹⁰⁵

Ministri Fuqiplotë, Ali Kolonia, në një dokument të vitit 1923, në dosjen 206, të Arkivit të MPJSH, shkruan: *Eshte per te shenuar mendimi i shtypit serb, i cili kohe pas kohe sistematikisht po shkruan mbi nevojën e largimit me hire ose pahire te elementeve shqiptare dhe turke nga tere Serbija Jugore pa edhe nga Bosna. Si arsye per ket tregojne antagonizmin qe existon midis te krishterit dhe myslymanvet, si dhe mosbindesine e mosafërimit dhe mosbashkimit te ndienjave fetare myslymane ne frymen e shtetit te sotme te Jugosllavise, dhe per interesin qe ka Jugosllavia t'i kolonizojë ata vende me elementet te krishtera te saja, tepërta neper vise te tjera dhe qe mentalitetet e ndryshme nuk jane me u pajtuar dot kurre. Shtohet dhe qe, Qeveria per te lehtësuar ikjen e myslimanëve, duhet te perkujdeset per me rregulluar sa me shpejt çështjen e emigracionit te tyre per ne Anadoll. Po sic po marrim vesht, kryetaret e myslymanëve te Kosoves kane lajmeruar popullin te mos shesin pasunien dhe te mos emigrojnë ne shtete te tjera”.*

Kurfarë arsye sociale, ekonomike, ose arsimore–kulturore nuk do të mund të tubonin në atë bashkësi të fortë të të gjithë myslimanëve në jug, se paguesit shtetërorë, hoxhallarët dhe imamët nuk arrinin t'i tubonin rreth besimit profetik, as agjitorët e rrejtshëm që iu kanë drejtuar disa Angorës, ndërsa të tjerët Tiranës. Vetëm kështu të tubuar në një organizatë e të gjithë myslimanëve të Serbisë jugore dhe ne ato njihte edhe sot ata mbahen.

Në këtë kohë kur Qeveria do të mohojë çdo të drejtë shqiptarëve dhe të tjerëve, Ferhat Draga, kryetar i Xhemijetit, do ta kritikojë politikën hegjemoniste të Beogradit dhe militantëve të ndryshëm, si Miliq Kërsta, të cilët, të frymëzuar e dirigjuar nga Qeveria, ushtronin dhunë e terror në Kosovë e gjetiu. Ai do të denoncojë

¹⁰⁵ Arkivi i MPJSH, viti 1923, dosja 206.

Reformën agrare, shpërnguljen me dhunë të shqiptarëve në Turqi dhe kolonizimin e Kosovës e viseve shqiptare. Qëndrimi i tij politik është i qartë, kur thotë: *“Ne nuk jemi kundër kolonizimit. Le të zbatohet ajo në ato vende ku ka pak popullsi. Konsiderojmë se së pari duhet t’u jepet tokë vendësve tanë, që janë bujq dhe nuk kanë mjaft tokë, pastaj ç’tepron të sillen kolonët, bujq të vyeshëm, nëse është nevoja. Por, në radhët e kolonëve që sillen tash, pjesa më e madhe prej tyre nuk janë për bujqësi, si për shembull në Dukagjin, ku ka aso rastesh që koloni merr pushkën, lahutën dhe ulet nën hije, ndërsa tokën ia punojnë shqiptarët nën presionin e “autoritetit” të pushkës. Ka raste kur shqiptari e mbjell, e korr dhe e bën duaj, pastaj ia beh koloni, i merr duajt dhe i çon në lëmë të vet. Të gjitha këto bëhen me qëllim të caktuar që të tronditet popullsia shqiptare dhe të shpërngulet”*¹⁰⁶. Ndërsa, sa i përket reformës agrare në mes tjerash thekson “..... Kur të përmendet reforma agrare, para syve na del grabitja, dhuna, plaçkitja, dhe thjeshtë nuk mund të gjenden fjalë që të dëshmojnë se çfarë do të thotë reformë agrare në vendin tonë....”¹⁰⁷. Ai ua bën të qartë kreatorëve të politikës serbe se *“Tendenca që shqiptarët të shkrihen, nuk është e mundur të realizohet. Shkrimi e kësaj popullsie dhe shpërngulja nuk do të bëhet realitet kurrë”*¹⁰⁸.

Edhe Kosta Peçanac, si kryetar nderi i Organizatës çetnike, në mes tjerash propozon që çështja agrare t’i besohet pushtetit ushtarak, ndërsa avokatëve të Shkupit duhet tërhequr vërejtjen, se interesat shtetërore janë më të rëndësishme se të tyre.¹⁰⁹

Në një raport të Legatës shqiptare në Beograd, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Tiranë, datë 3.XII.1923, shkruan se *Kolonizimi në token e Kosovës do vazhdojë dhe pas ketaj me anën e Ministrisë. E keqja është se nuk u mjaftohen vetëm me tokat*

¹⁰⁶ Gazeta “Hak”, nr. 689.

¹⁰⁷ Gazeta Hak, Shkup, nr. 678, fsye 28.11.1923 dhe nr. 681, datw 1.12.1923; Skender Asani, Xhemijeti, v. e c., fq. 39-40.

¹⁰⁸ Gazeta “Hak”, nr. 693.

¹⁰⁹ “Politika”, nr. 5520, 6.IX.1923.

çifligëve, po u rrembehen dhe shtëpите dhe arat e paketa te katundareve, pa shume here kollonistet u kane rrembyer dhe gruren nga lemi. Banuesve te vjeter kosovar nuk u eshte dhene sa nje pellembe toke nga çifligjet e ndare. Myslimanet i perdorin shume per hangarira si per te ndrequr udhet dhe per ngrehur kulla rojtese. ... Mbas kerkimit te deputeteve te Xheminetit po pregatitet ne Ministri nje projekt i ri fetar mysliman, ku do parashikohet dhe mesimi i turqishtes ne klasat e fese, dhe Min. i Arsinit po pergatit nje projekt per shkollat fillore myslimane, po nuk u dihet se me cilen forme, si do qe thuhet se ca deputet kane kerkuar dhe gjuhen shqipe.

Deputetet e Xheminetit shpresojne se keto projekte si dhe nje e agrarit do te paraqiten per votim ne parlament, dhe thuhet qe per kete do vene kembe”.

Në dokumentin tjetër nr. 1410/2, datë 11 dhjetor 1923, të kësaj Legate në Beograd, theksohet: Me kërkesën e deputetëve të Xhemijetit, Qeveria kinse kishte marrë përsipër zbatimin e pikave: 3. Rregullimi i çështjes agrare mbi bazen qe çdo pronari te vjeter t’i lihet 30 ha toke dhe te perzohen nga kjo toke tere bujqerit e instaluar gjer tashte padrejtesisht; 4. T’u paguhet pronjareve te vjeter vlefte e tokes, qe eshte ndare mbas agrarit, me çmim te caktuar; 5. Te ngrihen tere sekuestrat nga pronat e atyre personave qe ndodhen brenda ne shtetin, si dhe te atyre qe vertetojne me dokumenta mosarratisjen e tyre; 6. Te çelen shkolla ne gjuhen turqishte dhe shqipe, si mbas nacionalitetit te myslimaneve; 7. Te pushohet kolonizimi me elemente ta huaj ne Kosove e Metohi.

Gazeta “Politika” e Beogradit, më 9 dhjetor 1923, boton artikullin “Radikalët dhe Xhemijeti”, ku, në mes tjerash, shkruan: “Qeveria dje ka filluar marrëveshjen me “Xhemijetin”; Bisedimet po i zhvillojnë Dr. Jankoviq dhe dr. Kojiq. – Këshillimet e radikalëve. – Opozita po fillon me krijimin e një blloku opozitar. Bisedimet janë zhvilluar me Ferhat bej Dragën, kryetari i klubit.

Gazeta boton edhe kërkesat e Xhemijetit, ku në mes tjerash kërkohej:

1. që menjëherë të sillet ligji për gjyqet e sheriatit;
2. që të jepet autonomia vakëfeve;
3. që të hapën shkollat e nevojshme myslimane dhe që numri do të konstatohet sipas numrit të myslimanëve.
4. që të zgjidhet reforma agrare në Serbinë jugore dhe që myslimanëve t'iu garantohet maksimumi i nevojshëm dhe të hiqet sekuestrimi për pronat e myslimanëve ish poseduesve;
5. që sa më parë të ndriçohet rasti i Mitrovicës, fajtorët të dënohen dhe që në përgjithësi të sigurohet siguria publike në viset jugore.

Në takim janë zhvilluar diskutime. J. Qirkoviq ka konstatuar se as radikalët e as Xhemijeti nuk iu kanë përmbytur marrëveshjeve të tyre. Duhet dalë në ndihmë kërkesave të Xhemijetit, por për çështjen e marrëdhënieve agrare në asnjë rast nuk guxojnë të zgjidhen pa deputetët e viseve jugore. Padyshim, deputetët e Xhemijetit nëse dëshirojnë të marrin pjesë në zgjidhjen e marrëdhënieve agrare, duhet të hyjnë në klubin radikal.

Gazeta shkruan se përveç tjerash se qarqet qeveritare nuk dëshirojnë të japin përgjigje precize që të paraqesin konkluzionet se Qeveria ka vendosur që të pranon të gjitha kërkesat e Xhemijetit për marrëdhëniet agrare. Kjo çështje është shtyrë, dhe siç theksohet, vendimi për atë do të bihet në afatin prej një muaji pas nënshkrimit të marrëveshjes. Ndërsa, marrëveshja ndërmjet Xhemijetit dhe radikalëve do të duhej të nënshkruhet nesër. Deputetët e Xhemijetit duhet të hyjnë menjëherë në klubin e radikalëve.¹¹⁰

Më datën 11 dhjetor 1923, "Politika" boton artikullin "Qeveria i lëshon pe Xhemijetit". Në një mbledhje të Klubit të deputetëve radikal, u diskutua gjerësisht. Lidhur me agrarin u tha se nuk

¹¹⁰ "Politika", 9. XII. 1923, Beograd.

pajtohen që Xhemijetit t'i jepet ndonjë koncesion në aspektin e agrarit. U zhvillua një diskutim i gjerë.

Xhemijeti, megjithatë nuk ka qenë aq optimist, i disponuar. Plenumi i klubit sot dhe dje para dhe pas dreke ka mbajtur mbledhje, megjithatë z. Ferhat beg Draga ka deklaruar mbrëmë se ende nuk ka ardhur deri te prurja definitive e vendimit. Sepse, ka thënë z. Draga, atë që radikalët mendojnë për kërkesat tona, neve na janë të njohura vetëm nga gazetatat. Zyrtarisht asgjë nuk na është thënë. Se a do të marrim pjesë në mbledhjen e Kuvendit ose jo, do të vendosim para mbledhjes.

Se, siç deklarojnë deputetët e Xhemijetit, të cilët dje kanë ardhur në Beograd, me këmbëngulje kërkojnë që Qeveria të heqë dorë nga kolonizimi i Kosovës dhe Metohisë. Nëse nuk dëshiron që ta ndërpresë, atëherë që atë ta bëjë deri me sjelljen e ligjit agrar. Në anën tjetër, Xhemijeti nuk ka vendosur ende për arsye se z. Pashiq personalisht ka refuzuar që të nënshkruar protokollin e marrëveshjes, pa të cilin Xhemijeti nuk dëshiron të pranojë marrëveshjen.

Në mbledhjen e Këshillit financiar lidhur me Buxhetin e Ministrisë së Reformës agrare është diskutuar gjerësisht për çështjen agrare. "Folësi i parë, z. Gj. Popoviq, ka kërkuar zbatimin e Reformës Agrare në Serbi, ku gjithashtu shumë fshatra janë pa tokë, të cilën e ka grabitur shteti.

Dr. H. Krizman ka kërkuar që urgjentisht dhe përfundimisht të zgjidhet çështja agrare. Gjendja provizore që për hapin e parë ishte e nevojshme, po e komprometon reformën agrare, po i sjell shumë dëme ekonomike dhe po jep mundësi për spekulantë të ndryshëm. Ligji për reformën agrare duhet të përkufizohet vetëm për çështjen e blerjes, sepse të gjitha të tjerat me ligje dhe me Kushtetutë janë zgjidhur".

Z. R. Jojiq ka folur për kolonizimin e atyre viseve që më parë i takonin Malit të Zi.

Diskutimin e ka përfunduar z. Sret. Vukosavleviq, demokrat, që e ka qortuar partinë radikale se reformën agrare po e konsideron si taktikë që të mbetet në pushtet. Ndalet kolonizimi i Kosovës dhe Metohisë, ku është më e nevojshmi, nën presionin e Xhemijetit. Pengon kolonizimin atje ku zbatohet vetvetiu. Ashtu që sot po do që të zhvendosë kolonët nëpër qarkun e Bellopojës dhe të Plevlës, që vet janë ambientuar dhe kanë ndërtuar shtëpitë. Në zgjidhjen e marrëdhënieve çifligare po pengon që populli të kuptojë seriozisht reformën agrare, dhe të emancipohet nga bejlerët – populli ende po e paguan hakun. Pazarllëku i sotëm me Xhemijetin, për çështjen e reformës agrare është cinik.

Ministri i reformës agrare z. Simonoviq: “Kolonizimi do të zbatohet seriozisht, ndërsa 30 milionë të ndarë në buxhetin e vitit të kaluar për ndihmë kolonëve, nuk ka mundur të harxhohet”. “Në viset jugore janë ndarë 47.435 hektarë tokë për afro 22 mijë familje...”.¹¹¹

Gazeta “Politika” e datës 12 dhjetor 1923 informon se dje është nënshkruar marrëveshja ndërmjet radikalëve dhe “Xhemijetit”. Marrëveshjen e kanë nënshkruar z. Ferat Draga dhe dr. Kojiq. Ndërsa, Pashiqi nuk e vë nënshkrimin e vet në këtë protokoll.

Në artikull janë paraqitur kushtet reciproke, si p.sh. çështja e agrarit, autonomia e vakëfeve e të tjera.

Edhe shumë deputet shqiptarë të Xhemijetit diskutojnë në Parlamentin e Mbretërisë SKS, përkatësisht jugosllave kundër zbatimit të reformës agrare. Kështu, Aqif Blyta, në mes tjerash thekson: “Nuk është e vërtetë se kanë marrë vetëm tokat e bejlerëve dhe të parisë. Ata (nëpunësit agrarë) marrin fushat e bujqve shqiptarë dhe ua japin të pasurve, funksionarëve dhe avokatëve serbë. Zotërinj, në Serbinë

¹¹¹ “Politika”, 11.XII.1923, Beograd.

jugore ligji agrar ka çuar në uri vetëm shqiptarët. Asnjë serbi nuk i është marrë asnjë pëllëmbë toke”.¹¹²

Dokumenti më i rëndësishëm është diskutimi i Ferhat Dragës në Parlament në vitin 1924, për krimet serbe në Kosovë, masakrat e shumta, vrasjen e personaliteteve të njohura nga pushteti, për kaçakët, pronat e shqiptarëve etj. Që në fillim Ferhat Draga thekson se “.. kjo është hera e dytë që në emër të klubit tonë të quajtur Xhemijet unë po mbaj fjalim dhe që opinionit publik pak t’i shpjegoj se çfarë është pozita jonë në viset jugore... Dhembjet, plagët tona dhe vuajtjet tona në Serbinë jugore nuk mund të zbulohen me një interpelancë, të cilën e kam paraqitur në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Zotërinj, nga ne është plaçkitur toka ,është marrë dhe nuk është paguar, por u është dhënë mëshirë për tërë tokën që u takonte çipçinjve. Nëse ju dhe Kuvendi do të bëheni grabitës, kjo është çështje tjetër, por unë përherë e di se dikush, kur ka një pronë 36 vjet, atëherë ajo është e tij dhe nuk ka të drejtë askush të përziehet. Asnjë deri më tani nga Kaçaniku deri në Shkup, pastaj deri në Plevle, nuk ka arë dhe cep të tokës që t’u kthehet agallarëve dhe bejlerëve, mund të ketë një ose dy, por prapë po ju them se ne jemi rajë dhe ju sundimtarë. Nuk është vetëm kjo, zotërinj, atyre fshatarëve u merren arat e tyre dhe u jepen kolonëve, por për atë do të flas më 26, kur do të jetë Buxheti agrar.”¹¹³

Qëllimi i regjimit ishte i qartë, donte përfitim kohe. Por, me stabilizimin e regjimit, kur votat e deputetëve të Xhemijetit nuk iu duheshin, atëherë me një presion te paparë, duke përdorur njete te llojllojshme e pengoi punën e Xhemijetit. Xhemijeti ndërpreu punën publikisht, por anëtarët e saj vazhduan punën në forma të

¹¹² Stenografske beleške Skupštine Kraljevine SHS, 23.12.1923; AQSH, F. 65, v. 1924, dosje 25, fl. 18.

¹¹³ Diskutimi i Ferat Dragës, botohet në gazetën “Hak”, të muajit mars 1924, Stenografske beleške Skupštine Kraljevine SHS, LXIV, mbledhja e rregullt, 20 mars 1924; Arkivi i MPJSH, viti 1924, dosja 101.

ndryshme. Në këtë kohë, në fund të janarit 1925, Ferhat Draga burgoset. Ekzistojnë disa dokumente rreth burgosjes së tij në Shkup dhe dërgimit për në Mitrovicë. Fjalimi në burg, dënimi i tij, qëndrimi në burg deri më 11 janar 1928 etj. Përkitazi me këtë, “Liria Kombëtare, Gjenevë, 1 janar 1928, fq. 4. Pas burgosjes politike të Ferhat Dragës, në fillim të vitit 1925, “Xhemijeti” u likuidua si parti legale.

“Politika” e datës 24.II.1925, Beograd, boton artikullin e korrespondentit nga Shkupi, më 20 shkurt, me titull: “Pse është shpërndarë Xhemijeti”.

Në artikull shkruan: Duke i mbështetur dy mendimet për shpërndarjen e Xhemijetit: e para, se e ka shkatërruar pushteti zgjedhor me terror; dhe e dyta se e kanë shkatërruar ngjarjet në Shqipëri dhe në Bullgari.

Tani të shohim se cila është e saktë.

Në vendin tonë ekzistojnë dy të pakënaqur, por në mesin e tyre ekzistojnë dallimet. Sepse, nuk është e njëjtë të jesh kundër regjimit dhe të jesh kundër shtetit. Ne kemi njerëzish kemi. Kemi edhe parti të organizuara. Njëra prej atyre partive është “Xhemijeti”, e cila ka dështuar në këto zgjedhje, nuk është ajo çka është ajo demokratikja.

Z. Davidoviq kërkon shtetin unik dhe sa më i fortë bashkimi shpirtëror i fiseve tona. Shefi i “Xhemijetit”, Ferhat Ali Draga, larg është nga ajo. Ai në vitin e kaluar, nga kthimi prej Zagrebit, haptas ka përshkruar qëllimin e politikës së tij: **“Çdokush të vetën e ne tonën. Çka kërkon Serbia kur ne nuk e prekim në kufij të saj!”**, ka thënë Ferhat begu, i entuziazmuar me përshtypjet, të cilat i ka sjellë nga Zagrebi.

Koncepcioni i politikës separatiste të Radiqit i ka pranuar edhe përpara dhe më shpejt se sa ai ka mundur t’ia parashtrijë.

Sipas mendimit të tij, duhet që sa më parë të ndahet shteti jugosllav në disa pronarë. Pronat e Serbisë së Vjetër, duhet t’i takojnë, sipas

asaj ndarje, z. Dragës. Radiqi i ka thënë *se nuk është larg dhe se ka garanci*.

“Xhemijeti”, si organizatë politike i ka ndihmuar të gjitha qeveritë në Beograd, ose në mënyrë oportuniste ka qëndruar dhe është sjellë para tyre. Me kthimin e Ferhat begut nga Zagrebi, Xhemijeti ka sulmuar në drejtimin tjetër. Ferhat begu ka kërkuar nga Këshilli Qendror që politika e Xhemijetit të ndryshohet dhe që të jetë *“në harmoni dhe marrëveshje të fshehtë me politikën e të nënshtruarve: kroatëve, malazezëve dhe maqedonasve”*.

Gazeta “*Balkanska federacija*” ka qenë matëse e asaj politike. Në atë gazetë në gusht të vitit 1924, ka shkruar serbi Pavle Pastajiq se *“Serbia nuk ka të drejtë në territore më larg se Ristovci”*.

Turqit dhe bullgarët e kanë shumëzuar atë letër dhe e kanë dërguar nga dora në dorë. Mirëpo, dy-tre anëtarë të Këshillit Qendror të Xhemijetit ishin më të qartë se shefi Draga. Ata në Xhemijet kanë krijuar krizën me rastin e këtyre propozimeve. Kenan Zija ka mbrojtur politikën oportune dhe ka thënë:

– “Lidhja e politikës sonë me atë të Zagrebit dhe rreth “Federatës Ballkanike”, e cila po inaugurohet nga jashtë, është e njëjtë dhe e gabueshme, sikurse të lidhemi haptas edhe me Angorën dhe me Kemal Pashën”.

Ferhat Draga, fizikisht si më i forti në Xhemijet, ka reaguar dhe iu ka përgjigjur: *Po edhe me Angorën...* Më pastaj kriza u paraqit haptas. Kenan Zija ka humbur edhe më tepër.

Duhet pasur ndërmend se në fillim të kësaj krize ende ishte gjallë Todor Aleksandrov, ndërsa në krye të Qeverisë shqiptare ishte shefi i vërtetë Bajram Curri me Elez Jusufin dhe Begun e Mitrovicës. Atëherë në Serbinë e Vjetër defilonin kaçakët në një anë dhe komitet bullgarë në anën tjetër. Këtë pjesë të shtetit tonë duhej ndezur në momentin e përshtatshëm. Sipas mendimit të shefit të Xhemijetit, kjo ishte e mundshme, sepse Bajram Curri e udhëheqë një pjesë të Shqipërisë, ndërsa Aleksandrov Bullgarinë. Përveç

këtyre, Radiqi me Hungarinë dhe me sovjetët e ka rregulluar këtë ngjarje.

Kenan Zija nuk e ka ndarë atë mendim. Ai e ka ditur se Serbinë e Vjetër nuk është lehtë për ta ndezur, e aq më vështirë tërë shtetin. Ai ishte i mençur si dhe plaku Foqo ndërmjet dahijve para njëqind vjetësh. Ferhat Draga këtë nuk e ka kuptuar dhe aty është fillimi i rënies së tij dhe rënia e “Xhemijetit”.

Kenani është larguar nga partia dhe ai Xhemijetit i ka sjellë shumë dëme sesa të gjitha mjetet zgjedhore dhe të gjitha marifetet e qeverisë. Këtë udhëheqësit e Xhemijetit nuk e kishin paraparë, kaosi i Komitetin bullgar dhe vdekja e Aleksandrovit, rënia e qeverisë së kaçakëve në Tiranë dhe kthimi i Ahmet Zogut.

Këto ngjarje me mjeshtri i kanë shfrytëzuar anëtarët e përjashtuar dhe të fyer të Këshillit Qendror të Xhemijetit ndërmjet turqve dhe shqiptarëve, të cilët i frikësohen forcës, të cilën vetëm atë e vlerësojnë dhe e respektojnë.

Madje, Ferhat beg Draga edhe para zgjedhjeve, pas të gjitha këtyre ngjarjeve haptas ka thënë: ***“Mund të punojë kush çka të dojë, ushtria ime është e sigurt”.***

Se sa ajo ushtri është e sigurt, është përcaktuar në mënyrë reliev në këto zgjedhje. Në të vërtetë, në vet Kaçanikun, Kadriu, përkrahës i partisë radikale, iu ka sjellë radikalëve 2024 vota pa kurrfarë terrori dhe të gjitha me biseda “në katër sy”. Ashtu gati ishte gjithkund.

Bullgarët dhe shqiptarët në Serbi të Vjetër nuk e donin politikën e Xhemijetit. Por, kjo nuk do të thotë se e donin atë serbe. Do të thotë se e kanë kuptuar dhe ndier, ashtu siç ishte, se ky shtet është më i fortë sesa mendonin.

Do të ishte naive të thuhet se ata nuk kuptojnë në politikë. Dinë ata mjaft. Ka te ata diçka mistike dhe profetike. Kur flasin për kthimin e Ahmet begut në pushtet në Shqipëri dhe për trazirat në Bullgari, ata juve iu befasojnë me vështirimet e tyre. Kur flasin për

shkatërrimin e Xhemijetit, iu thonë haptas se atë nuk e ka shkatërruar pushteti me terror, por mendja e cektë e udhëheqësve të saj.

Në një dokument, promemorie e datës 17 tetor 1935, në emër të myslimanëve të jugut, Ferhat Draga dhe dr. Momçillo Ivanoviq ia paraqesin të dhënat faktografike kryeministrit për grabitjen e tokave të shqiptarëve nga organet e pushtetit.

Edhe deputeti i Vushtrisë, Sherif Voca, në mbledhjen e Kuvendit popullor të mbajtur më 7 mars 1937, diskuton për vuajtjet e kosovarëve. Ai thekson se “... *Ata nuk kerkojne as rruge prej asfalti, as ferovi duple, as universitete, as gjinnaze, vetem kerkojne nga nje shkolle fillore atje ketu. Ata nuk kerkojne as spitale neper qendra, por spitale neper qarqe, nuk kerkojne kopshte, as ato qe kerkojne prej kohesh krahinat e tjera...*”. Popullin po e shkatërron reforma agrare. Toka iu merret shqiptarëve që po e trashëgojnë me qindra vjet, se kjo tokë nuk është e mjaftueshme as për shqiptarët e as për kolonët. Thekson se reforma agrare shqiptarët e pështjelli me të zezë. Kërkon revizion të reformës agrare, kërkon drejtësi e barazi dhe kërkesa të tjera.¹¹⁴

Në një raport të mëvonshëm, të vitit 1938, të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Mbretërisë jugosllave, flitet për organizimin politik të pakicës shqiptare, që deri në vitin 1925 kanë pasur organizatën e tyre „Xhemijeti”. Gjithnjë ishin në anën e regjimit. Prej shkëputjes së partisë së Xhemijetit, pakica shqiptare ishte në tërësi me regjimin. Nga momenti i marrjes më të madhe të tokës deri 0,40 ari, por edhe pas Konventës për shpërngulje, ata të bashkuar i kanë forcuar radhët e tyre dhe tani kërcënohen me opozitë nëse nuk iu plotësohen kërkesat e tyre në pikëpamje të reformës agrare....¹¹⁵

Ferhat Draga në gazetën “Kosova”, të vitit 1942, e kishte përgatitur artikullin më 17.X.1935, me titull “**Si u** zbatue reforma agrare në

¹¹⁴ Arkivi i MPJSH, viti 1937, dosja 126;

¹¹⁵ AVII, P.17, k.94, f.1, d.16.

Kosovë”, ku paraqet shembuj konkret të personave që iu është marrë toka në tërësi, vendbanimet e tyre, sipërfaqen e tokës etj.

Përfundim

Nga e tërë kjo mund të përfundojmë se, sikurse dëshmohet, nën pushtetin serb, pjesa më e madhe e popullsisë së Kosovës është gjetur në një robëri të vërtetë koloniale. Pushtetarët serbë shumë shqiptarëve ua kanë marrë burimin e të ardhurave, tokën dhe bagëtinë, nëpërmjet të zbatimit të kolonizimit të trevave shqiptare me elementin sllavë dhe marrjen e tokave nën maskën e reformës agrare dhe detyrimin e tyre që të lënë atdheun e të vendosën në Turqi e gjetiu.

Kundër kësaj robërie shqiptarët bënë rezistencë në forma të ndryshme, siç ishin shoqatat e ndryshme shqiptare, deputetët shqiptarë, por edhe partia politike Xhemijeti.

HAKIF BAJRAMI

Prishtinë

PARTIA POLITIKE “XHEMIJET–i” (BASHKIM) NË SHQIPËRINË KONTINENTALE KRIJON HISTORI KOMBTARE

Nga Kongresi i Berlinit (1878) në Evropë u krijua filozofia gjeostrategjike e mbuluar me ideologji të tipit ‘kryqëzatë’: 1+1+1= (anti Islam + anti turk + pro ortodoks), që u reflektua në të gjitha rrjedhat e fatit të popullit shqiptar, për një shekull. Mbi këtë filozofi ideologjike, u krijua falanga ushtarake – politike – ballkanike – ortodokse, me qëllim për t’i përligjur të “drejtat” e copëtimit të tokave që pjesërisht (ose në tërësi) identifikoheshin si vende “pro–islame–pro–turke”, e që kryesisht ishin troje shqiptare. Mbi këtë politikë imperialiste, masoneria evropiane, e gjashtë Fuqive të saj, i rekrutoi gjatë janarit–tetorit 1912, oficerët më fanatik (620 oficerë të lartë evropianë) për ta larguar Perandorinë Osmane nga toka e Evropës. Kështu, Evropa i doli krah luftës së “shenjtë ortodokse”, kryqëzatës së Aleancës Ballkanike më 1912.

Si rezultat i filozofisë 1+1+1, Konferenca e Londrës (1913), e ligjësoi okupimin e tokave të huaja e jo “çlirimin” siç propagandohej, si e “drejtë legale”, sidomos mbi tokat shqiptare, të cilat u copëtuan pa mëshirë. Lidhur me këtë, **Eduard Grei** (Ministër i Jashtëm britanik), më 17 prill 1913, deklaroi: *“Marrëveshja ndërmjet Fuqive lidhur me kufijtë (verior) të Shqipërisë u arrit pas një përpjekje diplomatike të gjatë e të vështirë. U vendos që bregdeti dhe Shkodra t’i mbeten Shqipërisë, ndërsa Peja, Prizreni, Dibra dhe (pas shumë bisedimesh) Gjakova të LIHEN jashtë Shqipërisë. Kjo marrëveshje le një pjesë të madhe territori për t’u ndarë midis Serbisë e Malit Zi, si fryt i fitores së tyre. Arritja e kësaj*

*marrëveshje ishte esenciale për PAQEN në Evropë dhe, sipas mendimit tim, ajo u arrit në kohën e duhur për të ruajtur paqen midis **Fuqive të Mëdha***". Se çfarë paqe u arrit, tregon fillimi i Luftës Botërore (1914–1918), pikërisht në ato shtete (Serbia dhe Austro– Hungaria, më 28 korrik 1914), sepse donin zgjerime të reja. Nuk ishin të kënaqura me grabitjet e tokave fqinje. Për këtë zgjerim, shikoni dokumentin **SEKRET** nga **28. VI. 1881** në mes Vjenës dhe Beogradit, neni **VII**: "Obligohet Beogradi, mos ta **pengojë** Vjenën në **ANEKSIMIN** e Bosnjës dhe Hercegovinës", fakt ky që ndodhi më 1908. Obligohet Vjena që mos ta **PENGOJË** Serbinë të zgjerohet kah Vilajeti i Kosovës dhe Manastirit (neni **VII** i Konventës sekrete 28. VI. 1881), që i okupoj më 1912. Për këtë shiko: H. Bajrami, "*Si e okupoj Serbia Kosovën më 1912*", I, Prishtinë, 2003, f.28. – "**Tajna Konvencija 1881**", fototip në origjinal.

Orekset imperialiste, ato shtete që kanë grabitë toka të huaja, edhe sot nuk i refuzojnë mundësitë! Këto fakte thuhej se me qëllim po harrohen se kush ishin shkaktesit e luftërave dhe tragjediave dje, nga ata që shihnin ëndrra mesjetare!

Opinionin ynë nuk do me asnjë çmim ta pranojë se kur e çliruan kryengritësit shqiptarë Kosovën dhe kryeqytetin e saj, Shkupin, më 26 gusht 1912, aty do të vijin **TRE përfaqësues të Fuqive (francezi, austriaku dhe rusi)** dhe ia komunikuan Hasan Prishtinës tekstualisht: "Çfarëdo rezultati të kësaj lufte juaj, ndryshim të kufijve të Perandorisë Osmane nuk ka"! Hasan Prishtina dhe ndihmësit e tij, me lot në sy urdhëruan demobilizimin... Është rrenë mesjetare turkoshake, se Isa Boletini kinse kishte kërkuar "marshim deri në Selanik, për ta liruar Sulltanin". Isa nuk e kishte asnjë mundësi për ta penguar Hasan Prishtinën që ta shpallë pavarësinë në Shkup. Por, këtë fuqi dhe mundësi e kishin gjashtë Fuqitë evropiane, të cilat folën në Shkup me një zë (Anglia, Franca, Gjermania, Austro Hungaria, Italia dhe Rusia)... Tani shtrohet pyetja: Pse pati ndryshim të kufijve në favor të Aleancës Ortodokse Ballkanike në nëntor 1912,

dhe këto fuqi jo që reagues, por e ndihmuan me armatim, oficerë të lartë dhe me diplomaci perfide, në Londër, duke krijuar kufij STRATEGJIK në favor të Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë. Dihet faktet, pra. Madje, është bërë e njohur pjesëmarrja e **620 oficerëve** të lartë evropian, në cilësinë e instruktorëve në armatat e Aleancës Ballkanike. Madje tani dihet se në “Luftën e Kumanovës ka komanduar një oficer i lartë gjerman (Gjenerali Henri), e jo oficerët serbë”. (Shiko: **Kosta Jezdiq, “Narod i drzhavnici Serbije”,** Beograd **1913, strogo pov.** F.7, i botuar për nevoja diplomatike në 10 ekzemplarë!).

Në Luftën e Parë Botërore morën pjesë 36 shtete në një sipërfaqe prej 4 milionë kilometra katrorë; në luftime marrin pjesë mbi 1 miliardë banorë, mobilizohen 70 milionë ushtarë, vriten 11, diku shkohet në 26 milionë, plagosen 21 milionë ushtarë dhe civilë; marrin pjesë 190 000 avionë, 9000 tanke, 140 000 mjete motorike. Dëmet e luftës saktësisht nuk do të dihen kurrë. Ja çfarë PAQE vendosi E. Grei, pasi që i kishte **sakrifikuar gjysmën e trojeve shqiptare, në tavolinat e Konferencës së Londrës më 1913!!!** (A. Hakif Bajrami, *Si e okupoj Serbia Kosovën më 1912*, Prishtinë 2003, f. 189; Istorija sveta... f. 542.). Çfarë paqe u arrit pra, me këtë pazar kriminal në Londër më 1913, flasin pasojat e Luftës së Dytë Ballkanike (1913) dhe Luftës së Parë Botërore (1914–1918).

Konferenca e Fshehtë e Londrës (26 prill 1915), e përligji filozofinë e “*thikës pas shpine*” ndaj çdo aleati kur kemi të bëjmë me interesa, duke aneksuar Italia pjesët më strategjike të Adriatikut Lindor. Kështu, Italia u vuri thikën shteteve “katolike–protestante” (Austro–Hungarisë dhe Gjermanisë), të cilat e humbën luftën para forcës së një Gjysmë Antante (Francë+Angli), sepse më 17 tetor 1917, Rusia ndryshoi kursin ideologjik dhe i mbylli pazaret duke favorizuar SHBA–të, të cilat hynë në Luftë (1917) si borxhli dhe dolën si fitimtarë me kamatë të shekullit. Mbi parimet e fitores së “mileniumit”, u thirr Konferenca e Versajit (1919), si aeropagu më kriminal në histori, që për fatin e tokave shqiptare u bë prapë pazar

më tragjik deri atëherë, duke lënë të okupuar tërë Shqipërinë Kontinentale, nën okupimin e Mbretërisë imperialiste SHS. (*B. Parimet mbi të cilat u thirr Konferenca e Versajit 1919 në: DASIP. B. Arbnasi i Konferencia Mira u Versaju 1919, analizë e paregjistruar-HB*).

Si pasojë e pakënaqësisë shqiptare për territorin e okupuar më 1 maj 1918, në Shkodër themelohet Komiteti “Mbrotja Kombëtare e Kosovës” (**KMKK**), për ta vazhduar luftën aty ku e “lanë” Kryengritjet e Mëdha Nacionalçlirimtare Shqiptare anti-turke (1908–1912), duke mos pranuar okupimet dhe copëtimet e shembullit të E. Greit e kompanisë së tij më 1913. Në këto rrethana, themelohet edhe partia politike shqiptare, duke e përfshirë pjesën më të madhe të Shqipërisë Kontinentale (pa Çamërinë e plagosur rëndë), sipas njëgullave religjioze krishtere–islame, prapë me pazare (Dinastia + N. Pashiqi), duke shfrytëzuar politikën e “mundur” anti–islame, anti–turke dhe pro–ortodokse (1878–1918), për ta lejuar të vepronte legalisht një parti “religjioze”. Mbi të gjitha, parti që nuk guxonte me asnjë çmim të quhet kombëtare (shqiptare), pra të quhet **XHEMJET**, sepse me këtë faktor një ditë duhej liru shqiptarët trevat e veta stërgjyshore. Prapë Fuqitë evropiane lejuan që okupatori të vepronte, me kusht që shqiptarët do të shpronësohen, shpërngulen dhe shfarosen. Dokumentet arkivore dëshmojnë se për tragjedinë shqiptare kishin njohuri të gjitha Fuqitë evropiane dhe heshtën.

RRESHTIMI I RI GJEOSTRATEGJIK (1919–1941)

Nga Versaji doli rreshtimi tjetër gjeostrategjik: **anti–gjerman, anti–Kominternë dhe Pro–Vatikan** (1+1+1). Në këto rrethana u lejua Xhemijeti nga N. Pashiqi edhe për faktin se Mali i Zi (kishte konkordatë me Vatikanin nga viti 1864) dhe Serbia që u bë Jugosllavi (kishte konkordatë me Vatikanin nga viti 1914), me mundësinë që “kur të forcohet Dinastia në tërë territorin, Jugosllavia të shndërrohet në shoqëri “homogene” dhe tërë shteti

një ditë të konvertohej në Serbi **integrale**. Pas një konsolidimi shtetëror parashihej SHKATËRRIMI i Xhemijetit të ndodhë, duke i burgosur themeluesit, ose duke e përçarë për brenda dhe duke i vrarë nëpër terr, kuptohet edhe nga mercenarët shqiptarë. Dhe ky realitet ndodhi më 1924/5, për shumë faktorë që do t'i shpjegojnë në fund të këtij studimi filozofiko-politik dhe historiko-shkencor. Në këto rrethana **XHEMIJETI** (BASHKIMI) kishte mundësi të veprojë për pesë vjet legalisht, vetëm mbi baza fetare “**anacionale**” shqiptare. Kjo shansë është shfrytëzuar si mundësi historike për realitetin gjithëtnik shqiptar.

E vërteta: Xhemijeti e ka një parahistori të ndritur. Më 1909 në Stamboll themelohet Klubi politik “**SHQIPTARI**”, që drejtohej nga Ibrahim Temo. Më 1912 ky klub politik konvertohet në “**BASHKIMI**” me qendër në Shkup, i drejtuar nga Nexhip Draga. Ndërsa i njëjti klub politik, më 1915, në Mitrovicë, i drejtuar nga Hasan Prishtina emërohet në “**SHPËTIMI**”, për t'u kthyer parap në Shkup më 17. XII. 1919, me emër jo shqip “**XHEMIJET**”, i drejtuar nga Nexhip Draga, Qenan Zija dhe Ferat Draga, deri më 1925. (C. Hakif Bajrami, *Programi kombëtar politik i shqiptarëve më 1992*, Prishtinë 1997; *Xhemijeti*, dorëshkrim 1976.).

★★★★

Pas Luftës së Parë Botërore, mbi gjysma e trojeve shqiptare mbetën të okupuara nga Mbretëria SKS dhe Greqia. Në trojet e okupuara lindin dy parti politike kombëtare. Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, me seli në Shkodër, u themelua më 1 maj 1918 dhe me asnjë çmim nuk e pranonte okupimin. Përkundrazi, vendosi në Program që të luftojë me fuqinë e armës për çlirim dhe bashkim me Shqipërinë bregdetare¹¹⁶. Ndërsa, për herë të parë në histori shqiptarët nën robërinë e Mbretërisë SKS u organizuan në një parti politike me emrin legal XHEMIJET. Por, emri ilegal i partisë ishte:

¹¹⁶ Arkivi i Shqipërisë, Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, Dosja nr. 1; AVIIB. P.17, K.22-Kosovski Komitet, Statut i Program delatnosti.

“Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave Shqiptare (Myslimane) në Jugosllavi”. Ky emër në opinion publikohet i denominuar si “XHEMIJET-i”, në përkthim “**BASHKIM-i**”. Kjo parti shtrihej nga Sanxhaku, nëpër tërë Vilajetin e Kosovës dhe gati tërë ish Vilajetin e Manastirit. Ishte pra partia më e madhe shqiptare, duke përfshirë tërë Shqipërinë Kontinentale nën robërinë e Mbretërisë SKS.

KONGRESI I PARË I XHEMIJETIT 1919

Xhemijeti themelohet në **Kongresin e Parë** më 17 XII 1919 në Shkup (Kryeqytet i Vilajetit Kosovës), në prani të **64 delegatëve** nga të gjitha rrethet administrativo-territoriale shqiptare. E vërteta: “Xhemijeti” mbetet partia më e madhe në histori, që i përfshinte të gjitha viset e robëruara shqiptare nën Mbretërinë SKS¹¹⁷. Kongresi aprovoi Statutin dhe Programin. Me Statut, Xhemijeti shtrihej në çdo cep ku banonin shqiptarët nën Jugosllavinë. Partia i kishte dy instucione drejtuese: **Hejeti Feale-Këshilli i Përgjithshëm** dhe **Hejeti Teftishije-Këshilli Mbikëqyrës (Ekzekutiv)**. Të mendohet se edhe organet drejtuese duhej të kishin emërime turqisht, fakt ky që kishte prapavijë meskine antishqiptare nga dinastia dhe Qeveria SKS¹¹⁸.

Pas një diskutimi njëorësh, **kryetar** i Xhemijetit në Kongresin e Parë zgjidhet **Nexhip Draga**, ndërsa **nënkryetar** **Sheh Sadedini** i Tetovës. Sekretar i Xhemijetit zgjidhet **Aqif Blyta** i Pazarit të Sanxhakut. Me propozimin e Aqif Blytës, Kongresi i drejtohet oratori i parë **ZIJA Beu** (u vetëdeklarua se është me rrënjë i

¹¹⁷ Hakif Bajrami, Kongresi i Parë i Xhemijetit, 17 XII 1919, Shkup, f.1-128, dorëshkrim nga viti 1977.

¹¹⁸ AVIIB. P.17. Osnivački Kongres Xhemjeta, prostiranje i unutrašnja organizacija; H. Bajrami, Xhemjeti, orgnaizatë nacionale shqiptare e mjegulluar me qëllim me premisa religjioze; H. Bajrami, Pse Xhemjetin pushteti parafshist i M. SKS e lufton me të gjitha mjete ta quaj parti “turke”, “myslimane”, “Bejlerëve” e denominime tjera të mëvonshme si “boshnjake”, “arnaute”? Dihet, duhej opinionit të jashtëm pushteti donte t’i servojë një popull të tërë si “turmë” anacionale e cila një ditë duhet të shpronësohet, shpërngulet dhe shfaroset, për t’u sllavizuar Kosova dhe Manstiri si Toplica 1878.

originës shqiptare, por më vonë u konvertua në asgjë–HB) nga Ohri, duke e paraqitur Programin e Xhemijetit, sepse me profesion ishte jurist. Njëherit Kongresi i paraqitën për aprovim këto kërkesa, të cilat Kryesia duhej negociuar me pushtetin: 1. **Kërkojmë** që pasuritë e vakëfeve të cilat janë konfiskuar të kthehen në shfrytëzim drejtuesve të tyre; 2. Kërkojmë që shkollat myslimane të kenë autonomi, ndërsa shteti të ketë të drejtë t'i mbikëqyrë; 3. Kërkojmë që fëmijët myslimanë mos të **obligohen** të bëjnë kryq në shkollat shtetërore, pasi që shkollat shqipe nuk po na lejohen; 4. Kërkojmë që në zgjedhjet parlamentare dhe komunale, listat zgjedhore të pranohen dhe në emrin tonë vetëm kandidatët myslimanë; 5. Kërkojmë që reforma agrare mos t'i përfshijë vakëfet; 6. Kërkojmë që prona e konfiskuar të paguhet brenda një viti, ndërsa toka t'u takojë vetëm atyre që e punojnë; 7. Kërkojmë që çipçinjët të marrin tokën që është mera e lirë e jo t'u dhurohet kolonëve sllavë, sepse ata nuk kanë asnjë lidhje me këto troje.

Kongresi u deklarua për përpilimin e Programit, i cili nuk do të ketë premisa religjioze. Me këtë propozim doli Jusuf Bej Ohri. Për propozimin dhe arsyetimin e Programit ishin të autorizuar: Jusuf Bej Ohri, Kadri Bej, Sali Bej Shkupi, Mithat Shemsiu dhe Tefik Bej Koçani¹¹⁹.

ÇKA PARASHIHTE PROGRAMI I XHEMIJETIT

1. Autonomi religjioze dhe arsimore për të gjithë myslimanët. Bashkimi i drejtimit fetar në tërë vendin me ligj duke siguruar lidhje me Halifatin; 2. Gjykata dhe Sheriati për martesë (kurorëzime)

¹¹⁹ AJ. S. 14. K. 519-Kongres muslimana na Jugu 1919; H. Bajrami, Pse nuk u lejua emri i shqip i organit “HAK”, për Xhemjetin-shiqo: DASIP. B. Senzhernenski Ugovor o nacionalnim manjinama, 10 shtetor 1919. Nikolla Pashiqi arriti në Senzhern të fitojë status mosparnimi për shqiptarë dhe maqedonas, neni 9 dhe 10, ku thuhet se ato vise dhe ata popuj që Serbia i ka okupuar para 1 janarit 1913, nuk përfshihen në paragrafët e kësaj Marrëveshje ndërkombëtare. Kështu shqiptarët dhe maqedonasit mbeten jashtë sistemit të drejtave në shkollim dhe identitet kombëtar “minoritar”.

të mbetet çështje familjare dhe trashëguese; 3. Ruajtja e këshillave të vakëfëve dhe mearifëve (krahinave); 4. Gjuha kombëtare myslimane dhe arsimimi religjioz me autonomi shkollore; 5. Largimi nga shkollat i lutjeve sipas mënyrës ortodokse dhe rregullimi i librave prej të cilave do të hiqen artikujt me karakter religjioz; 6. Vërtetimi i deputetëve myslimanë për Kuvendin Kushtetues, për tërë popullsinë muslimane si dhe organizata e posaçme si pjesë përbërëse e partisë që i takon; 7. Përfshirja e vakëfëve për shqyrtim ose kompensim të pronës përkatëse; 8. Përfshirja nga reforma agrare si dhe pronat e bejlerëve me theks të posaçëm për zgjidhjen e përsëgjithshme të çështjes agrare; 9. Kompensimi i të ardhurave për bejlerët nga ana e çipçinjëve; 10. Kthimi i pronës në gjendjen e para vitit 1912, që do të thotë mos të konsiderohen çipçinj ata të cilët prej vitit 1912 ishin nën pushtetin e Serbisë ose armiqve, pa pajtimin e popullsisë që janë vendas në pronat e bejlerëve¹²⁰.

Xhemijeti veprroi në rrethana politike konfliktuale (sepse shqiptarët me Marrëveshjen e Senzhermenit nuk u pranuan si pakicë, sepse ishin okupuar para 1 janarit 1913–HB), deri në kongresin vijues.

Organi i Xhemijetit **“HAK”** filloi të dalë më **23 shkurt 1920**¹²¹. Pas një pune të bujshme, kryetari i Xhemijetit, Nexhip Draga, sëmurët rëndë dhe shkoi në Vjenë për shërim. Atje vdes më 1921. Pas sëmundjes së rëndë të Nexhip Dragës, Xhemijetin e merr në drejtim Ferat Draga, më 12 janar 1920. Nën drejtimin e tij përgatitet kongresi vijues i Xhemijetit¹²².

Partia shqiptare “Xhemijet” i nevojitej Beogradit për t’i bërë oponencë votës që ishte shfaqur nga fillimi si krijesë imperialiste – (Jugosllavisë) në sallonet e Versajit, nga qarqet franceze dhe angleze,

¹²⁰ “MISAO”, Beograd 1920, I, II, f. 461.

¹²¹ “Hak” do të fillojë (26 korrik) të botohet për çdo ditë me germa arabe me gjuhë turke, ndërsa dy herë në javë edhe në gjuhën serbishte. Por me asnjë çmim nuk lejohej nga Nikolla Pashiqi (personalisht) të botohet shqip, ashtu si kërkonte Ferat Draga dhe themeluesit e Xhemijetit.

¹²² H. Bajrami, Kongresi i Dytë i Xhemijetit – Bashkimit dhe përpjekja e Qenan Zijës të krijoi përçarje në parti me hjekësi të Radikalëve

që ishin triumfalistë të Luftës së Parë Botërore. Në këto rrethana, Serbia avancohet me forcën diplomatike dhe ushtarake të tyre, duke u konvertuar në Mbretëri SKS, e cila gradualisht do të luftojë për t’u bërë homogjene dhe integrale. Kështu, në vend të nominimit “Serbi”, megjullohet termi “Jugosllavi”, si “një popull i përbërë prej TRE FISEVE”¹²³.

KONGRESI I DYTË I XHEMIJETIT 1920

Kongresi i Dytë i Xhemijetit mbahet në Shkup nga 20–26 korrik 1920 me moton: “Të gjithë myslimanët e Jugut në një front nacional për të drejta popullore”. Në këtë Kongres ndryshoi nominalisht e tërë strategjia politike e Nexhip Dragës, i cili fizikisht mungonte. Prandaj, para se të fillojë punimet, Kongresi e transformoi emrin e Xhemijetit në “Organizata Myslimane e Serbisë Jugore të Mbretërisë SKS”, e në disa raste kemi të bëjmë edhe me denominim “Xhemijeti i myslimanëve të Maqedonisë dhe Sanxhakut”. Të gjitha pësh-tjellimet nominative i krijoi Qenan Zija, i cili zgjidhet për një kohë të shkurtër edhe drejtues i Xhemijetit. Kuptohet, i tërë dokumentacioni argumenton se kemi të bëjmë me një puç politik destruktiv, i cili nuk do të ndalet si kahe deri në ndalimin e veprimtarisë politike, fakt ky që e kërkonte Mbreti dhe të gjitha partitë serbe si në orkestër.

Kongresi u kushtoi rëndësi zgjedhjeve parlamentare që u mbajtën më 28. XI. 1920. Kongresit do t’i paraqet pengesa kryemiftiu (Suprem) i Mbretërisë SKS, Abdyl Bej Efendia, një serbofil dhe mik i N. Pashiqit dhe Esad Pashës që e kishte shoqëruar ushtrinë serbe në Korfuz dhe Selanik¹²⁴. Me gjithë këtë, nga të pranishmit e

¹²³ Bogumil Hrabak, Reokupacija Kosovskog Viljateta 1918, dorëshkrim i papr-nuar për botim në “Vranjski Glasnik” 1974; H. Bajrami, Versaji dhe imperializmi francez në ofensivë mbi tokat shqiptare, punim i lexuar publikisht më 1975, në Novi Sad, i refuzuar për botim!

¹²⁴ B. Hrabak, studimi i cituar, nuk është botuar si i veçantë, por është inkorporuar me disa shtrebbërime të vet autorit në rrethana të metastazimit fashizmit serb si libër: XHEMJET, 1994, f. 280.

rreshtuar drejtë kombëtarisht në Kongres, u kërkua që shkolla shqipe të pranohet, që reforma agrare t'i përfshijë të gjitha shtresat e shoqërisë. Vendasve u kërkua mos t'u grabitet toka e t'u dhurohet kolonëve sllavë, të cilët armatoseshin dhe me armë i grabitnin tokat e familjeve kaçake dhe atyre që ishin të pasura, krejt me qëllim që viset shqiptare të sllavizohen. Për këtë qëllim, u tha në Kongres, pushteti po sjellë mercenarë rus dhe sllavë tjerë, të cilët nuk janë bujq, por xhandarë dhe vrasës ordinerë të popullit, e ku po ndihmohen edhe nga ushtria dhe administrata¹²⁵.

ZGJEDHJET KOMUNALE DHE XHEMIJETI

Zgjedhjet komunale që u mbajtën më 22 gusht 1920, sollën në trevat e okupuara shqiptare një fenomen të afrimit të Xhemijetit me Partinë Radikale. Ndodhi ky afrim për faktin se Radikalët lejonin më tepër **autonomi lokale** dhe në këtë fushë shqiptarët e shihnin një shans që sado pak të kyçen në pushtetin i cili zbatohej pa kontroll, sepse ende shteti i ri nuk kishte kushtetutë të përbashkët. Shqiptarët donin një pushtet jo unitar dhe jocentralist¹²⁶.

ZGJEDHJET PARLAMENTARE NË MBRETËRINË SKS MË 28. XI. 1920

Zgjedhjet parlamentare në viset shqiptare mbahen nën kërcënimin se pushteti do të përdorë “shkopin, pushkën, topin dhe zjarrin kundër atyre që i rezistojnë Dinastisë”. Megjithatë, shqiptarët do të arrijnë t'i zgjedhin deputetë: Ali Shefikun, Haxhi Mustafën, Bejtullah Rexhepagajn, Emin Jasharin, Ismet Karabegun, Mahmut Omerin, Mehmet Alinë, Muhamed Mustafë Shehzadën, Ramush Osmanin, Qamil Jasharin, Qenan Zijën, Hysni Begun dhe Ali Riza

¹²⁵ “Hak”, nr. 653; H. Bajrami, Kosova 1918-1941, Prishtinë 1981, f.201.

¹²⁶ H. Bajrami, Kosova...f. 181, Në këto rrethana më 1 mars 1919 do të konstituohet Parlamenti i Përkohshëm i Mbretërisë SKS, i cili deri më 28 nëntor 1920 do të mbajë mbledhje në bazë të Kushtetutës serbe nga viti 1903.

Begun. Gjithsej ishin zgjedhë 13 deputetë, të cilët do të gjinden para detyrës së komplikuar që ta pranojnë ose jo Kushtetutën¹²⁷.

Në rrethana të pushtetit parafashist, në Parlamentin e konstituar më 29 XII 1920 do të aprovohet “OBZNANA”, me të cilën nuk sulmohen vetëm partitë që nuk ishin “shtetëformuese”, por edhe individët me ndikim politik dhe kombëtar¹²⁸. Në atmosferën politike terroriste që krijoi “Obznana” për t’u sjellë shteti me papërgjegjësi, Millorad Draskoviçi do ta vizitojë në mars 1921: Kaçanikun, Prizrenin, Gjakovën, Prishtinën, Vushtrrinë dhe Mitrovicën, duke lëshuar pastaj një ultimatum që të gjithë shqiptarët duhet t’i dorëzojnë armët deri më 10 mars 1921. Aksioni i çarmatimit do të përcillet me mizori nëpër të gjitha lokalitetet e shqiptarëve. Gjatë këtij aksioni barbar vriten **12.346** persona civilë, burgosen **23.060** persona, rrahën **1.635** persona duke mbetur për jetë invalid, digjen **6.025** shtëpi banimi, plaçkiten **10.515** shtëpi banimi të shqiptarëve¹²⁹.

SI U APROVUA KUSHTETUTA E VIDOVDANIT (28. VI. 1921)

Në opinion është krijuar bindja se Xhemijeti ka votuar dhe e ka mundësuar aprovimin e Kushtetutës anatishqiptare e quajtur e Vidovdanit, sepse u aprovua në ditën kur dikur kinse (më 28. VI. 1389) kishte ndodhë Lufta e Kosovës. Në fakt, dokumentet më të reja kanë argumentuar se ajo “luftë” nuk ka ndodhë fare, por është fiksuar nga popat dhe propaganda mesquine e sulltanëve, sepse u konvenonte që ta fshehin komplotin që i ishte bërë Sulltan Muratit nga të bijtë.

Kuvendi legjislativ i Mbretërisë SKS mbledhet më 12 dhjetor 1920, në bazë të një Rregulloreje të Përkohshme, e aprovuar më 8

¹²⁷ H. Bajrami, Kosova, Prishtinë 1981, f. 197

¹²⁸ H. Bajrami, Kosova 1918-1941, Prishtinë 1981, f. 193

¹²⁹ 14. Hakif Bajrami, Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizim serb i Kosovës 1844-1995, Prishtinë 1995. F. 96.

dhjetor 1920. Kuvendi legjislativ më 25 janar 1921 e zgjodhi **Këshillin Kushtetues** prej 42 anëtarësh. Këshilli u konstitua më 1 shkurt, ndërsa shqyrtimin e çështjes kushtetuese e filloi më 16 shkurt 1921. Afati për ta përpiluar Kushtetutën ishte për 14 ditë pune¹³⁰. Prej 42 anëtarëve të Këshillit Kushtetues, 23 votuan pro projektit kushtetues qeveritar, 19 ishin kundër. Lidhur me këtë, më 4 mars 1921, Këshilli Kushtetues shqyrtoi projektin e qeverisë dhe aty nuk parashihej që pakicat kombëtare të nominohen si kategori kushtetuese. Në këtë drejtim, më 13 maj 1921 Kushtetuta si projekt i Qeverisë u miratua në parim, me 227 vota pro (Radikalët, Demokratët, JMO, Fraksioni i Partisë Fshatare). Ndërsa votuan **kundër 93** deputetë (PKJ, Klubi Jugosllav me bunjevasit, Klubi Popullor, Socialdemokratët, Socialistët, **Xhemijeti**, Republikanët dhe një votë e dr. Ante Trubiqit). Pra, Xhemijeti në fillim votoi kundër Kushtetutës së Vidovdanit. Ndërsa më vonë e ndryshoi qëndrimin.

PSE XHEMIJETI VOTOI KUNDËR APROVIMIT PARAPARK TË KUSHTETUTËS?

Para se të hynin në votimin definitiv, Xhemijeti i parashtrroi pesë (5) pika si kusht për ta votuar Kushtetutën e Mbretërisë SKS. Ato pika ishin: 1. Pronat bujqësore nën 30 hektarë t'u mbesin pronarëve; 2. Kur prona e kalon kuotën 30 hektarë, pronarit t'i mbesin 75% të asaj prone, ndërsa 25% t'i nënshtrohet reformës agrare, por ajo sasi e pronës të kompensohet; 3. Prona si tërësi të përkufizohet nga viti 1912; 4. Maksimumi i pronës të pranohet ai që ishte në vitin 1912, duke e përfshirë edhe atë që e kanë grabitë (sllavët) uzurpatorët; 5. Ndarja e pronës të mos bëhet në baza fetare dhe kombëtare bujqve që kanë ardhur nga jashtë shtetit¹³¹.

¹³⁰ H. Bajrami, Kosova 1918-1941, Prishtinë 1981, f. 196

¹³¹ H. Bajrami, Kosova 1918-1941, Prishtinë 1981, f. 196; "Hak" 3 mars 1921.

Në këto rrethana do të fillojnë “pazaret” intensive me Xhemijetin nga ana e Nikolla Pashiqit. Dhe, Xhemijeti do të heq dorë nga 4 kërkesat e paraqitura, por do të mbetet vetëm pranë pikës së parë (1). Kështu, më 28. VI. 1921 aprovohet Kushtetuta e Vidovdanit me **223** vota **pro**, **35** vota kundër dhe **161** vota abstenim. Kësaj radhe tekstin e Kushtetutës e mundësoi për t’u aprovuar vota e **13** deputetëve të **Xhemijetit**, sepse Radikalët premtonin dhe e kishin futur në nenet e saj autonominë lokale “si prioritet”. Dhe, duke u gjetur me Kushtetutë shtetërore që e garantonte Dinastinë serbe, Qeveria më 2 gusht 1921 aprovoi “**Ligjin mbi mbrojtjen e shtetit**”, që ndryshe u quajt “**Ligji i Vdekjes**”, duke i siguruar popullit serb konceptin unitarist të shtetit dhe duke vënë në horizont krijimin e një Jugosllavie homogjene dhe Serbia në te të avancohet në subjekt integral. Ky synim doli në sipërfaqe më 6 janar 1929, me suprimimin e Kushtetutës dhe me proklamimin e Mbretërisë Jugosllave, në mënyrë që paralajmëronte se po “krijohej populli jugosllav” e që duhej të ishin serbët kudo që jetonin në shtet. Me këtë serbët duhej ta kishin primatin, në mënyrë që gradualisht disa popuj t’i shfartosin (shqiptarët...) dhe disa të tjerë t’i konvertojnë¹³².

KONGRESI I TRETË I XHEMIJETIT (14–18. IV. 1922)

Kongresi i Tretë i Xhemijetit mbahet më 14–18 IV 1922 në Shkup. Temë kryesore ishte çështja e pengimit të **kolonizimit** të viseve shqiptare me sllavë dhe respektimi i një reforme agrare të drejtë. Para se të fillohet me çështjen e arsimit të myslimanëve (shqiptarëve), në Kryesinë e Xhemijetit në Kongres, përpos Ferat Dragës dhe Qenan Zijait, zgjidhen edhe: Rifat Rushidi i Mitrovicës, Fehmi Gjylbegu i Shkupit, Isnil Kemali i Manastirit, Hysen Hyseni i Prilepit. Njëherit Kongresi zgjedh një Këshill për arsim, ku hynin: Aqif Blyta, Qenan Zija, Bajram Ajvazi, i cili i sjell abetaret e para në Kosovë nga Tirana. Për herë të parë shumë anëtarë jo vetëm të Kryesisë, fillojnë t’i mësojnë gërmat e alfabetit

¹³² H. Bajrami, Kosova 1918-1941, Prishtinë 1981, f.197; Hak, 3-7 gusht 1921.

kombëtar, edhe pse ishin persona me fakultet. Në vijim diskutohet për pacenueshmerinë e banesës, lirinë e lëvizjes dhe tregtisë, për kthimin e të gjithë muhaxherëve në pronat e veta si dhe hynë në konkluzë se “kolonët sllavë nuk po merren me bujqësi”. Ky konstatim shkaktoi “bombë” në shtypin opozitar jugosllavë dhe botëror. Në fund do të diskutohet dhe programohet që Xhemijetit të merret me çështje sociale (me çështjen e varfërisë së 85% të anëtarësisë). Me propozimin e Ferat Dragës (që ishte kooptuar në Kryesi), aprovohet një dokument që kishte për bazë sigurimin e të drejtave elementare për qytetarët myslimanë në viset jugore, sepse shqiptarët po ndiqeshin dhe po internoheshin për asgjë, por faji ishte vetëm i llojit, pse ishin shqiptarë¹³³. Në fund të vitit Nikolla Pashiqi, duke menduar se është forcuar politikisht, më 16. XII. 1922, do të shpallë zgjedhjet parlamentare për 18 mars 1923. Kongresi shpali një strategji politike që krijoi famë në komb, por jo njohje që të frymojë shqip, sepse pushteti po e pengonte me çdo mjet¹³⁴.

KONGRESI I KATËRT I XHEMIJETIT (20–29 JANAR 1923)

Kongresi i Katërt i Xhemijetit mbahet më 20–29 janar 1923 në Shkup, si gjithëherë në Hotelin KOPAK (Kafja Pallas) në praninë e 100 delegatëve. Kongresin e hapi Rifat Ruzhdi Aga, kryetar i degës së Xhemijetit në Mitrovicë. Fillimin e Kongresit e drejton Qenan Zija, duke sjellë një fjalim të shkurtër se çfarë kishin biseduar Ferat Draga dhe Q. Zija me Nikolla Pashiqin më 4 janar 1923, në Beograd.

Kongresi punën dyditore në fillim do të kushtojë çështjes pse Xhemijeti e kishte votuar Kushtetutën e Vidovdanit më 28 VI 1920¹³⁵. Në vijim do të debatohet për pjesëmarrjen e Xhemijetit në

¹³³ Hak 1-16 XII 1922; KMKK, D.2, d. 708045; H. Bajrami, v. cit. f. 201.

¹³⁴ H. Bajrami, Kosova 1918-1941, Prishtinë 1981, f. 202.

¹³⁵ “Hak”, 30 janar 1923; Vidovdanski Ustav 1921 i njohova primena, studim në “Pravda” Sarajevë më 12 VIII 1921.

zgjedhjet parlamentare me listë të veçantë. Qenan Zija, si jurist, të pranishëmve do t'ua përkujtojë Ligjin Elektoral, të aprovuar më 27 qershor 1922. Lidhur me këtë, sipas nenit 70 të Kushtetutës, të drejtë vota kishin ata persona që i plotësonin tri (3) kushte: 1. Duhej ta kishin shtetësinë e Mbretërisë SKS; 2. Duhej të kishin moshën minimale 21 vjeç; 3. Duhej kandidati të jetë mashkull. Të gjithë zgjedhësit kishin të drejtë **pasive**, në lidhje me kriterin se votuesi duhej të jetë shtetas i SKS. Të drejtë **aktive** kishin të gjithë ata shtetas që i kishin mbushur 30 vjet dhe që duhej ta njihnin në të folur dhe të dinin shkrimin serbisht¹³⁶.

Kongresi u mbajt në prani të **61 delegatëve**. Këshilli i Përgjithshëm (**Hejeti Feale**) debatoi për pjesëmarrje në zgjedhjet parlamentare. Për paraqitje të Xhemijetit as me radikalë e as me demokratë, votoi Këshilli i Ekzekutiv (**Hejeti Teftishije**), duke i kandiduar deputët për secilin qark administrativ.

Siç dihet, në zgjedhjet parlamentare më **18 mars 1923**, Xhemijeti i fitoi **14** deputetë: Aqif Blyta–Zveçan, Qamil Jashar beu për Tetovë, Qamil Osmani për Shkup, Qenan Zija për Manastir, Dervish Sherkajdiu për Priepole dhe Beranë, Ferat Draga për Rashkë–Zveçan, Xhemijl Agushi për Prishtinë, Halim beg Deralla për Tetovë, Hasan Shukri Mustafa për Shkup, Nazim Gafurri për Prishtinë, Rifat Rushiti për Zveçan, Sadedin Rushiti për Manastir, Salih Jusufi për Llap, Shaban Mustafa për Mitrovicë¹³⁷.

Para se të shkohet në zgjedhje, **Këshilli i Përgjithshëm** më 9 shkurt 1923 e botoi në Hak një proklamata ku thuhej: Të luftojmë për zhvillim kulturo–arsimor të myslimanëve në Jug; Të luftojmë për zgjidhje të çështjes agrare, ashtu si kanë vepruar shtetet e civilizuar; Prodhuesit e duhanit ta rrisin prodhimin dhe t'u ndihmohet në kultivim; liria dhe të drejtat e garantuara të respektohen njësoj për të gjithë qytetarët; Anarkia që e favorizon pushteti të zhvishet me

¹³⁶ Ustav Kraljevine SHS, çlan 70; Izborini sistem Kraljevine SHS, f. 50.

¹³⁷ “Hak” 30 mars 1923-me germa arabe: “Fitorja brilante e Xhemijetit”.

fakte para botës nga Klubi i Deputetëve të Xhemijetit në Kuvendin e SKS. Kongresi për herë të parë debatoi për pozitën e shqiptarëve duke akuzuar uzurpimet e pronave të tyre, nga ana e funksionarëve serbë—malazezë. Kongresi debatoi edhe për organizatat terroriste të pushtetit si: Bella Ruka, Crna Ruka, N. Odbrana, ORJUNA, SRNAO etj, të cilat ndihmoheshin tinëzisht nga ushtria, kisha dhe xhandarmëria, për likuidimin e Lëvizjes së armatosur shqiptare, të cilën e drejtonte KMKK, ku fjalën kryesore e kishin: Hasan Prishtina, Bajram Curri, Elez Isufi, Azem Bejta, Mehmet Kojufi, Vllëzrit Bajqinofci, Ramë Vllasa, Iliaz Raçaku, Jusuf Mehaniqi etj.

Për herë të parë **agjentët e pushtetit që ishin të pranishëm në Kongres, i shkruajnë Ministrisë Punëve të Brendshme**, se kjo organizatë nuk ka më premisa fetare, por thjesht kombëtare shqiptare, që duhet konsideruar si filialë e KMKK. Këto fakte flasin se zanafilla për ndalimin e Xhemijetit ishte nga fundi i vitit 1923, kur publikisht Xhemijeti kërkoi më shumë lidhje me Shqipërinë, për ta hapur kapitullin e hapjes së shkollave shqipe, të cilat pushteti i refuzonte me çdo mjet¹³⁸.

ZGJEDHJET KOMUNALE NË GUSHT 1923 DHE REFLESIONET POLITIKE

Pjesëmarrja masive e shqiptarëve në zgjedhjet parlamentare dhe fitimi i 14 vendeve në Parlament do ta **frikësojë** tejmasë dinastinë dhe qeverinë e saj. Prandaj, jo vetëm radikalët, por edhe demokratët dhe organizatat terroriste serbe me kishën në ballë, ndërmorën sulme frontale ndaj zgjedhësve në Qarkun e Kosovës dhe në Qarkun e Zveçanit. Sidomos në Prishtinë, do të komentojë Ferat Draga në interpelancën e tij në Parlament, por edhe në

¹³⁸ Fjalimi i Ferat Dragës në Parlamentin e M. SKS, në Stenografske Beleshke Narodne Skupshtine Kraljevine SHS, separat; Fjalimi i Ferat Dragës është botuar edhe në gjuhën shqipe, së pari në: “KOHA DITORE”; Fjalimi i Jovan Magovqeviqit më 30 III 1924; Fjalimi i Aqif Blytës në Parlamentin e MSKS më 30 III 1924 në “S. Beleshke” nr. XXXI.

Mitrovicë do të vriten, duke shkuar në zgjedhje, 26 shqiptarë. Vrasja do të ndodhë për t'i frikësuar zgjedhësit që me fuqinë e votës t'i marrin drejtimit e komunave. Pushteti robërues i kolonizimit dhe synimit të sllavizmit, të shpërnguljes dhe shfarosjes së shqiptarëve, megjithatë nuk do t'ia arrijë për ta fashitur fuqinë demokratike të popullit, që të merret pushteti me fuqinë e votës. Populli ishte rreshtuar kështu që nga poshtë–lartë të merret pushteti në trojet e tyre, ku dominonte shumica absolute shqiptare, edhe pse edhe me fuqinë e armës ishte rreshtuar Lëvizja Nacionalçlirimtare (Kaçake) Shqiptare, e drejtuar legalisht nga Komiteti i Kosovës. Lidhur me këtë, dokumentet e kohës vërtetojnë se edhe Xhemijeti i drejtuar nga Ferat Draga, ishte ilegalisht në anën e Azem e Shotë Galicës, me luftëtarë anëmbanë viseve të robëruara shqiptare¹³⁹.

Në rrethana të një fushate barbare antishqiptare u mbajt Kongresi vijues i Xhemijetit në Shkup. Kongresi mbahet për dy arsye. Së pari më 17. XII. 1923 në **Gjenevë “Lidhja e Kombeve”** do të debatohet për çështjen çame, dhe sigurisht falë luftës diplomatike të KMKK dhe Xhemijetit, do të vinte në rend dite në Lidhje të Kombeve edhe çështja e Peticionit të Hasan Prishtinës, Bajram Currit dhe Bedri Pejani. Prandaj jo vetëm Nikolla Pashiqi, por edhe Ahmet Zogolli do të organizojnë likuidimin e Avni Rrustemit, që ishte zë i fuqishëm i vegjëlisë dhe shqiptarëve të robëruar, e që mendonte, fliste dhe vepronte ashtu si e këshillonte zëri i ndërgjegjes kombëtare, që t'i dali krah pjesës së robëruar të kombit. Pikërisht për këtë arsye, më 20 prill 1924 do të bëhet atentat mbi tribunin e popullit, Avni Rrustemin, në Tiranë. Avniu vdiq më 22 prill 1924, për ta ngritur tërë ndërgjegjen kombëtare kundër tiranisë kudo që vepronte. Për këtë arsye më 25 maj 1924, Bajram Curri me forcat e

¹³⁹ Interpelanca e Ferat Dragës, në “Stenografske beleške Narodne Skupstine, 30 mars 1924; Jovan Magovceviqi, Replika ndaj fjalimit Ferat Dragës 30 mars 1924; Interpelanca e Aqif Blytës për mizoritë e pushtetit SKS në Krahinën e Sanxhakut, 30 mars 1924-fotokopje te autori nga viti 1976; A.J. S. 14. K. 192-Tajni sastanci ORJUNE za krvave izbore na Jugu”, analizë për përdorim intern, dok. i paregjistruar.

veta marshoi drejt Tiranës, për ta sjellë në pushtet tribunin dhe intelektualin më famë-lartë kombëtar, Fan Nolin¹⁴⁰.

Ky realitet e mobilizoi pushtetin e Beogradit që t'i hyjë përgatitjes për likuidimin edhe të prijësit të kryengritjes shqiptare, Azem Bejtës, duke e plagosë atë në një luftë frontale me ushtrinë më 15 korrik 1924. Azem Galica vdiq nga plagët më 25 korrik 1924, për t'u varrosë 72 metra nën dhe në një shpellë të tokës Kosovës (Drenicë). Varri t tij ishte enigmatik dhe prej tij pushteti e kishte frikën në çdo kohë, deri më 1941 kur kapitulloi turpshëm. Pushtetin e Beogradit e frikoi edhe fakti se më 6 tetor 1924, Këshilli i Lidhjes së Kombeve ia njohu Shqipërisë juridiksionin mbi Shën Naumin. Ky fakt e detyroi Nikolla Pashiqin, i cili Ahmet Zogollit i kishte siguruar strehim, që t'i hyjnë një pazari "alla-Esat Pasha". Qëllimi i atij pazari, për çka Xhemijeti nuk mund të qëndronte indiferent, sidomos Ferat Draga dhe Aqif Blyta, do të mësohet dhe informohet populli i robëruar se Zogolli ishte dakorduar me N. Pashiqin për t'u ndihmuar me ushtri dhe xhandarmëri që të sulmohet pushteti demokratik i Tiranës nga tri drejtime: nga **Peshkopia** forcat mercenare (12.000) i drejtonte major Leon de Gjilardi, nga Prizreni dhe Luma ku komandonte Ceno Bej Kryeziu me 3.000 mercenarë, një skuadër që ishte përgatitur në Podgoricë prej 1.400 mercenarëve rusë dhe serbomalazezë, të cilët duhej bllokuar Shkodrën dhe nga Qafë Thana 700 mercenarë të drejtuar nga Malo Bushati dhe Salahedin Blomshi. Dokumentet e Xhemijetit zbulojnë se luftimet më të përgjakshme mercenare-shqiptare ishin zhvilluar në zonën ku komandonte Ceno Begu me disa oficerë serbë. Me forcat jugosllave (serbe) në prapavijë dhe

¹⁴⁰ DASIP B. "Marmabo", F. 118- Kombinimet për t' u hakmarrë për atentatin ndaj Esat Pashës dhe për të dominuar Serbia në viset e robëruara shqiptare, por edhe për ta kontrolluar me mercenarë pushtetin e Tiranës, Analizë më 18 XII 1924; AVIIB. P. 17. K. 23- Vojni i politički uzroci intervencije na Jugu, decembar 1924.

logjistikë primare, komandonin oficerët e lartë vragellistë, të cilët ishin arratisë nga Rusia më 1918¹⁴¹.

Rezultati i zgjedhjeve komunale në gusht 21–23 gusht 1923 dëshmoi se Xhemijeti do të ndalohet shumë shpejtë. Në sajë të terrorit shtetëror që i “fitoi” votat me shkop, plumba dhe topa ishte një paralajmërim se pushteti ishte dridhur nga rezultatet e zgjedhjeve parlamentare të 18. III. 1923, kur Xhemijeti i fitoi 14 mandate. Në bazë të fakteve që prezantohen pas zgjedhjeve të përgjakshme, del se: në Rrethet e Vushttrisë radikalët kishin fituar në 9 komuna, në Rrethin e Gjakovës radikalët fitojnë në 6 komuna, 1 fitojnë demokratët dhe 1 radikalo–xhemijeti. Në Rrethin e Pejës në 6 komuna fitojnë radikalët, 1 komunë e fitojnë demokratët. Në Rrethin e Sharrit 14 komuna i fitojnë radikalët dhe 2 komuna i fitojnë demokratët. Në Rrethin e Nerodimës 6 komuna i fitojnë radikalët, 2 komuna i fiton Xhemijeti, 1 demokratët dhe 1 i pavarur. Në Rrethin Mitrovicës 2 komuna i fitojnë radikalët, 6 komuna i fitojnë demokratët. Në Rrethin e Gjilanit të gjitha komunat i fitojnë radikalët, në Rrethin e Llapit 10 komuna i fitojnë radikalët, 1 komunë e fitojnë demokratët dhe 1 komunë të pavarurit. Në Rrethin e Graçanicës 6 komuna i fitojnë radikalët, 7 komuna i fitojnë demokratët dhe 1 komunë e fiton Xhemijeti. Për këto zgjedhje nuk jepen të dhëna për Rrethin e Drenicës, por në këtë krahinë u emëruan me terror përfaqësuesit radikalë. Krimet e çdo lloji u manifestuan sidomos në Prishtinë dhe Mitrovicë, ku sipas “Hak”, u vranë 26 deri në 27 zgjedhës shqiptarë¹⁴².

Kushtet me të cilat Ahmet Zogolli u kthye në pushtetin e Tiranës ishin pesë. Ato në hollësi i diskutuan në Sarajevë dhe u finalizuan në Beograd: 1. Ceno Bej Kryeziu të zgjidhet Ministër i Punëve të Brendshme në Shqipëri; 2. Xhandarmërinë në Shqipëri ta

¹⁴¹ AJ. S. 14. ‘Arhivalije’-Likudacija kaçačkih bandi, Elaborat 1924; Strategija povratka Zogollia na presto 1924, Prgram f. 1-29.

¹⁴² Politika, 21-23 gusht 1923; Fjalimi i Ferat Dragës në Parlament 30 mars 1924; Zgjedhjet e përgjakëshme në Kosovë në AJ. S. 14. K.53;63 dhe 64.

organizojë Mbretëria SKS; 3. Miniera e Pukës t'i jepet me koncesion Jugosllavisë (me qellim që të përcillet prej andej çdo lëvizje në veri të vendit); 4. T'i lejohet një vijë hekurudhore Mbretërisë SKS nga Prizreni e deri në Shëngjin; 5. Serbisë t'i dhurohet Shën Naumi dhe Taraboshi. Lidhur me këtë edhe "vjehtëri" i Zogollit që ishte arratisuar në Romë, do ta bëjë një pazar të tillë prej 16 pikash (janë botuar në Tiranë në: "Studime Historike"), por nuk patën asnjë relevancë, sepse Zogolli u shkëput nga Shefqet Verlaci, të cilin nuk donte ta ketë "vjehtëri". Pazarit është bërë, kuptohet me diplomatët serbë dheurvejuesit italianë. Por, këto akorde –pazare, dinakëria e Zogollit do t'i relativizojë më 24 janar 1925, me moton: **"Hyn në pazar, por mos u shit, sepse nëse shitesh, ma pazar nuk ka"**! Pas kthimit "triumfal" të Zogollit në pushtetin e Tiranës më 24 dhjetor 1924, nuk do të pranohet asnjë pikë e pazarit me jugosllavët në fillim. Dhe "anija" politike dhe shtetërore e Zogollit do të kthehet kah Roma, së pari në diskrecion e pastaj publikisht. Kështu, së pari do të likuidohet Elez Isufi më 28 XII 1924, për ta pasur "rahatinë në Shqipërinë e Mesme e sidomos në Dibër". Çështja e pacifikimit të Kosovës do të mbetet sipas Zogollit dhe Pashiqit, si detyrë ekskluzive serbe. Në këtë "pazar" hynte edhe roli i dyfishtë politik i Ceno Bej Kryeziut, me të cilin "princi i Matit nuk donte të merret menjëherë, por në vijim"¹⁴³. Në këtë projekt marrin pjesë 6 oficerë të lartë. Merr pjesë edhe Vasa Qubrilloviqi dhe një politikan deputet, i quajtur Jovan Magovqeviq, por edhe komisar i jashtëzakonshëm për Kosovë, Mihajlo Ceroviq. Madje, ishin aktiv edhe Tomë Popoviqi, Punisha Raçiqi dhe Miliq Kërsta¹⁴⁴.

¹⁴³ AVIIB. P. 17. K. 23, Vojni, politički i strategiski uzroci intervencije u Albaniji, da bi Kosovsko pitanje bilo u trećem planu u Drushtvu Naroda u Zhenevi 1924

¹⁴⁴ Shiko edhe: dr. Jusuf Osmani, Si u vra Ceno Begu në Pragë më 1928; Kush ishte Anton Beça dhe Akibiad Bebi e kush Shefqet Verlaci në: AVIIB. P. 17. K. 619- "Biografije albanskih përvaka, 1929".

KONGRESI I PESTË I XHEMIJETIT, 25. VI. 1924

Kongresi i Pestë i Xhemjetit mbahet më 25 qershor 1924 në Shkup në praninë e 500 delegatëve. Edhe ky kongres e kishte frikësuar tejmasë pushtetin e: kampeve të përqendrimit, djegieve të lokaliteteve, shpronësimit, shpërnguljes dhe shfarosjes së shqiptarëve në Anadoll. Prandaj, nga 1 e deri më **14 gusht 1924**, me të gjitha mjetet do të ndërmerret për likuidimin e Azem Bejtës dhe Lëvizjes Nacionalçlirimtare që e drejtonte KMKK publikisht dhe Xhemijeti ilegalisht. Lidhur me këtë fushatë, pushteti do të arrijë që ta përçajë Xhemijetin përbrenda, përmes disa turkoshakëve, si Qenan Zijës e disa xhemijeto–radikalëve tjerë, që i kishin lëshuar siprancat në të gjitha trevat e Shqipërisë Kontinentale si quhet ilegalisht treva shqiptare nga Ushtria e Mbretërisë SKS¹⁴⁵.

Në vijim, Qenan Zija do ta akuzojë **Hejetin** (Këshillin) dhe **Hakun**, se po mbanin lidhje ilegale me kaçakët e Azem Galicës. Qenan Zijës në Kongres i kundërvihet Halim Deralla i Tetovës dhe Qamil bej Kumaraxhiun nga Shkupi. Ferat Dragës në këtë kundërhënie nuk i mbetej rrugë tjetër, por të zbulohet dhe ta mbajë krahun e Halim Bej Derallës dhe Qamil Beut, ku manifestohet ai qëndrim në **Konkluzat e Kongresit**: 1.Pranohet puna e Klubit të Deputetëve; 2.Konkludohet se përçarja në Xhemijet nuk ka shkaktuar thyerje te anëtarësia; 3.Kërkohet që Klubi i Deputetëve të veprojë i pavarur; 4.Këshilli Kryesor ta përcjellë punën e Klubit të Deputetëve se si po e përfaqësojnë popullin në Parlamentin e Mbretërisë SKS¹⁴⁶.

PSE U NDALUA XHEMIJETI?

Papritmas, më 2 gusht 1924, me nxitje të radikalëve, sulmohet publikisht në shtyp Ferat Draga nga Halim Deralla, “sepse janë nën

¹⁴⁵ AJ.S. 14. K. 519, Është vrarë Azem Galica gusht 1924.

¹⁴⁶ “HAK”, 26 VI 1924; AJ. S. 14, K.101, Valda treba da bude zadnji kongres turaka”-analizë politiko-police; AVIIB. P. 17, K. 519- “Turci su na kraju svoje atiserpske delatnosti”, analizë nga Shkupi 28 VI 1924

ndikimin e Davidoviçit dhe Pribiçeviçit që Mbretëria SKS të konvertohet në Republikë”. Ferat Draga këtij sulmi i përgjigjet se “Nuk jam serb më i madh se Davidoviçi”! Me këtë akuzë Xhemijeti përçahet në dy **taborre**: në **grupacionin politik nacional** (F.Draga) dhe në grupacionin politik **anacional** (Q. Zija). Me këto ndryshime pushtetit të radikalëve do t’i hapet shtegu që pas vdekjes së Azem Galicës më 25 korrik 1924; pas kthimit triumfal të Zogollit në Tiranë më 24 dhjetor 1924; pas vrasjes Elez Isufit më 28 dhjetor 1924, të projektojë likuidime tjera të personaliteteve të luftës shqiptare për liri. Në këto rrethana Këshilli i Lidhjes së Kombeve më 6 tetor 1924 ia njeh Shqipërisë Shën Naumin dhe Jugosllavia do të trembet tejmasë mos një ditë me iniciativë të **Xhemijetit**, çështja e Kosovës do të del në rend dite në Gjenevë. Në këto rrethana, do të **ndalohet “Xhemijeti”** më **18. XII. 1924**. Menjëherë fillojnë burgosjet me moton: “Agjentët arnautë kundër Dinastisë” më 27 dhe 28 dhjetor 1924. Më 30 janar 1925 në Shkup burgoset Ferat Draga, i cili akuzohet se me prapavijë i ka tubuar **“myslimanët e tri racave: turke, serbe dhe shqiptare”**. Ferat Draga dënohet me 101 vjet burg. Burgini ishte parathënie për mos me marrë Xhemijeti pjesë në zgjedhjet parlamentare që do të mbaheshin më 8 shkurt 1925¹⁴⁷. Likuidimet e personaliteteve shqiptare vazhdojnë për ta vënë ndalimin e Xhemijetit nën “hije”:

Likuidimi Luigj Gurakuqit më 2 mars 1925, likuidimi i Bajram Currit më 29 mars 1925 dhe falja e Shën Naumit Jugosllavisë, tregon se Ahmet Zogolli po zbatonte nga pazari i pesë pikëve. Këto fakte e zbulojnë tërë prapavijën kriminale të dinastisë serbe, që kishte synim paralizimin politik të shqiptarëve, e pastaj të vinte në shprehje shfarosja, duke synuar një Konferencë ndërkombëtare (1926), si ajo e Lozanës 1923, për këmbimin e popullsisë në mes Greqisë dhe Turqisë. Jugosllavia synonte diçka të tillë me Turqinë, qysh më 1926. Për këtë arsye, me rastin e trevjetorit të Konferencës së Lozanës (Turqi – Greqi, 1923), Mbretëria SKS më 1926, do ta

¹⁴⁷ AVIIB.P.17. K. 23. “Ili kraj Xhemijeta ili opshti rat sa arnautima 29 XII 1914.

shtrojë pyetjen: “Pse edhe ne mos ta ndërtojmë një konventë të tillë, pasi që Xhemijeti është i vdekur, ndërsa KMKK i plagosur nga regjimi i Zogollit dhe paratë tona”?!

Bisedimet serbo–turke, herë të heshtura e herë publike, do të zgjasin deri më 11 gusht 1938. Por, Ferat Draga do t’u qëndrojë të gjitha presioneve politike, kishtare, ushtarake dhe policore jugosllave, duke kërkuar me të gjitha mjetet që të ruhet substanca e popullit shqiptar në trojet e veta stërgjyshore. Lidhur me këtë, ai do të konkludojë më 1925: “Aty ku ka shqiptarë, gjithmonë do të ketë Shqipni, edhe pse zyrtarisht, shumë troje shqiptare, tani quhen ndryshe. Shqipnia Kontinentale do të fitojë. Dhe kur të vdesim, kujdes me varret tona, nëse i hapni. Sepse, një dorë do ta gjeni të kthyer kah Sanxhku, e dorën tjetër do ta gjeni të kthyer kah Çamëria. Për Kosovën do të përkujdesen: populli, shkolla dhe pushka plotë, të cilat kanë veprue me një komandë – që siguron fitore!”¹⁴⁸. Pas këtij testamenti vizionar, likuidimet pas vdekjes N. Pashiqit, do të vazhdojnë: më 1928 vritet nga xhandarmëria serbe Nazim Gafurri në qendër të Prishtinës; më 1929 vritet nga policia sekrete serbe Shtjefen Gjeçovi në Zym të Hasit; më 1931 vritet nga policia sekrete serbe në Zagreb Milan Shuflaj; më 1933 vritet nga mercenarët e Zogollit dhe Boxha Maksimoviq–Kundakut në Selanik, Hasan Prishtina. Për të gjitha këto atentate **pistën** duhet kërkuar, kur foli hapur Ferat Draga në Parlament më 30 mars 1924¹⁴⁹.

FJALIMI HISTORIK I FERHAT DRAGËS NË PARLAMENT ËSHTË CENSURUAR

Ja pjesa që është censuruar dhe nuk është botuar kurrë në asnjë gjuhë, pra as në serbishte. **Në fund** shënojmë këtë argument të shprehur nga Ferat Draga në interpelancën e tij më 30 mars 1924, e cila është botuar pjesërisht në “Stenografske beleshke”, dhe ai fjalim

¹⁴⁸ AVIIB. P. 17. K.519-Izjave Kenana Zije isledniku MUD-a 1925

¹⁴⁹ AVIIB. P. 17. K. 519, Ko ih je sprečio i ko je naredjivao ubistva, strogo pov. 1935.

citohet pa mbarim. Por, aty është censuruar një “detaj” që flet shumë se Xhemijeti ishte parti **politike shqiptare**, me emër të lejuar konvertivë të gjuhës turke.

Ferat Draga më 30 mars 1924, në interpelancë do të shpërthej pas një provokimi nga Jovan Magovçeviq, malazezo–serb e shumë të tjerë nga salla e Parlamentit. **Aty Ferat Draga**, e tha edhe këtë: “.... **Unë jam shqiptar i Shqipërisë së Vjetër që quhet Kosovë**, i fisit Kelmend (Vuthaj), që i ka pasur rrënjët edhe në Toplicë, deri te Nishi, deri më 1878. Pra, unë dhe këta **14 deputetë** të Xhemijetit këtu, jemi shqiptarë, ma i vjetër se ti (Ju) në këto troje. Ju sllavët keni ardhur në shekullin e VII në pjesët veriore të rrjedhës së Danubit. Një kohë keni jetuar si paganë, pa fe, me adete të egra, si njerëz të shpellave. Në fund të shekullit XI keni arritur të stabilizoheni në disa vise të Krahinës së **Rases** – tani **Rashkës**, ku tani lidhet edhe Sanxhaku i Pazarit të Ri. Atëbotë të parët tanë arbanas i kishin mbi **1000 vjet krishterizëm** – religjion të besimit në një Zot. Larg jemi zotëri NE dhe JU, por robëria na ka sjellë NEVE këtu ku jemi sot, në dekadën e tretë të shekullit XX. Lidhur me këtë, duhet të hiqet një dilemë se të **katërmbëdhjetë** deputetët e Xhemijetit, që janë këtu, janë të gjithë shqiptarë prej babe e nane. **Rrënjën** e kanë shqiptare dhe le të mos dinë shkrim e lexim krilicë si ju kërkon. **Zotëri**, secili prej tyre i flet nga tri gjuhë, e besa me serbishten bëhet katër. E ju këtu gjuhën e juej (serbishten) e flisni me gabime të liga kulturore – civilizuese. Respekt Vuk Karaxhiqit. (Aplaudojnë republikanët dhe xhemijetlinjtë!). Ju serbët, më shumë keni fjalë fyese në fjalorin e juaj (Ju serbët pra, në të folur–FD), se sa shprehje lavdie e urtie jetësore e njerëzore. Lexoni pak më tepër shtypin evropian, çka thonë për juve. Lexoni mikun e Juaj Arqibad Rajsit, se çka thotë për tregtarët e juaj në kohën e luftës 1914–1918. Lexoni, lexoni se çfarë ‘partiotësh’ jeni. PO, tregtarët e juaj miellit i vënin edhe disa mule kg dhe për të grabitë para. Nga salla: “Ndoshta po mendon në ndonjë gjerman, mik të juaj nga Vjena!”. Zotëri ju serbët deri më 1903 më shumë e keni pas Mbretin në Vjenë se sa në Beograd. Ndoshta për këtë mungesë edhe keni bërë

atentat në te dhe familjen Obrenoviq. Ju e keni një mani, **derisa t’ju nevojitet një politikë, atë e fetishizoni. Kur nuk ju nevojitet e fjeni dhe e vrisni për vdekje.** Ashtu jeni sjellë me dhëndërrin e Juaj, kriminalistin dhe gazetarin Arqibad Rajs. Ai është këtu ende në Beograd dhe me iniciativë të tij na është rrëfyer në Klubin e Xhemijetit para disa javësh. Por, Ai është problem i juaj. Ndërsa, ne shqiptarët nuk urrejmë asnjë gjuhë, asnjë popull, por e kemi luftuar çdo robëri, dhe lufta jonë e lavdishme e Skënderbeut, mbetet për të mësuar secili komb në tokë, se deri ku i arrin skajet atdhetaria. E Ju, nga urrejtja do të plakeni shumë shpejtë. Këtë urrejtje e tregojnë rrudhat e juaja në fytyra, e tregojnë grimasat me të cilat më përcillni me sytë e juaj të përgjakur në zgjedhjet komunale në Prishtinë dhe Mitrovicë. Këtë patologji nuk mund ta fshihni. Nuk shtihet kodra në thes, si po tentoni, duke bërë cinizëm ndaj shqiptarëve në saje të ushtrisë franceze (1917–1918), që ju ka sjellë këtu ku jeni”.

Draga më tej vazhdon: “Ne shqiptarët do të vazhdojmë rrugën tonë, dhe atë nuk do jeni ju që na e detyroni, sepse këtë fenomen nuk ka arritur të na e imponojë as Osmanlia islamist, as katolicizmi i Vjenës, e askush tjetër. Nga salla: “Keni qenë pushtetarë të tokave 1389–1912?”. Po zotëri, pyetje provokative, por përgjigja është katastrofale për juve serbët, sepse kur erdhën turqit, toka ishte në duar të shumë feudalëve arbanasë, të cilët shumë shpejtë dhe me lehtësi e ndërruan fenë, për t’i ruajtur pronat, sepse armiku donte realitet të tillë. ”Svako ture (mysliman), mozhe vezir biti; E kujt është feja sunduese, e atij është edhe prona tokësore”, ishte moto e Osmanlisë. Në atë shtet 500 vjeçar kanë jetuar dy lloje qytetarësh: “milet i mysliman” (qytetari mysliman) dhe “milet i zëimë” (qytetari krishter). Nuk ka pra në atë Perandori as arbanas, as serb, as turq, etj. E ju, nuk e keni ndërruar fenë, sepse nuk keni pasur fe fare që tregonte stabilitet. E pra, nuk keni pasur as prona fare si popull me kulturë nomade. Pronat, sipas Panta Sreçkoviqit (historian konservativ serb–FD) dhe Konstantin Jureçekut, ishin të kishës (uniute), dhe të princit apo despotit. Bëri e i nguci kush ato prona, dënimet ishin drakonike. Ja se çka shkruan Jureçeku i Juej në

historinë e Serbisë. “Më 1330– Nëse një arbanas ose vllah vetëm thotë se ara ose kullosa ishte e tij, do të dënohet me 500 copë dele”... Reagime të zhurmshme, nuk dihet kush reagon!. **Draga vijon:** më vonë mbretërit dhe cari Juaj jetëshkurtër për nëntë vjet (1346–1355, Car Dushanit–FD). Shikoni se si është kurorëzuar Car Dushani në Shkup më 1346 si: “**Car i serbëve, arbanasëve dhe bullgarëve**”. Ky fakt lexohet te Spiridon Goçeviçi, të cilin e keni paguar t’ua shkruajë historinë! Dhe ajo “carevinë” e juaj ka zgjatë vetëm 9 (nëntë) vjet, pra deri më 1355. Aty është fundi i carevinës suaj, e cila pas kësaj kohe është bërë copë e grimë në princëri miniaturale. Askush nga princat e juaj e besa edhe tanët së bashku, nuk i ka dhënë llogari askujt, deri me instalimin e Osmanlive këtu më 1371 në Maricë; më 1375 në Nish dhe më 1387–1389 në Kosovë. Nga salla: “Mirë e paske mësuar historinë ore pasha i turkut’!. Jo zotëri, ne nuk jemi turq. E paskeni harruar atë porosinë e **Prota Matejës** nga viti **1881** kur i tha hapur popullit tuaj, për ta mësuar se kush jemi ne shqiptarët: “**Aranutu div junaku zlo ti se sa svih strana sprema, al u krvi junaçkoj mu bash ni kapi turske NEMA**”! Nuk kemi lidhje as fisi e as gjaku me turq. Por, zotëri demokratë dhe radikalë, pashë nuk ka pasur fisi im kurrë. Kryengritjet çlirimtare nuk i kemi ndërprerë kurrë. Ndërsa, historinë e kam lexuar dhe mësuar në dorëshkrimin e: **J. Tomiqit, O ARBANASIMA**, e botuar këtu në Beograd më **1913**”; e kam lexuar **Tucoviqin** ku ai thotë se **Karagjorgji** ishte **Kelmend**, pra baba i tij ka **fol** në **familje shqip**. Emrin e vërtetë e ka pasë **Pjetri**, e jo **Petroviq**. Ndërsa, **Karagjorgji** e kishte emrin e vërtetë **Gjergj**. Mu për këtë ia keni **prerë kokën** dhe ia keni dërguar Sulltanit në Stamboll më 1821, nga princi juaj Obrenoviq. E **Gjergji** i **Pjetrit** u ngrit në kryengritje më 1804, dhe deri atëherë ku ishit ju, i keni shërbyer Stambollit me pietet. E ne arbanasët jemi të njohur për **54** kryengritje të mëdha nacionale. Por, mos harroni se sulltanët duke menduar se ju kanë miq, ua lejojnë shkollat më 1868 në gjuhën e Vukut në Stamboll, e lëre më në Shumadi pa Beograd, e pa viset

tjera që i keni marrë me forcën e Gjashtë Fuqive në Berlin më 1878 dhe Londër më 1913.

Dhe më duhet hapur t` Ju them se shqiptarëve nuk ua lejoi sulltani i Stambollit shkollën në katër vilajetet e tyre denbabaden: në Kosovë, në Manastir, në Janinë e në Shkodër. Kjo është historia jonë. E përrallat e juaja janë kah japin shpirt, sepse u ka dalë boja. Nuk i beson më askush përshkrimit nëpër manastire dhe qymeze këngësh me lahutë. Bota po shkollohet e po sheh çdo pjesë të tokës se si jetohej. E ne shqiptarët jetojmë sot, për një jetë të lirë. Merreni “Radničke novine”, punimet e censuruara dhe do të mësoni kulturë njerëzore tolerante. Madje, e kam lexuar **Illaron Ruvarcin**, historian, dhe atij nuk kam arsye të mos i besoj. E kam lexuar Kosta Novakoviqin, para se të vij këtu në këtë Parlament, dhe më besoni se prapë popullin serb nuk e urrej”. Nga salla – “Mos po doni të bëheni Leninist?” Ferat Draga: “Jo zotëri, as mendja nuk më shkon, por shkoni e i pyetni punëtorët e mi në punishten time në **Moistir**, se si jam sjellë me ta. Aty ka pasur edhe serbë, jevgjë, e shqiptarë kuptohet 85%, por dallim kurrë nuk kam bërë. Unë jam nga natyra socialdemokrat”.

Nga salla: “Ti nuk e paske lexuar “**OBZNANEN**”? Draga: “Jo nuk e kam lexuar, por e kam kuptuar nga gjaku i derdhur në rrugët e Prishtinës dhe Mitrovicës gjatë zgjedhjeve komunale, ku venet e kryetarëve të komunave i keni grabitur me forcë. E kam ‘lexuar’ Obznanën, nga shembulli i shtëpive të rrënuara me topa e zjarr në viset arnauete nga ushtria dhe xhandarmëria. Për këtë që e them kam fakte dhe ato i ka botuar organi i Xhemijetit, gazeta HAK besnikërisht me titull: “Pokol u Prishtini i Mitrovici, 21–22 avgust 1923, Pokol u Dumnici 1924 e me radhë...”!¹⁵⁰

Pas mbarimit të seancës në Parlament më 30 mars 1924, Ferhat Draga do të skajohet për të bujtur në Klubin e **JMO**—së të Mehmet

¹⁵⁰ Materiali na është lejuar në “konfidencë” nga arkivistët me sinqeritet të plotë në “A-XXX”.

Spahos, i shoqëruar nga Aqif Blyta (i Sanxhakut), Nazim Gafurri (i Prishtinës) dhe Salih Hoxha (i Llapit). Aty do të qëndrojnë deri në ora 22 dhe pastaj nëpër terr të natës, do të vendosen në Klubin e “**Hrvatska Selačka Stranka**”, me leje të Stepan Radiqit, i cili u vra në Parlament më 1928, pikërisht nga kriminelët që bënin krime në Kosovë: Punisha Raçiq dhe Toma Popoviq, të shoqëruar nga Miliç Kërsta deri në hyrje të Parlamentit, sepse nuk ishte deputet. Atë natë (30 mars 1924) Ferhat Draga ishte paraparë të vritet nga milici i Punisha Raçiqit, i quajtur Miliç Kërsta. Por, do të pengohet nga Orestie Kërstiqi dhe shefi i kabinetit të N. Pashiqit. Për shkak se u kuptua më vonë që Draga kishte gjetur strehim te HSS-i kroat, Stepan Radiqi edhe për kundërshtime të tjera do të vritet në sallën e Parlamentit më 1928¹⁵¹.

Në fund të fundit ky patriot (**Ferhat Draga**), ka vdekur natyrshëm më 1944, por varri i tij është fare i pashënuar dhe pa përkujdesje kombëtare, edhe pse është zbuluar kohë më parë nga **dr. Jusuf Osmani**. Kujdes pra shqiptarë me të kaluarën, sepse nuk na lejohej më kështu, se gjithmonë politikanët të kanë vepruar në kushte si janë sot. Të jetojmë në kohën e tyre, me guximi e tyre. T'i kuptojmë vuajtjet e tyre, sakrificat e tyre, se si kanë mbijetuar duke bërë edhe oportunizma politike, por duke krijuar shanse historike të lindë **EPOKA e NEOLIFTES (1998–1999)**, së cilës i prijnë antifashistët, ideologët Hasan Prishtina deri më 1933, Bedri Pejani deri më 1941–1946, e pse jo nga 1941–1944 antifashisti Fadil Hoxha; nga ideologu i shekullit në luftë për çlirimin e Kosovës: **ADEM DEMAÇI (1958–1999)**; heronjtë Zahir Pajaziti, Salih Çeku, Agim Ramadani, Fehmi e Xhevë Lladrofc, Shkëlzen e Luan Haradinaj, Adrian Krasniqi, **Tahir Sinani** dhe mbi të gjithë **ADEM JASHARI**, gjithmonë, derisa të jetojë njeriu – sa të jetojë shqiptari mbi tokë.

¹⁵¹ A.J.S. 14, “Ostaci ‘Crne Ruke’ nisu unisteni”, Povodom atentata na Kralja Aleksandara u Marseju 1934”.

*HALIM PURELLKU**Universiteti i Tetovës*

XHEMIJETI NE ZGJEDHJET PARLAMENTARE NË RRETHIN E KËRÇOVËS (1920, 1923, 1925)

Mbretëria Serbo–Kroato–Sllovene formalisht u shpallë më 1 dhjetor 1918, si monarki kushtetuese parlamentare. Ndërkaq, me dekret (‘ukaz’) të Qeverisë Serbo–Kroato–Sllovene, më 1 mars të vitit 1919 kishte filluar punimet e quajtura: „Përfaqësia (Asamblea) e Përkohshme Popullore“ e Mbretërisë Serbo–Kroato–Sllovene (në vazhdim: Mbretërisë SKS). Në këtë asamble përfaqësohej dhe e ashtuquajtura: „Serbia Jugore“ me gjithsej 24 deputetë. Detyra themelore e „Përfaqësisë (Asamblesë) së Përkohshme Popullore“ ishte të përgatis zgjedhjet për Kuvendin Kushtetutëdhënës (Konstituanten) të Mbretërisë Serbo–Kroato–Sllovene.¹⁵²⁾

Ndërkohë, në Mbretërinë SKS u ringjallën partitë politike dhe u krijuan të reja, ashtu që tani në të ashtuquajturën „Serbia Jugore“ vepronin më shumë parti si Partia Demokratike, Partia Radikale, Partia Komuniste e Jugosllavisë, por dhe Organizata Nacionale Turke (Xhemijeti).

Qarqe të caktuara, me fe muhamedane (myslimane), nga „Serbia e Jugut“, që në vitin 1919 kishin ndërmarrë iniciativë për organizim politik te tyre, lidhur me qëndrimet që do të mbaheshin ndaj zhvillimeve politike e shoqërore në Mbretërinë SKS. Kjo iniciativë u kurorëzua me aktin e mbajtjes së kongresit në Shkup, i cili zhvilloi punimet me 18 dhjetor 1919. Në kongres morën pjesë 64

¹⁵²⁾ .) Владан Јовановић, Југословенска држава и Јужна Србија 1918-1929 (Македонија, Санџак, Косово и Метохија у Краљевини СХС), Београд, 2002, fq. 64.

delegatë „myslimanë“ nga të gjitha anët e të quajturës “Serbia e Jugut”. Kongresi vendosi të krijohet organizata politike me emrin: “Organizata Nacionale Turke (Xhemijeti)”, dhe për kryetar të saj u zgjodh Nexhip Draga, kurse për nënkryetar u zgjodh Sheh Sadudini. Në Kongres, u diskutua për parimet programore bazë mbi të cilat do të definoheshin aktivitetet dhe veprimtaria politike e kësaj organizate politike. Për hartimin e Projekt-programit u autorizua Këshilli, i përbërë nga Zuhri Beu, Mithad (?), Tefik Beu nga Koçani, Kadri Beu nga Shtipi dhe Sali Beu nga Shkupi.¹⁵³

Zgjedhjet parlamentare në vitin 1920: Zgjedhjet e para parlamentare për Kuvendin Kushtetutëdhënës në Mbretërinë SKS u mbajtën më 28 nëntor të vitit 1920. Ata u organizuan mbi bazë të Ligjit mbi Zgjedhjet, i aprovuar nga Asambleja e Përkohshme Popullore, më 3 shtator të vitit 1920, i cili ligj në esencë s’ishte gjë tjetër pos Ligjit mbi Zgjedhjet i Mbretërisë së Serbisë i vitit 1903 me ndryshimet dhe plotësimet e vitit 1910. Këto zgjedhje u organizuan mbi bazë të sistemit proporcional zgjedhor.¹⁵⁴ Zgjedhjet do të përcillen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, për këtë qëllim pranë kësaj ministrie vepronte “Sektori për Zgjedhjet” (Odelenje za izbore).¹⁵⁵

Në periudhën midis dy luftërave botërore as rrethi i Kërçovës nuk mbeti jashtë sferave të interesit dhe të ndikimit të partive politike jugosllave. Që në vitin 1920 partitë politike kryesore kishin ngritur “klubet” e tyre në këtë rreth. Jeta politike në rrethin e Kërçovës zhvillohej nëpërmjet aktiviteteve partiake; agitacion dhe propagan-

¹⁵³.) Архив на Институтот за национална историја (në vazhdim: АИНИ), Скопје, Фонд (në vazhdim: Ф.) Трета армијска област (në vazhdim: ТАО), Кутија (në vazhdim: К.) XXXV/3, Реден Бр. 379, Инвентар Бр. 6429, 6433, Пов. Ђ. Бр. 6429, 18.12.1919, Скопје dhe. Пов. Ђ. Бр. 6433, 18.12.1919, Скопје, Команда e Krahinës së Armatës III, Shkup, ministrit të Luftës, Beograd.

¹⁵⁴.) *Алманах Краљевине Срба, Хрвата и Словенаца, 1921-1922*, Загреб, 1922. Свезак I, Део 1, 2, 3, fq. 16-I.

¹⁵⁵.) Државен архив на Република Македонија (në vazhdim: ДАРМ), Скопје, Фонд (në vazhdim: Ф.) Архив на СФРЈ, Београд, Микрофилм М-С/1188, Бр. 11534, 7.12.1920, Штип.

dë, që intensifikoheshin veçanërisht gjatë proceseve të zgjedhjeve.¹⁵⁶ Sipas burimeve jugosllave, edhe Xhemijeti zhvillonte një fushatë politike të fuqishme ndër popullatën muhamedane të qarkut zgjedhor të Manastirit, do të thotë dhe në rrethin e Kërçovës, **në kuadër të të cilit qark ishte dhe ky rreth**, nëpërmjet myftinjve dhe imamëve.¹⁵⁷

Në zgjedhjet parlamentare (28.11.1920) në qarkun e Manastirit, që do të thotë edhe në rrethin e Kërçovës, me listat e tyre zgjedhore konkurruan katër parti politike, dhe atë: Partia Demokratike, Partia Radikale, Organizata Nacionale Turke („Xhemijetit“) me bartës të listës Qenan Zija dhe Partia Komuniste e Jugosllavisë. Lista zgjedhore (kandiduese) e Xhemijetit për qarkun zgjedhor të Manastirit, do të thotë dhe për rrethin zgjedhor të Kërçovës përfaqësohej nga feudalë dhe klerikë muhamedan. Ndërkaq, sipas nenit 13 të Ligjit mbi Zgjedhjet, në listën zgjedhore të Organizatës Xhemijeti, kandidonin dhe dy kandidatë nga rrethi i Kërçovës, ata ishin: Beqir Abduloviq, imam nga Kërçova dhe Sadudin A. Ahmedoviq (**Xhambazi**^{-H.P}), imam nga fshati Cërvicë i Kërçovës.

Në zgjedhjet e 28 nëntorit të vitit 1920, rrethi zgjedhor i Kërçovës administrativisht ishte në përbërje të qarkut zgjedhor të Manastirit dhe ishte i ndarë në 15 njësi zgjedhore—vendvotime.¹⁵⁸ Në rrethin e

¹⁵⁶.) ДАРМ, Скопје, Фонд (në vazhdim: Ф.) 1038, Кутија бр. 3, арх. един. 12, лист 44-46 (në vazhdim sipas këtij shembulli: 1038.3.12/44-46), Пов. П. Бр. 10, Кичево, 18.12.1920, Letër e një grupi të mësuesve në Kërçovë, mbikëqyrësit të shkollave, Kërçovë.

¹⁵⁷.) ДАРМ, Скопје, Ф. о1.1037-Министерство за внатрешни работи на Кралството СХС, Кутија о6 фасцикал о3, list 199 (Në vazhdim sipas këtij shembulli: ДАРМ, Скопје, Ф. о1.1037.о6.о3/199), Телеграм, 21.11.1920, Шифра из Битоља, Пов. Бр. 2170, прфектура e Manastirit, kabinetit të ministrit të РВ; Ро ату, Ф. Архив на СФРЈ-Београд, М. М-С/1188, Бов. Бр. 2170, Шифра из Битоља; Статистички преглед избора народних посланика за Уставотворну Скупштину Краљевине СХС, извршени на дан 28. новембра 1920, Београд, 1921.

¹⁵⁸.) ДАРМ, Скопје, Ф. Министерство за внатрешни работи на Кралството СХС, - о1.1037, о6.о1/42, Избори 1920-Изборен округ Ботолски; Ро ату, Ф. о1.1037.о6.о3/204, Кандидатска листа; Статистички преглед избора народ-

Kërçovës në këto zgjedhje të drejtë vote gëzonin gjithsej 7388 qytetarë/zgjedhës, nga të cilët votuan gjithsej 4176 votues ose 56,52% e zgjedhësve. Nga rezultatet e zgjedhjeve shihet se më se 40% e popullatës së këtij rrethi i bojkotoi zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese. Ndërkaq, Lista zgjedhore e Organizatës Nacionale Turke në rrethin e Kërçovës fitoi gjithsej 921 vota nga gjithsej 4176 vota. Ashtu që në bazë të rezultateve zgjedhore dhe sipas nenit 13 të Ligjit mbi Zgjedhjen e Deputetëve Popullor, nga qarku zgjedhor i Manastirit u fituan gjithsej 8 (tetë) mandate deputetësh nga partitë konkurruese, kurse Organizata Nacionale Turke fitoi një (1) mandat/ deputet, që do të thotë se asnjëri nga dy kandidatët e Xhemijetit për deputetë nga rrethi i Kërçovës nuk e fituan statusin e deputetit.¹⁵⁹⁾

Sipas vlerësimit të nënprefektit të rrethit të Kërçovës, procesi zgjedhor më 28 nëntor të vitit 1920 në këtë rreth u zhvillua „në qetësi të plotë”.¹⁶⁰ S’kishte se si të zhvillohej ndryshe, pasi që autoritetet kishin ndërmarrë masa paraprake të natyrës represive për të frikësuar popullin. Në këtë kuadër dhe xhandarmerisë i ishin dhënë autorizime të posaçme për të penguar me çdo kusht fushatën zgjedhore të kundërshtarëve të pushtetit, një masë e tillë ishte dhe fushata e angazhimit në ushtrime ushtarake në prag të zgjedhjeve të personave për të cilët dihej përcaktimi i tyre politike dhe disponimi i tyre se për kë do të votonin.¹⁶¹

них посланика за Уставотворну Скупштину Краљевине СХС, извршени на дан 28. новембра 1920, Београд, 1921.

¹⁵⁹.) ДАРМ, Скопје, Ф. о1.1037. 6.3/219-222, Телеграм бр. 310 из Кичева, 29.11.1920, (36548); Статистички преглед избора народних посланика за Уставотворну Скупштину Краљевине СХС, извршени на дан 28. новембра 1920, Београд, 1921.

¹⁶⁰.) Mr. Halim Purellku, Aktiviteti i PKJ-së në zgjedhjet e vitit 1920 dhe 1923 në rrethin e Kërçovës, „Jehona“, nr. 10, Shkup, 1986, fq. 88. ДАРМ, Скопје, Ф. о1.1037.о6.о1/42.

¹⁶¹.) АИНИ, Скопје, Ф. Збирка секавања, К. XXXVIII723, Ред. бр. 178; „Социалистичка зора“, Бр. 85, Скопје, 24.11.1920 dhe Бр. 86, 25.11.1920.

Zgjedhjet parlamentare në vitin 1923: Organizata e Myslimanëve të Jugut–„Xhemijeti“ („Bashkimi“) si organizatë politike vazhdonte të mëtojë të përfaqëson interesat e popullatës me fe muhamedane në jugun e Mbretërisë SKS, por dhe kjo popullatë, sipas vlerësimeve zyrtare, mbështeste organizatën në jetësimin e politikës së saj.¹⁶² Xhemijeti në përgatitjet për zgjedhjet e radhës, në konferencën e saj të mbajtur në Shkup, 20–29 janar të vitit 1923, miratoi njëzëri rezolutë që në zgjedhjet e reja të del e vetme pa u përfshi në koalicion.¹⁶³ Por, në ato zona ku myslimanët janë pakicë që vendosur të negociojnë me radikalët dhe demokratët për bashkëpunim.¹⁶⁴ Sipas burimeve jugosllave, qëndrimi i Xhemijetit pro qeverisë i dedikohet dhe sugjerimit nga Stambolli, nga se nga këtu i sugjerohej Xhemijetit që të ruajë marrëdhënie sa më të mira me Qeverinë jugosllave dhe në varësi nga rrethanat lokale t'i udhëzon, siç thuhet shprehimisht, „turqit“ (do të thotë se politika zyrtare turke vazhdonte të mohon identitetin dhe qenien kombëtare të shqiptarëve) të votojnë për radikalët, kurse në raste të veçanta nëse Pashiqi nuk pranon kushtet e Xhemijetit, atëherë ata të votojnë të pavarur.¹⁶⁵ Për bartës të listës zgjedhore të Xhemijetit në qarkun zgjedhor të Manastirit që nominuar Qenan bej Zija.¹⁶⁶

Në zgjedhjet parlamentare të mbajtura më 18 mars 1923, rrethi i Kërçovës sërish përbënte rrethin votues, i ndarë në 15 vendvotime. Rrethi votues i Kërçovës përfshihej në kuadër të qarkut votues të Manastirit. Sipas legjislaturës zgjedhore (elektorale) të atëhershme,

¹⁶².) ДАРМ, Скопје, Ф. о1.1037.06.02/86, Строго. Пов.Бр. 1, 2 јануара 1923, Скопље, prefektura e Shkupit, ministrit të PB.

¹⁶³.) ДАРМ, Скопје, Ф. о1.1037.06.02/86, Бр. 33, 31 јануара 1923, Скопље, Prefektura e Shkupit, Ministrisë së PB.

¹⁶⁴.) ДАРМ, Скопје, Ф. о1.1037.06.02/90, Телеграм, 24.01.1923, Шифра из Скопља, Пов. Бр. 8, nga Zhupani i madh i Shkupit, kabinetit të ministrit të Punëve të Brendshme.

¹⁶⁵.) ДАРМ, Скопје, Ф. о1.1037.06.02/97, Пов. Ђ. Бр. 1335, 7.02.1923, у Београду, inspektori, kabinetit të Ministrisë së PB.

¹⁶⁶.) ДАРМ, Скопје, Ф. о1.1037.06.02/92, Telegram, 30-31.01.1923, Шифра из Скопља, Поверљиво, Zhupani i madh i Shkupit, ministrit të PB.

të drejtë votomi gëzonin vetëm burrat që ishin shtetas të Mbretërisë SKS dhe të cilët i kishin mbushur 21 vjet moshë. Kështu që, sipas këtij sistemi zgjedhor, në rrethin e Kërçovës në 100 banorë burra, të drejtën e votës e gëzonin 57,5% prej tyre apo gjithsej 7651 veta. Përkatësisht, nga popullata e gjithmbarshme e rrethit të Kërçovës të drejtën e votës e gëzonin vetëm 27,2% e popullatës.¹⁶⁷

Në nivel të qarkut zgjedhor të Manastirit, do të thotë dhe në rrethin e Kërçovës, gjashtë (6) parti politike paraqitën listat e tyre zgjedhore me bartësit e listave, por në çdo listë zgjedhore ishin nominuar dhe kandidatë dhe zëvendës nga çdo rreth zgjedhor i përfshirë në kuadër të këtij qarku zgjedhor. Organizata Xhemijeti, për bartës të listës zgjedhore në këtë qark kishte nominuar Qenan Zija, me profesion rentier dhe ish deputet nga Manastiri, kurse kandidatë të listës nga rrethi i Kërçovës ishin Abdul Amid, imam nga Kërçova dhe zëvendës—Ali Memed, rentier nga Kërçova.¹⁶⁸

Në zgjedhjet parlamentare të 18 marsit të vitit 1923, në rrethin e Kërçovës votuan 4549 ose 59,5% e zgjedhësve. Më së shumti vota në këtë rreth fitoi Lista zgjedhore e Xhemijetit dhe atë: 1.897 ose 41.7% te votave. Në bazë të rezultateve në këto zgjedhje, nga qarku zgjedhor i Manastirit partitë kandiduese fituan gjithsej gjashtë (6) mandate deputetësh. Sipas përkatësisë kombëtare: 4 deputetë ishin serbë, 1 ishte shqiptar dhe 1 ishte turk. Ndërkaq, Xhemijeti fitoi dy (2) deputetë, dhe atë: Qenan Zija dhe Sadedin Rushid, njëri ndjehej shqiptar dhe tjetri turk.¹⁶⁹

¹⁶⁷.) ДАРМ, Скопје, Фол.1037.06.04/275, Изборни округ Битолски; По ату, о1.1037.06.04/276 dhe 284, Рекапитулациона окружна листа; Статистика избора народни посланика Краљевине СХС, 18.03.1923, (Израдио Д-р Лаза М. Костић), Београд, 1924, fq. 1, tabela I, 4, 13, tabela IV, fq. XIII..

¹⁶⁸.) ДАРМ, Скопје, Ф. о1.1037.06.04/266, Пов. Бр. 132, 22.02.1923 год., Битољ, zhupani i madh i Manastirit, ministrit të PB; Статистика избора народни посланика Краљевине СХС, 18.03.1923, (Израдио Д-р Лаза М. Костић), Београд, 1924, fq. 2, tabela II.

¹⁶⁹.) Статистика избора народни посланика Краљевине СХС, 18.03.1923, (Израдио Д-р Лаза М. Костић), Београд, 1924, fq. 4, 13, 160 dhe 165-166.

Zgjedhjet parlamentare në vitin 1925: Në zgjedhjet parlamentare të 8 shkurtit të vitit 1925, përsëri rrethi i Kërçovës përbënte rrethin votues të Kërçovës dhe ishte i ndarë në 15 vendvotime. Ky rreth edhe në këto zgjedhje ishte në përbërje të qarkut zgjedhor të Manastirit. Në këto zgjedhje, në qarkun zgjedhor të Manastirit, do të thotë edhe në rrethin zgjedhor të Kërçovës, u paraqitën njëmbëdhjetë (11) lista zgjedhore të partive të ndryshme politike, nga të cilat edhe lista e Organizatës së Myslimanëve të Jugut, me bartës të listës Qenan Zija dhe lista e Xhemijetit me bartës të listës, Mahmud Neadim Adem.

Në këto zgjedhje, në rrethin zgjedhor të Kërçovës të drejtë vote gëzonin gjithsej 7920 veta (zgjedhës), kurse nga ata në zgjedhje dolën gjithsej 4972 votues. Ndërkaq, shumicën e votave në rrethin e Kërçovës i fitoi Partia Popullore Radikale. Kurse Xhemijeti në këto zgjedhje fitoi në qarkun votues të Manastirit vetëm 961 vota ose 2.9% dhe në këtë qark nuk fitoi asnjë mandat/deputet, kurse Organizata e Myslimanëve të Jugut në këtë qark fitoi gjithsej 2530 vota apo 7.8%. Ndërkaq, në rrethin e Kërçovës, Xhemijeti fitoi vetëm 39 vota ose 0.8%, kurse Organizata e Myslimanëve të Jugut fitoi 453 vota ose 9.1%. Kështu, në bazë të rezultateve nga këto zgjedhje, në qarkun zgjedhor të Manastirit u fituan gjithsej 6 (gjashtë) mandate deputetësh, dhe atë 3 deputetë fitoi Partia Radikale dhe 3 deputetë Partia Demokratike, kurse Organizata e Myslimanëve të Jugut dhe Xhemijeti, nuk fituan asnjë **mandat** deputeti.¹⁷⁰

Ndërkaq me diktaturën monarkofashiste të 6 janarit të vitit 1929, u likuiduan plotësisht të gjitha mbeturinat e demokracisë parlamentare në vend. Bartës të diktaturës u bënë ushtria dhe policia, ata e shtypnin çfarëdo tendence progresive shoqërore në vend.¹⁷¹ Me zbatimin e diktaturës së 6 janarit u shpërndanë dhe u ndaluan të

¹⁷⁰.) Статистика избора народни посланика Краљевине СХС 8.02.1925, Београд, 1926, fq. 3, 140-141, 148-149 dhe 152-157.

¹⁷¹.) Juliana Vrčina, Naša najnovija istorija, Pregled (1919-1945), Beograd, 1967, fq. 88-89.

gjitha organizatat dhe partitë politike, në radhë të parë ato nacionale dhe insistohej për formimin e organizatave politike me orientim pro-regjimit. Por, nën ndikimin e rrethanave ndërkombëtare dhe të krizës ekonomike në vend, mbreti ishte i detyruar që në shtator të vitit 1931 të sjellë të ashtuquajturën "Kushtetutën e oktrouar". Me këtë formalisht në vend sërish u vendos sistemi parlamentar, me këtë edhe pluralizmi politik, që ndihmoi në përtëritjen e jetës politike në vend.¹⁷²⁾

¹⁷²⁾.) Juliana Vrčinac, Naša najnovija istorija..., fq. 109-110.

NEBI DER VISHI

Universiteti i Tetovës

VEPRIMTARIA E QENAN ZIJA – MANASTIRLIUT (1863–1935)

Xhemijeti (Bashkimi) 1919 – 1925 ishte parti legale e shqiptarëve myslimanë në Mbretërinë Serbo – Kroato – Sllovene, e cila u formua 98 vjet më parë, më 18 dhjetor 1919 me seli në Shkup. Në mesin e 64 delegatëve, pjesëmarrës në Kongresin e Parë ka qenë edhe Qenan Zijai (i njohur me mbiemrin edhe Manastirliu), të cilët përfaqësonin të gjithë viset shqiptare që nga Mexhitlia në jug e deri te Tregu i Ri (Novi Pazari) në veri.

Duke u mbështetur në Programin dhe Statutin e miratuar në Kongresin e Parë, Xhemijeti shumë shpejtë do të organizohej si çdo parti tjetër e atyre viteve. Në radhët e shqiptarëve, Xhemijeti u njoh si “Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të Shqiptarëve, kurse në sytë e pushtetit të Mbretërisë Serbo – Kroato – Sllovene (SKS), si Organizata e Myslimanëve të Jugut, kurse në planin ndërkombëtar serbët e paraqitën atë si organizatë nacionale turke, për të pasur terren që t’i cilësonin shqiptarët si turq dhe të justifikonin dëbimin e tyre në Anadoll.¹⁷³

Një nga personazhet enigmatike që vepronte në kuadër të Xhemijetit në këto vite, ishte Qenan Zijai – Manastirliu nga Manastiri, rentier dhe deputet në Parlamentin e Mbretërisë SKS në vitet 1920 – 1925. Lindi në qytetin e Manastirit në vitin 1863 në një familje me prona të mëdha. Shkollën fillore dhe medresenë e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën ushtarake në Stamboll.¹⁷⁴ Duke u bazuar në studimet e deritashme kushtuar Qenan Zijait, aktiviteti i tij

¹⁷³ Fjalori Enciklopedik shqiptarë, Vëll. III, Tiranë, 2008, faqe 2951;

¹⁷⁴ Eugen Shehu, “Maqedonia shqiptare”, Tiranë, 2002, faqe 232;

politik mund të ndahet në dy pjesë: e para dhe pas vitit 1912. Në vendlindje kthehet në vitet e fundit të shek. XIX dhe kryen një varg funksionesh në administratën e Vilajetit të Manastirit. Në gusht të 1908 ishte prijës i Partisë Liberale si dhe merr pjesë në themelimin e Klubit “Bashkimi” dhe zgjidhet në Pleqësinë e Klubit.¹⁷⁵ Merr pjesë edhe në Kongresin e Dibrës në korrik të vitit 1909, për të cilin në vitin 1912 në Stamboll do të botojë librin “Debre Kongresi” (Kongresi i Dibrës)¹⁷⁶, ku jep shënime mjaft me vlerë për këtë tubim të organizuar nga xhonturqit.

Pas Luftës së Parë Ballkanike dhe vendosjes së administratës serbe, në vitet 1912–1915, Qenan Zijai do të shërbejë si tagrambledhës (rentier). Për aktivitetin politik të Qenan Zijajit pas 1912 do të citojmë historianin Reshat Nexhipi, i cili në mes tjerash thotë: “Si mjaft personalitete tjera shqiptare, edhe ky, për shkak të presionit të madh nga ana e pushtetit serb, që nuk duhet të jetë arsytim për të, ai harroi shpejt idealet e mëparshme kombëtare dhe filloi të deklarohet për turk, gjë që i mundësoi tepër jo vetëm që të mos përgjigjej për patriotizmin e mëparshëm, por të fitojë bile edhe privilegje të posaçme, duke u bërë pronar i tokave të mëdha në kohën e Jugosllavisë së vjetër borgjeze si dhe deputet”¹⁷⁷.

Në zgjedhjet e para parlamentare që u mbajtën më 28 nëntor 1910 për Parlamentin e Mbretërisë SKS, Qenan Zijaji – Manastirliu kryesonte listën e Xhemijetit (Bashkimit) për Qarkun e Manastirit, me ç’rast zgjidhet deputet i kësaj partie dhe së bashku me shtatë deputetët e tjerë, e mbështetën formimin e Qeverisë radikale që udhëhiqej nga Nikolla Pashiqi më 1 janar 1921¹⁷⁸. Grupi parlamentar i Xhemijetit do të marrë pjesë edhe në miratimin e Kushtetutës së Vidovdanit më 28 qershor 1921. Gazeta “Politika”

¹⁷⁵ Reshat Nexhipi, “Kongreset e Alfabetit dhe shkollave shqipe”, Shkup, 1992, f. 121;

¹⁷⁶ Ali Vishko, “Kongreset e Alfabetin dhe shkollave shqipe”, Shkup, 1992, f. 121;

¹⁷⁷ Reshat Nexhipi, “Shtypja dhe rezistenca shqiptare në Maqedoni nëpër shekuj”, Manastir, f. 173;

¹⁷⁸ Hakif Bajrami, “Rrethanat ekonomike e politike në Kosovë 1918-1941”, Prishtinë, 1982, faqe 216;

shkruante se për Kushtetutën votuan 223 deputetë, ndërsa 35 deputetë e kundërshtuan dhe 161 të tjerë abstenuan. Akti më i larë juridik u arrit të miratohet në saje të lëshimeve që bëri Qeveria ndaj Xhemijetit, të cilës iu premtua se do t'ia bëjë disa koncesione¹⁷⁹. Gazeta njofton në vazhdim se Kushtetuta u miratua, meqë votuan edhe myslimanët e Jugut si: Ali Shefkiu, Haxhi Mustafa, Bejtulla Rexhepagiqi... dhe Qenan Zijai.¹⁸⁰

Më 4 prill 1922 u mbajt Kongresi i Tretë i Xhemijetit (Bashkimit). Pas këtij Kongresi, filloi një etapë e re e kësaj organizate politike. Pas shumë seancash të 61 pjesëmarrësve, Kongresi zgjodhi Qenan Zijanë nga Manastiri – për kryetar, Ismet Bej Kemalin – nënkryetar, (deputet nga Gjakova) dhe Kemal Osmanin – arkëtar nga Shkupi. U zgjodhën edhe dy organe: Këshilli Qendror dhe Këshilli Ekzekutiv si dhe u vendos që gazeta “Hak” (E Drejta) të dalë për çdo ditë në gjuhën turke dhe dy herë në javë në gjuhën serbokroate.¹⁸¹

Në zgjedhjet e dyta parlamentare të 18. 03. 1923 për Parlamentin e Mbretërisë SKS, në Qarkun e Manastirit marrin pjesë gjashtë parti politike dhe zgjedhin 6 deputetë nga kjo njësi zgjedhore. Listën e Xhemijetit e kryesonte Qenan Zijai, e cila fitoi 6742 votues ose 23,4%¹⁸² dhe dy mandate deputetësh Qenan Zijai dhe Sadedin Rushidi, po ashtu rentier nga Manastiri. Në këto zgjedhje parlamentare Xhemijeti fitoi 14 deputetë.

Më 25 maj 1923 për kryetar të Kuvendit të Mbretërisë SKS zgjidhet Luba Jovanoviqi dhe në këtë mënyrë radikalët kryen pjesën e parë të programit për formimin e qeverisë së tyre. Në Kuvend nuk kishin ardhur deputetët e Partisë Fshatare Kroate dhe në vend të 312 deputetëve ishin vetëm 245. Në mesin e tyre ishin: 108

¹⁷⁹ Gazeta “Politika”, Beograd, 29.06.1921;

¹⁸⁰ Po aty;

¹⁸¹ Hakif Bajrami, Rrethanat politike dhe ekonomike në Kosovë, Prishtinë, 1982, faqe 217;

¹⁸² Statistika izbora narodnik poslanika Kralevine SHS, održanih 18 marta 1923 godine, Beograd 1924, str 13-14.

radikalë, ndërsa 115 të opozitës (51 demokratë, 11 të Partisë Bujqësore, 2 të Partisë Socialdemokrate, 2 të Partisë Federaliste Malazeze etj). Partia Radikale arriti marrëveshje me Partinë Xhemijeti që kishte 14 deputetë, në mesin e të cilëve edhe Qenan Zijai – Manastirliu, si dhe me Partinë Gjermane që kishin 8 deputetë, dhe në këtë mënyrë siguruan shumicën e nevojshme prej 130 deputetësh nga 245 sa ishin prezentë¹⁸³.

“Bashkimi” (Xhemijeti) në fillim paraqitej si organizatë që zhvillonte aktivitete kulturore – arsimore, por duke pasur edhe qëllime të tjera, kjo parti arriti që të depërtojë te shtresat e ndryshme shqiptare në Jugosllavi. Në fillim u quajt Organizatë për mbrojtjen e të drejtave të myslimanëve, kurse më vonë e ndërroi emrin Organizata e myslimanëve të Serbisë Jugore “Bashkimi” – duke u mbështetur në fenë islame të shqiptarëve, të turqve të Maqedonisë dhe myslimanëve të Sanxhakut u përpoq që t’i fus këta popuj nën një flamur, por nuk ia arriti qëllimin. Në udhëheqjen e Xhemijetit kishte krerë të tillë, si bie fjala Qenan Zijai, ish udhëheqës i Organizatës “Bashkimi Kombëtar”, dhe redaktor i fletores “Haki Karan”, i cili në vitin 1918 i flaku – idealet kombëtare¹⁸⁴.

Në mënyrë që organizimi të jetë sa më i fortë dhe punët të shkonin sa më mirë, në Kongresin e Katërt Xhemijeti zgjodhi Këshillin Qendror (Hejeti Feale), i cili u ngarkua me detyrë të analizojë situatën politike e shoqërore dhe zgjodhi kryetar Hysni Jusufin nga Priepola. Kongresi pat zgjedhur edhe Këshillin Ekzekutiv Mbikëqyrës dhe i dha atij autorizime të gjëra që t’i rregullojë me statut çështjet përkitazi me Klubin e Deputetëve dhe Këshillit Qendror. Ky Këshill Mbikëqyrës (Hejeti Tefitishije) ishte i përbërë nga një anëtar të çdo qarku dhe kishte të drejtë të zgjidhte edhe Këshillin Qendror në vend të Kongresit.

¹⁸³ Hakif Bajrami, Rrethanat... Vepër e cituar, 217;

¹⁸⁴ Gazeta “Hak”, dt. 03.IX.1923; 12.IX, 15.IX.1923; Hakif Bajrami, Rrethanat ekonomike.... Vepër e cituar, faqe 218;

Këshilli kishte pranë Klubit të Deputetëve në Beograd dhe delegatin e vet, Selami Beun nga Strumica, i cili ishte njëkohësisht përkrasht i Qenan Zijasë, e që së bashku përbënin krahun e djathtë të organizatës “Bashkimi”, ithtarët e të cilit luftonin që masa myslimane e Jugosllavisë në tërësi të shpërngulet në Turqi.¹⁸⁵ Ky i ndiqte punët e klubit dhe e informonte vazhdimisht Qenan Zija Manastirliun për aktivitetin e tij dhe për veprimet që zhvilloheshin në terren.

Në radhët e “Bashkimit” në këtë kohë punët nuk ishin në rrugë të mbarë. Dhe mosmarrëveshjet e para nuk shpërthyen në këtë Këshill, sepse këtu diplomacia e Pashiqit nuk ishte e përqendruar dhe së pari kundërthëniet shpërthyen në radhët e Klubit të Deputetëve në Beograd. Qenan Zijai, i cili gjithnjë e më tepër tregojë më i afërt me ide me radikalët, që i detyruar për shkak të presionit nga poshtë t’ia lëshojë udhëheqjen e Klubit Ferat Bej Dragës dhe Halim Derallës.

Qenan Zijai, së bashku me tre deputetë kaloi në opozitë të djathtë, si kundërshtar i udhëheqësive shqiptare kosovare. Kështu veprroi kundër “Bashkimit”, si frontalisht, ashtu edhe në prapavijë. Në të njëjtën kohë nga pozita e kryetarit të Këshillit Qendror, Hysni Jusuf aga dha dorëheqje. Kështu, Ferhat Draga, duke u bërë kryetar i Xhemjetit arriti të jetë personaliteti kryesor i kësaj partie.¹⁸⁶

Për shkak të konflikteve në Klubin e Deputetëve dhe zgjedhjeve në Këshillin Qendror, në Shkup mbajti mbledhje Këshilli Ekzekutiv (Hyjeti Tefishije), i cili u mor gjatë me kundërthëniet e mospajtimet në Klubin e Deputetëve. Duke biseduar për mundësitë e pajtimit të udhëheqësive, ku u paraqitën interesat dhe qëndrimet e kundërta, më tepër duke i favorizuar interesat personale, se sa ato të popullit, do të krijohet një situatë, të cilën radikalët dhe borgjezia serbomadhe e dëshironin, sepse në atë mënyrë popullsinë shqiptare

¹⁸⁵ Po aty, faqe 218;

¹⁸⁶ Po aty.;

e shihnin të “pambrojtur” dhe llogarisnin se me anën e propagandës dhe dhunës do të mund të arrijnë shpërnguljen e popullsisë shqiptare në mënyrë më të vrullshme, sidomos në Kosovë, ku punët nuk shkoni sipas planifikimeve dhe laboratorëve të Qeverisë së Pashiqit dhe të udhëzimeve të oborrit mbretëror.

Në mbledhje të Hejetit Teftishije merrnin pjesë të gjithë deputetët, të cilët para Këshillit mbronin dhe arsyetonin mosmarrëveshje të thella ndërmjet grupit në pakicë të udhëhequr nga Qenan Zijai dhe shumicës nga Ferat Bej Draga në krye¹⁸⁷. Në diskutime Qenan Zijai gjithnjë luftonte për t’iu afruar pushtetit me bashkëveprim dhe të kapitullojë para tij. Me tërë forcën fajësonte Ferat Dragën dhe shtypin e tij si përgjegjës për ngjarjet tragjike në Kosovë gjatë zgjedhjeve komunale.¹⁸⁸ Në këtë tubim që diskutuar edhe për qëndrimi e “Bashkimit” ndaj pushtetit të radikalëve. Përkrahësit e Ferat Bej Dragës ishin për atë që Partia “Bashkimi” të kalojë në opozitë, sepse radialët nuk realizonin premtimet e dhëna ndaj shqiptarëve, ndërsa përkrahësit e Qenan Manastirliut ishin të mendimit jo të kalojnë në opozitë, por, përkundrazi, qeverisë duhej dhënë ndihmë e mbështetje pa kurrfarë kushti. Pas shumë diskutimesh u pat arritur të hartohet një statut që do t’i rregullonte të drejtat e Klubit të Deputetëve dhe marrëdhëniet në të ndaj këshillave të Bashkimit në terren.¹⁸⁹

Në këtë situatë, përkundër një pajtim relativ, përçarja ishte e dukshme, sepse përkrahësit e Qenan Zijasë arsyetuan se në “kushte kaq të vështira” nuk kanë arsye të kalojnë në opozitë, ndërsa përkrahësit e Ferat Bej Dragës shpresonin që me shumicën e tyre të detyrojnë tërë Klubin e Deputetëve të kalojnë në opozitë, nëse Qeveria nuk i plotëson kërkesat e tyre. Në këto divergjenca të mëdha Qenan Zijai kishte përkrahjen e pushtetit dhe ai që kërcënuar se do të botojë një gazetë me titull “Dogrusaz”, (Fjala e

¹⁸⁷ Po aty.;

¹⁸⁸ Po aty, faqe 218;

¹⁸⁹ Po aty;

drejtë) dhe do të konvokojë kongresin e të gjithë turqve në Veles. Përpos kësaj ngjarjeje, në radhët e “Bashkimit” qe paraqitur edhe rryma e udhëhequr nga Aqif Haxhi Ameti, i cili në këto kushte llogariste të formonte një organizatë të veçantë për Sanxhakun. Shkakun për këtë, deputetët e Sanxhakut e kishin gjetur në faktin se Qenan Zijai kishte kërkuar rregullimin e reformës agrare vetëm në Maqedoni, ndërsa për Sanxhakun, këtë çështje e kishte pranuar si të rregulluar¹⁹⁰.

Sipas të gjitha indikatorëve, shihet qartë se “Bashkimi” nuk do të mundte të qëndrojë pa kaluar në opozitë, pa marrë parasysh qëndrimin e Qenan Zijasë dhe të Shaqir Kadiqit nga Sanxhaku, sepse Qeveria, për shkak të qëndrimit të njohur ndaj shqiptarëve, në përgjithësi nuk ishte e gatshme t’i realizojë kërkesat e “Bashkimit”. Në këto rrethana radikalët dëshironin që kjo “Fushë e shahut” të mos bëhet fortë e komplikuar, meqë ishte për “Lojë të thjeshtë”, por duke pasur nevojë për të, dëshironin që kjo kullë ”të mos shembet deri sa të gjendej ndonjë parti tjetër kapitulluese”... Policia kishte informata të sakta për organizatën “Xhemijet”, të cilat ia dha Qenan Zijaji dhe ithtarët e tij.¹⁹¹

Kundër qëndrimit të djathtë oportuniste të Qenan Zija Manastirliut, ishte Ferat Bej Draga. Sipas tij duhej të kihet parasysh edhe problem ishqiptar e jo vetëm problem i pronës. Duhet të përmirësohet pozita e katundarit tonë të varfër dhe të shtypur. Ne nuk jemi kundër qeverisë, por jemi kundër torturave të bashkatdhetarëve që po pësojnë në çdo hap, thotë Ferat B. Draga.

Që të shuhet “Xhemijeti”, Pashiqi vendosi që së pari të burgoset Ferat Draga. Pashiqi kishte dërguar edhe misionarë në Kosovë për t’i likuiduar disa personalitete në zë. Kështu, prefekti i Mitrovicës e ftoi Ferat Dragën nga Shkupi më 25. I. 1925 dhe i komunikoi urdhrin e burgimit. Pas burgosjes së tij, shkruan gazeta “Pravda”¹⁹²,

¹⁹⁰ Po aty.;

¹⁹¹ Po aty, f. 221;

¹⁹² Gazeta “Pravda”, 25.I.1925;

janë burgosur edhe tre radhitës të gazetës “Hak”, me qëllim që të pengohet dalja e saj.

Menjëherë pas arrestimit, Ferat Draga, sado që nuk kishte faj, gjyqi i shkallës së parë të Mitrovicës e dënoi atë në prag të zgjedhjeve parlamentare me 20 vjet burg, për të paralizuar aktivitetin e tij politik paraelektorale¹⁹³.

Në shkatërrimin e Xhemijetit, përveç qeverisë radikale të Nikolla Pashiqit, pa dyshimin ndikoi edhe aktiviteti përçarës i Qenan Zijait, i cili sipas Nenit 11 të Statutit të kësaj organizate, ishte i përjashtuar nga ajo së bashku me atë edhe disa ithtarë të tij. Aksioni i disidentëve të “Xhemijetit prej dite në ditë po bëhej gjithnjë e më i fortë”. Ata shpallën një proklamata në të cilën theksonin se janë kundër udhëheqjes së “Bashkimit” dhe “Hakut”¹⁹⁴.

Në zgjedhjet e treta parlamentare që u mbajtën më 8 shkurt 1925, Qeveria doli e bashkuar. Partia Radikale dhe Partia e Pavarur Demokratike dolën së bashku në Listën e ashtuquajtur “Blloku nacional” me një parullë të përbashkët shtet – themeluesit kundër të gjithë antishtetërorëve¹⁹⁵.

Qeveria Pashiq – Pribiçeviq në një sërë aksionesh të paligjshme, duke keqpërdorur tërë aparatit shtetëror, arritën të sigurojnë një shumicë relative deputetësh. Në të ashtuquajturat “pjesë jugore” zgjedhjet qenë mbajtur me një qëllim të caktuar, që të shkatërrohet organizata e shqiptarëve të Kosovës “Bashkimi”, aq më parë se Qenan Zijai e disa udhëheqës nga Sanxhaku tanimë kishin dalë prej saj, ndërsa pjesa tjetër gjendje në burg.¹⁹⁶

Në zgjedhjet parlamentare të 8. 02. 1925 për Parlamentin e Mbretërisë SKS, në qarkun e Manastirit u zgjodhën 6 deputetë (4 nga partia Radikale që fitoi 51.6% të votave ose 16, 763 votues, dhe

¹⁹³ Gazeta “Pravda”, dt. 25.I.1925, Gazeta “Politika”, dt. 01.02.1925;

¹⁹⁴ Gazeta “Politika”, dt. 02.02.1925;

¹⁹⁵ Haqif Bajrami, Rrethanat politike... vep.cit.f. 233;

¹⁹⁶ Po aty, f. 236;

2 deputetë të Partisë Demokratike që fitoi 26,6% ose 8653 votues. Listën e Partisë së Xhemijetit do ta kryesoi Mahmud Nedin Adem që mori 961 vota ose 2.9 %, kurse Qenan Zijai që kryesonte listën e Partisë Myslimane (Organizata e Myslimanëve të Jugosllavisë) mori vetëm 2530 vota ose 7.8% dhe nuk u zgjodh deputet¹⁹⁷.

Lidhur me zgjedhjet e shkurtit, gazeta “Pravda” shkruan: “Në Serbinë jugore janë bërë falsifikime të papara dhe se radikalët po bëjnë plane për koalicionin në mënyrë që ata të formojnë qeverinë. Pasi gjatë zgjedhjeve ishte ushtruar terror i madh ndaj myslimanëve (shqiptarëve), ata po i lëshojnë me nxitim trojet e veta dhe po shpërngulen në Turqi.”¹⁹⁸

Gjatë zgjedhjeve në Kosovë nuk u bënë vetëm burgime krerësh shqiptarë, por u burgosen edhe anëtarët e familjeve të tyre.¹⁹⁹ Përkundër terrorit të përhershëm, Xhemijeti u solidarizua me Partinë Fshatare Kroate, duke e quajtur aplikimin e “Obznanës” kundër kësaj partie si “turpin shtetëror”.²⁰⁰ Bashkimi vlerësoi këtë hap si përpjekje të marrë qeverisjen që të eliminojë 4 kroatë. Derisa “Xhemijeti” jepte deklarata të guximshme, Qenan Zijai me grupin opozitar të tij gëzohej për zgjerimin e Obznanës kundër Partisë Fshatare Kroate.²⁰¹

Kundër Ferat Dragës u ngrit edhe Qenan Zija Manastirliu, i cili u deklarua për oportunizëm, duke e quajtur afrimin e Xhemijetit me kroatët njësoj si me Angorën dhe Kemal Pashën, ndërsa Ferat Draga i përgjigjet: po edhe me Angorën nëse është e nevojshme”.²⁰²

¹⁹⁷ Statistika izbora narodnik poslanika Kraljevine SKS, održani na 08.02.1925, Beograd, 1926, god, st. 3 - L

¹⁹⁸ Gazeta “Pravda”, dt. 10.02.1925 dhe 26.VI.1926;

¹⁹⁹ Fuat Çulinoviq, Sllom Stare Jugosllavije;

²⁰⁰ Gazeta “Politika”, Dt. 31.XII, 1924 dhe 03.I.1925;

²⁰¹ Po aty, gazeta “politika, dt. 02.01.1925

²⁰² Haki Bajrami, Rrethanat ekonomike dhe politike në Kosovë (1978-1941), Prishtinë1982, faqe 238;

Gazeta “Politika” e dt. 24. 02. 1925 do të shkruajë: “Qenan Zijai nuk pajtohet me Ferat Dragën, prandaj është përjashtuar nga Xhemijeti, e me këtë më tepër i ka bërë dëm “Bashkimit” se sa të gjitha mjetet e tjera elektorale parlamentare si dhe presionet e qeverisë në përgjithësi²⁰³.

Qenan Zijai – Manastirliu, dispononte me pasuri të madhe në Manastir në rajonin e Mariovës, të cilën më vonë ia rrëmbejnë serbo – sllavët. Këtë pasuri të madhe e kishte fituar, gjegjësisht e kishte trashëguar nga i ati dhe nga e shoqja, por edhe në mënyrë të tjera, ndoshta johumane, që i ka lejuar koha – shkruan profesor Reshat Nexhipi²⁰⁴, kështu, pothuajse tëra viset e Mariovës qenë pronë e tij. Në një rast kur pushteti deshë t’ia marrë tokat në fshatin Trap, i revoltuar nga ky veprim, kishte përzënë dhjetë familje nga ky vend dhe i kishte djegur shtëpitë e tyre, të cilat ua kishte dhënë ai. Për pasurinë e madhe të tij flet edhe fakti, se vetëm për synetin e djalit të tij kishte shpenzuar 1000 napolona flori, thotë prof. Reshati.

Më vonë Qenan Zijai – shpërngulet në Turqi, ku edhe vdes në vitin 1935.

²⁰³ Po aty;

²⁰⁴ Rreshat Nexhipi, Shtypja dhe rezistenca shqiptare në Maqedoni nëpër shekujt, Manastir 1996, faqe 174-175

ZEQIRJA IDRIZI

Universiteti FON – Shkup

HALIM BEJ DERALLA – URË LIDHËSE MIDIS XHEMIJETIT DHE KOMITETIT TË KOSOVËS

Veprimtari i çështjes kombëtare, Halim bej Deralla, i përket brezit të burrave që vunë gurin e parë të themelit të Rendit Publik të shtetit Shqipëri. Halimi qëndroi e rezistoi i paepur në rrugën e rilindësve shqiptarë dhe luftëtarëve sypatrembur të zgjidhjes së fatit të Shqipërisë së robëruar. Ai, në shumë momente, është pjesë e pandarë e veprimtarisë atdhetare të Isa Boletinit, të Bajram Currit e Hasan Prishtinës, të Bedri Pejaniit e Sali Gjukë Dukagjinit, të Nexhip Dragës, të të jatit Mehmet pashë Dërrallës, të Ismail Qemalit e Luigj Gurakuqit, të Muço Qullit e Salih Nivicës, të Ahmet Zogut e Aqif Pashë Elbasanit, të Dervish Himës e Jashar Erebarës me shumë shokë, që në kohë e situata të ndryshme daltuan emrin e tyre në rrugëtimin e Shqipërisë.

Halim Deralla, ka lindur në fshatin Gradec, rrethina e Tetovës, në vitin 1879. Fëmijërinë e kalon aty e më tej, nis mësimet e para në shkollën qytetëse të Tetovës. Mbasi mbaron mësimet aty niset në Stamboll, kryeqendra e Perandorisë Osmane, e lakmuar sidomos nga djemtë e dyerve të mëdha, siç ishte Halimi. Në të vërtetë mëson shumë, ku kalon pjesë më të madhe të kohës mbi libra dhe pas mbarimit të shkollës së mesme vijon studimet, në vitin 1898, në Fakultetin e Drejtësisë. (*Z. Idrizi, Treva e Pollogut në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare 1899–1913, Tetovë*). Falë reputacionit që Mehmet Pashë Derralla gëzonte asaj kohe në rrethet patriotike shqiptare, Halimi do të binte në kontakt me idetë e para të rilindësve shqiptarë, për autonominë e trojeve arbërore. Studentin e Tetovës do ta shihnin me respekt në Stamboll, jo vetëm për këmbënguljen në përvetësimin e dijeve, por edhe për natyrën e tij

disi të heshtur, fjalëpak dhe krenarë. Kështuqë me mbarrimin e fakultetit të drejtësisë emërohet si nëpunës i lartë i administratës osmane. Ai do të dallohej për korrektësinë në funksionet shtetërore. Madje, shkallët e karrierës së tij në fushën e jurisprudence, mund të ishin tejet të lehta, nëse në agim të shekullit të kaluar, nuk do të kishte dalë në pah, çështja shqiptare. Në fillim të vitit 1908, i jati i Halimit, Mehmet Pashë Deralla, në bashkëpunim të ngushtë me Ismail Qemalin, Hasan Prishtinën, Dervish Himën, Ibrahim Temon, Mid'hat Frashërin etj, ideojnë lëvizjen autonomiste në Vilajetet shqiptare, tashmë atij i duhet të udhëtojë në krahina të ndryshme, të zgjojë vetëdijen nacionale, të zgjojë bashkëkombësit e vet prej territ osman pesë shekullorë. Por, i duhet të qeverisë edhe pronat e mëdha që ka në Tetovë e rrethina, dhe në këto kushte ai thërret të birin e vet, Halimin, për ta ndihmuar në detyrën e madhe që duhet të përballonte. Halimi, tanimë pothuajse 30 vjeçar, me shtatin e lartë, me atë vështirimin e thellë e të menduar, do të ngarendë për t'u vënë plotësisht në shërbim të kombit të vet, duke kuptuar se drejt pavarësisë së trojeve etnike, shkohej me pushkë dhe dituri. Halimi do të jepte ndihmesë të madhe në vitin 1908, sidomos në përkrahje të shkollave shqipe, në Maqedoninë shqiptare. (*Z. Idrizi, Treva e Pollogut në*) Me nismën e tij, i përkrahur edhe nga Dervish Hima, biri i Derallave do të blinte abetare dhe libra shqip për t'ua shpërndarë falas nxënësve në Tetovë e rrethina. Burime të diplomacisë austro-hungareze, duke folur për në këto troje, na bëjnë me dije se ;”ndonëse zyrtarisht shkollat nuk janë çelur, në to zhvillohet rregullisht çdo ditë dy orë mësim për gjuhën shqipe”. (*Arkivi i Institutit të Historisë-Tiranë. Fondi i dokumenteve të Vjenës. Raport i konsullit Pollanc, dërguar Vjenës, dok.26*).

Në vitet 1908–1912 shtëpia e Derallave në Tetovë do të shndërrohej në një qendër të shqiptarizmit. Mehmet Pasha dhe i biri Halimi do të shihnin kurdoherë në krye të lëvizjeve të mëdha atdhetare, duke dhënë ndihmesë jo vetëm me trimërinë, guximin, logjikën, por edhe me pasurinë e tyre. Të dy sëbashku ata do të

prisin e do të përcillnin në shtëpinë e madhe në Tetovë, trimat patriotë e atdhetarë si Sali Gjukën, Bedri Pejanin, Bajram Currin, Isa Boletinin, Mid'hat Frashërin, Hamdi Ohrin, Hoxhë Vokën dhe dhjetëra atdhetarë të tjerë nga krejt viset etnike shqiptare. Ata do të merrnin pjesë në Kuvendin e Junikut e mandej në fillim të viteve 1912, do të komandonin çetën e parë të luftëtarëve tetovarë, e cila rroku armët për t'u bërë ballë sulmeve turke dhe atyre serbo-bullgare. Në nëntorin e vitit 1912, atëherë kur Mehmet pashë Deralla udhëtonte drejt Vlorës si një përfaqësues i popullit të Kosovës, i biri i tij, Halimi, në krye të një çete prej 200 luftëtarësh tetovarë, do të vihej në mbrojtje të trojeve shqiptare. (*Z. Idrizi, Treva e Pollogut në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare 1899–1913, Tetovë*). Dihet tanimë se pas rënies së Turqisë fqinjët tanë të përkrahur dhe nga Fuqitë e Mëdha, kërkonin aneksimin e tokave tona. Orekset shovene parashihnin copëtimin e plotë të Shqipërisë nga grekët, bullgarët, serbo – malazezët, ndërsa përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha koteshin të përgjumur kur ndahej toka shqiptare. Ishin bijtë e saj, si Halim Deralla, të cilët pa marrë në sy rrezikun, luftonin viseve të atdheut për lirin e tij. Pas dorëheqjes së Ismail Qemalit–Vlorës dhe kabinetit të tij, Mehmet Pashë Deralla kthehet sërish në Tetovë.

Në fillim të vitit 1915, Mehmet Pashë Deralla dhe Halim bej Deralla u zunë robër nga ushtarët serbo-bullgarë. Arsyet e arrestimit dhe të burgosjes kishin lidhje me kundërshtimin e armatosur të tyre ndaj forcave serbe dhe bullgare. Në shtator të 1913–s, Mehmet pasha dërgoi Halimin dhe Mynipin nga Vlora për në Tetovë, për të ndihmuar veprimtarinë e bashkatdhetarëve në Kryengritjen e shtatorit të vitit 1913. (*Z. Idrizi, Treva e Pollogut në...*) Në fillim të vitit 1914, Mehmet Pasha u kthye në rrethinën e Tetovës dhe jetonte si kaçak, duke u endur së bashku me të birin maleve të Sharrit. Ata të dy kapen në fillim të vitit 1915 nga forcat serbo-bullgare dhe dërgohen në burg, në këshqjellën e Karlovës në Bullgari, ku dhe dënohen me vdekje. Më vonë, sipas rrëfimeve të Emine Derallës, një nga oficerët serbë e kishte njohur Halim beun

në burg, kështu që kishte mundësuar arratisjen. Më 22 dhjetor 1918, ishte zgjedhur edhe anëtar i Kryesisë së Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, e përbërë nga: Hoxhë Kadri Prishtina (kryetar), Qerim beg Begolli, Hysni beg Curri, Bedri beg Pejani (sekretar), Halim beg Gostivari, Salih Nivica (drejtor i gazetës “Populli”), Sejfi Vllamasi, Bajram Fevziu, Hamit Gjylbegu, Riza Dani (anëtarë). Më 6 mars 1920, kur krerët e Shkodrës vendosen për bashkimin e qytetit me qeverinë e Tiranës, në sajë të punës këmbëngulëse të Komitetit të Kosovës, Halim Gostivari, “Drejtor i Përgjithshëm i Policisë”, mbërriti në Bushat, së bashku me ministrin e Drejtësisë, Hoxhë Kadri Prishtinën dhe me ministrin e Brendshëm, 25 vjeçarin Ahmet bej Zogun, për të marrë në dorëzim dhe për të organizuar mbrojtjen e Shkodrës, si dhe për të riorganizuar policinë e qeverisë së re, kërkesë e kahershme e Komitetit. Halim Jakova–Gostivari kreu detyra edhe gjatë “Luftës së Koplikut”, në verën e vitit 1920. Edhe në këtë rast Halimi që në Shkodër së bashku me bashkëveprimtarët: Hoxhë Kadri Prishtinën dhe me Ahmet bej Zogun dhe shumë kosovarë nën komandën e Hasanit të Jakup Ferrit dhe Qerim Begollit (te cilin këtë të fundit e kishte edhe nip, Qerim Begolli ishte djali i Esmës, motrës së Mehmet pashë Derallës) Në një raport të Ministrisë së Punëve të Brendshme 10. V. 1920 Nr. 3204 të Serbisë thuhet: **Kryetari i qarkut me aktin nr. 613 nga 12-ti i këtij muaji më dorëzoi raport që thotë:** Një person në Shkodër dhe në kthim deklaroi te kryetari i asaj krahine, atëherë: Kadri Hoxha, ministër i Drejtësisë në Qeverinë e Shqipërisë së tashme, me prejardhje nga Prishtina, anëtar i mirënjohur i Komitetit Shkodran “Kosova”, të cilin e njihja prej më parë, por personalisht me të fola edhe para një muaji, sërish madje edhe tani që isha, si arsye për të hyrë në klub, ku shkova te Kadri Hoxha, i cili më priti me shumë dashamirësi dhe më pyeti se si është këtu, dhe unë ju përgjigja pyetjeve, ndërsa ai me kënaqësi e dëgjonte bisedën time që qQeveria serbe ndaj nesh sillet butë. Më pyeti për Nexhip Muharremin dhe Xhaferin (rebelët nga Luma, të cilët kanë ardhur nëpërmjet Lumit Drin te italianët

më 28 janar të këtij viti, ndërsa më parë kanë qenë në ndonjë shërbim). Tani janë prapë te ne, por jo në ndonjë shërbim, por janë nën mbikëqyrje në Prizren. Iu thashë që janë (në Kollovoz–Topojan) tek italianët dhe kjo i shqetësoi, dhe u skuq kur e dëgjoi atë dhe më pas tha se ata nuk duhet të jenë këtu, duhet të kthehen në Serbi, në shtëpitë e tyre dhe të kërkojnë që t’u falet, ose nëse nuk duan le të vijnë këtu, por tek italianët nuk duhet të rrinë asnjë minutë. Më vonë më tha që do t’ju shkruante letër, **Zotit Ministër të Ushtrisë dhe të Marinës**. Derisa ne këtu bisedojmë, hyri Bedri Beu, Pejani, nga familja Mahmud Begoviq, e pas tij katër të rinj të moshave 23 deri në 28 vjeç, të gjithë shtathedhur, mbresëlënës dhe të veshur mirë, të cilët futën brenda një qeskë gati plot me letra. Ndërsa Kadri Hoxha iu kthye Bedri Beut për të sapoardhurit, ndërsa unë u ktheva nga djemtë dhe fillova bisedën që mos të bie në sy se po i dëgjoja, ata të rinj dukeshin se ishin të njohur të Bedri Beut dhe ai i pyeti se ku e kishin kaluar Drinin dhe ata thanë: te “Vau i Dardhës”, ndërsa Kadri Hoxha e mori qeskën, i zbrazti letrat, një letër në një zarf më të madh e tërhoqi nga pirgu, e hapi dhe e vështroi dhe sërish në vete pëshpëriti: “Halim Bej Deralla”, tetovar me prejardhje, ndërsa tani kryetar i Komunës së Gjakovës, punëtor shumë i përkushtuar shqiptar për një Shqipëri. Në të njëjtën kohë Bedri Beu pyet për dikë, por nuk munda ta kuptoj mirë se për kë e kishte. Pas gjithë kësaj, ky iu përgjigj se është në Pejë dhe se është shëndoshë e mirë. Gjithashtu këtu po sjelli edhe disa të dhëna nga Gazeta “Hak“, e cila në faqet e saj trajtonte tema të ndryshme të jetës shoqërore të shqiptarëve dhe të komuniteteve tjera të fesë islame. Në faqet e kësaj gazete trajtoheshin tema për veprimtarinë politike të Xhemijetit, për qëllimet e pushtetit, i cili nëpërmjet reformës agrare dhe kolonizimit realizonte projektin e shpërnguljes së popullatës shqiptare nga trevat etnike dhe shkombëtarizimin e saj, për veprimtarinë e deputetëve të Xhemijetit në Kuvendin e Mbretërisë SKS, për dhunën sistematike që ushtronte xhandarmëria serbe ndaj popullatës së pafajshme, për arsinin në gjuhën amtare, për jetën fetare dhe mbrojtjen e monumenteve të etnokulturës

myslimane, për varfërinë e skajshme dhe ekonominë e rënduar të popullatës shqiptare në këtë mbretëri. Po ashtu “Xhemijeti” ka punuar nën maskën për tendenca arsimore – kulturore, andaj është lejuar veprimi i saj në tërë popullatën myslimane në viset jugore. Organizata në fillim është quajtur me emrin “Islam Muhafezen Hukuk Xhemijeti” (Organizatë për mbrojtjen e të drejtave të myslimanëve). Më vonë organizata e ndërroi emrin në: Organizatë e myslimanëve të Serbisë jugore. Këtë organizatë e ka udhëhequr Qenan Zija Beu, ish-udhëheqës i shoqatës “Bashkimi Kombëtar” dhe redaktor e gazetës “Haki Kata”. Gazeta më pastaj shkruan për mbajtjen e Kuvendit dhe zgjedhjen e Këshillit qendror. Konfliktet në Organizatë kanë filluar në mes deputetëve në Beograd, ndërmjet Zija Beut dhe kryesuesve Ferhat Draga dhe Halim Derallës. Ky klub i deputetëve po merr prestigj shqiptar.

Kongresi fitoi edhe rrymën e dytë politike të drejtuar nga avokati Qenan Zija. Ky njeri nuk kishte ndjenja kombëtare shqiptare dhe për çdo lëvizje do ta njoftojë qeverinë e Pashiqit. E vërteta, Qenan Zija ishte një agent i paguar i Oborrit Mbretëror dhe kishte ambicie të zë ndonjë vend në Ministrinë e Drejtësisë. Prapa “shpinës” së këtij grupi, Ferat Draga, Aqif Blyta e shumë patriotë të tjerë, do ta përpilojnë një kërkesë rezolute dhe pa emër do t’ia dërgojnë Shoqatës së Kombeve në Gjenevë. Rezoluta do të zihet nga qarqet ushtarake dhe si e tillë kurrë nuk do të arrijë në adresën e caktuar. Rezoluta gjendet në origjinal në gjuhën frënge në AJ në Ministrinë e Drejtësisë, nga viti 1920. Rezoluta sipas të gjitha gjasave ishte shkruar në Shkodër nga Bedri Pejani dhe Hasan Prishtina dhe përmes kanaleve ishte sjellë në Shkup, por nuk pati sukses, sepse posta e Beogradit e ndali dhe dërgoi në Ministrinë e caktuar. Kongresi i Xhemjetit e zgjodhi edhe Kryesinë e re me kryetar Ferat Dragën, ndërsa sekretar Aqif Blytën. Kongresi do t’i japë instruksione Redaksisë “HAK” që t’i grumbullojë të gjitha faktet rreth mizorive që po ushtronte pushteti serb ndaj shqiptare, me kërkesë që ato fakte të botohen dhe kështu u bë. Faktet që botoheshin në “HAK”, pastaj gazetat tjera i distribuonin në gjuhën

e tyre dhe bota filloi të njihet me planet gjenocidale serbe. Jo vetëm kaq, në saje të atyre informatave, në Shoqatën e Kombeve do të fillojë edhe Komiteti i Kosovës të plasojë fakte për mizoritë në Rrafshin e Kosovës me titull: “Çka dëshmojnë plagët e Kosovës”.

Kongresi i dytë i Xhemjetit debatoi për fatin e familjeve shqiptare që ishin izoluar në Kampin e Përqendrimit në Nish. Aty, u tha në Kongres, ishin grumbulluar 604 familje shqiptare si të marrë peng. Kushti për lirin e tyre ishte dorëzimi i kryengritësve shqiptar të drejtuar nga Azem Bejtë Galica. Sipas dokumenteve, asnjë kryengritës nuk ishte hamendur që të dorëzohet. Flijimi i familjeve për të vuajtur e shumë prej tyre nuk u kthyen të gjallë në Kosovë, ishte çmimi që duhej paguar për të mbetur shqiptarët në trojet e tyre. (A. J. S. 14. K. 96 –a; 101; 104). Aqif Blyta ishte jo vetëm organizator, por edhe ideolog kryesor i Kongresit TRETË të Xhemjetit në Shkup më 14–18 prill 1922. Në këtë Kongres shquhet si patriot, sepse theksoi që të kërkohet me çdo kusht nga Beogradi hapja e shkollave shqipe në viset e okupuara shqiptare, nga Pazar i Ri (Sjenica e deri në Strugë, nga Prizreni e deri në Kumanovë). Kongresi me propozimin e Fetat Dragës dhe Aqif Blytës do të vëjë në rend dite çështjen e shpërnguljes së disa familjeve shqiptare në saje të propagandës që bëhej në popull se “Turqia po kërkon nefus”. (Hak, 19 prill 1922). Nga foltorja e Kongresit Aqif Blyta do të deklarojë se asnjë kërkesë e tillë nuk është zyrtare. Këso kërkesash bëjnë disa matrapaz që janë të pirë ta fetishizojnë Padishahun, e atij si duket, vet turqit do të ia dërgojnë tërë historinë në muze. Atje shkëlqesia e tij, Kemal Ataturku, është kah e krijon një Turqi të re, moderne dhe evropiane. Ne nuk duhet të hamendemi, por me të gjitha mjetet politike duhet ta përkrahim. (“Hak” 19 prill 1922).

Kongresi do të debatojë edhe për qëndrimin e deputetëve shqiptarë në Parlamentin e Mbretërisë SKS, duke theksuar se nuk ka përkrahje të Qeverisë pa kushte. Ne e përkrahëm aprovimin e Kushtetutës, por me asnjë efekt Qeveria nuk është duke e respek-

tuar marrëveshjen. Përkundrazi, ndaj popullit tonë po dërgon ekspedita, kinse po e çarmatos popullsinë dhe prej një ndjekjeje masive ndaj shqiptarëve, po del se i kanë zbuluar 3–4 pushkë me 15–20 fishekë. Jo, “çarmatimi bëhet për ta frikësuar popullin dhe për ta drejtuar popullin në Anadoli. Ky është qëllimi, por ky është edhe mësimi që në zgjedhjet e ardhshme të dalim sa më të bashkuar, e ta themelojmë Grupin tonë parlamentar, me të cilin do të diktojmë në qeveri shumë interesa që duhet t’ua mbrojmë qytetarëve tanë”. (“Hak”, fjalimi i Ferat Dragës, 18 prill 1922).

Aqif Blyta është organizator dhe drejtues në Kongresin e katërt të Xhemjetit më 20–29 janar 1923 në Shkup. Në këtë Kongres Ferat Draga ishte ideologu kryesor që mori përsipër organizimin e anëtarësisë së Xhemjetit për të marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare më 18 mars 1923. Nga këto zgjedhje u zgjodhën 14 deputetë shqiptarë, që do të mbesin në histori si grupi parlamentar më kombëtar në mes dy luftërave në viset e robëruara shqiptare në Jugosllavinë mbretërore 1918–1941. Në lidhje me këtë, gjithnjë si anëtar NDERI i KMKK do të veprojnë në trevat shqiptare: Aqif Blyta (Jeni Pazar), Qamil Jashari (Tetovë), Qamil Osmani (Shkup), Qenan Zija (Manastir), Dervish Skejadini (Berane), Ferat Draga (Zveçan), Haxhi Xhemaj Agushu (Prishtinë), Halim Beg Deralla (Tetovë), Hashim Shukri Mustafa (Shkup), Nazim Gafurri (Prishtinë), Rifat Rushiti (Mitrovicë), Sadedin Rushiti (Manastir), Sali Jusifi Hoxha (Llap), Shaban Mustafa (Vushtrri). Këta politikanë në punën e tyre do të përputhën në një front: në atë të mbijetesës së shqiptarëve. Kishte në radhët e tyre të atillë që kokën e kishin në viset e robëruar, ndërsa mendjen e kishin në rrënojat e Perandorisë Osmane, në të cilën ishin edukuar dhe arsimuar politikisht. Me fjalë tjera, ishte shumë vështirë të sheshohet në këtë “pjekuri” turko-manë të zhveshët njeriu sa çel e mbyll sytë. Ishin të atillë “Qenan Zija, Dervish Skejadini e ndonjë një tjetër. Por, kishte në radhët e tyre si Nazim Gafurri, Halim Beg Deralla, Ferat Drga dhe Aqif Blyta, që kombëtarën e kishin vënë si istikam për të mbrojtur çështjen shqiptare. Kishte në radhët e treta të luhatshëm që për pak

para ishin të gatshëm të shkojnë pas çdo flamuri, pra edhe pas atij të Kralit serb. (Kështu faktografojnë dokumentet: AJ. S. 14. K.10; Xhemijeti dhe programi politik; “Hak”, Raporti nga Kongresi i katërt, 31 mars, 1923; *Pravda*, 28. III. 1923).



Kongresi i Tretë i Xhemijetit mori një vendim historik se: “Do të luftojmë me të gjitha mjetet që kolonizimi mos të rëndojë më tej popullin tonë; Që shpërngulja mos ta përfshijë si mortajë popullin tonë, sepse këto vise të parët tanë nuk i kanë tjetërsuar edhe kur kanë qenë në pozitë edhe më të vështirë; se ushtrinë e kralit nuk do ta furnizojmë me mish të njomë (me rekrutë), e ky pushtet po na torturon në çdo hap; Se nuk do të rrimë duarkryq e do të reagojmë në qarqet e Shoqatës Kombeve me peticione dhe promemorie ku do të i shtrojmë kërkesat tona për barazi dhe zhvillim *(Halim Bej Deralla ulur me shkop ne duar)* ekonomik, ku do të pasqyrojmë faktin se pushteti gjakatar në viset tona vetëm shfrytëzon çdo gjë dhe nuk investon asgjë; se në viset tona shkollimi për mjek, inxhinier dhe ekonomist është emër kuptimi; se në viset tona nuk ka biblioteka, nuk lejohen shkolla shqipe, përpos medrese ku

shkollohen disa të rinj që mësojnë aq sa të kanë një ritual diturie se si me i shti shqiptarët në varr, se si me u mbajt ligjëratat nëpër xhamia se “për myslimanin kjo botë është kalimtare, se duhet vetëm për botën tjetër të mendojmë e të jetojmë për te”. Këto ankesa kanë mbetur të botuara në faqet e “Hakut” si relikte dhe mjerisht deri më sot nuk janë përkthyer dhe botuar shqip, sepse përmbajtja e tyre shqip atëherë ishte e ndalur”. Kush na pengon sot, që ta dimë anën e “errët të historisë”. Ata që e njohin shkrimin arab dhe gjuhën e vjetër turke, duhet t’i përvjeljin mangët dhe t’ia sheshojnë kombit historinë e vërtetë, jo vetëm nga kjo periudhë, por edhe për kohët tjera. Halim Deralla, si deputet i trevave të Maqedonisë shqiptare, do të sillte në këtë parlament, me zërin e lartë krejt barbarizmat serbosllavo–bullgare që luheshin në kurriz të bashkëkombësve të vet, nën regjimin e urryer serb. Deralla ashtu si kundër i ati, mbronte pa u frikuar çështjen shqiptare, ndonëse kërcënimet i vinin nga të katër anët, madje duke i bërë edhe tentativa për ta eliminuar fizikisht. Në rast të shpërnguljeve të mëdha që Beogradi kishte planifikuar me Stambollin, për ekstradimin e shqiptarëve mysliman në Azi, Halim Deralla jo vetëm në parlament, por sidomos në Tetovë, Gostivar e Kumanovë, madje deri në fshatrat e Prilepit, do të shkonte vet të bisedonte me bashkëkombësit e tij, duke potencuar idenë se trojet shqiptare kurrë nuk duhet të braktisen. Edhe në disa raste kur autoritetet sllavo–bullgare u rrëmbyen me forcë fshatarëve shqiptarë shtëpitë dhe tokat e tyre, Halim Deralla i ndihmoi ata me flori, duke u blerë shtëpi të reja. Tejet vizionar, në rrafsh të politikës shqiptare dhe asaj ballkanike, Halim Deralla do të mbante një qëndrim të prerë, veçanërisht në ngjarjet e qershorit të vitit 1924. Si rrallë kush prej politikanëve të asaj kohe, ai do ta konsideronte revolucion bolshevik, veprimin e Fan Nolit dhe përkrahësve të tij, madje në shenjë revolte do të linte Tiranën ku nuk i munguan edhe ofertat për poste të rëndësishme. Në shtëpinë e madhe të Derrallave në Tetovë, sëbashku me vëllezërit e tij, Gajurin dhe Hysenin, do të kujdesej për pronat e trashëguara të familjes, pa harruar edhe kuvendet me prijësit e

çetave të kaçakëve të Maqedonisë shqiptare. Lëvizjen kaçake në këto treva, Halim bej Deralla do ta ndihmonte jo vetëm me porosi e udhëzime, por sidomos me ndihmë të pakursyer materiale.



Halim Bej Deralla

Vetë shtëpia e tij në Tetovë, shpesh herë do të ishte strehë e sigurt e prijësve kaçakë. Kur Ahmet Zogu me ndihmën e shteteve të Evropës mori rrugën e udhëtimit për në Shqipëri, ai ka bujtur një natë së bashku me 200 burra, në shtëpinë e Halimit në Tetovë. Halim Beu e ka pritur siç e donte ndera e shqiptarit dhe sipas të dhënave familjare, e ka përcjellë të nesërmen duke i bashkangjitur formacioneve të tij edhe disa trima të Tetovës, Gostivarit e Kumanovës, të cilët do të përcillnin deri në Tiranë. 24 dhjetori i vitit 1924, i quajtur ndryshe si Triumfi i Legalitetit, mban kësaj brenda tij edhe bujarinë dhe besnikërinë e Halim bej Derallës dhe tetovarëve në përgjithësi. Në vitet 1925–1928 biri i Tetovës, zgjidhet përsëri në parlamentin shqiptar si përfaqësues i këtyre trevave. Edhe në këto vite ai do të dallohej sa për frymën e vendosmërinë për shtetin ligjor në shtetin amë, aq edhe për mbrojtjen e të drejtave kombëtare të bashkëkombësve të vet si në

Kosovë, Maqedoni, Çamëri etj. Fjala e tij se *“na jena përgjegjës përpara historisë për jetën e 2 milionë shqiptarëve që padrejtësisht u ndan nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër në vitin 1913”*, do të dëgjohej e fuqishme në sallën e parlamentit shqiptar dhe do të pasohej edhe nga burra të tjerë të shquar, si Ali bej Këlcyra, Rauf Fico, At Gjergj Fishta, Mustafa Kruja etj.

Në fillim të viteve 30 të shekullit të kaluar, Halim Derralla shkon sërish në Tetovë të jetojë pranë gruas, vajzave, vëllezërve dhe bashkëluftëtarëve të vet të shumtë. Ndërkaq personaliteti i tij nuk mund të pajtohej me reformat kolonizuese serbosllavo–bullgare, si dhe me dhunën fizike dhe psikologjike të ushtruar ndaj banorëve të Maqedonisë shqiptare, ndaj ai e ngre lart zërin e tij në mbrojtje të fatit të bashkëkombësve të vet. (*“Rrëfimet” e njëres nga vajzat e Halim Bej Derallës, Emine Deralla*). Duke qenë jurist i sprovuar, Beogradi nuk mund ta arrestonte pasi gjyqi mund të demaskonte akoma më keq regjimin serbosllav. Për këtë shkak serbët, ashtu si kundër kanë vepruar edhe qindra herë të tjera, paguan njerëz për të vrarë Halim Derallën. Dy atentate radhazi në vitet 1930–1931 bënë jehonë të madhe jo vetëm në Tetovë, por edhe në Tiranë e ma gjerë. Ndërsa forcat e errëta të Beogradit i tmerronte ideja se edhe pas këtyre atentateve Halim Tetova jetonte ende, ishte Mbreti i shqiptarëve, Ahmet Zogu, i cili e ftoi bujarisht burrin e shquar të linte Tetovën dhe të shkonte në Tiranë. Një vit më pas, në pranverën e vitit 1932, Halim Derralla sëmuret në shtëpinë e tij. Ardhja e një mjeku të dyshimtë bëri që dy orë pas vizitës, burri i Tetovës të mbyllte sytë përgjithmonë, në mënyrë disi misterioze. (*Halim Beu vdiq në Tiranë, në vitin 1932”, përshkruan Nixhare Deralla*). Populli i Tiranës dhe i gjithë viseve etnike shqiptare e përcollën me respekt birin e vet, personalitetin e shquar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

ISMET AZIZI

Gjilan, Kosovë

AQIF BLYTA – FIGURË KRYESORE E ORGANIZATËS XHEMIJETI

Aqif Blyta pa dyshim është personaliteti dhe lideri më me ndikim i boshnjakëve dhe shqiptarëve të Sanxhakut në periudhën e Mbretërisë së SKS (1918–1929) dhe Mbretërisë së Jugosllavisë (1929–1941). Ai është një lloj fenomeni politik i kësaj periudhë kohore. Edhe atëherë kur veproji krejtësisht i pavarur pa asnjë parti që do të qëndronte prapa tij, dihej se në trevat e Dezhevës (Pazarit të Ri) dhe në atë të Senicës askush nuk mund të merrte votat e votuesve dhe zgjedhësve pa mbështetjen e Aqifit.

Për t'ia zvogëluar rolin historik, disa historianë e vënë në rend të parë origjinën shqiptare të familjes së tij. Ata harrojnë se Aqifi ka lindur në Pazarin e Ri dhe është sanxhakli dhe është në trojet e veta, dhe se gjithë jetën ia përkushtoi luftës për një të ardhme më të mirë të Sanxhakut dhe banorëve të tij shqiptarë, boshnjakë, serbë që jetojnë aty, për këtë ideal dha edhe jetën. Përveç kësaj, ata harrojnë, se partia Xhemijeti jo vetëm që mbledhi shqiptarët, por edhe boshnjakët dhe të gjithë myslimanët e tjerë nga territori i Sanxhakut, Kosovës dhe Maqedonisë. Duhet të theksohet se Aqif efendiu, gjë që është e rrallë në atë kohë, ishte një intelektual i kompletuar me shkallë të lartë arsimore, me akademi ushtarake, por edhe një biznesmen shumë i suksesshëm, i cili i përkiste elitës ekonomike të Sanxhakut në atë kohë.

Aqif Blyta ka lindur në vitin 1887 në Pazarin e Ri në familjen Blyta, bir i Eminut dhe Jaldëzës. Ai ishte shqiptar dhe familja e tij ishte me prejardhje nga Gjakova. Duke qenë besimtar i devotshëm, ai e mori mbiemrin e gjyshit të tij Ahmeti, i cili kishte qenë në haxh, kishte marrë titullin haxhi, dhe kështu edhe rrodhi mbiemri

Haxhiahmeti. Për ta komprometuar, emrin e familjes Blyta, lideri komunist i Pazarit, Ramiz Cërnishanin, ka shkruar: "*Ai e mbajti mbiemrin e babait të tij Blyta, të cilin e vë në pah nga fillimi i pushtimit në vitin 1941 për t'u definuar si shqiptar para pushtuesve gjerman*". Mandej regjistrohet dhe u diplomua në Akademinë Ushtarake në Manastir. Në vitin 1913 u vendos në Turqi, kur edhe përfshihet nga Lufta e Parë Botërore. Si oficer aktiv në gradën e kapitenit, luftoi në anën ushtinë turke gjatë Luftës së Parë Botërore. Sipas Zhivkoviq, fitoi Kryqin e hekurt gjerman të klasës së dytë për trimëri".²⁰⁵

Blyta u kthye në vendlindje në vitin 1919, kur filloi karriera e tij politike.²⁰⁶ Darko Tanaskoviq për Blytën thotë se "Personalitetin e tij politik e ndërtoi në bazë religjioze dhe përkushtimit ndaj Islamit, si dhe karizmës personale dhe pasurisë së fituar gjatë periudhës midis dy luftërave, duke u marrë me tregti. Sipas bashkëkohanikëve, Blyta ishte nën ndikimin e sofizmit. Dhe përveç kësaj, shpesh u shfaq në xhami të ndryshme, por jo vetëm për shkak të ndjenjave fetare, por edhe për të mbajtur fjalime politike, në sajë të të cilave përhapi ndikimin e vet politik.²⁰⁷ Psikologjinë e masës e kuptoi mirë dhe me shkathtësi përdori demagogjinë dhe popullzimin²⁰⁸ Përveç

²⁰⁵ Istorijaska arhiva Novi Pazar (u daljem dijelu IANP-a), fond 285, Zbirka kopija, Memorandum o Krajosandarmanu od 838 okruga Kosovsko-mitrovački od 10.01.1942. godine, 19.

²⁰⁶ M. Radović, "Novi Pazar u NOB-u", II, 145

²⁰⁷ Aktiviteti propagandues i Blytës ishte krejtësisht legjitim dhe shteti nuk mund të ndërhyjë kundër tij. Në mënyrë të veçantë, prania e çështjeve politike dhe sociale gjatë predikimeve në xhami nuk është e pazakontë, sepse Islami nuk e pranon në parim ndarjen e sferës fetare dhe socio-politik. Prandaj, imami ose Hatibi (predikues të shquar) në xhami i është lejuar për të folur për çështjet politike dhe sociale. Rreth këtyre çështjeve më së shumti mbahen fjalime gjatë lutjeve të së premtes, lutjet e më i vizituar gjatë javës xhumasë, mbahen të premtën në mesditë, një predikim të vetëm quhet hydbë. Periudha e aktivitetit më intensive është gjatë Ramazanit .. Tanasković, D. (2000) Islam i mi, Beograd: Partenon. Fq.306–307, 310,-315,

²⁰⁸ M. Radović, (2007). Efendija sećanje i izreke, Novi Pazar,, , 179

kësaj, një burim gjerman nga 1941 e përshkruan Blytën si "një personalitet të shkëlqyer nga i cili del energji e madhe."²⁰⁹

Blyta ishte një nga njerëzit më të pasur në Sanxhakun lindor. Ishte kryetar i Bordit Drejtues të Shoqatës Tregtare të tregtisë në Qytet, këshilltar i Odës Ekonomike në Podgoricë, ndërsa prej vitit 1938 deri në gjysmën e parë të vitit 1940 edhe anëtar i Drejtorisë së Vakufit dhe Kuvendit të Vakufit në Shkup.²¹⁰

Në aktivitetin e Xhemijetit, fillimisht një lëvizje fetare–kulturore, dhe më vonë parti shqiptare–myslimane (boshnjake) e cila tubonte krerët myslimanë të Maqedonisë, Kosovës dhe Sanxhakut, Blyta kyçet në vitin 1919. Në kuvendin themelues të mbajtur në Shkup, më 19 dhjetor 1919²¹¹ Blyta u zgjodh sekretar i kësaj partie²¹². Kryetari i partisë ishte Nexhib Draga, një prej politikanëve të shquar në mesin e shqiptarëve, i cili në momente të caktuara, kur ishte nevoja, ishte aleat i radikalëve. Nexhipi ishte vëllai i madh i liderit të ardhshëm Xhemijetit dhe bashkëpunëtorë i ngushtë i Blytës.²¹³ Ferhati, përndryshe, në këtë kohë ishte i ikur jashtë atdheut.²¹⁴

Në nivel lokal, Blyta ishte organizator i kuvendit themelues i Xhemijetit në Novi Pazar, i cili u mbajt më 4 prill 1920. Tubimi i aprovoi të gjitha vendimet e Kuvendit themelues. Në këtë

²⁰⁹IANP, fond 285, Zbirka primeraka, Memorandum o akreditaciji 838 okruga Kosovsko-Mitrovački od 10.01.1942. god., 19.

²¹⁰ *Senat, Narodna skupština: Narodno predstavnštvo. Biografski leksikon, Beograd, 1939,*

²¹¹ „Politika“, 13. septembar 1923. godine, 1. Džemijet u prevodu sa turskog bukvalno znači udruženje ili zajednica. Prvobitni nazivi ove stranke bili su Organizacija za odbranu muslimanskih prava, odnosno Organizacija muslimana Južne Srbije...

²¹² Б. Храбак, „Новопазарске џемијетлије“, *Новопазарски зборник*, 27, 2003, стр. 243; М. Радовић, *верџер е ситиуар фј.*, 170.

²¹³ Б. Храбак, „Партијски живот на Косову и Метохији и Рашкој 1919–1923. године“, *Новопазарски зборник*, 24, 2000, 147, 156.

²¹⁴ В. Храбак, „ЈМО према муслиманима Сандžака, Космета и Македоније 1919–1929. године“, *Новопазарски зборник*, 19,

kontekst, u miratua rezoluta e veçantë, një nga dy nënshkruesit ishte Aqif Blyta.²¹⁵

Në tubim u vunë themelet e Xhemijetit në Pazarin e Ri dhe rrethinë. Sipas autorit M Radoviq²¹⁶ "që nga themelimi i Xhemijeti, Aqifi ishte anëtar dhe lider i tij në Novi Pazar, deri në shpartallimin e kësaj partie. Luajti rol të rëndësishëm në Këshillin e Përgjithshëm të Xhemijetit." Megjithatë, edhe pse ishte i renditur lart në listën e Xhemijetit, Blyta, nuk arriti të kandidohet në zgjedhjet parlamentare në nëntor të vitit 1920, kur Xhemijeti kishte fituar tetë mandate. Sipas M. Radoviqit: "Ka dy arsye për këtë. Së pari, Blyta si një ish—oficer i një vendi armik i Serbisë, kishte probleme për të marrë shtetësinë jugosllave dhe iu deshën disa vite për ta rregulluar këtë status."²¹⁷ Meqë ai e dinte gjuhën turke, shqipe dhe serbe, si i deleguar i partisë, edhe pse nuk ishte deputet, shpesh shkoi në Beograd për çështje të ndryshme politike. Ai me ndërgjegje të lartë kreu funksionin e sekretarit të partisë. U angazhua në ruajtjen e unitetit në parti dhe unitetin e të gjithë myslimanëve në Jugosllavi. Kërkoj që të harrohen grindjet partiake nga e kaluara dhe kundërshtoi përçarjet në Xhemijet. Centralizimi i tij partiak është pasqyruar mirë kur kërkoj që kandidatët për deputetë të nënshkruajnë dorëheqjet blanko në rast se nuk ndjekin direktivat e partisë. Megjithatë, si shqiptar që ishte, ai ishte më i përafërt me rrymën pro shqiptare në Xhemijet, duke përkrahur Nexhipin (vdiq 1922) dhe Ferat Dragën.²¹⁸

Në janar të viti 1923, Ferhad Draga, në Kongresin e 4—të të partisë, si lider i shqiptarëve të Kosovës, si dhe me përkrahjen e myslimanëve (pra shqiptarëve dhe boshnjakëve) të Sanxhakut imponohet lider i partisë. Për ngritjen e tij të shpejtë është merituar Aqif Blyta, i cili Dragës i siguroi përkrahjen e sanxhaklinjëve.

²¹⁵ M. Sekulić, "Rezultati parlamentarnih izbora u Raškom okrugu u periodu ograničenog parlamentarizma (1920-1929)", Novopazarski zbornik, 22, 1998, 170

²¹⁶ Radović, M. Efendijina sećanja i kazivanja strana 179

²¹⁷ Радовић, М. по ат. 179

²¹⁸ Радовић, М. *vepër e cituar.*, 179

Për shkak të gatishmërisë së tij në Xhemijet dhe mbështetjes politike ndaj Ferat Dragës, Blyta emërohet në krye të listës së kandidatëve të Xhemijetit për qarkun e Shtavicës (Tutinit) në zgjedhjet parlamentare të marsit 1923.²¹⁹ Xhemijeti në këto zgjedhje kaloi shumë mirë, duke i fituar 14 mandate dhe si partner i koalicionit hynë në qeverinë e Nikolla Pashiqit.²²⁰ Aqif Blyta në njësinë e tij zgjedhore arriti një fitore bindëse, duke fituar 51.78% të votave.²²¹ Rezultati i zgjedhjeve në qarkun Shtavicë (Tutinit) dhe Dezhevë (Novi Pazarit) dëshmuar për reputacionin dhe ndikimin e Blytës që ka pasur në këtë trevë. Ferat Draga po ashtu korri fitore në qarkun e Zveçanit–Rashkës. Megjithatë, zgjedhjet në qarkun e Dezhevës dhe Shtavicës kaluan me një numër të parregullsive,²²² kështu që komisioni verifikues i kontestoi pothuajse të gjitha mandatet e fituara të Xhemijetit, dhe në mesin e tyre edhe atë të Blytës. Atij para se gjithash i është zënë për të madhe bashkëpunimi i tij me kaçakun e mirënjohur Jusuf Mehoniqi, dhe një kohë të gjatë nuk ka pasur shtetësi serbe e jugosllave, dhe se ka jetuar gjatë në Turqi. Falë ndërhyrjes së të parit të radikalëve Nastas Petroviq, Blytës iu

²¹⁹ Zivković citon AJ, fond. 14, Ministarstvo unutrašnjih poslova (u daljem delu teksta MUP), f. 8, 133.

²²⁰ Nikolla Pashiqi, pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, me anën e një qarkoreje publike i vënë në dijeni shkencëtarët–historianë serb se: “Pa marrë parasysh mospajtimet tona në përcaktimet ndërpartiake në Serbi, në të ardhmen e nesërme shkencëtarët serb kanë mundësinë që t’ia lajnë borxhin Serbisë dhe tërë krishterimit sllav, këtij programi nacional të historiografisë retrograde serbe, “shqiptarët nuk ishin komb, por myslimanë dhe mbetje apo mbeturinë turke në Ball–kan”. Maqedonia ishte “Serbi Jugore” pa territor shqiptar, sipas konceptit: “e kujt është gjuha, i tij është edhe territori”. Rrjedhimisht, sipas parimit: “e kujt është feja, i tij është edhe territori” – s’mund të kishte komb shqiptar apo komb maqedonas. D. Bislimi, Historiografia pseudoshkencore serbe për shqiptarët ndërmjet dy Luftërave Botërore, Jeta shoqërore e shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë ndërmjet dy luftërave Botërore, Instituti për trashëgimi kulturore Shkup (Konferencë shkencore, 14–15 tetor 2015 – Shkup)

²²¹ Blyta në zonën e tij zgjedhore mori 3676 prej gjithsej 7,099 të votave. Rivali i tij kryesor, radikal Zhivko Shushiq mori 1,954 vota. Në përgjithësi, Xhemijeti në rrethin e Zveçanit–Rashkës mori 10,707 vota nga 21,384 vota, i cili ishte rreth 50.1%. Pjesëmarrja në zgjedhje ishte 75,15%AJ, fond 14, MUP, f. 9, 547.

²²² AJ, фонд 14, МУП, ф. 8, 121, 140–141

respektua mandati dhe në vitin 1923, u bë deputet në Kuvendin e Mbretërisë SKS.²²³ Përveç kësaj, Blyta nga Xhemijeti u kandidua për 6 komisione dhe në fund arriti të bëhet anëtar i tre komisioneve.²²⁴

Karriera e Blytës si deputet, edhe pse jetëshkurtër, ishte për t'u mbajtur në mend. Në të vërtetë, sipas Hrabakut, deputetët e Xhemijetit, për shkak të mos njohjes së gjuhës serbe, por edhe në mungesë të aftësive profesionale dhe politike, rrallëherë kanë marrë fjalën në parlament për t'u drejtuar opinionit.²²⁵

Aqif Blyta ishte me përvojë dhe njohës i mirë i rrethanave. Paraqitja më e dalluar e tij në Parlament ishte më 6 dhjetor 1923 në një takim të Komitetit Financiar. Aqif Blyta në fakt, edhe pse nuk ishte në rend të ditës, pra që kishte të bënte me buxhetin për vitin e ardhshëm, e hapi temën e vrasjes dhe torturimit e shqiptarëve etnikë në Mitrovicë dhe Gjakovë nga ana e autoriteteve policore gjatë zgjedhjeve komunale të mbajtura në gusht 1923. Ai kërkoi që autoritetet të rrisin përpjekjet e tyre për të gjetur dhe ndëshkuar autorët e krimit. Në anën tjetër, ka kritikuar vonesën e aprovimit të Ligjit për gjykatat e Sheriatit, me të cilin është menduar të jetë themeli i koalicionit ndërmjet radikalëve dhe Xhemijet.²²⁶ Blyta u ankua edhe për çështjen e pazgjidhur të reformës agrare në

²²³ Hrabak, B. (2003).:Džemijet: organizacija muslimana Makedonije, Kosova, Metohije i Sandžaka :1919-1928 Beograd: Autori.fq.175.

²²⁴ U kandidua për Komitetin për shpronësimin e pronave të mëdha dhe të kolonizim, Komitetin për amendamentimin e Ligjit Këshillit shteror dhe administrimin e gjykatave, Komisioni për njohjen e avokaturave në Dalmaci, Komiteti për Studimin e Ligjit me propozim të Jovo Popović ,mepropozimit Agatonovićit në Komisionin për ndryshime ligjore për dëme të luftës dhe Komiteti Financiar. Ai u bë anëtar i shpronësimit të pronave të mëdha dhe të kolonizim, Komiteti për Studimin e Ligjit me propozim të Jovo Popović dhe në Komitetin Financiar *Стенограмске белешке Народне скупштине, Редовни сазив за 1923. и 1924. годину*, књ. II, Београд, 1924, 1022–1026.

²²⁵ Umesto poslanika Džemijeta govorili su uglavnom poslanici Jugoslovenske muslimanske organizacije (JMO)... Hrabak,B. (1995) JMO prema muslimanima..., Novopazarski zbornik, br. 19, 1995,169.

²²⁶ „Vreme“, 7. decembar 1923. godine, 1.

krahinën e Sanxhakut.²²⁷ Diskutimi protestues i Blytës ka qenë i projektuar në qarqet udhëheqëse të Xhemijetit si reaksion ndaj marrëdhënieve të tensionuara midis partnerëve të koalicionit. Në këtë takim Blyta nuk kanë votuar për buxhetin e ri dhe se anëtari tjetër i Komitetit Financiar nga radhët e Xhemijetit ishte në takim (zyrtarisht ai ishte i sëmurë), buxheti nuk është miratuar dhe ministri i Financave, Millan Stojadinović, ishte i detyruar të japë dorëheqjen. Duke sulmuar partnerët e koalicionit në qeveri, e cila ishte tashmë në krizë, Blyta tërhoqi vëmendjen e opinionit politik. Rebelimi i tij gjatë fjalimit dha sinjal rënien e shpejt të qeverisë.²²⁸

Disa ditë më vonë, më 15 dhjetor 1923, Aqif Blyta, në seancën e rregullt të Kuvendit vazhdoi kritikën e tij. Ai akuzoi të gjithë ish autoritetet jugosllave se myslimanëve në Sanxhak iu është konfiskuar në mënyrë të paligjshme toka, dhe iu është dhënë ortodoksëve. Kështu, në të njëjtën kohë nga foltorja e parlamentit sulmoi qeverinë dhe opozitën, e cila shkaktoi një tronditje në mesin e deputetëve. Në vazhdim kërkoi të respektohen të drejtat kushtetuese të myslimanëve në Sanxhak, Maqedoni dhe Kosovë, në të vërtetë të trajtohen njëjtë si serbët, kroatët dhe slovenët. Garantoi se myslimanët janë besnik ndaj Beogradit (si provë për këtë numëroi viktimat myslimane që ranë në mbrojtjen Beogradit në vitin 1915) dhe se kurrë nuk do të kthehen kundër "fqinjëve" të tyre serbë. Ai gjithashtu kërkoi nga opozita të formojë një komision

²²⁷ Pas Luftës së Parë Botërore në të gjithë Jugosllavisë me Ligjin për Reformën Agrare bejlerëve iu është marrë toka, i cili u prit me entuziazëm nga fshatarët serb e myslimanë. Megjithatë, disa bejlerë dhe agallar me këtë rast u dëmtuan njaft rëndë. Në fakt, toka u shit me çmime shumë të ulëta, dhe shteti sa kalonte koha, në mënyrë të qvazhdushme zbritte qiratë në tokat e konfiskuara. Bejlerët, por edhe familjet fshatarë myslimane u shkatruan, sepse me vështirësi të mëdha hasën në përshtajen e tregut kapitalist. Situata në Sanxhak ka qenë veçanërisht problematike. Pjesa më e madhe Bejlerëve ishte e pakënaqur me autoritetet juji tokat dhe privilegjet. Grupa autora, Novi Pazar i okolina, Beograd, 1969, 287; B. Hrabak, „Partijski život...“, 157.

²²⁸ „Vreme“, 7. decembar 1923. godine, 1.

i cili në vend të ngjarjes të vërtetë pohimet e tija se reforma agrare për popullsinë myslimane ka shkaktuar probleme, pa ndonjë dobi.²²⁹

Deri nga mesi i vitit 1924 Blyta ishte tashmë njëri nga politikanët me ndikim në Xhemijet. Përveç paraqitjeve të tija të suksesshme publike, në lidhje me këtë dëshmon fakti se se personalisht Nikolla Pashiq i bënë ftesë për negociata kur Qeveria, për shkak të krizës në mars 1924, bën përpjekje për të zbutur marrëdhëniet me Xhemijetin. Në shkurt 1924 Aqif Blyta pati një paraqitje të re në Kuvend. Gjegjësisht, pasi pësuan disa civilë shqiptarë në fshatrat rreth të Vushtrisë gjatë fushatës për të kapur një vjedhës nga xhandarmëria, Fehrat Draga dhe Aqif Blyta dorëzuan një interpelancë në Ministrinë e brendshme.²³⁰ Në këtë kontekst Blyta diskutoi në Kuvend më 30 mars 1924 kur interpelanca ishte në rend të ditës. Blyta u lidh me diskutimin e Farhat Dragës për dhunën ndaj popullatës jo të krishterë në Kosovë dhe Sanxhak nga ana e policisë. Pas këtij diskutimi pasuan raporti i detajuar i Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe disa sulme ndaj Farhat Dragës dhe Xhemijetit nga politikanët serbë nga Kosova dhe Dukagjini.

Megjithatë, forcimi i Xhemijetit dhe prononcimet më të lirshme të përfaqësuesve të tij, dhe përafrimit ndaj opozitës, në të vërtetë ndaj Partisë Fshatare republikane kroate të Stjepan Radiq (me kontaktet tashmë ekzistuese me JMO), nuk i përshtatej Nikolla Pashiqit. Ai, në gjykatë, me mbështetjen e gjykatës, arrin eliminimin e Xhemijetit nga skena politike jugosllave.

Tehu i sulmeve të tyre verbale ishin të drejtuara ndaj bashkëpunimit të anëtarëve të Xhemijetit me shumicën e bandave kaçake.²³¹ Blyta, në anën tjetër, përmendi se xhandarët nga qarku i Shtavicës

²²⁹Steno. beleške Narodne skupštine, Redovni saziv za 1923. i 1924. godinu, knj. I, Beograd, 1924, 244–246.

²³⁰ Interpelanca....

²³¹Për më tepër në lidhje me bashkëpunimin e Xhemijetit me kaçakët shih në: „Politika“, 4. mart 1924. godine, 1; 5. mart 1924. godine, 1; 10. mart 1924. godine, 4; 20. mart 1924. godine, 1–2; 21. mart 1924. godine, 2–3; 27. mart 1924. godine, 1;

(Tutinit) janë në lidhje me kaçakët dhe ndajnë plaçkën me ta. Ai tha se nga kaçakët pësojnë myslimanët dhe serbët dhe se Xhemijeti nuk ka asnjë lidhje me ta. Ai gjithashtu përmendi marshimin e Kosta Peçancit nëpër Sanxhak në vitin 1922. Përfundoi duke akuzuar qeverinë se nuk ka taktika të drejta për të luftuar kaçakët dhe ndjekjet e tyre zakonisht përfundojnë me ushtrim të dhunës kundër popullatës jo-të krishterë.²³²

Aqif Blyta dhe Ferhat Draga janë shënuar si persona për të cilët duhet ushtruar presion policor. Blyta u arrestua katër herë midis 27 dhjetorit 1924 dhe 6 shkurtit 1925.²³³ F. Draga u arrestua gjithashtu disa herë. Zgjedhjet në Novi Pazar dhe rrethinat e saj kanë kaluar me shumë dhunë kundër myslimanëve dhe një numër parregullsisht. Për shkak se rezultatet e publikuara të Xhemijetit për qarkun e Dezhevës dhe Shtavicës nuk mund të merren si të vërteta për shkak të presionit nga autoritetet ekzekutive, nuk dihet se sa vota Blyta fitoi këtë herë.

Me ndërprerjen e ekzistencës së Xhemijetit, u ndërpre karriera politike e Aqif Blytës për shumë vite, sepse aktiviteti i mëtijshëm publik kishte me shkaktuar presion të ri ndaj autoriteteve ekzekutive. Megjithatë, Blyta mbeti politikan i ndikim në Novi Pazar dhe rrethinat e tij. Për shumë, Blyta ishte një mik i respektuar, tregtar dhe politikan në zë, por gjithashtu një simbol i rezistencës ndaj Beogradit dhe një shteti që myslimanët e rajonit kurrë nuk e pranuan plotësisht. Ndikimi i tij nga Novi Pazar u përhap në rajonet përreth, veçanërisht në rajonin e Shtavicës. Nga ana tjetër, Blyta kuptoi avantazhet e pozicionit të tij. Ai mbledhi ish-anëtarët e Xhemijetit nga zonat e Dezhevës dhe Shtavicës dhe mbajti kontakte me ta. Duke i "drejtuar" votat myslimanëve, kishin një ndikim të madh në zgjedhjen e liderëve politikë serbë nga rrethi Dezhevës dhe Shtavicës. Ndikimi i tij u ndje në të gjitha zgjedhjet

²³² Radović, M. (2007). po aty, Stenogramske beleške 1924, po aty f., , 421–424.

²³³ „Politika“, 2. januar 1925. godine, 3.

në këtë rajon deri në vitin 1941. Nga ana tjetër, ai mori mbështetje politike nga politikanët serbë dhe autoritetet lokale për të zgjeruar më tej popullaritetin e tij politik.

Si përfundim

Aqif Blyta është figura më e famshme historike e gjysmës së parë të shekullit të XX-të në trevën e Sanxhakut lindor. I lindur në familje të pasur në Novi Pazar, e cila i mundësoi arsimin në shkollat më të mira dhe Akademinë më të mirë të kohës në Ballkan. Në fillim të vitit 1919, ai u kthye nga Turqia në vendlindje. Atëherë fillon veprimtarinë e tij aktive politike, së pari në Xhemijet, pastaj në parlamentin jugosllav ku deri në vitin 1925, dy herë kishte mandat, e mandej aktivitet gjysmë–publike në nivel lokal. Përveç që ishte kreu i Xhemijet për Sanxhak dhe sekretar i saj, ishte edhe kolumnist në organin e kësaj partie ,gazetën "Hak". Duke i shfrytëzuar aftësitë diplomatike dhe lidhjet me ambasadën turke, arriti të ndikojë në uljen e shpërnguljes nga Sanxhaku dhe Kosova. Falë aftësive të tij intelektuale e politike dhe pasurisë së madhe që ka fituar si tregtar, Blyta gëzonte autoritet të madh si në Sanxhak dhe në Kosovë, dhe jo vetëm te boshnjakët dhe shqiptarët, por edhe te serbët lokalë.

NAIM HALIMI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

XHEMIJETI NË DITARIN E ATDHETARIT KUMANOVAR, AZEM HOXHA²³⁴

Mbarimi i Luftës së Dytë Botërore, shqiptarët që jetonin në trojet e tyre jashtë Shqipërisë së vjetër (mendohet për Shqipërinë Londinëze), i la ata në gjendje shumë të vështirë. Nga lufta humbi gati një e treta e popullsisë. Ekonomia u shkatërrua. Dëmshpërblimet luftarake që u prematuan, nuk u realizuan. Ajo që i dëmtoi edhe më shumë këta shqiptarë (që dikur jetonin në Vilajetin e Kosovës, Manastirit e Shkodrës), qe Konferenca e Versajit (1919), e cila këtë trevë shqiptare e la nën sundimin e Mbretërisë Serbo-Kroato-Sillovene, ku dominoi borgjezia serbomadhe me Karagjorgjeviqët në krye, e cila kurrë nuk e zgjodhi drejtë çështjen agrare e as atë kombëtare të popujve të saj, kuptohet as atë të shqiptarëve. Shqiptarët në këtë shtet, lëre që s'u pranuan si të barabartë me të tjerët edhe pse ishin mbi një milion, por as si qytetarë të rendit të dytë. Atyre s'u njoh asnjë e drejtë kombëtare. Ata u njohën me emrin përbuzës "arnaut", ndërsa territori i tyre "Serbi jugore", me qendër në Shkup (i cili për ta u bë Beogradi II-të).

Azem Hoxha, thotë se, pa hyrë thellë në historinë e sundimit antishqiptar të këtij shteti, i cili pati për qëllim zhdukjen tonë në

²³⁴ **Azem (Latif) Hoxha** (1890-1964) ishte nga Malësia e Kumanovës, fshati Shtrazë. U shkollua në familje, Kumanovë, Shkup e Stamboll, për fe, histori e drejtësi. Njohu shumë gjuhë. Pas LPB-ës u kthye në atdhe. U punësua në myftini ku punoi si hoxhë e myfti. U dallua për dituri, oratori, zotësi e trimëri. Mori pjesë në shumë ngjarje me rëndësi. La shënime për histori. Në vitet e 80-ta në bibliotekën e tij të pasur u gjet dhe një ditar, fletore me 50 fletë, me titull „Xhemijeti”, e shkruar në gjuhën shqipe me një stil të pasur të dialektit kosovar, pjesë të së cilit përmbanë kjo kumtesë.

forma të ndryshme, shqiptarët mbijetuan, madje edhe politikisht u organizuan. Për t'u organizuar politikisht, më 17 dhjetor 1919 në Shkup, në prani të 64 delegatëve, shumica shqiptarë nga viset prej Struge në Novi Pazar, mora pjesë edhe unë si kumanovar, i deleguar nga populli i kësaj ane, Karadakut. Këtu në Shkup, në një shtëpi afër konakut të dikurshëm të Vilajetit të Kosovës u themelua Partia politike Xhemijeti, e cila një ditë pas (më 18 dhjetor 1919), u publikua. Në mbledhje, partia mori dy emra. Emri i saj i vërtetë qe „Shoqëria e mbrojtjes së të drejtave shqiptare”, ndërsa në opinion për t'u maskuar u paraqit me emrin legal: „Shoqata islame për mbrojtje dhe drejtësi” ose Xhemijeti (arabisht: shoqëri, shoqatë, organizatë, bashkim). Kuvendi pas një debati tetë-orësh aprovoi Statutin, Programin, zgjodhi Këshillin qendror dhe atë Mbikëqyrës, kryetar Nexhip Dragën, luftëtarë i vjetër i LKSH-së, nënkryetar Sheh Sadudinin nga Tetova dhe sekretar Aqif Blytën nga Novi Pazar, me prejardhje gjakovare. Pas kësaj, Kuvendi u shpërnda, thotë hoxha në shënimet e tij, duke marrë për detyrë që secili kuvendar në vendin e tij të punojë, në ndalimin e përpjekjeve serbo-sllave për shkatërrimin, dëbimin, kolonizimin dhe asimilimin e shqiptarëve dhe myslimanëve, duke bashkëpunuar me Lëvizjen kaçake dhe Komitetin e Kosovës. Në këto rrethana e kushte të rënda Xhemijeti e nisi punën dhe u bë e vetnja mburojë e Lëvizjes çlirimtare shqiptare në tërë territorin e mbretërisë SKS-së. E para punë e saj u bë ndalja e kolonizimit, e marrjes së tokave të shqiptarëve dhe e dëbimit të tyre. Për të qenë më të suksesshëm hymë në zgjedhjet parlamentare të vitit 1920, tregon më tej Hoxha, ku morëm si Xhemijet 14 deputetë, në mesin e të cilëve edhe unë, me 3 të tjerë nga viset shqiptare prej Presheve deri në Manastir. Kjo s'qe shumë për ne, por u ndie zani i kërkesave shqiptare në Beograd. Në Parlament shtruam shumë çështje që e preknin popullin tonë. Bashkëpunuam edhe me partinë politike të myslimanëve të Bosnjës ku në disa raste patëm përkrahjen e tyre si: për autonominë e plotë fetare, gjyqet e sheriatit, vakëfet, për përdorimin zyrtar të gjuhëve jo serbe në shkolla, për mbrojtjen e pasurive

etj. Në Parlament, deputetët e Xhemijetit për sa kohë qëndruan, shtruan shumë ankesa e kërkesa, madje organizuan edhe protesta duke njoftuar botën e edhe Shoqatën e popujve në Gjenevë, me qëllim që të përmirësohen kushtet e popullit shqiptar.

Nikolla Pashiqi, udhëheqës i radikalëve serb, edhe pse punonte vetëm për serbë e Serbi, meqë kishte nevojë të siguronte shumicën në Parlament, një kohë bashkëpunoi me ne, në Beograd e Shkup, shumëçka premtoi, madje edhe shkollim në gjuhën amtare, gjë që ishte edhe e drejtë ndërkombëtare, mirëpo kurrë asgjë nuk realizoi. Votat tona (thotë Hoxha në ditarin e tij) i shfrytëzoi sa për të ardhur në pushte, për ta forcuar atë dhe për ta votuar Kushtetutën. Kjo, padrejtësi i hidhëroi shumë shqiptarët dhe i detyroi të bëhen të pa dëgjueshëm ndaj tij. Për t'u njoftuar më mirë me situatën që ekzistonte pas një viti e dy muaj (23 janar 1920), Xhemijeti e nxori edhe gazetën „Hak” (arab. drejtësi, e drejta, e vërteta), në turqisht dhe serbisht. Kjo gazetë ndonëse s'ishte në gjuhë shqipe lexohej me ëndje dhe mjaftë e informonte popullin për situatën, rrjedhat e kohës dhe punën e Xhemijetit, e cila kryesisht që e orientuar në unitetin e popullit, në ruajtjen dhe ngritjen e vetëdijes kombëtare dhe fetare, të lirisë, atdheut e pasurisë, duke bashkëpunuar me të gjitha shtresat e popullsisë. Kjo punë e Xhemijetit nuk i shkoi për qejf Serbisë.

Pashiqi duke parë se do ta humbë pushtetin vendosi ta zhduk Xhemijetin. Së pari u vra (vdiq), në sall të operacionit në Vijenë, Nexhip Draga, ndërsa vëllai i tij i vogël që e trashëgoi, Ferat Draga, u dënua me shumë vite burg. Fat të njëjtë patën edhe shumë deputetë e atdhetarë shqiptarë. Kështu u veprua edhe me Lëvizjen kaçake dhe Komitetin e Kosovës. Xhemijetçinjtë nuk e patën përkrahjen e duhur fatkeqësisht as të Shqipërisë dhe në rrethana e kushte të tilla Lëvizja Kombëtare Shqiptare që zhvillohej nëpërmjet Xhemijetit, në vitin 1924 u shua.

ZEQIRIJA IBRAHIMI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

IDENTITETI POLITIK I XHEMIJETIT

Sa herë që e studiojmë të kaluarën, problemi i studiuesve mbetet qasja studimore, sepse shpeshherë ata nuk mund të çlirohen krejtësisht nga subjektivizmi i aktualitetit dhe jo rrallëherë të kemi analiza dhe kualifikime që rezultojnë si të pasakta ose, edhe më keq, tendencioze. Një fat të tillë e ka edhe organizata politike “Islam Muhafezen Hukuk Xhemijeti” (Organizatë për Mbrojtjen e të Drejtave të Myslimanëve), që më vonë e mori emrin “Organizatë e Myslimanëve të Serbisë Jugore”, dhe e cila në historiografinë shqiptare njihet me emrin “Xhemijeti”.

Në kontekst të asaj që e thamë në fillim, sot për një shqiptar të shek. XXI është pak e kuptimtë si mundet që një organizatë politike që i mbron interesat kombëtare të shqiptarëve ta ketë emrin arab/turk. Kjo mund të ishte temë e veçantë edhe një për shumë tema të historisë sonë kur ato gjykohen nga perspektiva të aktualitetit. Sidoqoftë, në këtë artikull do të flasim për identitetin politik të Xhemijetit.

Emri

Ashtu si e thamë më sipër, emri i kësaj organizate ishte më i gjatë, ndërsa ajo njihej shkurtimisht me emrin Xhemijet. Në fakt, rrënja e kësaj fjale është nga arabishtja, që nënkupton bashkësi/komunitet (të njerëzve, të pjesëtarëve të një kombi, të një besimi etj.), madje ajo fjalë edhe sot e kësaj dite përdoret në trajtën e komunitetit të xhamisë (xhemat). Nëse edhe sot në mjedise religjioze shqiptare të Maqedonisë dhe Kosovës (por edhe të Shqipërisë tashmë) përdoret termi *xhemat*, duhet të jemi shumë të sigurt se në fillim të shekullit

të shkuar, kur nuk ishte bërë as një dekadë e ndarjes së shqiptarëve nga Perandoria Osmane dhe kur kontaktet e shqipes me osmanish-ten vazhdonin të rridhnin, një emër i tillë ishte fare lehtë i pranuar dhe nuk do të duhej të kishte asgjë kontestuese.

Këtu duhet theksuar edhe diçka tjetër. Nga fundi i gushtit të vitit 1908 shqiptarët e formuan klubin “Bashkimi”²³⁵ (në turqisht edhe ai njihej si “Xhemijet”), nën emrin e të cilit u ftua edhe Kongresi i Manastirit dhe i cili do ta botojë edhe gazetën “Shkupi” (në më 1911–1912). Kjo i bie se Xhemijeti i viteve 1919–1925 mund të ishte një anë tjetër e medaljes së *Bashkimit* të viteve 1908–1912. Sidoqoftë, Xhemijeti ishte një fjalë e pranuar gjerësisht për shqiptarët e asaj kohe. E, nëse kësaj i shtohet edhe konteksti i Mbretërisë Serbo–Kroato–Sllovene, e cila i ndalonte partitë politike etnike (Mbretëria SKS i njihnte si kombe vetëm serbët, kroatët dhe sllovenët, ndërsa të tjerët i lejonte të organizoheshin në grupe religjioze), që ishte mundësia e vetme legale për të artikuluar kërkesa politike, por edhe faktit se – përmes emrit – kamufloheshin interesat e shqiptarëve nën interesat e bashkësive të tjera religjioze, zgjidhja e emrit të organizatës politike mund të duket një mënyrë e mirë e përfaqësimit politik të shqiptarëve në ato rrethana. Të përkujtojmë se në kohën kur rrezikohej të zhbëhet plotësisht qenia jonë kombëtare sigurisht tema më pak e rëndësishme do të ishte se si do të quhej organizata që do ta kryente rolin e kësaj mbrojtjeje.

Xhemijeti dhe nacionalizmi shqiptar

Nëse Xhemijetin e vështrojmë nën llupën e nacionalizmit shqiptar, detyra e parë që duhet ta bëjmë është që ta përkufizojmë për çfarë nacionalizmi flasin²³⁶. Nëse me nacionalizëm shqiptar nënkuptojmë

²³⁵ Skender Asani, *Veprimtaria organizatës politike Xhemijeti në Trevat Lindore (1919-1925)*, Logos-A, Shkup, 2017, fq. 14.15. Sipas tij, në klubin “Bashkimi” bënte pjesë edhe Nexhib Draga, që pastaj do të ishte themelues edhe i Xhemijetit.

²³⁶ Për këtë shih: Milazim Krasniqi, *Nacionalizmi shqiptar*, SHB “Logos-A” – Shkup, 2014.

unifikimin e kombit me shtetin, siç projektohej nga Sami Frashëri në “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhetë”, i bie të themi se Konferenca e Londrës e vulosi se shqiptarët së paku edhe një kohë nuk do të mund të ishin në një shtet të përbashkët, andaj edhe nuk mund të flitej për nacionalizëm shqiptar në kuptimin rilindës të tij. Prandaj, nacionalizmin shqiptar kundrejt Xhemijetit duhet ta vështrojmë më shumë në rrafshin identitar, arsimor e kulturor. Dhe, në këtë drejtim, mund të themi se Xhemijeti u angazhua për mbrojtjen e qenies shqiptare në Mbretërinë SKS, natyrisht të mbuluar nën petkun e religjionit islam. Janë dhjetëra dëshmi se Xhemijeti në kërkesat e veta kërkonte arsim në gjuhën amtare, që për shqiptarët nënkuptonte arsim në gjuhën shqipe. Kështu, fjala bie, në programin themelor 10–pikësh të Xhemijetit, artikulohej edhe kërkesa për arsim në gjuhën amtare: “4. *Gjuhë amtare për popullatën josllave, përkatësisht myslimane në arsimin fillor, dhe autonomi në funksionimin e shkollave*,”²³⁷ Ose, në Proklamatin e zgjedhjeve të vitit 1920, nga Xhemijeti bëhej kjo thirrje: “*Po afrohen zgjedhjet për Kuvendin Ligjdhënës. Nëse dëshirojmë të jetojmë të lirë e me drejtësi, në rajonet ku jetojmë, t’i fitojmë liritë fetare, të drejtat kombëtare dhe qytetare, duhet të gjithë të marrim pjesë në zgjedhjet që do të mbahen më datë 28 të këtij muaji*.”²³⁸ Ndërkaq për elementin e barazisë në kërkesat e Xhemijetit thuhej: “*Të praktikohet barazia, pa asnjë dallim nga popujt e tjerë në këtë shtet*”, si dhe: “*Shteti të mos bëjë diferencim mes serbëve dhe myslimanëve*.”²³⁹

Xhemijeti, duke synuar mbrojtjen e territoreve etnike shqiptare nga kolonizimi, që stimulohej përmes reformës së famshme agrare (që ua merrte pronat shqiptarëve dhe sillte aty kolonë serbë), në fakt e mbronte gjeografinë shqiptare në ato troje. Fjala bie, po në atë program disa pika i kushtohen kësaj:

3. *Ruajtja e vakëfit dhe të mirave të tjera materiale;*

²³⁷ Skender Asani, *Veprimtaria*, fq. 51

²³⁸ Po aty, fq. 67

²³⁹ Po aty, fq. 94

7. *Përfashtimi i vakëfit nga sekuestrimi ose kompensimi me marrjen e të mirave materiale;*

8. *Përfashtimi i pronave të bejlerëve nga reforma agrare, me përkushtim në përcaktimin e rregullimit të çështjes së reformës agrare;*

10. *Nga viti 1912, pa pëlqimin e pronarëve, ishin marrë pronat e bejlerëve, dhe ishin vënë nën pushtetin serb dhe nën administrimin e dhunshëm të armiqve. Organizata angazhohet për kthimin e pronave në gjendjen e para vitit 1912.*²⁴⁰

Në aspektin e angazhimit për arsim në gjuhë amtare, po i sjellim edhe disa elemente të tjera që e përdëftojnë këtë. Në një tubim të mbajtur në Shkup më 25 shkurt 1921 në Shkup, ku morën pjesë shumë delegatë të Xhemijetit, u fol kryesisht për arsimin dhe aty, madje, u kërkua *“Hapja e shkollave për arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë...”* por edhe që: *“Gjuha serbe të mësohet në mënyrë fakultative si gjuhë e huaj”*,²⁴¹ që i bie se gjuhë e detyrueshme duhej të ishte gjuha amtare. Në kontekst të shkollave ka edhe një listë pikash, të miratuara në Kuvendin e Xhemijetit, të mbajtur në qershor të vitit 1911 në Shkup, ku për çështjen e arsimit në gjuhën amtare ishte shkruar:

- *Myslimanët e trevave verilindore, të kenë shkollat e tyre, me të cilat do të udhëheqë Organizata Myslimane. Në këtë shkolla duhet të punohet sipas programeve të përgatitura nga organizata;*
- *Të kërkohet nga shteti kredia e nevojshme për mbajtjen e këtyre shkollave;*
- *Gjuha amtare lirisht të mësohet në shkollat myslimane;*²⁴²

Në lidhje me qëndrimin e Xhemijetit ndaj arsimit në gjuhën amtare e kemi edhe një dokument të legatës franceze në Shkup, në të cilën konsulli frëng i njoftonte autoritetet në Francë se *“ata duan që*

²⁴⁰ Po aty, fq. 51-52

²⁴¹ Po aty, fq. 78

²⁴² Po aty, fq. 93

*fëmijët e tyre të mësojnë serbisht, por duan gjithashtu edhe mësimin e gjuhës amtare, d.m.th gjuhën turke ose shqipe*²⁴³
 Madje, kur bëhet fjalë për botimet në gjuhën shqipe, Xhemijeti do të jetë edhe më i drejtpërdrejtë: *“T’u lejohet shtypshkronjave të botojnë libra në gjuhën shqipe dhe turke për shkollat, për shembull Abetare*²⁴⁴

Kur i shikon këto kërkesa në këtë kohë, ato janë gati të njëjta me kërkesat e shqiptarëve të Maqedonisë në këtë kohë. Mjafton të kujtojmë se shqiptarët e Maqedonisë edhe në shekullin tonë në dokumentet e shtetit e quajnë gjuhën shqipe *“gjuhë që e flasin mbi 20% të popullsisë”* dhe tashmë askujt gati nuk ia vret veshin fakti se nuk përdoret togu *“gjuha shqipe”*²⁴⁵.

Familja Draga

Një element tjetër që e vulos identitetin shqiptar të Xhemijetit është pa dyshim familja që e barti këtë organizatë, pra familja Draga. Edhe nëse, për shkak të gjuhës së kamufluar ose termave politikë të përdorur në artikulet e Xhemijetit, megjulohet diçka në identitetin e saj, janë Nexhib dhe Ferhat Draga, dy themeluesit dhe bartësit e Xhemijetit, kujdestarët dhe dëshmitarët e identitetit shqiptar të tij. Në të vërtetë, familja Draga njihet edhe si pjesëmarrëse në shpalljen e pavarësisë në Vlorë më 28 nëntor 1912, ku ishte nënshkruar edhe Ajdin Draga, vëllai i Nexhibit dhe Ferhatit.²⁴⁶ Ndërsa familja Draga më parë ishte pjesëmarrëse edhe në Lidhjen Shqiptare të Pejës më 1899, ku përmendet Ali Pashë Draga.²⁴⁷

²⁴³ Skender Asani, *Dokumente për veprimtarinë politike të Xhemijetit*, Logos-A, Shkup, 2017, fq. 35

²⁴⁴ S. Asani, *Veprimtaria e...*, fq. 95.

²⁴⁵ Shih: Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë dhe ligjet për përdorimin e gjuhëve.

²⁴⁶ Shih: Nebi Dervishi, *Hajdin Draga – pjesëmarrës në Kuvendin e Vlorës*, ITSHKSH, Shkup, 2015, fq. 18

²⁴⁷ Po aty.

Identitetin e fuqishëm etnik të Dragajve e konfirmojnë edhe shumë dokumente të tjera, raporte të konsujve etj., një pjesë e të cilëve po i sjellim edhe këtu më poshtë. Kështu, për shembull, konsulli italian në Shkup, duke raportuar për arrestimin e Ferhat Dragës, do të thotë se ai akuzohej për irredentizëm shqiptar.²⁴⁸ Ndërkaq në një fjalim që e kishte mbajtur Ferhat Draga në Kuvendin Popullor në Beograd më 20 mars 1924, ai do të shprehet vet se: *“Nuk e kam gjuhë të nënës gjuhën serbe; gjuha ime është gjuha arnauete (shqipe), prandaj sërish po them të më falni nëse gjatë fjalëve të mia harroj ndonjë shprehje. Nuk jam shkolluar në gjuhën serbe.”*²⁴⁹

Ferhat Draga përmendet edhe si bashkëpunëtor i Komitetit të Kosovës. Kur u arrestua, ai u akuzua edhe për bashkëpunim me këtë organizatë.²⁵⁰ Po ashtu në atë rast ai akuzohej edhe si bashkëpunëtor i Hasan Prishtinës. Në aktakuzë thuhej: *“Sepse gjatë okupimit ka qenë kryetar i komunës dhe në shoqëri me Dervish Beun dhe Hasan bej Vuçitërnën ka bërë organizim për regjistrimin e vullnetarëve në ushtrinë austriake.”*²⁵¹ Madje, nipi i Ferhat Dragës, Shefketi, ishte vrarë pikërisht si bashkëpunëtor i Komitetit të Kosovës.²⁵² Si aktivist të çështjes shqiptare dhe i shtetit shqiptar, Ferhat Dragën e njihje edhe diplomacia perëndimore. Kështu në një raport të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë, mes tjerash, thuhej: *“Në njërën prej tyre paraqitet veçanërisht aktiviteti i këtyre muajve të fundit nga eksponenti më autoritar i pakicave shqiptare në Jugosllav, zotit Ferhat bej Draga, i cili – i thirrur në Kostandinopojë nga Zogu – ka marrë udhëzime nga ai për linjën që duhet të ndjekë ndaj Jugosllavisë dhe situatës së re të krijuar në Shqipëri.”*²⁵³ Ndërkaq, në një raport të konsullit mbretëror për shtetin shqiptar thuhej:

²⁴⁸ Shih: Skender Asani, *Veprimtaria politike*..., fq. 164.

²⁴⁹ Skender Asani, *Dokumente*..., fq. 132.

²⁵⁰ Случај г. Ферхад бег Драге, “Наша Стара Србија“, бр.26, Скопје, дт.04.02.1925, 2. (Cituar sipas Skender Asani, *Veprimtaria politike*..., fq. 89)

²⁵¹ Skender Asani, *Dokumente*..., fq. 190

²⁵² Skender Asani, *Veprimtaria*..., fq. 89.

²⁵³ *Dokumente*..., fq. 252.

Është lajm tërësisht fals se Ferhat Draga merr para nga Qeveria e Beogradit. Ai është persekutuar rregullisht nga të gjitha regjimet e Beogradit, me çdo lloj keqtrajtimi, burgosje e sekuestrim pasurie. Në fakt, në vitet 1923–1924, kur ishte kreu i partisë së quajtur “Xhemijet”, e cila në radhët e veta kishte 20 deputetë²⁵⁴, pjesa më e madhe e të cilëve ishin shqiptarë dhe boshnjakë myslimanë, mbron-te pakicat shqiptare në Dhomën politike, ndërkohë që presidenti i Këshillit Nikolla Pasto e burgosi dhe e shkriu partinë e tij.

Të gjitha citime dhe faktet dëshmojnë se Xhemijeti ishte një organizatë politike me strumbullar shqiptar, e cila kishte gjetur rrugën, që nën një emërtim dhe mbulesë tjetër, t’i artikulonte dhe mbron-te interesat e shqiptarëve të mbetur jashtë Shqipërisë. Për këtë në një artikull të gazetës “Politika” të 20 marsit 1923 thuhej: *“Organizata e myslimanëve të Serbisë Jugore me emrin “Xhemijet” ka punuar nën maskën për tendenca arsimore–kulturore, andaj është lejuar veprimi i saj në tërë popullatën myslimane në viset jugore.”*²⁵⁵ Madje, edhe më vonë (më 1940) në një raport të Regjimentit të xhandarmërisë së Vardarit, që i drejtohej Komandantit të Zonës III Ushtarake, përsëri thuhej: *“Shumica janë përcaktuar për SHQIPËRI TË MADHE nën protektoratin e Italisë. Udhëheqësit Ferhat bej Draga, Sherif Voca, Iljaz Agusheviq, Shabani nga Mitrovica e Kosovës etj. – e kanë zhvilluar aktivitetin e jetës, duke u kamufluar mbi bazat e pastra fetare.”*²⁵⁶

Xhemijeti si përfaqësim autokton

Nëse tashmë jemi të bindur se indi lidhor i Xhemijetit ishte pikërisht interesat kombëtare shqiptare, na bie të diskutojmë pak edhe për tipin e nacionalizmit shqiptar që e solli kjo organizatë politike, por edhe profilin e saj politik.

²⁵⁴ Skender Asani në monografinë kushtuar Xhemijetit shkruan se Xhemijeti i fitoi 14 deputetë. Shih: S. Asani, *Veprimtaria....*, fq. 8.

²⁵⁵ Po aty, fq. 70.

²⁵⁶ Po aty, fq. 257

Meqë e kemi të qartë profilin atdhetar të Ferhat Dragës, kur kësaj i shtohet edhe fakti se ai u gjend thuaja në të gjitha organizimet e shqiptarëve të kësaj ane, fjala bie më 1937 ishte ndër aktivistët më të zellshëm dhe më të rëndësishëm në zgjedhjet e Bashkësisë Islame në Shkup (kur për herë të parë shqiptarët e morën në dorë atë institucion), që pati rol të madh në pengimin e shpërnguljes së shqiptarëve, në këtë mënyrë arrijmë ta kuptojmë edhe më mirë Xhemijetin²⁵⁷. Për një shqiptar të këndejkufirit, e kemi fjalën për kohën e Xhemijetit, të ishe mysliman kjo nënkuptonte të ishe edhe shqiptar dhe ta mbroje identitetin fetar, kjo nënkuptonte ta mbroje edhe identitetin kombëtar. Ta luftoje reformën agrare dhe kolonizimin, si dhe ta luftoje shpërnguljen e shqiptarëve për Turqi, nuk kishte vepër më patriotike në atë kohë. Kjo ishte betejë për ta mbrojtur qenien biologjike, por edhe politike shqiptare. Madje, kundruar kështu, edhe kërkesat e spektrit religjioz, që i shtronte Xhemijeti ishin shumë të rëndësishme në këtë aspekt, sepse përmes tyre qenia jonë mbrohej nga asimilimi. Vetëm duke e kultivuar sentimentin fetar, Xhemijeti arrinte ta ruajë dallimin e shqiptarëve nga serbët dhe të tjerët, që – siç e dimë më vonë me komunizmin, kur u përjashtua feja – u synua të bëhej jo vetëm asimilim politik, por edhe etnik. Këtu mund të kujtojmë se Mbretëria Jugosllave në vitin 1924 kishte hapur në Shkup “Medresenë e Madhe të Mbretit Aleksandar”, që kishte për qëllim krijimin e teologëve të përshtatshëm për pushtetin. Andaj, dijetarët myslimanë të kohës u angazhuan me medrese private, që ta mbrojnë identitetin e tyre nga këto invazione.

Krejt kjo e bën projektin politik të Xhemijetit një projekt që ishte edhe autokton, por edhe autentik. Së pari ishte autokton, sepse u krijua nga brumi etnik shqiptar, që ishte kalitur ndër vite në lëvizjen kombëtare shqiptare, duke dhënë prova serioze, ndërsa ishte autentik, sepse kishte gjetur modelin e përfaqësimit autentik

²⁵⁷ Shih: Qerim Lita, *Masat e dhunshme në Mexhlin e Ulemasë së Shkupit*, SHENJA nr. 82, Shkup, fq. 79-83

deri atëherë të paparë në traditën e organizimit politik të shqiptarëve. Prandaj bien në ujë të gjitha interpretimet që Xhemijetin duan ta vendosin në kontekste që ia kontestojnë përpjekjen për mbrojtjen e qenies shqiptare të këndejkufirit. Bile, nëse e shtyjmë më tej këtë analizë, do të kishim thënë se Xhemijeti është një vazhdimësi e frymës nacionaliste të Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe, madje, këtu erdhi në shprehje nacionalizmi shqiptar tipik për këto rrethana, që – për fat të keq – do të shtypej me ardhjen e komunizmit. E vërteta është se Xhemijeti, përveç që ishte organizatë politike me identitet islam, që arrinte të artikulonte edhe kërkesa kombëtare, ishte njëherazi edhe organizatë e borgjezisë shqiptare (nëse mund të quhej ashtu kasta e bejlerëve shqiptarë të asaj kohe), si edhe organizatë antikomuniste. Dhe, këtu mbase zë fill edhe animoziteti që ka pasur historiografia shqiptare, deri vonë e dominuar nga kjo mendësi, që Xhemijetin e ka përjashtuar nga lëvizjet kombëtare shqiptare.

Por, në kohën tonë, kur gjërat kanë marrë trajtë tjetër, kur kërkohet deideologjizim i shkencës dhe i mendimit historiografik, është detyrim i studiuesve që të gjitha ngjarjet dhe figurat historike të trajtohen ashtu si kanë qenë dhe pa paragjykime. Vetëm kështu, në fakt, krijohet edhe hallka e organizimit tonë politik si komb dhe, pavarësisht se ndonjëherë nuk do të na pëlqejë, e vërteta duhet të thuhet patjetër. Është e qartë se komunizmi deshi ta prodhojë njeriun e ri dhe të thotë se me komunizmin fillon historia, por në kohën e integritimeve europiane është e rëndësishme që ne të dëshmojmë si komb se qysh në fillim të shekullit XX ne kemi pasur organizata dhe aktivitete politike, që e kanë profilizuar identitetin politik të shqiptarëve të kësaj treve, pra të Kosovës, Maqedonisë së sotme dhe Luginës së Preshevës. Dikujt mund të mos i pëlqejnë edhe lëvizjet e majta, si dhe periudha komuniste, por e vërteta është se shqiptarët më shumë se gjysmë shekulli besuan dhe u angazhuan në kuadër të asaj fryme dhe asaj ideologjie, madje duke u shtypur dhe i shpallë reaksionare e tradhtarë të gjitha organizatat e tjera politike.

Nëse e vështrojmë edhe bashkëpunimin e Ferhat Dragës me dijetarët myslimanë të kohës, si Ataullah efendi Kurtishi²⁵⁸, që kishte dhënë verdik fetar (fetfa) se “është haram të shpërngulesh në Turqi”, një kushtim që ishte ana tjetër e medaljes së angazhimit të Xhemijetit për pengimin e shpërnguljes, kompletohet mozaiku i aktiviteteve shoqërore publike e politike të shqiptarëve mes dy luftërave botërore.

Kështu figura e Ferhat Dragës, e një njeriu të edukuar në shkollë perëndimore, me identitet të pakontestuar kombëtar e fetar, që kishte marrëdhënie të mira edhe me shtetet perëndimore, por edhe me Shtetin Shqiptar, si dhe me Turqinë e kohës²⁵⁹ (bashkëpunoi me ta për ta penguar shpërnguljen e shqiptarëve), në një mënyrë është personifikimi i saktë i nacionalizmit tipik i shqiptarëve që mbeten jashtë Shqipërisë Londineze, që mund të shërbejë edhe sot si shembull për orientimin politik të shqiptarëve të Maqedonisë dhe më gjerë.

Xhemijeti si e djathtë konservatore

Edhe pse është vështirë të flitet për organizata të profilizuara politike në aspekt ideologjik, ashtu siç trajtohen partitë politike në Europë sot, aq më shumë që kushtet sociale që e kanë prodhuar të majtën dhe të djathtën në Europë nuk kanë qenë as për së afërmi të ngjashme me ato në kontekstin shqiptar, megjithatë nëse tërhiqen paralele mund të konstatohet se Xhemijeti, në terma politikë europianë, ishte një model i partive të djathta²⁶⁰ konservatore²⁶¹. Natyrisht, kjo nuk ishte diçka e përpunuar në aspektin teorik, sidomos kur kihet parasysh se Xhemijeti u formua si “ndihmë e shpejtë” për

²⁵⁸ Shih: Taxhudin Bislimi, *Medreseja “Medah” e Ataullah efendiut dhe nxënësit e saj*, Shkup, 2012

²⁵⁹ Skender Asani, *Dokumente....*, fq. 252

²⁶⁰ Shih: Malvina Tema, *Politika dhe ideologjia*, UETPRESS, Tiranë, 2017, fq. 28-35

²⁶¹ Shih: Ben Dupre, *50 ide politike që duhet t'i dijë çdo njeri*, Plejad, Tiranë, 2012, fq.60-63

ta mbrojtur qenien tonë etnike dhe politike, por shikuar në programin e saj, mund të dalim edhe në përfundime të tilla.

Xhemijeti angazhohej për pronën private, ishte kundër të majtës komuniste, angazhohej për të drejta fetare dhe kombëtare, e mbronte fuqinë e bejlerëve (në terma europianë ajo mund të ishte një borgjezi), kujdesej për familjen, ndërsa ne sot e dimë se partitë politike europiane që i përkrahin këto vlera janë të spektrit të djathtë konservator.

E përmendëm këtë jo vetëm për ta legjitimuar profilin politik të Xhemijetit dhe për të vënë paralele me partitë moderne politike, por edhe për të theksuar se mbase ky profilizim, e jo identiteti i theksuar fetar, ka qenë arsyeja që historiografia e majtë e ka parë me sy negativ këtë organizatë. Siç theksuam më sipër, duke e konsideruar veten pioniere të organizimit politik dhe pikënisje të historisë, Partia Komuniste (qoftë ajo në Shqipëri ose në Jugosllavi) nuk ka dashur të pranojë se organizimi politik i shqiptarëve fillon pikërisht me të djathtën, sepse – bazuar në këto vlera – shqiptarët, veçanërisht në atë kohë, ishin konservatorë dhe e majta ishte një mish i huaj që u imponua në trupin e tyre. Ndoshta për këtë arsye edhe dështoi.

Sidoqoftë, edhe organizatat e tjera politike, që vijuan deri në prag të LDB-së dhe gjatë saj, si organizata e studentëve shqiptarë “Besa” ose Organizata Nacional-Demokratike Shqiptare (e njohur si NDSH), por edhe “Balli Kombëtar”, të personifikuara nga personatetet si Shaip Kamberi, Azem Morana, Mulla Idriz Gjilani etj., janë fryma e njëjtë, natyrisht në trajta të tjera, e asaj që ishte Xhemijeti në vitet 1919–1925.

Përtej gjithë kësaj që u shtrua, edhe përkundër paragjykimeve dhe stereotipave, mund të themi se është bërë detyrim shkencor i studentëve dhe studiuesve të shkencave politike të universiteteve shqiptare që t’i njohin të gjitha hallkat e organizimit politik të

shqiptarëve, sepse vetëm ashtu janë objektivë si studiues, por edhe vetëm ashtu kombi shqiptar është i plotë në planin e tij politik.

Burimet:

- Asani Skender, *Veprimtaria politike e organizatës politike Xhemijetit*, Logos-A, Shkup, 2017
- Asani Skender, *Dokumente për veprimtarinë politike të Xhemijetit*, Logos-A, Shkup, 2017
- Bislini Taxhudin, *Medreseja "Medah" e Ataulah efendiut dhe nxënësit e saj*, Shkup, 2012
- Dervishi Nebi, *Hajdin Draga – pjesëmarrës në Kuvendin e Vlorës*, ITSHKSH, Shkup, 2015
- Dupre Ben, *50 ide politike që duhet t'i dijë çdo njeri*, Plejad, Tiranë
- Krasniqi Milazim, *Nacionalizmi shqiptar*, SHB "Logos-A", Shkup, 2014
- Lita Qerim, *Masat e dhunshme në Mexhlin e Ulemasë së Shkupit*, revista "Shenja" nr. 82, Shkup, shkurt 2018.
- Tema Malvina, *Politika dhe ideologjia*, UETPRESS, Tiranë, 2017

*JORINA VERLI**Tiranë*

PROCESI I SHPRONËSIMIT DHE SHPËRNGULJES SË SHQIPTARËVE NGA JUGOSLLAVIA PAS SHUARJES SË XHEMIJETIT

Spastrimi etnik i viseve shqiptare, përkatësisht shkombëtarizimi i tyre i dhunshëm, ishte gjithnjë një synim konstant i qarqeve drejtuese të Beogradit, i llogaritur si faktori thelbësor që mund të garantonte aneksimin e tyre të pakthyesëm. Në këtë kuadër terrori sa herë krijohej rasti, si edhe shpronësimi, shpërngulja e shqiptarëve, krahas kolonizimit sllav të tokave shqiptare, ishin mjetet e preferuara, që u dëshmuuan efikase që nga “homogjenizimi” i Pashallëkut të Beogradit në gjysmën e parë të shek. XIX, deri te spastrimi i sanxhakut të Nishit në vitet 1877–1878, e më pas përgjysmimi i popullsisë shqiptare në vilajetin e Kosovës dhe të Manastirit në vitet 1912–1915. Disa dhjetëra mijë shqiptarë në rastin e parë, mbi 100 mijë në të dytin dhe rreth gjysmë milion të tjerë në rrjedhën e Luftërave Ballkanike dhe gjatë Luftës së Parë Botërore, u likuiduan e u dëbuan, kurse pasuritë e pronat e tyre u grabitën për t’u hapur vend kolonëve sllavë, të ardhur e të sjellë masivisht për të ndryshuar përbërjen etnike të viseve “të çliruara” rishitas, domethënë të aneksuara më së fundi²⁶².

E gjithë klasa politike e Serbisë ishte në unison për zbatimin e politikës së sipërpërmendur. Diferencat ekzistonin vetëm për mënyrën, formën dhe mjetet se si duhej zbatuar kjo politikë, e si

²⁶² Shih *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.II, Tiranë: 2002; vëll.III, Tiranë: Toena, 2007; Kristaq Prifti, *Popullsia e Kosovës*, Tiranë: Kristalina-KH, 2015; Justin McCarthy, *Vdekje e dëbim, pastrimi kombëtar i myslimanëve osmanë 1921-1922*, Tiranë: ALSAR, 2017, f. 157, 171 etj.

duheshin përballuar pengesat e diktuar nga situatat e pafavorshme, apo pengesat e brendshme, ose ndërkombëtare, që u krijoheshin qarqeve drejtuese të Mbretërisë së Serbisë, fillimisht, ose të Jugosllavisë pas 1918–ës.

Rezistenca shumëformëshe e shqiptarëve ishte faktor kryesor i brendshëm që ndikonte në rënien e forcës goditëse të Beogradit gjatë zbatimit të politikës antishqiptare të spastrimit etnik.

Padyshim, në këtë kuadër, pas vitit 1918 pati rol rezistenca e organizuar nga Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” dhe nga Partia e “Xhemijetit”. Forcat radikale të elitës politike shqiptare të organizuara legalisht jashtë Jugosllavisë e ilegalisht brenda saj, organizuan deri rezistencën me armë në Kosovë, si edhe ndërmorën hapa diplomatikë e propagandistikë që synonin sensibilizim të opinionit publik e të kancelarive dhe forumeve ndërkombëtare si Lidhja e Kombeve. Kurse forcat e moderuara shfrytëzuan Kushtetutën jugosllave, parlamentin dhe ndikimin në jetën politike dhe qeverisjen e vendit, duke u bërë herë spontanisht, herë në mënyrë të sinkronizuar, mburoja të popullsisë shqiptare përballë dhunës së institucionalizuar shtetërore të qarqeve drejtuese të Beogradit.²⁶³

Shembuj të shumtë dhe fakte të njohura dëshmojnë se Xhemijeti gjatë viteve 1919–1924 të ekzistencës (u shpërbë më 1925), nën drejtimin e Nexhip Dragës (1919–1921), dhe më pas, vëllait të tij, Ferhat Dragës (1921–1925), luajti një rol të konsiderueshëm në pakësimin e presionit shtetëror për dhunimin, shpronësimin dhe shpërnguljen e shqiptarëve, si edhe kolonizimin me elementë sllavë

²⁶³ Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” (përmbledhje kumtesash), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: 2004; Lush Culaj, *Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” (1918-1924)*, Prishtinë: 1997; Egjber Skëndi, *Hoxhë Kadria*, Prishtinë: 1992; Limon Rushiti, *Lëvizja kaçake në Kosovë (1918-1928)*, Prishtinë: 1981; Ibrahim Çitaku, *Azem Galica dhe veprimtaria luftarake e çetave kaçake të Drenicës*, Prishtinë: 1996; *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, vëll. II (Tiranë, 2008), vëll. III (Tiranë, 2009), zërat Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, *Xhemijeti*; Marenglen Verli, *101 Profile Biografike* (Nga Kosova për Kosovën), Tiranë: Kristalina-KH, Tiranë:2017; etj.

të tokave të tyre. Duke shfrytëzuar procesin zgjedhor dhe forcën e votës në Skupshtinë të deputetëve të vet, duke shtuar numrin e votuesve përkrahës me mbulesën fetare të organizatës, çka i siguroi rregullisht disa deputetë, madje më 1923, 14 deputetë²⁶⁴, Xhemijeti krijoi një forcë, që i dha mundësi të manovronte në qarqet politike jugosllave, midis pozitës dhe opozitës, në favor të interesave të shqiptarëve dhe të myslimanëve të tjerë të së ashtuquajturës “Serbi Jugore”. Nikolla Pashiqi në krye të Partisë Radikale, qoftë në rastin e miratimit të Kushtetutës së Vidovdanit, qoftë për të shmangur krizat qeveritare, kur ishte në pushtet, u detyronte t’i bënte koncesione Xhemijetit sepse kishte nevojë për votat e deputetëve të saj. Dhe këto lëshime konvertoheshin në zbutjen e politikës zyrtare të dhunës e të spastrimit etnik të viseve shqiptare.²⁶⁵

Xhemijeti dhe vëllezërit Draga, nën analizën e vlerësimit me kriteret klasore, në vitet pas Luftës së Dytë Botërore, janë atakuar nga historiografia në Shqipëri e sidomos në Jugosllavi (RFSJ). Sipas këtij këndvështrimi Xhemijeti ishte një organizatë, ose parti e çifligarëve e ngritur mbi baza fetare, që mbronte vetëm interesat e tyre klasore; vëllezërit Draga kanë qenë “turkomanë”, që kanë pasur probleme me ligjin dhe e përdorën Xhemijetin për të mbrojtur interesat klasore e për të shpëtuar nga shpronësimi çifligjet e një pakice shqiptarësh të pasur etj. Në fakt veprimtaria e Xhemijetit dhe Nexhip e Ferhat Dragës, përgjithësisht shkoi në të mirë të gjithë popullsisë shqiptare. Duhet konsideruar mençuri bashkëpunimi i krijuar në kuadër të kësaj organizate me elitën politike të turqve dhe myslimanëve të tjerë në Kosovë e Maqedoni, apo në të ashtuquajturën “Serbi Jugore”, duke luftuar për të siguruar mandate edhe përtej Kosovës, rajonit të Shkupit, Tetovës, Ohrit e Kumanovës deri në Manastir e Kravadar²⁶⁶, por edhe për të fituar

²⁶⁴ *AQSH*, Fondi: MPJ (251), viti 1923, dos.185, dok 37, 54. Njoftim i legatës për MPJ-në Tiranë.

²⁶⁵ *AQSH*, Fondi: MPJ (251), viti 1924, dos. 101, dok. 72, 81, 105-123; *po aty*, viti 1923, dos. 185, dok. 193, 200.

²⁶⁶ *AQSH*, Fondi: MPJ (251), viti 1923, dos. 185, dok. 37, 54.

mbështetjen e myslimanëve të Bosnjës, edhe për të gjetur në rajon mbështetjen e Republikës së Turqisë, e cila kishte një interesim të veçantë për myslimanët e Ballkanit. Koha tregoi se duke përdorur edhe lidhje konfidenciale disa herë, madje edhe në verën e vitit 1938, pas nënshkrimit të Konventës Turko – Jugosllave për shpërnguljen e të paktën 250.000 turqve (në fakt shqiptarëve) drejt Turqisë, F. Draga, tashti jo më si drejtues i Xhemijetit, por padys-him si figura më e njohur në Kosovë, ndikoi në pengimin ose zvarritjen e shpërnguljes në përmasat që do ta kishin likuiduar popullsinë shqiptare në Kosovë, në mënyrë të parikuperueshme²⁶⁷.

Diplomati i Shqipërisë në Beograd njoftonte eprorët në Tiranë më 17 prill 1923 se Xhemijeti ishte orientuar ose rreshtuar me Partinë Radikale, edhe pse fillimisht llogaritej krahas partive të ngritura mbi baza nacionale, të Stefan Radiçit (kroat), Anton Koroshecit (slloven), Mehmet Spahos (boshnjak), hungarezëve dhe gjermanëve dhe ishte shfaqur si kundërshtar i partive serbe Radikale dhe Demokrate, “përkrahëse të konstitucionit të sotshëm”²⁶⁸. Në një njoftim të mëparshëm të 11 shkurtit 1923, ai kishte raportuar se orientimi i sipërpërmendur kishte ndodhur pasi Qeveria jugosllave kishte pranuar kërkesat e Xhemijetit, të negociuara nga F.Draga dhe kishte nënshkruar një protokoll, ku ndër të tjera theksohej në pikën 3 se “Rregullimi i çështjes agrare [do të bëhej] mbi bazën që çdo pronari të vjetër t’i lihet 30 ha tokë dhe të përzihen nga kjo tokë tërë bujqit e instaluar gjer tashti padrejtësisht”. Në pikat e tjera 4, 5, 6 dhe 7, përkatësisht shënohej se duhet:

4. “T’u paguhet pronarëve të vjetër vlefata e tokës që është ndarë sipas agrarit me çmim të caktuar; 5. Të ngrihen gjithë sekuestrot nga pronat e atyre personave që ndodhen brenda shtetit dhe atyre që vërtetojnë me dokumente mosarratisjen e tyre; 6. Të çelen shkolla në gjuhën turqishte dhe shqipe sipas nacionalitetit te

²⁶⁷ AQSH, Fondi: MPJ (251), viti 1930, dos. 194, fl. 402. Ishin shpërngulur 26450 familje afërsisht 150.000. Informacion dhënë F. Dragës nga Ajete Çausi më 1930.

²⁶⁸ AQSH, Fondi MPJ, viti 1923, dos. 185, dok. 37, 54.

muslimanëve; 7. Të pushohet kolonizimi me elementë të huaj në Kosovë dhe Metohi...”.²⁶⁹

Në një raport të 31 dhjetorit 1923, Legata i raportonte Tiranës zyrtare se Xhemijeti nuk kishte paraqitur program nacional. “Kjo, vijonte diplomati i akredituar në Beograd, mundet të vijë nga mungesa e guximit; kështu që për këtë kohë vetëm për çështje fetare bëhet fjalë, por më tutje mbase mund të transformohet në ngjyrën tjetër. Me kërkesë të Xhemijetit, vijon raporti, po përgatitet në Ministrinë e Arsimit një projekt për shkollat fillore myslimane, por nuk dihet në cilën formë, si do që thuhet se ca deputetë kanë kërkuar dhe gjuhën shqipe. Deputetët e Xhemijetit, përfundonte raportin, shpjegojnë se projektet për fenë e shkollën, si dhe ai i agrarit, do të paraqiten për votim në parlament dhe se për këtë [ata] do të ngulin këmbë”²⁷⁰.

Një nëpunës i lartë serb i kohës, Gj. Kërstiq, në një botim të tij të vitit 1928 të titulluar “Kolonizimi i Serbisë Jugore” (“Kolonizacija na Juzhnoj Srbiji”), pas 14 muajsh shërbimi me cilësinë e të Plotfuqishmit kryesor agrar në Shkup (maj 1927–1 gusht 1928), që kontrollonte dhe drejtoritë për gjithë të quajturën “Serbi Jugore”, ose “viset e jugut”, përkatësisht për Kosovën e Maqedoninë, të gjithë procesin e shpronësimit dhe kolonizimit, e vlerësonte të paarrirë. Ai theksonte se, për shkak të ndërhyrjes së politikës, përfshi edhe veprimtarinë e Xhemijetit, por edhe të vështirësive të ndryshme, objektive e subjektive (si paaftësia dhe korrupsioni i administratës në të gjitha nivelet, mosakordimi dhe mungesa e bashkëpunimit të dikastereve etj.), shpronësimi i shqiptarëve dhe kolonizimi i viseve të tyre kishte ecur jo në përmasat e duhura. “Pengesë kryesore janë deputetët, revoltohej Gj.Kërstiqi në broshurën e tij. Këta i kam konsideruar si fatkeqësinë më të madhe

²⁶⁹ *AQSH*, Fondi MPJ, viti 1923, dos. 185, dok.193.

²⁷⁰ Po aty, dok. 193.

për veprimtarinë tonë”.²⁷¹ “Kwadri ynë administrativo–policor në Serbinë Jugore, vijonte më tej Gj. Kërstiqi deri më sot, me disa përjashtime, ka qenë ... instrument i përllogaritjeve partiako–politike”²⁷².

Krstiqi, vlerësonte si efikas veprimin shtetëror grek për instalimin në Greqi brenda 2 vjetëve të 116.842 familjeve me rreth 460.000 anëtarë, të ardhur nga Anadulli pas Luftës Greko–Turke, të cilave iu ishin dhënë 568 mijë ha²⁷³ dhe kërkonte që instancat më të larta shtetërore të Jugosllavisë mos ndaleshin për asnjë arsye dhe ta konsideronin kolonizimin “një ndërmarrje shtetërore të dorës së parë”²⁷⁴.

Periodha pas likuidimit të Xhemijetit solli probleme të ndryshme për Beogradin. Në periudhën e “qetë”, Jugosllavia ishte më e monitoruar, dhe më e penguar për të vepruar si do të dëshironte për spastrimin etnik të viseve shqiptare. Po kështu Turqia nuk mund të ishte, për shkaqe të ndryshme, e gatshme të priste shqiptarë të shpërngulur në përmasat që do të dëshironte Beogradi.²⁷⁵

Në vitet 30, figura të reja pasuan deputetët e dikurshëm të Xhemijetit. Ata penetruan në partitë jugosllave, të cilat u ngritën pas pauzës që krijoi më 1929 shpërndarja e parlamentit dhe vendosja e diktaturës të Mbretit Aleksandër, realizuar në anën e gjeneralit Zhivkoviç. Përgjithësisht kjo elitë politike shqiptare e viteve 30–të kundërshtoi politikën e kolonizimit dhe të shpërnguljes. Që nga viti 1933, e veçanërisht pas vitit 1935, Ferhat Draga me mbështetësit e tij dhe disa deputetë e senatorë të Bashkimit Radikal Jugosllav si Zejnel Ibrahim Strazimiri (i Kaçanikut), Sherif Voca (Vuçiterni), Xhafer Sulejmani (Tetovë), Kadri Saliu (Gostivar), Mustafa Derguti

²⁷¹ Gjeorgje Krstiq, *Kolonizimi i Serbisë Jugore*, (Sarajevë: 1928), Tiranë: Koha, 1995, f. 21.

²⁷² Po aty, f. 57.

²⁷³ Po aty, f. 70.

²⁷⁴ Po aty, f. 16.

²⁷⁵ Zamir Shtylla, “Aspekte të politikës së shpërnguljes me dhunë të shqiptarëve nga Kosova në vitet 1936–1941”, në *Studime historike*, nr. 3, Tiranë: 1990, f. 79.

(Rahovec), Iljaz H. Xhemal (Prishtinë), Beqir Bedriu (Suharekë), Muhamet Zllatku (Dibër), etj., dërguan ose ndikuan në dërgimin çdo vit në Beograd të protestave e peticioneve dhe nxitën demonstrime kundër shpronësimeve, kolonizimit dhe shpërnguljeve, që nuk kaluan pa lënë gjurmë e shpesh penguan ose ndalën procesin.²⁷⁶

Ferhat Draga, nga ana tjetër, në bashkëveprim me shtetin shqiptar, kishte bërë të gjithë lëvizjet e mundshme për të penguar politikën shtetërore antishqiptare të shpronësimeve, shpërnguljeve e kolonizimit. Më 17 tetor 1935, përmes një promemorie drejtuar kryeministrit Stojadinoviç, ai kërkonte të ndalej keqtrajtimi i shqiptarëve, shpronësimet e shpërnguljet e tyre.²⁷⁷

Gjithsesi, insistimi dhe sforcimi i qarqeve drejtuese të Beogradit veçanërisht në gjysmën e dytë të viteve 30-të, çoi në shtimin e sipërfaqes së sekuestruar, e të shpronësuar e të kolonizuar. Në vitin 1941, pra në prag të shkatërrimit të Jugosllavisë, ishte pesëfishuar sipërfaqja e tokave të grabitura nga shqiptarët dhe trefishuar numri i kolonëve të ardhur që numëronin mbi 14 mijë familje vetëm në Kosovë²⁷⁸. Kurse numri i të shpërngulurve kishte arritur për dy dekada në rreth një çerek milioni.

Në prag të Luftës së Dytë Botërore pasojat negative të këtij insistimi permanent shumëvjeçar ishin të mëdha. Në viset shqiptare ishin marrë 381.245 ha tokë, pra shumë herë më tepër sipërfaqe se deri në vitin 1925, ishin ngritur rreth 800 koloni dhe në duart e 17679 familjeve të kolonëve sllavë kishin kaluar 142.588 ha (rreth 88 mijë ha të tjerë iu ndanë sllavëve vendas dhe rreth 77.475 ha ushtrisë²⁷⁹).

Duke parë bilancin e vitit 1941 dhe duke e krahasuar me të dhënat për vitin 1925, mund të nxirret si përfundim se me veprimtarinë e

²⁷⁶ Marenglen Verli, *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë, 1912-1949*, Tiranë: Iliria, 1992, f. 161 – 174. Cítohen dokumente të AQSH të viteve 1933-1938.

²⁷⁷ Fondi: MPJ (251), viti 1935, dos.456, dok. 4, 7. Promemorie e Ferhat Dragës drejtuar kryeministrit jugosllav.

²⁷⁸ M. Verli, *Reforma agrare...*, f. 143.

²⁷⁹ M. Verli, *Reforma agrare kolonizuese ...*, f. 143.

vet Komiteti “MKK” nga njëra anë, dhe Xhemijeti nga ana tjetër, bënë punën e tyre dhe e kryen shërbimin e madh për të cilin u krijuan dhe vepruan. Ata ia arritën të frenonin spastrimin etnik në vitet 1919–1924. Shqiptarët e kanë vlerësuar Komitetin “MKK”. E kanë për detyrë të rivlerësojnë edhe Xhemijetin.

NATASHA DIDENKO

Shkup

JETA KULTURORE DHE POLITIKE E MYSLIMANËVE, SIPAS GLISHA ELEZOVIQIT (1918–1925)



Gligorije Glissha Elezoviq²⁸⁰ – u lind në vitin 1869 në Vushtrri. Rrjedh nga një bashkëshortësi e përzier, nëna Sulltana dhe babai Dimitar. Arsimin fillor serb e filloi në vitin 1891 në vendlindje (Narudinoviq, 425). Në vitin shkollor 1894/95 u regjistrua në Gjinnazin e Selanikut, kurse një vit më vonë, 1895/96, arsinimin e vazhdoi në Gjinnazin serb në Stamboll²⁸¹ (Zafirovq., 1934, 204).

²⁸⁰ Fotoja është marrë në:

https://sr.wikipedia.org/wiki/%D0%93%D0%BB%D0%B8%D0%B3%D0%BE%D1%80%D0%B8%D1%98%D0%B5_%D0%95%D0%BB%D0%B5%D0%B7%D0%BE%D0%B2%D0%B8%D1%9B (e shikuar më 20.11.2017)

²⁸¹ Stambolli atëbotë ishte qytet kozmopolit, në të cilin jetonin shumë të huaj, kurse lëvizja e mësuesve ishte e lirë, fakt ky që nuk vlente për mësuesit e gjimnazeve tjera serbe, të cilët ndiqeshin, dënoheshin dhe burgoseshin. Autoritetet turke ndryshe e shikonin gjinnazin e Stambollit dhe vlerësonin se ekzistimi i saj nuk paraqet çështje politike, për dallim nga gjimnazet tjera serbe në Mbretëron Osmane (Aleksandra Zh. Novakov, 2014, “Средње српске школе у Османлиском Царству (1878-1912), 338 (disertacion i doktoraturës)

Gjinnazi serb në Stamboll ishte shkolla e parë qytetare në Mbretërinë osmane dhe në krahasim me gjinnazet tjera, që ishin tetëvjeçare, gjinnazi serb në Stamboll ishte shtatëvjeçar (Novakov, 2014, 336). Nga viti shkollor 1892/93²⁸² deri në vitin shkollor 1901/02²⁸³, në këtë gjinnaz mësimet i vijuan gjithsej 146 nxënës, midis tyre edhe Gligorije Glisha Elezoviq.

Nga numri i përgjithshëm i nxënësve të Gjinnazit serb në Stamboll, një numër syresh përfundoi një ose dy klasë, ndërsaq dy gjenerata përfunduan gjinnazin shtatëvjeçar dhe e dhanë edhe provimin e lartë. Por, për shkak se në arkivin e Gjinnazit serb të Stambollit nuk janë ruajtur të dhënat për kalimin e provimit të lartë në vitin shkollor 1900/01, më poshtë po japim disa të dhëna të ruajtura, që kanë të bëjnë me nxënësit që e kishin përfunduar klasën e shtatë në atë vit shkollor. Midis tyre ishte edhe Gligorije Glisha Elezoviq (Novakov, 2014, 343).

²⁸² Në vitin shkollor 1892/93 qe sjellë vendimi i hapjes së klasës së parë të gjinnazit, mësimet e së cilës i ndiqnin nxënësit nga klasa e katërt. Në vitin 1893 nxënësit e klasës së tretë kaluan në të katërtën dhe kështu në shkollën fillore funksiononte klasa e parë e dytë, e katërt dhe klasa e parë e gjinnazit. Gjinnazi serb në Stamboll (e paramenduar si katërvjeçare), punonte sipas dispozitave për mësim të mesëm në Mbretërinë serbe me disa ndryshime të vogla në plan programim arsimor. Për të gjitha nevojat e saja kujdesej përfaqësia serbe në Stamboll (Ibid., 301).

²⁸³ Me propozim të Konferencës së dytë të drejtorëve që u mbajt në vitin 1901 në Beograd, ministri solli vendim për ndërprerjen e punës së Gjinnazit serbe në Stamboll, sepse nuk kishte më nevojë për funksionimin e saj. Ai angazhohej për hapjen e shkollës fillore në Stamboll, ku do të tuboheshin të gjithë serbët maqedonas që gjendeshin në Stamboll. Ndaj, viti 1901/02 ishte viti i fundit shkollor i Gjinnazit serbe në Stamboll. Në atë vit kishte vetëm dy klasë: VI dhe VII. Për herë të parë, në klasën VI, pos lëndëve tjera, mësohej edhe gjuha latine, me qëllim që nxënësit të jenë të përgatitur për Gjinnazin e Selanikut, ku si lëndë mësohej edhe latinishtja. (Ibid., 327).

Viti shkollor 1900/01²⁸⁴

1.	Gligorije Glisha Elezoviq, i lindur më 8. I. 1897, Vushtrri
2.	Danillo Vuk Kollakoviq, i lindur më 12. V. 1880, Novi Pazar
3.	Jovan Alkesiq, i lindur më 16. III. 1883, Kumanovë
4.	Kosta Mitiq, i lindur më 26. V. 1881, Prishtinë
5.	Llazar Kërste Jankulloviq, i lindur më 20.V.1884, Vollkovi (Tetovë)
6.	Marko Sima Pavllloviq, i lindur më 1.IX.1881, Rijekë (Boka Kotor)
7.	Nikolla Sterije Niçota, i lindur më 29.I.1880, Smederevë
8.	Petar Antonijeviq, i lindur në vitin 1880, Gjilan.
9.	Petar Llazarevqi, i lindur më 2.XII.1882, Stamboll
10.	Samuil Pandilloviq, i lindur më 15.III.1881, Selce (Manastir)
11.	Stevan Kuzman Kujinxhiq, i lindur në vitin, Rahovec (Kosovë)
12.	Stevan Simiq, i lindur në vitin 1882, Kratovë
13.	Stojan Bojkoviq, Nerodime
14.	Stojan Iliq, i lindur më 25.I.1880, Zhdillovë

²⁸⁴ (1929) Gjinnazi i meshkujve në Shkup, *Raport për vitet 1894-1929 (Me të dhënat për nxënësit që kishin dhënë provimin në gjimnazet serbe të Selanikut dhe Stambollit)*. Shkup, 36.

Si institucion edukativo arsimor, Gjinnaz serb në Stamboll një numri të nxënësve nga Serbia e Vjetër dhe Maqedonia, u mundësoi që arsimimin e tyre ta vazhdojnë edhe më tej (në të shumtën e rasteve në Shkollën e madhe në Beograd). Midis atyre nxënësve që iu mundësua vazhdimi i shkollimit, ishte edhe Gligorije Glisha Elezoviq (Novakov, 2014, 228 – 229).

Në vitin 1901 ai u regjistrua në Fakultetin Filozofik të Beogradit, ku në dy semestrat e parë si lëndë kryesore i regjistroi: histerinë serbe te prof. Stanoje Stanojeviq²⁸⁵ dhe gjeografinë te prof. Jovan Cvijiq²⁸⁶. Më vonë, në semestrin e tretë, e ndërroi grupin dhe si lëndë kryesore i regjistroi gjuhën serbo–kroate, dialektologji dhe gjuhën e vjetër sllave te prof. Aleksandar Beliq²⁸⁷ (Narudinoviq, 425), me të cilin në verë rastësisht e kaloi në ekskursionin gjuhësor. Në atë ekskursion, duke e dëgjuar fjalimin e Levça dhe Teminiç, Gligorije Glisha Elezoviq, konstatoi se dialekti i tyre është shumë i ngjashëm me dialektin e tij kosovar (Agjencioni Shtetëror i Kosovës: Fondi: Glisha Elezoviq, 22 kuti arkivore, të papërpunuara). Në fakt, kjo edhe e cyti të punojë në diplomën e tij me temë “Zërat në dialektin e Kosovës dhe Metohisë”, me të cilën temë ai diplomoi në Fakultetin Filozofik në Beograd (Narudinoviq, 425).

Prejardhja e familjes së tij dhe mjedisi ku ai u rrit ndikuan që Gligorije Glisha Elezoviq, pos gjuhës serbo–kroate, të flasë edhe gjuhë

²⁸⁵ Stanoje Stanojeviq (Novi Sa, 24 gusht 1874 - Vjenë, 30 korrik 1937) – historian serb, enciklopedisti i parë serb i Enciklopedisë popullore në katër vëllime, anëtar i Gjinnazit serb mbretëror dhe profesor i rregullt në Universitetin e Beogradit.

²⁸⁶ Jovan Cvijiq (Loznicë, 11 tetor 1865 - Beograd, 16 janar 1927)- shkencëtar serb, themelues i Shoqatës serbe të gjeografëve, kryetar i Akademisë mbretërore serbe, profesor dhe rektor i Universitetit të Beogradit, anëtar nderi i Universitetit të Sorbonës dhe Universitetit Mbretëror të Pragës. Pas ndërprerjes së Shkollës së lartë dhe themelimit të Universitetit të Beogradit më 12 tetor 1905, ishte zgjedhur ndër tetë profesorët e parë të rregullt të Universitetit.

²⁸⁷ Aleksandar Beliq (Beograd, 2 gusht 1876 - Beograd, 26 shkurt 1960)- filolog maqedonas, profesor dhe rektor i Universitetit të Beogradit, kryetar i Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve (më tej: ASSHA) dhe anëtar i shumë organizatave serbe dhe të jashtme.

tjera. Ai e dinte shqipen, por shërbehej edhe me gjuhën frënge, gjermane, ruse, italiane, polake dhe gjuhën bashkëkohore greke. Mirëpo, gjatë arsinimit të tij në Gjinnazin serb në Stamboll, ai shkëlqyeshëm e mësoi edhe gjuhën osmane, të cilën, më vonë, e zbatoi gjatë përkthimit dhe publikimit të burimeve osmane (Narudinoviq, 426). Njohja e shumë gjuhëve të huaja atij i mundësuan që të shkruajë dhe botojë shumë artikuj dhe punime në revista të ndryshme. Në këtë kuptim, ai qysh si nxënës në Gjinnazin serb të Stambollit, në vitin 1902 filloi t'i publikojë punimet e veta në Revistën e Stambollit²⁸⁸, nën pseudonimin Kotagend (Jovanoviq, 2007, 701), kurse më vonë bashkëpunoi edhe me revista tjera periodike, si: “Politika”, gazetën beogradase “Vreme”, “Vardar”²⁸⁹; “*Gllas naroda*” dhe “*Gllas privrede*” (Narudinoviq, 425–426), ku në periudhën prej vitit 1922 deri në vitin 1924 ishte edhe redaktor. Gjatë studimeve, punimet e tija qenë shpërblyer, duke u bërë edhe një nga themeluesit e Klubit të studentëve „Slovenski jug” (Jovanoviq, 2007, 701)

Në vitin 1905 Gligorije Glisha Elezoviq që emëruar si praktikant²⁹⁰ në gjinnazin e Plevles (Jovanoviq, 2007, 701), kurse nga 1 tetori i vitit 1906 u emërua si praktikant në Gjinnazin serb të Selanikut (Zafirovique, 1934, 142). Në vitin 1907 në Beograd e dha provimin për profesor, duke e mbrojtur temën “Theksi në emrat e dialektit të Kosovës dhe Metohisë” dhe me titullin profesor mbeti të ligjërojë në të njëjtin gjinnaz (Narudinoviq, 425). Në periudhën prej 9 mars 1908 deri në vitin 1912 punoi si profesor në Shkollën e mësuesisë në Shkup (Zafirovique, 1934, 149), kurse në vitin 1910 ishte kryetar i Këshillit arsimor në Dioqezën e Shkupit (Krestiq, 2015, 258–259).

Gligorije Glisha Elezoviq, si profesor në Shkollën e mësuesisë në Shkup, vërejti se gjuhës turke në programin arsimor i kushtohet

²⁸⁸ U botua prej 1895 deri më 1908

²⁸⁹ U botua prej 1908 deri më 1914

²⁹⁰ Arsimitar në shkollën e mesme pas provim të dhënë për profesor, përkatësisht stazhin në shkollën e mesme.

vëmendje e veçantë. Në fakt, kjo e cyti që të mendojë se kush janë ata që gjeneratave të reja do ua bartin dijen dhe njohjen e gjuhës turke, aq më tepër duke pasur parasysh se pas inkorporimit në programin arsimor, atë e ligjëronin hoxhallarët ose njerëz që kishin shkallë të ulët të arsimimit, bile edhe më të ulët se sa nxënësit (Krestiq, 2009, 574). Nisur nga kjo arsye, në vitin 1911 Gligorije Glisla Elezoviq, bashkë me Jovan Shantrij (ish arsimtar dhe anëtar i Gjykatës së shkallës së parë në Prizren) dhe Arsen Zdravkoviq (avokat), filluan të punojnë në Fjalorin turqisht – serbisht²⁹¹. Qëllimi i tyre ishte që fjalori të jetë i vëllimshëm, sa Fjalori serb²⁹² i Vuk Stefanoviq Karaxhiq dhe në të, pos fjalëve turke, të përfshihen edhe fjalët e arabe e perse, të cilat zbatoheshin në të folmen e përditshme të gjuhës zyrtare osmane. Mirëpo, meqë ata nuk patën mjete të mjaftueshme, kërkuan ndihmë nga Ministria e Punëve të Brendshme në Beograd, me qëllim që t'u ndihmohet për botimin, por edhe për honorarët e tyre (Krestiq, 2009, 575).

Më 30 mars, 1911, konsulli i përgjithshëm i Mbretërisë serbe në Shkup, Jovan M. Jovanoviq, iu përgjigj lutjes së tyre, duke kërkuar që të zvogëlohet vëllimi i Fjalorit, ndërkaq në aspektin financiar dha pëlqimin për mbulimin e harxhimeve të shtypit dhe letrës (Krestiq, 2009, 576). Mirëpo, ndaj këtij vendimi reagoi Gligorije Glisla Elezoviq dhe kërkoi nga Ministria e Punëve të Brendshme t'i marrë parasysh çështjet e shtruara në lutjen paraprake për botimin e Fjalorit në Beograd, edhe atë në 6–7 vëllime. Në fakt, ai kërkoi që

²⁹¹ Sipas Gligorije Glisla Elezoviq botimi i Fjalorit turqisht- serbisht ishte me rëndësi të madhe, jo vetëm për nxënësit ndër shkolla, por edhe për shkencën serbe në përgjithësi. Duke u nisur nga mendimi se fati i ka lidhur popullin serb dhe atë turk, ai vlerësonte se nëse dëshirohet që plotësisht të hulumtohet jeta dhe kultura e popullit serb, është e domosdoshme të hulumtohen edhe lidhja e saj me shtetin dhe popullin turk (Vasilej Gj. Krestiq (2009) “Документи о спољној политици Краљевине Србије 1903-1914” libri 4, Fletore 3/1. Beograd: ASSHA, Njësia shkencat historike, 575.

http://diplprepiska.mi.sanu.ac.rs/wb/Serbia-Forum/knjige/4_3_p1#page/573/mode/2up (e shikuar më: 28.11.2017)

²⁹² Edicioni i parë doli në vitin 1818 dhe përmbante 26.270 fjalë.

MPB—ja serbe të bëjë riformulimin e vendimit të saj paraprak (Krestiq, 2009, 577). Më 15 dhjetor të vitit 1911, Ministria e Arsimit, pas vlerësimit nga ana e konsullit të përgjithshëm në Shkup, Spiro H. Ristiq dhe profesorëve Millosh Peroviq e Dim. P. Dohçeviq, solli vendimi të mos pranohet Fjalori turqisht – serbisht i Gligorije Glisha Elezoviq, Jovan Shantirq dhe Arsen Zdravkoviq (Krestiq, 2009, 1338–1340).

Në vitin shkollor 1912/13, për shkak të Luftës së Parë Ballkanike, Shkolla e mësuesisë në Shkup nuk punoi. Mirëpo, pas luftës, pasi sërish filloi me punë, me vendimin nr. 23835 nga 5 nëntori i vitit 1913, Gligorije Glisha Elezoviq sërish u caktua profesor në Shkollën e mësuesisë në Shkup (Jovanoviq, 1913, 1124). Më vonë, ai u caktua të ligjërojë në shkollën teologjike në Prizren, ndërkaq në vitin 1915, ai me bashkëshorten, Kosaran, shkoi të punojë në gjimnazin e Valevës (Jovanoviq, 2007, 701). Pas çlirimit (1918), Gligorije Glisha Elezoviq sërish kthehet në Shkup, përkatësisht në Shkollën e mësuesisë (Narudinoviq, 425), ku më vonë do të emërohet edhe si drejtues i saj.

Në kohën e xhonturqve, përkatësisht në vitin 1908, Gligorije Glisha Elezoviq, si një nga punëtorët më të shquar të arsimit në hapësirat e Serbisë së Vjetër dhe Maqedonisë, qe zgjedhur anëtar në Këshillin e përkohshëm qendror të serbëve osman, kurse në vitin 1909 u emëruar sekretar i Kuvendit Popullor të serbëve osman.

Po në vitin 1909 u mbajt Kongresi i Dibrës, i udhëhequr nga pushtetit xhonturk, me qëllim që ta minimizojë Lëvizjen shqiptare për pavarësi. Organizatori formal i Kongresit ishte Komisioni konstitucional i shqiptarëve osman në Dibër. Ky komision u shpërndau ftesat delegatëve, të cilët ishin me orientime pro—osmane. Në ftesë, ndër të tjera, theksohej: "Të guxosh të marrësh vetëm një pëllëmbë të tokës osmane, do të ketë gjakderdhje të paparë deri më tani në histori. Që të vërehet uniteti ynë, ne, nga këtu, Dibra, që është qendra e Shqipërisë, i bëjmë ftesë popullit që të dërgojë përfaqësues myslimanë e jomyslimanë, që më 10 korrik të marrin pjesë në këtë

tubim” (Abdyli, 2002, 234). Sipas Ramiz Abdylit, nuk dihet numri i saktë i delegatëve që morën pjesë në Kongresin e Dibrës. Ekzistojnë më shumë burime për numrin e tyre. Mirëpo, sipas burimeve italiane, në Kongres morën pjesë 322 delegatë, nga të cilët shumica ishin shqiptarë, 30 ishin delegatë serbë (midis tyre edhe Gligorije Glissha Elezoviq), 25 “bullgarë”, 6 vllahë dhe 6–7 turq (Abdyli, 2002, 235). Gjatë kohës së Kongresit, me propozim të Qenan Manastriut, u përpilua një telegram, me të cilën shqiptarët obligoheshin se do ta respektojnë integritetin territorial të Perandorisë Osmane lidhur me çështjes e Kretës. Por, fjala “besë” në tekst u bë shkas për debatin midis delegatëve shqiptarë dhe delegatit serb Glissha Elezoviq, i cili tha se Kongresi i Dibrës nuk është shqiptar dhe se fjala “besë” në Evropë kishte kuptimin e “varvarizmit” dhe vlerësohej si diçka jashtë-ligjor. Konstatimi i Glissha Elezoviqit shkaktoi reaksione të ashpra te delegatët shqiptarë, të cilët këmbëngulën që ai publikisht të kërkojë falje dhe ta tërheqë konstatimin e tij. Delegatët shqiptarë morën përkrahje nga përfaqësuesi “bullgar” Shanov, nga Kosturi, me fjalët: “Besa në Shqipëri është fjalë e vjetër. Unë si bullgar, po mos të besoja në besën shqiptare, nuk do të vija këtu. Prandaj, besën shqiptare, gjithnjë, me gjithë zemër e përkrahi” (Abdyli, 2002, 239–240).

Gligorije Glissha Elezoviq nuk ishte anëtar i Organizatës revolucionare serbe dhe nuk mori pjesë në luftërat midis viteve 1912 – 1918 (Jovanoviq, 2007, 701). Në vitin 1912 ishte redaktor i gazetës së pavarur politike “Gllas naroda në Shkup. Gjatë vitit 1913 ishte sekretar i Qarkut të Tetovës, por që më vonë u shkarkua nga ana e shërbimeve policore.

Si përfaqësues i politikës serbe në Shkup pas Luftës së Parë Botërore, Gligorije Glissha Elezoviq, në periudhën prej vitit 1922 e deri më 1925, ishte një nga redaktorët kryesorë të revistës për kulturë, shkencë e politikë “Juzhna Serbija”²⁹³. Në periudhën prej vitit 1922 e deri më 1924 redaktorë të revistës ishin Glissha Elezoviq dhe

²⁹³ Botuar në Shtytskronjën „Crapa Cpõnja“.

Millan Çemerikiq²⁹⁴, kurse në vitin 1925 redaktorë ishin Glisha Elezoviq dhe Përvosh Sllankamenac²⁹⁵. Glisha Elezoviq ishte nënshkruar si pronar i botimit 1–2 dhe dy numrave të fundit (48–49). Në këtë revistë ishin të përfshira të gjitha llojet e ngjarjeve kulturore, ngjarje nga lëmi i letërsisë, artit, muzikës si dhe ngjarjet politiko–ekonomike në Shkup, si qendër e ngjarjeve të atëhershme në Serbinë jugore, përkatësisht Maqedoni (Vojinoviq, 1999, 283).

Ai ka publikuar shumë artikuj në revistën “Juzhna Serbija”, edhe atë:

- Elezoviq Glisha. (1922) Gazi baba – Ashik Çelebija (portret i letrarit turk). Në: *Juzhna Serbija* nr.1 (15 mar), 17–21.
- Elezoviq Glisha. (1922) Pushkat shqiptare (Artikull nga etnologjia). Në: *Juzhna Serbija* nr.4, (1 maj), 145–148.
- Elezoviq Glisha. (1922) Kongresi i tretë i myslimanëve të Serbisë jugore (1) (kronika ruse). në: *Juzhna Serbija* nr.4, (1 maj), 154–157.
- Elezoviq Glisha. (1922) ongresi i tretë i myslimanëve të Serbisë jugore (2) pasqyrë parlamentare). Në: *Juzhna Serbija* nr.5, (16 maj), 188–193.
- Elezoviq Glisha. (1922) Varrezat e njohura myslimane në Shkup. Vejsi efendija. Në: *Juzhna Serbija* nr.10, (1 gusht), 50–52.
- Elezoviq Glisha. (1922) Burime turke për historinë tonë (1). Vakëfi i Mehmed Begut, djali i Iska Begut në Tetovë. Në: *Juzhna Serbija* nr.11, (16 gusht), 124–133.
- Elezoviq Glisha. (1922) Burime turke për historinë tonë (2) Në: *Juzhna Serbija* nr.12, (1 shtator), 160–169.
- Elezoviq Glisha. (1922) Vakëfi i xhamisë së Kebir Mehmed Çelebija. Në: *Juzhna Serbija* nr.19, (16 dhjetor), 446–452.

²⁹⁴ Milla Çemerikiq (Prizren, 12 shkurt 1877-1940) – arsimtar, gazetar, poliglot, ekonomist, bankier, redaktor i shumë publikimeve periodike, që dilnin në periudhën turke: “Carigradski gllasnik”, “Vardar”, “Gllas naroda”, “Privredni pregled”, Juzhni Preglet”, Politika”, “Novo vreme”, “Rusko sillovo”.

²⁹⁵ Profesor i Fakultetit Filozof në Shkup

- Elezoviq Glisha. (1922) Zogu i egër. Dramë e Marko P. Cemoviq. Në: *Juzhna Serbija* nr.19, (16 dhjetor), 455–456.
- Elezoviq Glisha (1923) Vakëfi i xhamisë Kebir Mehmed Çelebija. Në: *Juzhna Serbija* nr. 20, (1 janar), 483–487.
- Elezoviq Glisha (1923) Burime turke për historinë serbe. Vakëfi i Xhamisë së Jahja Pashës në Shkup. Në: *Juzhna Serbija* nr.23, (16 shkurt), 97–105.
- Elezoviq Glisha. (1923) Burime turke për historinë serbe. Në: *Juzhna Serbija* nr.24, (1 mars), 156–162.
- Elezoviq Glisha. (1923) Burime turke për historinë serbe. Vakëfi i Xhamisë së Jahja Pashës në Shkup. Në: *Juzhna Serbija* nr.25, 1 prill, 199–202.
- Elezoviq Glisha. (1923) Burime turke për historinë serbe. Në: *Juzhna Serbija* nr.26, (16 prill), 251–257.
- Elezoviq Glisha. (1923) Burime turke për historinë serbe.. Në: *Juzhna Serbija* nr.27, (16 maj), 298–306.
- Elezoviq Glisha. (1923) Rojtarët. Një kontribut për historinë e popullit tonë nën sundimin e turqve. Në: *Juzhna Serbija* nr.28, (1 qershor), 321–329.
- Elezoviq Glisha. (1923) Skifterët dhe skifterizmi. Nga historia e skifterizmit (1). Në: *Juzhna Serbija* nr.30–31, (gusht), 446–457.
- Elezoviq Glisha. (1923) Skifterët dhe skifterizmi (2). Në: *Juzhna Serbija* nr.32–33, (shtator), 522–531.
- Elezoviq Glisha. (1923) Skifterët dhe skifterizmi (3). Në: *Juzhna Serbija* nr.33–34 dhe 34–35,/?/, (tetor), 580–591.
- Elezoviq Glisha. (1923) Skifterët dhe skifterizmi (4). Në: *Juzhna Serbija* nr.36–37, (nëntor), 622–637.
- Elezoviq Glisha, Luba Stojanoviq. (1923) *Jeta e mbretërve* Житије Краљева и kryepeshkopëve serb nga peshkopi Danillo dhe të tjerë. Pasqyrë. Në: *Juzhna Serbija* nr.36–37, (nëntor), 655–658.
- Elezoviq Glisha. (1924) Skifterët dhe skifterizmi (5). Në: *Juzhna Serbija* nr.38–39, (janar–shkurt), 684–711.

- Elezoviq Glisha. (1924) Shoqata për mësimin e historisë osmane. Pasqyrë historike, organ i Institutit për historinë osmane, viti 1910–1918. Në: *Juzhna Serbija* nr.40–41, (mars–prill), 762–773.
- Elezoviq Glisha. (1924) Monumentet turke në Beograd. Në: *Juzhna Serbija* nr.40–41, (mars–prill), 782–785.
- Elezoviq Glisha. (1924) Teqja e kaçanikut. Saçli Kyçuk Memed efendiu.–Vendi i besëtytnive.–Varianti shqip për Musa Kesexhinë dhe Krali Markon. Në: *Juzhna Serbija* nr.42–43, (maj–qershor), 808–813.
- Elezoviq Glisha. (1924) *Monumentet romake në Shkup dhe rrethinë*. Në: *Juzhna Serbija* nr.42–43, (maj–qershor), 814–822.
- Elezoviq Glisha. (1924) Monumentet turke në beograd (2). Në: *Juzhna Serbija* nr. 42–43, (maj–qershor), 822–833.
- Elezoviq Glisha. (1924) Skifterët dhe skifterizmi (6). Në: *Juzhna Serbija* nr.42–43, (maj–qershor), 837–841.
- Elezoviq Glisha. (1924) Dervishët, Teqetë në Shkup. Në: *Juzhna Serbija* nr.44–45, (qershor–gusht–shtator), 857–875.
- Elezoviq Glisha. (1924) Dervishët, Teqetë në Shkup (2). Në: *Juzhna Serbija* nr.46–47, (tetor–nëntor–dhjetor), 954–969.
- Elezoviq Glisha. (1925) Dervishët, Teqet në Shkup (3). Në: *Juzhna Serbija* nr. 48, (maj), 34–38.
- Elezoviq Glisha. (1925) Dervishët, Teqetë në Shkup (4). Në: *Juzhna Serbija* nr.49, (qershor), 105–116 (Vojonoviq,1999, 285–314).

Në vitin 1925, Gligorije Glisha Elezoviq u zgjodh profesor i rregullt i Shoqatës shkencore të Shkupit²⁹⁶, e cila publikonte shkrime të rëndësishme shkencore. Revista e saj më e rëndësishme ishte “Gllasnik”, e cila sipas tematikës dhe programit konceptual redaktues ndahej në dy njësi të veçanta: shkencat shoqërore dhe natyrore.

²⁹⁶ Themelimi i Fakultetit në Shkup (1920), kontribui për krijimin e më shumë revistave letrare, midis të cilave ishte edhe revista “Gllasnik” e Shoqatës shkencore të Shkupit

Deri në vitin 1941 u publikuan 21 numra (Stojanović 2005, 35), nga të cilat 12 ishin nga njësia e shkencave shoqërore dhe 9 nga njësia e shkencave natyrore (Vojinović, 2004, 199). Lista e bashkëpunëtorëve dhe redaktorëve të “Glasnik” ishte përpiluar me emrat e profesorëve të Fakultetit të Shkupit dhe Universitetit të Beogradit, të cilët më vonë u bënë anëtarë të Akademive në Beograd, Zagreb, Novi Sad, Sarajevë etj (Stojanović 2005, 35). Midis tyre ishte edhe emri i Gligorije Glisha Elezovićit, i cili ishte në Këshillin redaktues të numrit të parë të “Glasnik” të Shoqatës shkencore të Shkupit:

- Grujiq Radoslav M (redaktor), Gjorgjeviq Tihomir R., Gjeriq Vasilje, Rlezović Glisha, Kolendić Petar, Kostić Mita dhe Radovanović Vojislav S. (këshilli redaktues) (1925). Libri. I, Fletorja 1 dhe 2. Shkup.

Në revistën e Shoqatës shkencore të Shkupit, Gligorije Glisha Elezović ka botuar shumë artikuj, edhe atë:

- Elezović Glisha (1925) Monumentet turke në Shkup (I). 1. Isak Bugu dhe xhamia Allaxha; 2. Vakëfi i xhamisë Allaxha, Pasuritë e Isak begut në Shkup; 3. Vojvoda Isa beg Isaković dhe pasuritë e tij në Shkup e Sarajevë; 4. Vakëfi i Isa begut në Sarajevë, me pesë fotografi dhe faksimile të dokumenteve në gjuhën turke. Vëllimi I, fletorj 1, Beograd, 135–176.
- Elezović Glisha (1926) Monumentet turke në Shkup (II). 1. Pasuritë e Vakëfit të gazi Isa begut në Shkupit; 2. Vakëfi i xhamisë së Kebir Mehmed Çelebit, birit të Isa beg Isakovićit në Shkup; 3. Vakëfi i teqes Haxhi Agishi, nipit të gazi Isak beg Isakovićit në Shkup. Me një fotografi dhe faksimile të shkrimit në gjuhën turke. Vëllimi I, fletorja 2, Beograd, 397–474.
- Elezović Glisha. (1926) një kontaminim interesant në dialektin e Kosovës dhe Metohisë. Vëllimi II, fletorja 1–2, Sarajevë, 185–189.
- Elezović Glisha. (1928) Prodhimi i nitrat kaliumit në Jurumler të Shkupit. Vëllimi III, 203–208.

- Elezoviq Glisha (1929) Monumentet turke në Shkup. Huma Shah Sulltan. Vëllimi V, 243–261.
- Elezoviq Glisha. (1930) Monumentet turke në Shkup. III Pasuritë e Sulltan Muratit II. Me katër fotografi. Vëllimi VII–VIII, 177–192.
- Elezoviq Glisha. (1933) Xhamia Hatunxhi Vëllimi XII, 262–264.
- Elezoviq Glisha. (1934) Valitë e Shkodrës 1761–1892. Vëllimi XIII, 196–197.
- Elezoviq Glisha. (1936) *Rrëfime islame për prejardhjen arabe: të arnautëve, lazëve, abazëve dhe çerkezëve*. Vëllimi XV–XVI, 255–264. (Vojinoviq, 2004, 200–246).

Gligorije Glisha Elezoviq botoi shumë artikuj e punime në revista të ndryshme, mirëpo veprat e tija më të rëndësishme, me të cilat ai e vulosi krijimtarinë e tij të përgjithshme janë: Fjalori i dialektit të Kosovës dhe Metohisë²⁹⁷ dhe Monumentet turke²⁹⁸.

Në hulumtimet për përgatitjen e këtij punimi, me rëndësi të veçantë pos revistave të Arkivit shtetëror të Republikës së Maqedonisë, literaturës në disponim të Akademisë Maqedonase të Shkencave dhe Arteve, Institut të Historisë Kombëtare në Shkup, Institutit për Trashëgimi Kulturorë e Shpirtërore të Shqiptarëve në Shkup, Bibliotekës kombëtare dhe universitare “Shën Klimenti i Ohrit” – Shkup, ishte edhe fondi i papërpunuar Agjencisë Shtetërore të Kosovës.

²⁹⁷ Fjalori i dialektit të Kosovës dhe Metohisë është publikuar në dy libra. E para doli në vitin 1932, kurse e dyta në vitin 1935. Gligorije Glisha Elezoviq, pos që ishte filolog profesionale dhe dinte si ta trajtojë linguistikë me të gjitha fjalët, ai shumë mire e njihte edhe gjuhën shqipe dhe osmanishten, të cilat jo vetëm që patën ndikim në fjalor, por edhe në morfologjinë e të folurit në Serbinë jugore. Me botimin e Fjalorit, Gligorije Glisha Elezoviq dha një kontribut të veçantë në shkencë.

²⁹⁸ Monumentet turke janë botuar në dy vëllime. Vëllimi i parë përmban parathënien e Jovan Radoniqit dhe 226 dokumente turke të përkthyer të periudhës 1348–1520 dhe është botuar si libër i parë (1940), kurse vëllimi i dytë pos parathënies përmban edhe faksimile të 178 dokumenteve të periudhës 1348–1776, me përmbajtje të shkurtë në gjuhën frënge dhe regjistrin e zgjeruar në të dy librave, Është botuar pas Luftës së Dytë Botërore (1952).

Në këtë fond (të papërpunuar) të Gligorije Glisha Elezoviq ekzistojnë dokumente edhe në gjuhën osmane. Pas shfletimit të këtyre dokumenteve, mund të konstatohet se Gligorije Elezoviq në 22 tetor 1920 ishte listën kandiduese për këshilltar të Qytetit të Shkupi. Mirëpo, ai ishte edhe përfaqësues në Këshillin qendror zgjedhor, si përfaqësues i Partisë Radikale²⁹⁹.

Më 18 mars, 1923, ai ishte bartës i listën kandiduese për qarkun zgjedhor të Të Rashkës–Zveçanit³⁰⁰, si përfaqësues i Partisë Radikale. Në ato zgjedhje, Gligorije Glisha Elezoviq nga gjithsej 21.384 vota, mori 785 vota ose 3.7% (Kostiq, 1924, 23). Mirëpo, edhe përkundër humbjes në zgjedhjet e vitit 1923, ai ishte shumë i afër me qarkun radikal të Shkupit (Jovanoviq, 2007, 701).

Më 31 dhjetor 1924, Gligorije Glisha Elezoviq u dekorua nga Mbreti Aleksandar II Karagjorgjeviq me Medaljen Mbretërore “Sveti Sava”, shkalla IV, me propozim të ministrit të atëhershëm të Arsimit, Svetozar Pribiqeviq³⁰¹.

Gjatë shfletimit të dokumenteve për jetën kulturore dhe politike të myslimanëve sipas Gligorije Glisha Elezoviq, doli një e dhënë, që në fakt, na cyti mua dhe dr. Skender hasanit ta shfletojmë fondin e papërpunuar të Glisha Elezoviq në Agjencionin Shtetëror të Kosovës. Në fakt, kjo e dhënë https://scontent-vie1-1.xx.fbcdn.net/v/t31.0-8/886780_207598012760690_974692701

²⁹⁹ Partia Radikale ishte partia e parë zyrtare në Serbi, e cila u formua më 8 janar 1881 me emrin “Narodna Radikalna Stranka “. Ajo është një nga formacionet rralla politike, e cila edhe pas formimit të Mbretërisë SKS, e vazhdoi veprimtarinë politike. Një nga udhëheqësit e saj kryesor ishte Nikolla Pashiq. Në periudhën 1918 deri 1929, kjo parti vetë ose në koalicion me parti tjera ishte në pushtet. Me përjashtime të pakta, kjo parti gjatë kësaj periudhe kishte fjalën kryesore në politikën e Mbretërisë së SKS (Nadezhda Cvetkovska (2004) “*Политичките партии во парламентарните изборни борби во Вардарскиот дел на Македонија (1919-1929)*”, 28 fu.26).

³⁰⁰ Agjencia Shtetërore e Kosovës. Fondi Glisha Elezoviq, 22 kuti arkivore, i papërpunuar.

³⁰¹ Pasi u nda nga Partia Demokratike, formoi parti të vetë dhe u afrua me radikalët.

_o.jpg?_nc_cat=0&oh=57c3c18ba87c174950edd4e114a66b96&oe=5B4AF438 tregonte se në fondin Glisha Elezoviqit, ekzistojnë dokumente për themelimin e dhe veprimtarinë e organizatës politike Xhemijet³⁰², si përfaqësuese e popullatës myslimane (1919–1925).

Këtë e kemi evidentuar sipas citateve të hulumtuesve shkencor nga Beogradi, midis të cilëve është edhe Liljana Çoliq, e cila këtë e ka potencuar në punimin e saj me titull: Partija e Xhemijetit si parti parlamentare në Mbretërinë SKS. Në: (2002), "Istoriski časopos". Libri XLVII (2000). Beograd: Instituti historik, Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve, 171 fus. 39.

Mirëpo, gjatë shfletimit të fondit të Glisha Elezoviqit në Agjencionin Shtetëror të Kosovës, nuk mundëm t'i gjejmë ato dokumente. Shtrohet pyetja se përse mungojnë ato dokumente? Ekzistojnë më shumë hamendje dhe mendime për humbjen e atyre dokumenteve. Mirëpo, një nga ato hamendje është edhe bindja se ato dokumente janë marrë para vitit 1999, sepse fondi i Glisha Elezoviqit është i papërpunuar.

Në tetor të vitit 1926, Gligorije Glisha Elezoviq, u emërua kryeshef i njësisë për arsimin fillor në Ministrinë e Arsimit të Mbretërisë SKA, por për shkak të mosmarrëveshjeve me ministrin e atëhershëm të Arsimit, Velko Vukiqeviq, në gusht të vitit 1927, ai jep dorëheqje (Jovanoviq, 2007, 701) dhe pensionohet.

³⁰² "Xhemijeti" si organizatë politike ekzistonte edhe para luftërave ballkanike në Turqi. Ajo tubonte popullatën myslimane në Maqedoni nën udhëheqjen e agallarëve, bejlerëve dhe hoxhallarëve dhe fitoi mjaft mandate deputetësh për radikalët. Pasi e realizuan qëllimin, radikalët e ndalojnë në vitin 1925 dhe që atëherë kjo parti nuk paraqitet forcë e rëndësishme politike (Nadezhda Cvetkovska, 2004, *Политичките партии во парламентарните изборни борби во Вардарскиот дел на Македонија 1919-1929*), 33 fus.34).

Burimet arkivore:

Agjencioni Shtetëror i Kosovës: Foni Glisha Elezoviq, 22
kuti arkivore, i papërpunuar.

Literatura:

- АБДУЛИ РАМИЗ. (2002) *Албанското ослободително движење 1908–1910*. Том I. Скопје: Институт за национална историја.
- ВОЈИНОВИЋ СТАНИША. (1999) Библиографија часописа „Јужна Србија“ (1922–1925). Во: *Вардарски зборник* бр. 1: Београд, 283–320.
- ВОЈИНОВИЋ СТАНИША. (2004) Библиографија издања скопског научног друштва 1925–1940. Во: *Вардарски зборник* бр.3: Београд, 199–251.
- ВУКАДИНОВИЋ ЗОРАН Ч. (2007) Милан Чемериќић. Во: *Баштина, Приштина–Лепосавић*. Св.22, 323–331).
- ВУЈАКЛИЈА МИЛАН. (1954) *Лексикон страних речи и израза*. Београд: Просвета.
- (1936) *Grbove, zastave, drugi državni amblemi i zvanični znaci Kraljevine Jugoslavije*. Beograd: Ministarstva trgovine i industrije–Uprava za zaštitu industrijske svojine
- ЕЛЕЗОВИЋ ГЛИША. (1932) *Речник косовско–метохиског дијалекта*. Кн. I, Св. I. Београд.
- ЕЛЕЗОВИЋ ГЛИША. (1935) *Речник косовско–метохиског дијалекта*. Кн. I, св. II. Београд.
- ЕЛЕЗОВИЋ ГЛИША. (1940) *Турски споменици*. Св. I. Београд.

- ЕЛЕЗОВИЋ ГЛИША. (1952) *Турски споменици. Факсимили 178 разних турских докумената из времена од 1348 до 1776 година*. Кн. I, св. II. Београд.
- ЗАФИРОВИЋ СТОЈАН. (1934) *Споменица четрдесетогодишњице државне мушке гимназије у Скопљу*. Скопље: Штампарија Вардарске Бановине.
- ИЛИЋ ПАВЛЕ. (1997) *Споменик српског језика*. Во: *Баштина, Приштина*. VIII/8, 237–240.
- ЈАНКОВИЋ СЛАВКО и МИЛАНОВИЋ МИХАЈЛО (ред). (1957) *Ко је ко у Југославији (биографски подаци о југословенским савременицима)*. I издање. Београд.
- ЈОВАНОВИЋ ВЛАДАН. (2007) *Глигорије Елезовић Глиша*. Во: *Српски Биографски речник*. Нови Сад, 701–702.
- ЈОВАНОВИЋ МИЛАН Н (уред). (1913) *Министарства просвете и црквених послова*. Во: *Просветни гласник*. Бр. 12/XXXIV (декември). Белград: Државна Штампарија.
- (1928) *Ко је ко у Југославији*. Београд, Загреб.
- КОСТИЋ ЛАЗА М. (1924) *Статистика избора народних посланика Краљевине Срба, Хрвата и Словенаца одржаних 18 марта 1923*. Београд.
- КРЕСТИЋ ВАСИЛИЈЕ Ћ. (2009) *Документи о спољној политици Краљевине Србије 1903–1914*. Књ. 4, Свеска 3/1. Београд: САНУ, Одељење Историских наука
- http://diplprepiska.mi.sanu.ac.rs/wb/Serbia-Forum/knjige/4_3_p1#page/573/mode/2up (прегледано на: 28.11.2017).
- КРЕСТИЋ ВАСИЛИЈЕ Ћ. (2009) *Документи о спољној политици Краљевине Србије 1903–1914*. Књ. 4, Свеска 4/2. Београд: САНУ, Одељење Историских наука.
- http://diplprepiska.mi.sanu.ac.rs/wb/Serbia-Forum/knjige/4_4_p2#page/373/mode/2up

(прегледано на: 28.11.2017).

- КРЕСТИЋ ВАСИЛИЈЕ Ћ. (2015) *Документи о спољној политици Краљевине Србије 1903–1914*. Књига.4, Свеска.2/1. Београд: САНУ, Одељење Историских наука.
http://diplprepiska.mi.sanu.ac.rs/wb/Serbia–Forum/knjige/4_2_p1#page/257/mode/2up (прегледано на: 28.11.2017)

- (1929) *Мушка гимназија у Скопљу, Извештај за године 1894–1929 (са подацима о ученицима који су положили виши течајни испит у Цариградској и Солунској Српској гимназији)*. Скопље.

- NARUDINOVIĆ BISERA. *Bibliografija radova Gliše Elezovića*, 425–441..

- НОВАКОВ Ж АЛЕКСАНДРА. (2014) *Средње српске школе у Османлиском Царству (1878–1912)*. Нови Сад (докторска дисертација).

- НУШИЋ БРАНИСЛАВ Ћ.. (1903) *Косово – опис земље и народа (издање са сликама)*. II свеска. Нови Сад: Издање Матице Српске, 86–95.

- ПЕТРОВИЋ П. М. (1937) *СВЕЗНАЊЕ. Општи енциклопедиски лексикон*. Београд: Институт за национални публицитет у Београду.

- (2002) *Преглед општег и међусобног ранга краљевских ордена, медаља и споменица*. Во: *Архив часопис Архива Југославија*, 3, 153–155.

- СТОЈАНЋЕВИЋ ВЛАДИМИР. (2005) *Научна истраживања српских и југословенских научника и установа историјске проблематике предратне Јужне Србије (1919–1941 година)*. Во: *Вардарски зборник* бр.4, 35–50.

- ЦВЕТКОВСКА НАДЕЖДА. (2004) *Политичките партии во парламентарните изборни борби во Вардарскиот дел на Македонија (1919–1929)*. Скопје: Институт за национална историја.
- ЧОЛИЧ ЉИЉАНА. (2002) Партија Џемијет као парламентарна странка у Краљевини СХС. Во: *Историјски часопис*. Књ. XLVII (2000). Београд: Историјски институт, Српске академије наука и уметности, 153–174.

ALBANDOBRUNA

Instituti i Historisë “Ali Hadri”–Prishtinë

PJESËMARRJA E XHEMIJETIT NË ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË VITIT 1923 NË MBRETËRINË SKS

Rrethanat e acaruara shoqërore, ekonomike dhe politike, që e karakterizonin Mbretërinë Serbo–Kroate–Sllovene (SKS) në fillim të viteve ‘20 të shek. XX, pas shpërndarjes së parlamentit, më 21 dhjetor 1922³⁰³, ishin bërë dukuri e shpeshtë, që nga miratimi i Kushtetutës së Vidovdanit në vitin 1921. Kjo e dhënë ka të bëjë me faktin se asnjë parlament i Mbretërisë SKS, nuk e mbajti mandatin e tij katërvjeçar, kurse mandati i qeverive zgjaste prej dy muajve gjer në dy vjet³⁰⁴.

Partia Radikale, Partia Demokratike dhe Xhemijeti, me qëndrimet e tyre kontradiktore, hynë në zgjedhjet parlamentare të 18 marsit 1923 në Kosovë, me kundërtënie të brendshme dhe me orientime të kundërta politike³⁰⁵, sepse në fund të dhjetorit të vitit 1922 kontradiktat midis partive politike (Partia Radikale Serbe dhe Partia Demokratike Serbe) ishin rritur aq shumë, sa që Qeveria e koalicionit nuk pati sukses të qëndrojë në këmbë. “Xhemijeti” mori pjesë në zgjedhje parlamentare për mbrojtjen e interesave të popullsisë shqiptare të Kosovës dhe të krahinave të tjera, sidomos ajo reagoi ashpër ndaj persekutimeve, masakrave serbeve ndaj elementit

³⁰³ Skender Asani, *Xhemijeti veprimtaria e organizatës politike në trevat lindore (1919-1925)*, Shkup-Prishtinë-Tiranë, Logos-A, 2017, f. 106.

³⁰⁴ Mejdî Elezi, *Formimi dhe veprimtaria e partive politike borgjeze në Kosovë me vështrim të veçantë për “Xhemjetin” 1918-1929*, (Tezë e doktoratës në dorëshkrim), Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik: Katedra e Historisë, Prishtinë, 1985, f. 281.

³⁰⁵ Hakif Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918-1941*, Prishtinë: Instituti i Historisë së Kosovës, 1981, f. 204.

shqiptar dhe politikës kolonizuese serbe në trojet shqiptare³⁰⁶, e cila kishte si qellim të vetëm: thyerjen e homogjenitetit të kësaj pakice kombëtare në viset jugore të Mbretërisë Serbo–Kroato–Sllovene (më vonë Jugosllavisë)³⁰⁷. Ndërhyrja e deputetëve dhe e personalliteteve që përbënin këtë parti, e detyruan Serbinë të ndërpriste politikën e kolonizimit në Kosovë e në Rrafshin e Dukagjinit në vitin 1922³⁰⁸. Në shkurt të vitit 1923 para se të mbaheshin zgjedhjet parlamentare, “Xhemijet” mbajti kongresin e katërt. Në këtë kongres u vendos që kjo organizatë të marrë pjesë në zgjedhje në mënyrë të pavarur. Në përgjithësi, në zgjedhjet e 18 marsit të vitit 1923, vetëm se u thellua hendeku ndërnacional në territorin e Kosovës, ku po zhvillohej një aktivitet i madh politik. Kjo i angazhoi përfaqësuesit e “Xhemijetit” dhe të Partisë Radikale Serbe, për të siguruar sa më shumë vota, për shkak se në shumë mbledhje paralelektorale, Partia Radikale Serbe përdori lloje të ndryshme presioni dhe shantazhi, duke ja përshkruar atributin vetes, se vetëm ajo posedonte aftësi “politike që të sundojë në vend”. Sipas rezultateve të prezantuara, lista e “Xhemjetit” fitoi në këto qarqe zgjedhore: Zveçan, Ferat Draga³⁰⁹, Shaban Mustafa, Rafet Rushiti në Mitrovicë, Sakib Abdylrahmani në Vushtrri, Murat Kapiçiqi në Pazar të Ri. Sipas ligjit të zgjedhjeve meqë i kishin fituar mbi 50% të votave, për postin e parlamentarit, Kryesia e Partisë do të kualifikonte: Aqif Ahmetin (Aqif Blyta), Ferat Dragën, Rifat Rushitin dhe Shaban Mustafën. Në qarkun e Kosovës Listën e Xhemijetit e përfaqësonte

³⁰⁶ Hamit Kokalari, *Shkupi, Uskub (Konsiderata etnografike, historike, ekonomike)*, Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup; Instituti i Historisë së Qendrës të Studimeve Albanologjike-Tiranë, 2015, f. 31-32.

³⁰⁷ Hajredin Hoxha, “Politika e eliminimit të shqiptarëve nga trualli i Jugosllavisë së vjetër”, *Përparimi*, Nr.1, Viti XVI, 1970, f. 432; Ramiz Abdyli, “Faktorët që ndikuan në ndryshimin e strukturës socialiste në fshatin e Kosovës (1918-1941)”, *Kosova*, Prishtinë: Instituti i Historisë së Kosovës, Nr.15, 1986, f.f.159-166.

³⁰⁸ Shyqyri Hysi, *Histori e trojeve dhe e diasporës shqiptare*, Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2007, f. 74.

³⁰⁹ Marenglen Verli, *101 profile biografike, nga Kosova për Kosovën*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2016, f. 320.

haxhi Xhemajl Agushi. Në Listën e tij për pozitën e parlamentarit u kualifikuan: Sulejman Haxhi Agushi për rrethin e Prishtinës dhe Arif Ismajli për rrethin e Gjilanit, për rrethin e Llapit ishin kualifikuar Nazim Gafurri dhe Salih Jusufi³¹⁰, ndërsa për rrethin e Ferizajt Mahmut Isaku, dhe Tahir Hasani – për rrethin e Kaçanikut.

Në qarkun e Prizrenit në Listën e Xhemijetit kishte fituar Musa Hysen Ahmeti. Kjo listë nëpër rrethe dukej kështu: në rrethin e Sharrit fitoi Zejnel Ferati, në rrethin e Podgurit fitoi Hysen Hyseni dhe në rrethin e Podrimes fitoi Sulejman Kurti. Në qarkun e Dukagjinit me qendër në Pejë nuk kishte listë të posaçme për Xhemijetin. Në rrethet e këtij qarku Punisha Raçiç kishte arritur t'i lejonte shqiptarët të dilnin në votime vetëm në lista të përziera me radikalët, prandaj në tërë qarkun në Listën e Xhemijetit nuk fitoi asnjë kandidat shqiptar.

Në zgjedhjet e 18 marsit listat e Xhemijetit korrrën fitore solide edhe në Tetovë, ku fitoi Sheh Sadudini; në Shkup fitoi lista e Xhemijetit, të cilën e drejtonte Faik Efendia. Lista e Xhemijetit fitoi edhe në Kumanovë, Gostivar dhe Kërçovë. Ishte shumë me rëndësi se nga këto zgjedhje në radhët e shqiptarëve u forcua besimi në përkatësinë kombëtare shqiptare, me gjithë propagandën e egër që vinte nga disa turkofilë. Por, edhe një dëshmi doli në shesh nga zgjedhjet: se shqiptarët qendër të tyre politike dhe kulturore e konsideronin ende Shkupin³¹¹. Marrë në tërësi në tërë territoret e Kosovës, Maqedonisë dhe Sanxhakut, për kandidatët deputetë të “Xhemijetit” votuan 12 976 votues, ose 45,7% të zgjedhësve, kurse nga radhët e Partisë Radikale Serbe u zgjodhën 15 deputetë dhe nga radhët e Partisë Demokrate 12 deputetë³¹². Në këto zgjedhje partia “Xhemijeti” hyri e përçarë. Krahun disident i saj, të cilin në

³¹⁰ Izber Hoti, *Prishtina dhe rrethina (1918-1941)*, Prishtinë: Shtëpia Botuese “Faik Konica”, 2009, f. 45.

³¹¹ Hakif Bajrami, “Partia politike Xhem’ijeti (2)”, *Dituria islame*, Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës, 2001, Nr.132, f. 48- 49.

³¹² Mejdî Elezi, *Formimi dhe veprimtaria e partive politike borgjeze në Kosovë...*, f. 289-298.

Qarkun e Kosovës në listë e përfaqësonin Ramush Osmani si dhe në disa qytete të tjera të Kosovës (Gjilan, Graçanicë, Ferizaj) ishte për atë që sa më tepër të bashkëpunohet me Partinë Radikale Serbe dhe si e tillë kishte pranuar një platformë oportuniste, mirëpo ky krah i Xhemijetit nuk arriti të fuste asnjë deputet në parlament, pasi në tërë qarkun e Kosovës kishte marrë vetëm 13.0% të votave.

Mirëpo, pa marrë parasysh gjithë këtë presion, pas numërimit të votave suksesin më të madh e arriti në këto zgjedhje³¹³. Ajo fitoi në të gjitha rrethet ku shqiptarët ishin shumicë absolute, duke e bërë “Xhemijetin” forcën e tretë politike në Mbretërinë Serbo–Kroate–Sllovene, me 14 deputetë³¹⁴, dhe me këtë, radikalët serbë në këto zgjedhje kishin siguruar 108 vende, bëri marrëveshje me “Xhemijetit” dhe të Partisë së Gjermanëve Etnikë e cila kishte 8 deputetë, ku mund të formonin qeverinë pasi i siguroi votat e nevojshme me 130 deputetë; këtë përkrahje ata e siguruan me premtimet e dhëna nga Pashiqi për të drejtat e shqiptarëve, sidomos për hapjen e shkollave shqipe, ndarjen në përpjesëtim të mandateve³¹⁵, si dhe premtime të përgjithshme nga ana e palës serbe për shqiptarët³¹⁶, të cilat nuk i përmbushen kurrë. Kjo “lidhje” ishte fare e panatyrshme dhe e dëmshme për të, por ajo ishte e imponuar dhe e paraparë që ashtu edhe të shkatërrohej, gjë që edhe do të ndodhë pas dy vitesh, kur radikalët nuk do të jenë në gjendje që t’i mbikëqyrin të gjitha veprimet e liderëve të saj, veçmas të autoriteteve, siç ishte Fehrat Draga, u përpoq që hapësirën parlamentare ta shfrytëzojë për të nxjerrë në pah gjendjen e rëndë të shqiptarëve si dhe dhunën

³¹³ *Kosova vështrim monografik*, Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2011, f. 230.

³¹⁴ Ramiz Abdyli & Abdurraman Zulfiu, *Fjalor historik*, Shkup-Preshevë, 2009, f. 390.

³¹⁵ Muhamet Shatri, “Marrëdhëniet ekonomike-shoqërore në Prizren dhe rrethinë (1918-1941)”, *Kosova*, Prishtinë: Instituti i Historisë së Kosovës, Nr.15, 1986, f.275.

³¹⁶ Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, (Përktheu nga anglishtja Abdullah Karjagdiu), Koha & ShB e Librit, Tiranë, 2001, f. 282.

shtetërore ndaj tyre.³¹⁷ Andaj, pas këtyre zgjedhjeve (1923) dhe formimit të qeverisë të cilën e kryesonte Nikolla Pashiqi, gjendja politike në Kosovë u acarua edhe më shumë, pasi pakënaqësia dhe anarkia morën hov. Për të mos iu nënshtruar as Pashiqit dhe as Mbretit Aleksander³¹⁸, marrëdhëniet e “Xhemijetit” dhe radikalëve u keqësuan me shpejtësi. Politikani më i shquar i “Xhemijetit”, Fehrat Draga, dëshironte t’i ndërpriste marrëdhëniet me të menjëherë, për shkak të gjendjes së vështirë të popullsisë shqiptare të Kosovë, të cilën edhe deputeti demokrat serb nga Prishtina, Jovan Magovçeviqi, do ta paraqiste para Parlamentit sebo–kroato–sloven, duke u shprehur se: “*Serbia Jugore*” (*Kosova, Maqedonia dhe Sanxhaku*) nuk trajtohen as si koloni, pasi për të nuk vlente kushtetuta dhe ligjet e tjera. Populli maltretohej në mënyrë të ndryshme dhe ndiqej nga organet policore³¹⁹, andaj nga kjo kohë aktiviteti politik i tyre, kombëtar dhe demokratik legal dhe ilegal, sa vinte e bëhej më vendimtar për kahet dhe frymën e lëvizjes dhe të rezistencës shqiptare në Kosovë. Ndonëse Xhemjeti publikisht ishte deklaruar për partinë në pushtet (Nikolla Pashiqit), realisht kjo organizatë, e cila në gjirin e saj kishte futur të gjithë elementin revolucionar dhe demokratik mysliman në Kosovë, Maqedoni dhe Sanxhak, sa vinte e shfaqej si organizatë politike shqiptare kombëtare.³²⁰

Duke e parë se zgjedhjet e 18 marsit të vitit 1923 vetëm se i acaruan edhe më tej raportet ndërmjet nacionaliteteve në Mbretërinë Serbe–Kroate–Slllovene (SKS), ajo doli nga kapela e Partisë

³¹⁷ Jusuf Buxhovi, *Kosova 3*, Faik Konica-Jalifat Publishing, Prishtinë, 2012, f. 215.

³¹⁸ Harun Crnovshanina & Nura Sadikovic, “Haqif Blyta (Haqif Haxhiahmetovië) 1887-1945; I njohur si Haqif efendiu, hero i Sanxhakut me prejardhje gjakovare”, *Dituria islame*, Prishtinë: Bashkësia Islame e Kosovës, Nr. 243, viti 25, tetor 2010, f. 28.

³¹⁹ Mejdi Elezi, *Formimi dhe veprimtaria e partive politike borgjeze në Kosovë...*, f.311.

³²⁰ Muhamet Pirraku, “Nazim Gafurri (1882-1928); Shëmbëlltërrë e ndritshme e historisë kombëtare shqiptare”, *Dituria islame*, Prishtinë: Bashkësia Islame e Kosovës, Nr.18, 1990, f. 26.

Radikale Serbe dhe u orientua në mbrojtje të partive opozitare, si partia nacionaliste kroate, sllovene e hungareze, të cilat u angazhuan për rregullimin federativ të shtetit. Xhemijeti tani kishte dalë haptazi me kërkesa legale për të mbrojtur elementin e pambrojtur shqiptar, i cili po pësonte pos tjerash edhe nga torturat në masë në çdo hap.

Më 1924, deputetët e “Xhemijetit” votuan kundër buxhetit të qeverisë, që u paraqit në parlament për miratim, sepse kërkesat e saj nuk ishin përfillur fare, sidomos nuk ishte dhënë asnjë fond për shkollimin në gjuhën shqipe³²¹. Kjo i solli pasoja organizatës politike, si: rrënimin e xhamisë Burmalit (që kishte filluar në vitin 1924, kurse përfundimisht u rrënuar më 1925)³²², burgosja më 31 janar 1925 e kryetarit të Xhemijetit Ferat Draga³²³, ndërprerja e botimit të gazetës “Hak”³²⁴ dhe masat represive ndaj aktivistëve të kësaj organizate në zgjedhjet parlamentare të vitit 1925³²⁵, që çuan edhe në shkatërrimin e Xhemijetit.

³²¹ Robert Elsie, *Fjalor Historik i Kosovës*, Tiranë: Skeanderbeg Books, 2011, f. 320.

³²² Adnan Ismaili, “Zhbërja e identitetit islam në Shkup – 90-vjetori i rrënimit të xhamisë Burmalit”, *Scupi*, Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, Nr.12, 2015, f. 95.

³²³ Nebi Dervishi, “Kontributi i familjes Draga në Lëvizjen Shqiptare, nga gjysma e dytë e shek. XIX deri në vitet ‘30 të shek. XX”, *Scupi*, Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, Nr.12, 2015, f. 22.

³²⁴ *Fjalor Enciklopedik Shqiptar 3*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2009, f. 2951.

³²⁵ Skender Asani & Mehmet Prishtina, “Shkupi - qendër e rëndësishme e organizatës politike Xhemjeti”, *Scupi*, Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, Nr.12, 2015, f. 231.

NURIDIN AHMETI

Instituti Albanologjik – Prishtinë

XHEMIJETI NË HISTORIOGRAFINË SHQIPTARE

Njëra nga organizatat politike legale e themeluar dhe e cila vazhdoi veprimtarinë e saj në periudhën mes dy luftërave botërore me qendër në Shkup, ishte edhe “Organizata e Myslimanëve të Jugut, e njohur si “Xhemijeti” apo “Bashkini”, me kryetar Nexhip Dragën. Kjo organizatë politike dhe organi i saj “Hak” apo “E drejta”, u bënë zë i arsyeshëm për mbrojtjen e të drejtave të popullatës ku vepruan. Të paktën kështu thuhet në vështrimet e fundit të që i bëhen kësaj organizate politike dhe veprimtarisë së saj.³²⁶

Mirëpo, nga dekadat e para të pasluftës së Dytë Botërore e deri më sot, kur filluan të botohen shkrime për organizimet politike në vendin tonë pas vitit 1918, disa nga autorët e punimeve shkencore nuk e ndanin të njëjtin mendim për Xhemijetin dhe veprimtarinë e saj.

Historiografia e jonë, me disa përjashtime, deri në vitet e ‘90–ta e trajtoi Xhemijetin si një organizatë antikombëtare dhe si një organizëm që më shumë ishte e interesuar për avancimin e të drejtave fetare në Mbretërinë Serbo–Kroato Sllovene.

Pas viteve të ‘90–ta janë dominuese kontributet shkrimore nga studiuesit tanë të cilët mendojnë se Xhemijeti, udhëheqësit dhe organi i saj “Hak”, mbrojtën të drejtat nacionale të shqiptarëve në Mbretërinë Serbo–Kroato Sllovene.

³²⁶ *Fjalori Enciklopedik Shqiptar* 3, ASHSH, Tiranë, 2009, f. 2951.

Xhemijeti dhe veprimtaria e saj

Teksti zyrtarë dy vëllimesh i “Historisë së Popullit Shqiptarë” i botuar në Tiranë në vitin 1967 dhe i ribotuar, siç shkruan në fillimet e këtij botimi në Prishtinë më 1979, me “pak ndryshime të natyrës specifike”, Xhemijetin nuk e përmend fare.³²⁷

Rrjedhimisht, edhe në tekstet shkollore në gjuhën shqipe në Kosovë të botuara nga vitet e ‘60-ta, edhe pse trajtohet periudha në mes dy luftërave botërore të shqiptarët, periudhë kjo që përkon me formimin dhe veprimtarinë e Xhemijetit, për këtë organizatë dhe veprimtarinë e saj nuk shkruhet asgjë.³²⁸

Në vitin 1971 Prof. dr. Hajredin Hoxha boton artikullin mbi partitë politike dhe lëvizjet e tyre në Jugosllavinë borgjeze, siç e quan ai, dhe kur shkruan për Xhemijetin më shumë e sheh si një parti e cila ishte formuar për të plotësuar pluralizmin partiak të kohës.³²⁹ Me një konstatim të tillë nuk pajtohet plotësisht Prof. dr. Hakif Bajrami i cili mendon se qëllimi i konstatimit të Prof. dr. Hajredin Hoxhës nuk është parësor, por dytësor dhe se “roli i forcave subjektive shqiptare” ishte kryesor dhe se nuk qëndronin elemente për shtytje nga jashtë – konstaton studiuesi Bajrami.³³⁰ Në vitin 1981 në studimin monografik “*Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918–1941*”, Prof. dr. Hakif Bajrami, trajton edhe çështjen e Xhemijetit. Ky studiues mbi bazën e dokumentacionit të vjelur gjithandej në arkivat e ish-Jugosllavisë, është i bindur se kjo parti politike dhe prijësit e saj ishin në linjën e

³²⁷ *Historia e Popullit Shqiptarë II*, Prishtinë, 1979, f. 448-545.

³²⁸ Ali Hadri dhe Milan Perkaj, *Pasqyrë e historisë nacionale shqiptare*, Rilindja, Prishtinë, 1960, f. 128-137; Ali Hadri, *Historia e popullit shqiptar për shkollën fillore*, (Botimi i tretë), ETMMKSAK, Prishtinë, 1966, f. 105-117; Ali Hadri, *Historia e popullit shqiptar për shkollat e mesme*, (Botimi tretë i plotësuar), ETMMKSAK, Prishtinë, 1967, f. 117-129.

³²⁹ Hajredin Hoxha, “Partitë politike dhe lëvizjet e tyre ndër shqiptarët në Jugosllavin borgjeze”, *Përparimi*, nr. 12, Prishtinë, 1971, f. 1001-1005.

³³⁰ Hakif Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918-1941*, IHK, Prishtinë, 1981, f. 183.

Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe disa zëra të cilët e cilësojnë këtë parti si nacionale turke dhe fetare, sipas studiuesit Bajrami “nuk mund të qëndrojnë meqë më së mirë këtë e demanton fakti se Nexhip Draga, kryetari i saj, ishte luftëtarë i denjë i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare..., tendenca që ajo të quhet “turke” nuk është asgjë tjetër veçse nënçmim i lëvizjes kombëtare shqiptare..., vetë fakti se Xhemijeti shtroi edhe kërkesa për çlirim nacional, tregon qëndrim politik të borgjezisë, prej se cilës ishte krijuar”.³³¹ – konstaton autori H. Bajrami.

Në Kosovë Xhemijeti u trajtua më hollësisht në vitin 1985, kur në Universitetin e Prishtinës në Fakultetin Filozofik, në degën e Historisë, u mbrojt tema e doktoraturës me titull “Formimi dhe veprimtaria e partive politike borgjeze në Kosovë më vështrim të veçantë për Xhemijetin”, nga kandidati Mejdi Elezi, nën mentorimin e prof. dr. Masar Kodrës. Ky autor Xhemijetin dhe veprimtarinë e tij e sheh si tërësisht antikombëtare. Për me tepër, Mejdi Elezi i jep të drejtë vetës pa modesti të konstatoj se këtë organizatë politike e ka studiuar rrënjësisht duke arritur “në përfundimin se këtu punohet për një organizatë politike, e cila ka qenë instrument i borgjezisë serbomadhe, kurse elementi feudal-çifligar i Xhemijetit ka pasur për qëllim t’i mbroj interesat e veta klasore, e jo edhe të popullsisë shqiptare. Duke i pasur parasysh faktet që përmendëm më lart, nuk e kemi pranuar mendimin e disa autorëve—thekson autori Elezi, të cilët përpigën që Xhemijetin ta paraqesin si organizatë shqiptare, e cila mbronte interesat kombëtare dhe sociale të kombësisë shqiptare në këtë kohë në vendin tonë. Përkundrazi, Xhemijeti dënonte në përgjithësi lëvizjen kaçake, përkrahte çarmatimin e popullsisë shqiptare dhe nuk përpiquej që Reforma Agrare dhe kolonizimi në Kosovë të zbatohet nga aspekti klasor, e jo të ketë qëllim të asgjësimit të kombësisë shqiptare në këtë rajon..., është e vërtetë se nga radhët e Xhemijetit në zgjedhjet parlamentare u zgjedhën 14 deputetë shqiptarë, mirëpo ata e favorizuan politikën serbomadhe

³³¹ *Po aty*, f. 182-183.

në të gjitha seancat e parlamentit të atëhershëm të Mbretërisë Serbo–Kroato–Sllovene”.³³²

Në vitin 1990 studiuesi prof. dr. Muhamet Pirraku, trajton njërin nga personalitetet e njohura të Xhemijetit, dhe ndër kontribuuesit për shtrirjen e veprimtarisë së kësaj organizate të shqiptarët, Nazim Gafurri, të cilin e quan ”bamirës i madh i kombit shqiptarë”. Në fakt, përmes personalitetit të N. Gafurrit autori paraqet edhe shtrirjen dhe veprimtarinë e Xhmijetit.³³³

Në vitin 2001, kemi kontribute shkrimore prapë nga studiuesi H. Bajrami, duke mos lëvizur nga konstatimet për këtë organizatë politike që i kishte artikulluar me herët dhe konstatonte se “Orientimet politike të Xhemijetit gjatë veprimtarisë kanë qenë kryesisht në baza nacionale shqiptare, edhe pse qarqet e okupatorit përpqeshin t’i impononin orientim anacional. Për të arritur këtë qëllim, përmes disa drejtuesve brenda partisë, bënë përpjekje për t’u imponuar në vend të kombëtares, platformën e kamufluar anacionale”,³³⁴ por në vështrimin prej dy vazhdimesh studiuesi H. Bajrami e përmbyll shkrimin e tij me konstatimin se “Xhemijeti, e po të mos ketë punuar për asgjë tjetër, qoftë vetëm pse ua prishi planet jugosllavëve dhe italianëve më 1939–1940, – me këtë veprim ka shënuar epokën e vet historike dhe kombëtare”.³³⁵

³³² Mejdî Elezi, *Formimi dhe veprimtaria e partive politike borgjeze në Kosovë më vështrim të veçantë për “Xhemjetin*, (Punim i doktoraturës në dorëshkrim), Universiteti i Kosovës-Fakulteti Filozofikë-Dega e Historisë, Prishtinë, 1985, f. 354-355, 361.

³³³ Muhamet Pirraku, “Nazim Gafurri (1882-1929)-shëmbëlltyrë e ndritshme e historisë tonë kombëtare shqiptare”, *Dituria islame*, nr. 18, BIK, Prishtinë, 1990, f. 25; Muhamet Pirraku, “Shëmbëlltyrë e ndritshme e historisë tonë kombëtare shqiptare”, *Dituria islame*, nr. 19, BIK, Prishtinë, 1990, f. 18-22.

³³⁴ Hakif Bajrami, “Partia politike Xhemijeti”, *Dituria islame*, nr. 131, BIK, Prishtinë, 2001, f. 40.

³³⁵ Hakif Bajrami, “Partia politike Xhemijeti”, *Dituria islame*, nr. 132, BIK, Prishtinë, 2001, f. 50.

Në vitin 2007 në librin e tij studiuesi nga Gjirokastra Prof. dr. Shyqyri Hysi, Xhemijetin e vlerëson si lëvizje “atdhetare shqiptare”.³³⁶

Në vitin 2007 në Tiranë botohet “Historia e Popullit Shqiptarë”, dhe çuditërisht, kjo organizatë nuk përmendet.³³⁷

Për publicistin e studiuesin Jusuf Buxhovi, i cili në vitin 2012 botoi “Historia e Kosovës” në tre vëllime, Xhemijeti kishte petkun fetar (islam), orientinin turk (gazeta e saj ”Hak” do të botohej në gjuhën turke dhe atë serbe), ndërsa dihet se përfaqësonte dhe mbronte interesat e shqiptarëve”.³³⁸

Sot, në tekstet shkollore të historisë në Kosovë, pavarësisht se nuk flitet për Xhemijetin si organizim politik, por vetëm përmendet veprimtaria e deputetëve shqiptarë në parlamentin e Jugosllavisë së atëhershme, si: Nexhip e Ferhat Draga, Aqif Blyta, Ramë Bllaca etj., duke e vlerësuar angazhimin e tyre në ”demaskimin hapur dhe njoftimin e opinionit ndërkombëtarë për gjenocidin që ushtrohej ndaj shqiptarëve”.³³⁹ Ndërsa, “Historia e Popullit Shqiptarë” për shkollat mesme, i jep më shumë hapësirë Xhemijeti dhe veprimtarisë së saj duke e cilësuar si një organizatë e cila luajti rol të rëndësishëm “për demaskimin e politikës shoviniste serbo madhe ndaj shqiptarëve”.³⁴⁰

Për historianin dr. Skender Asani, i cili është marrë më hollësisht me veprimtarinë e Xhemijetit, këtë organizatë e vlerëson në këtë mënyrë: “Programi i Xhemijetit ishte jetësinë i programit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ajo me deputetët e saj në Parlamentin e Mbretërisë SKS, përfaqësoi denjësisht interesat e shqiptarëve në këtë

³³⁶ Shyqyri Hysi, *Historia e trojeve dhe e diasporës shqiptare*, ShB, Libri Universitar, Tiranë, 2007, f. 72.

³³⁷ *Historia e Popullit Shqiptar III*, ASHSH-Toena, Tiranë 2007, f. 100-272.

³³⁸ Jusuf Buxhovi, *Kosova* 3, Faik Konica-Jalifat Publishing, Prishtinë, 2012, f. 212.

³³⁹ Fehmi Rexhepi, *Historia 9*, ShB, Libri Shkollor, Prishtinë, 2012, f. 35.

³⁴⁰ *Historia e Popullit Shqiptarë për shkollat mesme*, Grup autorësh, ShB, Libri Shkollor, Tiranë, 1994, f. 162.

shtet, duke kundërshtuar në radhë të parë kolonizimin dhe reformën agrare, si dhe pengimin e shpërnguljes së tyre në Turqi e Shqipëri”.³⁴¹

Një shkrim interesantë, me titull “Xhemijeti i Ri” publikohet në rrjetet sociale në Kosovë në vitin 2014. Ky shkrim ka për autor filozofin dhe këshilltarin e kryeparlamentarit të Kosovës z. Kadri Veseli. Autori i këtij shkrimi është dr. Blerim Latifi, i cili duke analizuar sipas tij rrymën radikale islamike në Kosovës “Vehabizimin” dhe disa parti të cilat veprojnë sot në Kosovë, e që sipas të cilit kanë prapavijë të islamit politik, kjo e gjithë sipas filozofit Latifi i ka rrënjët te Xhemijeti. B. Latifi shkon deri aty, sa e një udhëheqësi të një lëvizje politike në Kosovë dhe një klerik të cilët veprojnë sot në Kosovë i krahason me veprimtarinë e Nexhip e Ferhat Dragës, “klerikët e sotëm kosovarë që kërkojnë futjen e sheriatit në të drejtën civile, futjen e dogmave fetare në sistemin e arsimit publik të Kosovës, partitë me orientim ideologjik islamik si “Partia e Drejtësisë” dhe “Lëvizja Bashkohu”, që për ko incidencë kanë në emrat e tyre vetë emrin e Xhemijetit, janë në thelb ringjallje e këtij të fundit. Ato janë Xhemijeti i Ri. Të tillë si Fuad Ramiqi e Shefqet Krasniqi janë pasardhës besnikë të Nexhip e Ferhat Dragës”.³⁴²

Ky shkrim nuk përfundon këtu, disa ora pas publikimit shkrimin nga z. Latifi, ish-kryeparlamentari i Kosovës, me profesion historian dr. Jakup Krasniqi, këtë shkrim e poston në rrjetet sociale dhe u sugjeron lexuesve që ta lexojnë këtë analizë të shkëlqyer sipas tij.³⁴³

³⁴¹ Skender Asani & Mehmet Prishtina, “Shkupi – qendër e rëndësishme e Organizatës Politike Xhemijeti”, *Scupi*, nr. 12, (Jeta shoqërore e shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore -Konferencë shkencore, 14-15 tetor 2015), ITSHKSH, Shkup, 2015, f. 232.

³⁴² Blerim Latifi, “Xhemijeti i Ri”, http://www.gazetaexpress.com/oped/xhemijeti-i-ri-41347/?archive=1?utm_source=referral&utm_medium=web&utm_campaign=copyright, <http://www.gazetaexpress.com/oped/xhemijeti-i-ri-41347/?archive=1>.

³⁴³ “Jakup Krasniqi e quan analizë të shkëlqyeshme tekstin e Blerim Latifit me titull “Xhemijeti i ri”, <http://www.gazetaexpress.com/lajme/jakup-krasniqi-e->

Studiuesit e huaj për Xhemijetin

Organizata politike Xhemijeti ka tërhequr edhe vëmendjen e studiuesve të huaj, historianëve e albanologëve. Ndër studiuesit e huaj, të cilët i janë qasur kësaj organizate politike janë: Noel Malcolm, Robert Elsie dhe Oliver Shmit.

Për këta studiues, Xhemijeti apo deputetët shqiptarë që ishin pjesë e parlamentit në Beograd bënë përpjekje për avancimin edhe të drejtave nacionale të shqiptarëve në Kosovë, “herë pas here kishin zhvilluar edhe veprimtari politike dhe kishin bërë protesta, duke reaguuar ndaj kushteve të përgjithshme të jetesës në Kosovë”—konstaton studiuesi britanik Noel Malcolm.³⁴⁴ Të njëjtin mendim si të studiuesit N. Malcolm e ndanë edhe studiuesi Robert Elsie.³⁴⁵ Ndërsa, studiuesi Oliver Shmit mendon se në këtë kohë, pavarësisht emrit që mbante Xhemijeti, nuk kishte lidhje koalicionuse në mes të myslimanëve shqipfolës edhe sllavishtëfolës të Bosnjë–Hercegovinës, dhe se kërkesat e Kaçakëve shqiptarë të parashtruara në këto vite ngjnin me ato të Xhemijetit, si: “dhënie fund të arbitraritetit nga ana e autoritete, pastaj autonomi, rihapja e shkollave shqipe të themeluar nga Austro–Hungaria dhe shqipen si gjuhë zyrtare”.³⁴⁶

Përfundim

Duke shfletuar punimet historiografike mbi Xhemijetin dhe veprimtarinë e saj nga autorët tanë, mund ta ndajmë në dy periudha kohore:

quan-analize-te-shkelqyeshme-analizen-e-blerim-latifit-me-titull-xhemjeti-i-ri-41430/?archive=1

³⁴⁴ Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, (Përktheu nga anglishtja Abdullah Karjagdiu), Koha&ShB e Librit, Tiranë, 2001, f. 281.

³⁴⁵ Robert Elsie, *Fjalori Historik i Kosovës*, (Përktheu Majlinda Nishku), Skanderbeg Books, Tiranë, 2011, f. 319-320.

³⁴⁶ Oliver J. Schmitt, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*, (Përktheu Enver Robelli), Koha, Prishtinë, 2012, f. 149.

E para – periudha pas viteve ‘50–ta deri në vitet e ‘90–ta, kur kjo organizatë dhe veprimtaria e saj u panë si organizatë antikomëtare dhe e cila kishte si synim vetëm avancimin e të drejtave fetare. Në këtë periudhë përjashtim bëjnë studimet e Prof. dr. Hakif Bajramit dhe

E dyta – periudha kohore pas viteve ‘90–ta e deri më sot. Në këtë periudhë karakterizohen shkrimet të cilat e trajtojnë të kundërtën e asaj që u tha para viteve të ‘90–ta, d.m.th., “Xhemijeti” dhe udhëheqësit e saj dhe organi “Hak” u trajtuan si një veprimtari e përbashkët për avancimin e të drejtave nacionale të shqiptareve dhe demaskimin e politikës shoviniste ndaj shqiptarëve të pushtetit të asaj kohe.

Për periudhën pas viteve të ‘90–ta, ndër autorët të cilët shkruan për këtë organizatë politike janë Hakif Bajrami, Muhamet Pirraku, Shyqyri Hysi, Jusuf Buxhovi. Është për t’u potencuar se studiuesi H. Bajrami, për sa i përket kësaj problematike, ka qëndrim konstant që nga vitet e 80–ta e deri në ditët e sotme. Për shkrimet e studiuesve të tjerë, para viteve të 90–ta vërehet ndikimi i rrethanave në të cilat ata jetuan, qoftë në shtrimin e problemeve apo edhe në përdorimin terminologjik.

Marrë në përgjithësi, shkrimet dominante janë ato të cilat e cilësojnë në Xhemijetin si një organizatë që me deputetët e saj shqiptarë e ka ngritur zërin në sensibilizimin edhe në arenën ndërkombëtare të të drejtave nacionale të shqiptarëve. Studimet e fundit rreth ndriçimit të kësaj organizate dhe botimi i dokumentacionit që lidhet me të dhe udhëheqësit e saj, japin më shumë të dhëna dhe më pakë u lenë hapësirë paragjykimëve.

MURTEZAN IDRIZI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

DISA BURIME ARKIVORE NË LIDHJE ME THEMELIMIN DHE VEPRIMTARINË PO- LITIKE TË ORGANIZATËS XHEMIJETI

Emri i plotë i organizatës politike Xhemijeti ishte “Shoqatë Islamiqe për Mbrojtje dhe Drejtësi” (Islam Muhafaza-yi Hukuk Cemijet). Ajo praktikisht ishte parti legale politike e shqiptarëve myslimanë dhe e pakicave tjera etnike me përkatësi fetare myslimane në Mbretërinë Serbo-Kroato-Slllovene.

Në këtë punim do të shpjegohen shkaqet që nxitën themelimin e Xhemijetit. Njëkohësisht, nëpërmjet materialeve të disa interpelancave kuvendore, do të kuptohet më sheshazi veprimtaria e kësaj organizate politike.

Në përgjithësi, Xhemijeti do të konsiderohet si organizatë politike për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve dhe pakicave tjera myslimane, sepse ata kishin shumë probleme të theksuara, si: shpërngulja e dhunshme për në Turqi dhe kolonizimi i tokave shqiptare me elemente sllave, reforma agrare përmes së cilës shqiptarëve ju merrej toka e bukës për t’ua dhënë kolonëve serbë, moslejimi i shkollimit në gjuhën amtare, moslejimi i përdorimit zyrtar të gjuhës amtare, terri informativ, përkatësisht, moslejimin e botimit të ndonjë gazete në gjuhën shqipe, etj. Për më tepër, pushteti inskenonte kurthe të ndryshme mbi shqiptarët, që pastaj ato t’i ndëshkojë në format më brutale.

Gjendja e tillë e rëndë, nxiti disa figura të shquara shqiptare të asaj kohe, të themelojnë Organizatën politike Xhemijeti. Lidhur me

themelimin e kësaj organizate, Legata shqiptare në Beograd, i raportonte Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, në të cilën ndër të tjerave thuhej: “Duke parë gjendjen e rëndë të myslimanëve, që të mbrohet jeta, pasuria dhe nderi i myslimanëve nga ligësitë dhe padrejtësitë e elementit sllav të këtyre trojeve, një grup është organizuar për të themeluar organizatën politike Xhemijeti”³⁴⁷.

Rreth themelimit të Xhemijetit

Burimet e shkruara hedhin dritë se organizata politike Xhemijeti, u themelua më 18 dhjetor 1919 në Shkup³⁴⁸, e cila udhëhiqej nga veprimtarët shqiptar³⁴⁹. Sipas autorit serb, Milovan Obradoviq, kjo organizatë, përkatësisht parti politike, pati gazetën e vet që mbante emrin “Hak”. E tërë anëtarësia e saj i përkiste konfesionit islam, ndërsa fushëveprimi shtrihej në territoret e sotme të Kosovës, Maqedonisë dhe të Sanxhakut³⁵⁰.

Para se të themelohet Xhemijeti, takimet dhe bisedimet për një veprimtari të tillë bëheshin në forma sekrete dhe intensive. Protagonisti kryesor i këtyre takimeve kuptohet se ishte Ferhat bej Draga. Këtë e shohim nga dëshmia e vajzës së tij, Fahirete Ferhat Draga, dhënë para organeve të UDB-së, menjëherë pas ripushtimit të këtyre tokave shqiptare nga forcat partizane jugosllave, e cila veç tjerash shprehet: “Babai rregullisht udhëtonte në Beograd për shkak veprimtarisë së tij politike. Njerëzit që i takonte Ferhat Draga ishin me reputacion, por edhe myslimanë të vyeshtëm”³⁵¹.

Ndërkohë, në lidhje me themelimin e organizatës Xhemijeti, të dhëna autentike ofron edhe Emin beu, i cili para organeve hetuese

³⁴⁷ Shkupi ndërmjet dy luftërave botërore (dokumente), përg. Skender Asani, Vëll. I, Logos-A, Shkup 2015, 291.

³⁴⁸ Milovan Obradoviq, Reforma agrare dhe kolonizimi në Kosovë (1918-1941), Instituti i Historisë, Prishtinë, 2005, 86.

³⁴⁹ Besnik Emini, E kaluara tani, Shoqata e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni, Shkup, 2016, 114-116.

³⁵⁰ Milovan Obradoviq, 69.

³⁵¹ ДАРМ. 1. 885. К. 18. Д. Драга Ферат Фахирете.

të zhvilluar kundër tij gjatë vitit 1948, shprehet: “Në jetën politike nuk isha shumë i interesuar deri në vitin 1919, kur përnjëherë u bëra anëtar i organizatës Xhemijet në Shkup, dhe nga atëherë fillova aktivisht të merrem me politikë”³⁵². Edhe Emin beu thekson se nuk ka qenë më herët i kyçur në politik, nga dokumentacioni që e posedojmë, shihet qartë se i njëjti shumë mirë i kishte njohur rrethanat e atëhershme politike.

Në fillim ishte një përvojë e hidhur me demokratët serb, të cilët aspak nuk i përfillën kërkesat e organizatës Xhemijeti, për këtë arsye udhëheqja e saj e pa të arsyeshme të arrij marrëveshje, për një koalicion me radikalët serb³⁵³. Koalicionin me radikalët më së miri e shpjegon deklarata e mësipërme e Emin Beut: “Gjatë themelimit të asaj organizate unë (Emin Beu –M. I.), Nexhip Draga, Aliti nga Kavadari e Blyta nga Sanxhaku, shkuam në Beograd pranë udhëheqjes së radikalëve e të demokratëve për të zhvilluar negociata se me cilën parti të futet në koalicion organizata jonë. Kur shkuam në Beograd, së pari negociuam me demokratët, mirëpo ata nuk na pranuan si grup në partinë e tyre, dhe aspak nuk i përfillën kërkesat tona. Atëherë iu drejtuam radikalëve të cilët pranuan të formohet “Xhemijeti” dhe pranuan koalicionim me ta”³⁵⁴. Atëherë kabineti i radikalëve në krye me Pashiçin do të ngelte pakicë në parlament, po mos të ishte vota e Xhemijetit. Në njëfarë mënyre, vota e grupit Xhemijeti, e mbajti gjallë Partinë Radikale³⁵⁵.

³⁵² Државен архив на Република Македонија (më tej ДАРМ). Ф. 885. К. 8., Записник од саслушањето на окривениот Емин Јашаер, службеник од Скопје, работено во УДБ за Македонија, 2-IX. 1948 године, Скопје.

³⁵³ Shkupi ndërmjet dy luftërave botërore..., 291.

³⁵⁴ Po aty, 291.

³⁵⁵ Po aty, 291: “Emin beu lindi në vitin 1889 në Shkup. Gjatë kohës së Jugosllavisë së vjetër ka qenë kryetar i Komunës së Shkupit. Ka pas lidhje me oborrin mbretëror dhe personalisht e ka vizituar mbretin Aleksandër, ndërsa gjithashtu edhe mbreti Aleksandër ka ardhur te çifligu i tij në Butel. Pas vdekjes së mbretit, ai e humb mandatin e deputetit, e njëkohësisht e humbi edhe pronën...”.

Takimet e themeluesve të Xhemijetit ishin të shpeshta, në ta diskutoheshin shumë çështje të rëndësishme, siç ishte edhe reforma agrare. Meqë me reformën agrare cenohej liria dhe pasuria e myslimanëve, njëkohësisht cenohej e drejta e gjuhës amtare në shkollë fillore dhe të mesme. Shpërngulja e shqiptarëve për në Turqi ishte problem shumë i madh për elitën politike shqiptare³⁵⁶. Ashtu që vetë themelimi i organizatës politike Xhemijet në Shkup, si synim kishte ruajtjen e pasurisë së myslimanëve dhe pengimi nga shpërngulja e tyre³⁵⁷.

Nga një dokument tjetër arkivor shihet qartë se deputetët ishin nga trojet shqiptare nën pushtimin e Mbretërisë SKS, që me këtë rast po e paraqesim pjesën ku përshkruhej biografia e udhëheqësit, përkatësisht deputetit të Xhemijetit, Zenel Ibrahim – Strazimiri: “Zenel Ibrahim Strazimiri, i lindur më 9 nëntor 1893 në Shkup. Gjatë kohës së Jugosllavisë së vjetër, si bej është futur në parti të ndryshme politike. Në vitin 1920 kandidohet për deputet nga rrethi i Kaçanikut, në listën e Xhemijetit dhe ka fituar”³⁵⁸. Atëherë qyteti Shkupit ishte si qendër provinciale e Vardarit, me pozitën gjeografike tërheqëse, veç më bëhet pjesë e Mbretërisë Serbe – Kroate – Sllovene³⁵⁹.

Në bazë të dokumenteve arkivore të botuara shihet qartë, përpjekja e pareshtur e deputetëve të Xhemijetit, në mbrojtjen e interesave kombëtare të popullsisë shqiptare. Në një seancë parlamentare, deputeti Ferhat bej Draga, i cili ishte edhe kryetar i Xhemijetit, mbajti një fjalim të zjarrtë kundër politikës diskriminuese ndaj popullsisë shqiptare, të cilën e zhvillonte udhëheqja e atëhershme politike e Mbretërisë SKS, duke theksuar: “Problemet e juaja nuk

³⁵⁶ Justin Mycarty, Vdekje dhe dëbim - spastrimi etnik i myslimanëve osmanë 1821-1922, ALSAR, Tiranë, 2015, 21.

³⁵⁷ Tokat e liruara 1941-1944 (përmbledhje dokumentesh), përg. Qerim Lita, Vëll. III, Logos-A, Shkup, 2016, 381-382.

³⁵⁸ ДАРМ. 1. 885. Кут. 2, Dosja, lista e të dhënave për ish deputetët e Jugosllavisë, 8. IV. 1952, Shkup, referent – kapiten Kiro Zendelski.

³⁵⁹ B.Emini, 114-116.

na tangojnë neve, ne kërkojmë të drejtat tona”. Bashkë me Ferhat Dragën ishte edhe Halim Deralla si deputet në Mbretërinë Serbe – Kroate – Sllovene. Edhe pse sipas Remzi Beut kjo mënyrë e paraqitjes ishte e shpejtuar dhe jo e matur që nuk duhej të bëhej në atë formë, sepse mbretëria më tej do të merr masa të menjëhershme³⁶⁰. Një raport diplomatik italian hedhë dritë se shqiptarët e formuan Xhemijetin për shkak persekutimit politik. Partia Xhemijeti, thuhej më tej “është një parti shqiptare ku marrin pjesë edhe minoriteti turk, por me gjithë atë kishte shumë presion nga shteti derisa u shpërbë”³⁶¹.

Rreth veprimtarisë së Xhemijetit

Xhemijeti me që formalisht konsiderohej se ishte parti e “myslimanëve të Serbisë jugore”, e njëjta nuk mund të llogaritej edhe si nacionaliste. Mirëpo, autori i librit “Reforma Agrare dhe kolonizimi i Kosovës 1918–1941”, Milovan Obradoviçi, duke pasur qasje të njëanshme, thotë se deputetët e Xhemijetit “luftonin për interesat personale, duke bërë pazarllëqe me partitë sunduese”, konkretisht me Partinë Radikale³⁶². Sipas tij, krerët e Xhemijetit ishin “agallarë apo bejlerë”, të cilët me këtë organizatë dëshironin t’i mbronin interesat e tyre, përkatësisht “të fitonin kompensim sa më të madh për tokat dhe sa ishte e mundur më shpejtë të nxjerrin ligjin për çështjen agrare”³⁶³. Radikalët serb, thekson më tej Obradoviçi, “dëshironin që urgjentisht të miratojnë Kushtetutën në Kuvend”, mirëpo për të nevojiteshin votat e deputetëve të Xhemijetit, dhe këta të fundit kushtëzonin në përmbushjen e kërkesave të tyre³⁶⁴.

³⁶⁰ Tokat e liruara 1941-1944 (përmbledhje dokumentesh), përg. Qerim Lita, Vëll III, Logos-A, Shkup, 2016, fq.381-382.

³⁶¹ Shkupi ndërmjet dy luftërave botërore (dokumente), 299.

³⁶² Milovan Obradovoiçi, 87.

³⁶³ Po aty, 69.

³⁶⁴ Po aty, 70.

Në vitin 1920, Xhemijet konsiderohej si organizatë e myslimanëve që funksionon për mbrojtje të drejtave të myslimanëve³⁶⁵. Në zgjedhjet e parafundit ajo numëronte 14 deputetë. Kreu udhëheqës politik i saj, synonte koalicion me një parti të madhe për t'i realizuar sadopak të drejtat e tyre kombëtare e fetare. Për këtë qëllim, ata vendosën kontakte me disa predikues fetar, përkatësisht, me ulematë e njohur shqiptarë të Kosovës e të viseve tjera shqiptare nën pushtimin e Mbretërisë së SKS-së, për parandalimin e shpërnguljeve të shqiptarëve nga trojet e tyre për në Turqi. Shkaku i kësaj shpërnguljeje, ishte persekutimi i vazhdueshëm dhe sistematik nga Qeveria e SKS-së³⁶⁶. Në lidhje me këtë po i referohemi deklaratës së lartcekur të vajzës së Ferhat bej Dragës, Fahirete Draga, ku shprehimisht thekson: “Miku më i ngushtë i babait tim në Shkup ka qenë Hasan Shukriu. Babai te ai ka qenë natë e ditë. Me të babai ka marrë pjesë në pozicionin e Bashkësisë Fetare Islame. Hasan Shukriu rregullisht ka ardhur te babai im i ndjerë, bisedonin e zhvillonin së bashku politikë. Babai ka pasur edhe miq tjerë si për shembull Sali Rustem beun dhe ndonjë tjetër”³⁶⁷. Nga kjo letër kuptohet se takimet që bënte Ferhat bej Draga me Hasan Shukriun, ishin me qëllim që nëpërmjet hoxhallarëve ta ndalonin shpërnguljen e shqiptarëve.

Aktiviteti i kësaj organizate ishte që nëpërmjet pjesëmarrjes në kuvendin e Mbretërisë me deputetët e saj të ndikojë në ruajtjen e pronave të popullsisë myslimane³⁶⁸. Veprimtaria e organizatës Xhemijeti mund të kuptohet edhe nëpërmjet disa interpelancave parlamentare të grupit Xhemijet dhe palës serbe opozitare. Në interpelancat parlamentare Ferhat Draga fliste serbisht me gabime për të cilët gabime kërkonte falje³⁶⁹. Ai në seancë përmendë tolerancën ndërfe-tare që ekzistonte në mesin e shqiptarëve, ortodoksët shkojnë në

³⁶⁵ Shkupi ndërmjet dy luftërave..., 257-258.

³⁶⁶ Po aty, 233-234.

³⁶⁷ ДАРМ. I. 885. К. 18. Д. Драга Ферат Фахирете.

³⁶⁸ B.Emini, 114-116

³⁶⁹ Shkupi ndërmjet dy luftërave..., 235.

kishën ortodokse, katolikët në kishën katolike, kurse myslimanët shikojnë në drejtëm të kalifit të Stambollit³⁷⁰. Gjatë fjalimeve të tij, rrëfen se Azem Bejta nuk kishte lidhje me organizatën Xhemijeti. Në atë kohë Xhemijeti akuzohej se ka lidhje me kaçakët. Dëshmi për këtë ne kemi protestuar pas secilës ndodhi dhe mundë ti shikoni arkivat e partive demokrate dhe radikale, thotë Ferhat Draga³⁷¹.

Nga ana tjetër, deputetët serb më së shumti akuzojnë kaçakët drejtpërdrejtë, sepse bëjnë keqpërdorime të pronave siç thuhej në “Serbin Jugore”, duke aluduar në Xhemijetin se gjoja, e njëjta ka lidhje me këto grupe kaçake. Një prej tyre që akuzon është edhe vetë ministri i Punëve të Brendshme, M. Vujiçiq, i cili thotë se kur thirren nga autoritet për një faj të vogël ata ikin në mal dhe bëhen kaçak³⁷². Ai më tej thotë se nuk bëj as një dallim midis shtetasve as nga feja as nga kombësia³⁷³. Akuzave të ministrit për Punë të Brendshme i kundërpërgjigjet përsëri Ferhat Draga, duke thënë se këto raste kanë qenë në të kaluarën, dhe se tashmë nuk ekzistojnë. Një deputet serb me emrin Jovan Magovçeviq, kritikon kryetarin e parlamentit, për shkak se “pa arsye” e ka pranuar interpelancën e Ferhat bej Dragës, e cila “ishte thirrur më vonë”, njëkohësisht duke iu drejtuar atij me emrin Ferhat. Ndaj kësaj reagoi Ferhat bej Draga, duke ia tërhequr vërejtjen “zotëri, ose thoni zotëri ose bej”³⁷⁴. Deputeti Jovan, vazhdon me akuzat ndaj kaçakëve duke aluduar se ata kanë përkrahje nga organizata Xhemijeti. Përsëri i kundërvihet Ferhat bej Draga, me fjalët “ne e pranojmë se në Llap kishte kaçakë, por ata u larguan dhe aty mbeten vetëm pleqtë, gratë dhe fëmijët, që më pas xhandarmëria vrau e preu gra dhe fëmijë, apo jo?...”. Nënkryetari i parlamentit pyet cili është shkak i ngjarjeve të përmendura? Përsëri reagon deputeti serb Jovan, duke thënë se “shkak janë kaçakët, të cilët përkrahen nga Xhemijeti, ndërsa

³⁷⁰ Po aty, 236.

³⁷¹ Po aty, 237-238

³⁷² Po aty, 247-248.

³⁷³ Po aty, 250.

³⁷⁴ Po aty, 252-253.

Xhemijeti përkrahet nga Qeveria, sepse i duhet për të qëndruar në pushtet”³⁷⁵.

Njëri nga deputetët opozitar serb duke shpjeguar Xhemijetin thotë: “gjatë regjimit turk ishin klasa e privilegjuar, një ishin bejlerët apo agallarët turq të qytetit dhe dy raja, bujqit dhe të vobektit, në grupin e dytë kishte edhe serb krishterë dhe shqiptarë myslimanë”. Me theks të veçantë ai përmendë se grupi i Xhemijetit përbëhet nga klasa e parë³⁷⁶. Deputeti serb flet me një urrejtje të madhe ndaj organizatës Xhemijeti, duke i akuzuar se ata e urrejnë kombin serb dhe se rrënjët i kanë në Azi. Deputeti i demokratëve akuzon politikën e radikalëve, se me çfarë arsye ata e bënë Xhemijetin si parti legale dhe shtetndërtuese. Ai thekson se e gjithë makineria radikale shtetërore është vendosur në funksion të kësaj organizate vetëm për të fituar demokratët në Serbin Jugore³⁷⁷.

Demokratët serbë akuzonin deputetët e Xhemijetit për “inorancë” në format më të ulëta. Përmendet Sali Jusufoviç si deputet nga Xhemijeti, i cili serbisht kishte mësuar nga një oficer serb dhe kishte mësuar për fe tek hoxha i vendit. Njëjtë si ky, përmendet edhe Xhemail Agushi, për të cilin thonë se nuk di as të shkruaj e as të lexojë³⁷⁸.

Një deputet tjetër me emrin Shamate, të gjitha akuzat i hedhë mbi Ferhat bej Dragën, duke thënë: “Nuk ka qetësi dhe rregull në Serbinë Jugore, për arsye se Ferhat Draga dhe Qenan Zia nuk dëshirojnë të ketë qetësi. Shikoni nga Kollashini deri në Rozhajë dhe nga Belo Poja deri në Rashkë, përgjegjës është Ferhat Draga. Ai sikur ta luan vetëm gishtin, kaçakët nuk guxojnë të sillen kështu me popullatën serbe”. Shamate duke vazhduar shton se “Ferhat Draga ka shumë influencë mbi shqiptarët. Sikur t’ju thoshte bajraktarëve dhe këshilltarëve në Drenicë për qetësi, besoni se ata do ta përzinin

³⁷⁵ Shkupi Ndërmjet Dy Luftërave Botërore (dokumente), 254.

³⁷⁶ Po aty, 255.

³⁷⁷ Po aty, 256.

³⁷⁸ Po aty, 257-258.

edhe Azem Bejtën, por edhe Memet Delin prej atje³⁷⁹. Deputetët serb akuzojnë edhe për lidhjen e Nexhip Dragës me disa oficer serb, të cilët i njëjti i inkurajonte se Serbia është shumë e fuqishme. Njëjtë si kjo akuzë edhe për Ferhat Dragën shprehet se kishte bashkëpunim me austriakët dhe ju jepte informata se ç'po ndodhë në Serbi dhe Kosovë. Por menjëherë e demanton Ferhat Draga duke thënë se “ata më afruan 5 milion korona, por unë refuzova një gjë të tillë”³⁸⁰.

Një deputet tjetër nga Xhemijeti me emrin Akif Ahmetoviç, në përkrahje të Ferhat bej Dragës, përmendë vrasjen e një hoxhe dhe disa myslimanëve në rajonin e Sanxhakut nga ana e kryeshefit të xhandarmërisë, Vidiç—it. Akifi përmendi edhe vrasjet edhe emrat e të vrarëve nga ana e xhandarmërisë³⁸¹. Në seancën e njëjtë foli edhe deputeti tjetër demokrat serb, Mihajlo Kujunxhiç, i cili thotë se nga viti 1918 e këndeje në fshatrat e Kosovës të banuar me serbë ndodhë një presion i paparë nga ana e kaçakëve. Deputeti në fjalë popullatën serbe e quan “viktimë e plaçkitjeve selektive nga ana e kaçakëve”. Në fjalimin e tij, organizatën politike “Xhemijetin” e paraqet si agresion ndaj shtetit, duke ju thënë se ju nuk e doni këtë shtet. “Sikur ta donit ju dhe Ferhat Draga, nuk do të krسته asnjë plumb në këto vise”. Po i njëjti deputet akuza hedhë edhe mbi radikalët serb, të cilët nuk duan që të zhduken kaçakët në përgjithësi. Kujunxhiç përmendë kryesuesin e kaçakëve Mehmet Konjuhun, i cili siç vë në dukje “ecë lirshëm në çdo vend të Kosovës”. Njëkohësisht përmendë edhe grupin e Azem Bejtës që funksionojnë ndaras nga grupi Konjuhut. Ai thotë se shokët e Azem Bejtës “më 24 shtator 1923 vranë Xhemail Dibrën pjesëtar i xhandarmërisë, sepse jepte informacione për lëvizjen kaçake”³⁸². Fjalimi i këtillë hapë dilema në lidhje me Xhemail Dibrën. Në vazhdimësi demokratët akuzojnë radikalët së bashku me Xhemijetin, për këtë të fundit thonë se kjo

³⁷⁹ Po aty, 259.

³⁸⁰ Shkupi ndërmjet dy luftërave..., 260.

³⁸¹ Po aty, 264-266.

³⁸² Po aty, 271-273.

ka një peshë të madhe në qeveri. Sepse nuk autorizon njerëz që me metoda të ndryshme ti parandaloj lëvizjet kaçake, në anën tjetër hedhë akuza ndaj radikalëve se ngelin të dobët ndaj deputetëve të Xhemijetit³⁸³.

Deputetët serbë vlerësonin se organizata politike Xhemijeti në fakt përbënte një lëvizje nacionale shqiptare, e cila ka për synim pengimin e asimilimit kulturor dhe politik të bashkëvendësve të tyre shqiptar në Kosovë. Me këtë politikë që zhvillon Xhemijeti, “një ditë do të na del nga dora edhe Maqedonia”³⁸⁴. Më në fund merr fjalë ministri i Punëve të Brendshme Milorad Vujiçiç, i cili, si radikal, për dallim nga deputetët demokratë, arsyeton bashkëpunimin me Xhemijetin duke përmendur të mirat që sjell kjo qeveri³⁸⁵.

Në bazë të një raporti italian mbi situatën politike në SKS dhe mbi organizimin e grupit Xhemijeti, shihet qartë se raportet serbe nuk janë të sakta. Nga raporti italian kuptojmë se gjuha shqipe nuk mësohej, madje as në vendet e banuara plotësisht me shqiptarë. Në raport përmenden dy shkolla, njëra në Shkup e tjetra në Prizren, në të cilat fshehurazi është mësuar gjuha shqipe edhe atë nga ana e priftërinjve katolikë. Kurse në Medresenë e Madhe “Kral Aleksandri i I”, nuk mësohej gjuha shqipe, të gjithë mësime të flitnin serbisht që nënkuptohet se ishin boshnjakë. Në përgjithësi raportet e huaja janë më të sakta se dokumentet serbe, të cilat nuk na japin një pasqyrë të pastër rreth këtyre zhvillimeve.

Në zgjedhjet lokale të vitit 1922, organizata politike Xhemijeti, në vendet ku shqiptarët ishin shumicë propozoi kandidatë shqiptarë. Të nesërmen xhandarmëria bastisi shtëpinë e Ferhat bej Dragës dhe disa shtëpi tjera duke vrarë 20 persona edhe duke keqtrajtuar shumë tjerë. Thuhet se koalicioni me radikalët ka qenë nën presion të forcës. Nga këto zgjedhje lokale fituan vetëm dy kandidatë

³⁸³ Po aty, 277.

³⁸⁴ Po aty, 279.

³⁸⁵ Po aty, 280.

shqiptarë në rrethin e Mitrovicës, të cilët më vonë edhe vriten me arsye se nuk kanë mbajtur uniformën shtetërore³⁸⁶.

Udhëheqja politike e Xhemijetit, shpresonte se përmes kësaj partie politike, shqiptarët do të mund t'i arrijnë aspiratat e tyre, në radhë të parë kombëtare, por edhe ato shoqërore–politike, ekonomike, arsimore e kulturore. Mirëpo, kjo shpresë u shua në zgjedhjet parlamentare të vitit 1925, kur pushteti i atëhershëm i SKS–së, hodhi poshtë listën e Xhemijetit, e cila përbëhej prej 14 personash, duke ua pamundësuar të zhvillojnë fushatë parazgjedhore para elektoratit të tyre shqiptar. Disa prej kandidatëve u detyruan të mbeten në shtëpitë e tyre, me pretekst se rrezikohej jeta e tyre. Pjesëtarët e organizatës protestuan ndaj kësaj dukurie, por ç'do njëri që protestoi nuk ngeli pa u dënuar³⁸⁷. Kjo shihet edhe nga deklarata e përmendur më lartë të Fahirete Ferhat Draga, e cila duke e përshkruar situatën e krijuar asaj kohe shprehet: “Ai (babi) në vitin 1925 nga ana e pushtetit jugosllav qe burgosur dhe qëndroi tre vjet në burg. Qe dënuar 20 vjet mirëpo gjyqi ia zvogëloi dënimin në tre vjet. Qe burgosur si fajtor politik, por si dhe për çka, neve nuk na është e njohur. U burgos në prag të zgjedhjeve të përgjithshme në vitin 1925 si deputet i popullit. Pas burgosjes më nuk ishte deputet e as që udhëtonte për Beograd. Kur u burgos babai pati edhe burgosje tjera, vetëm se të gjithë u liruan nga gjyqi, ndërsa ai u dënua”³⁸⁸. Në disa burime tjera arkivore shihet se Ferhat bej Draga u dënua me 4 vjet burgim, Nazim Gafuri u plagos, e më vonë edhe u vra në Prishtinë, Ramadan Fejzullau u dënua, disave iu konfiskua pasuria. Kjo katrohurë shtetërore ishte vetëm për t'i penguar që shqiptarët mos të merren me politikë³⁸⁹. Sipas të dhënave shqiptare

³⁸⁶ Shkupi ndërmjet dy luftërave..., 294-295.

³⁸⁷ Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë, Politika e Mbretërisë Jugosllave ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë 1929–1941, përg. Qerim Lita, Shkup, 2012, 126–127.

³⁸⁸ ДАРМ. 1. 885. К. 18. Д. Драга Ферат Фахирете.

³⁸⁹ Politika e Mbretërisë Jugosllave ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë 1929 – 1941, përg. Q.Lita, Shkup, 2012, 126–127.

në vitin 1926 në zgjedhjet parlamentare edhe pse fituan disa shqiptarë të organizatës Xhemijeti, ata nuk u pranuan, me pretekst se rezultatet nuk kishin qenë të sakta, pastaj duke përdorur mashën e tyre që kishin xhandarmërinë, me të vetmin qëllim që ti rrënojnë. Kemi shembullin e Shaip Pirokut kundërkandidat i Halim Deralles³⁹⁰. Është me rëndësi të thuhet se Organizata politike Xhemijeti, në zgjedhjet e vitit 1920 fitoi 8 vende në parlament³⁹¹, në vitin 1921, 12 vende në parlament³⁹², ndërsa në vitin 1923, 14 ulëse në parlament³⁹³.

Rreth Reformës Agrare

Mbretëria e SKS-së duke e parë vështirësinë e implementimit të Ligjit të Reformës Agrare, nëpërmjet Zyrës Shtetërore në Ministrinë për Politikë Sociale, vendosi që me 2 prill 1919 të hapë një ministri në vete të Reformës Agrare. Në krye të kësaj ministrie u caktua Franjo Polak³⁹⁴. Reforma agrare në disa vende injorohej shkakut i politikave të asaj kohe. Qeveria gjithashtu e shfrytëzonte reformën agrare, për ndarje të tokës ushtarakëve dhe në atë mënyrë e mbante kolonizimin në Vojvodinë, Slloveni, Maqedoni dhe Kosovë, me këtë i diskriminonte popujt jo sllav, përkatësisht shqiptarët, hungarezët, gjermanët etj³⁹⁵.

Me vendim të SKS-së qendra për realizimin e Reformës Agrare ishte e vendosur në Shkup³⁹⁶, mu aty ku ishte edhe qendra e organizatës politike Xhemijeti. SKS-së ushtroj metodat më të rrepta ndaj popullsisë shqiptare për t'i detyruar t'i lëshojnë vatrat e tyre, për t'ua konfiskuar pasurinë dhe tokat pjellore, dhe të njëjtën për

³⁹⁰ Tokat e liruar..., përg. Q.Lita, Vëll III, Logos-A, Shkup, 2016, 381-382.

³⁹¹ Milovan Obradoviq, 79.

³⁹² Po aty, 88.

³⁹³ Shkupi ndërmjet dy luftërave..., 257-258.

³⁹⁴ Arbër Salihu, Reforma agrare në SKS (ndikimi i saj në pjesët e ndryshme të vendit), (?), 19.

³⁹⁵ Po aty, 20.

³⁹⁶ Qerim Lita, Territoret Lindore Shqiptare 1912-1960, Vatra, Shkup, 2016, 47.

t'ua ndarë kolonialistëve serb. Kjo reformë do t'i dëshpërojë shqiptaret dhe më pas do t'i detyroj ti shesin tokat dhe të shpërngulen për në Turqi dhe Shqipëri³⁹⁷.

Raportet e diplomacisë italiane, në mënyrë të detajuar e përshkruajnë qëllimin e Reformës agrare. Në to veç tjerash thuhej: “Reforma agrare apo reforma e tokës, fshatarëve të cilët e punonin tokën ju premtoj pronarëve dëmshpërblim. Në fakt ligji filloj ti godas pronarët e mëdhenj shqiptarë (bejlerët), duke i hequr të gjithë ata nga vendi i tyre dhe në vend që tu jepen fshatarëve që punonin këtë tokë, ua dhanë udhëheqësve të luftës që ishin dalmat dhe malazezë. Me këtë ligj, humbën edhe tokën, por edhe pronarët apo zotërinjtë. E gjithë kjo ndodhi pas paktit të parë të Tiranës në vitin 1926, kur edhe filloj emigracioni drejt Shqipërisë dhe Turqisë”³⁹⁸. Emigracioni i shqiptarëve ndodhi për shkak të autoriteteve serbe, sepse ndodhte shpronësimi arbitrarë ose në njëfarë mënyre eliminohesh pronari. Versioni serb thotë se shqiptarët tokat ua shitnin myslimanëve. Kjo nuk është e vërtetë, sepse tokat që ishin pronë e shqiptarëve nuk lejohej të shiten, por iu dhurohej administratës malazeze apo serbe³⁹⁹. Me theks të veçantë në viset jugore, ku elementi shqiptar ishte shumë kompakt dhe me përkatësi myslimane. Mbretëria e atëhershme, kolonialistëve serb që erdhën në këto toka, ju mundësoj shtëpi, mjete për punimin e tokës dhe i lironte nga të gjitha tatimet shtetërore, me të cilën u ngarkuan shqiptarët⁴⁰⁰.

Xhemijeti nëpërmjet pjesëmarrjes në Kuvendin e Mbretërisë SKS, me deputetët e saj do të ndikojë në ruajtjen e pronave të popullsisë myslimane. Sipas Ligjit të Reformës Agrare ishte e paraparë që pronat t'u merren pronarëve të deriatëhershëm dhe tu jepen kolonëve serbe të cilët josheshin të vijnë nga viset tjera të

³⁹⁷ Po aty, 52.

³⁹⁸ Shkupi ndërmjet dy luftërave..., 296.

³⁹⁹ Po aty, 298.

⁴⁰⁰ Po aty, 233-224.

mbretërisë, në hapësirat ku kishte prona të mëdha tokësore të myslimanëve⁴⁰¹.

Përfundim

Në këtë punim rëndësi të veçantë u kemi kushtuar burimeve arkivore, me të cilët shpjegohet themelimi, veprimtaria dhe sfidat e organizatës politike Xhemijeti. Themeluesit e saj, që më vonë u bënë edhe parlamentarë, ishin nga komuniteti myslimanë, dhe shumica të përkatësisë etnike shqiptare. Grupi parlamentar i Xhemijetit e ngriti zërin ndaj gjitha padrejtësive, si ndaj shpronësimit të shqiptarëve me reformën agrare, gjithashtu edhe ndaj shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi që llogaritet si shpërngulje me presion.

Puna gjashtëvjeçare e organizatës Xhemijeti tregon pjekurinë dhe guximin e themeluesve, por edhe vështirësitë në këtë drejtim. Prandaj, mund të konstatojmë se organizata Xhemijeti ishte një pengesë për mbretërinë SKS-së, andaj edhe në vitin 1925–1926 do ti shohim arrestimet, vrasjet dhe burgosjet e shqiptarëve. Kjo është edhe një dëshmi se organizata Xhemijeti ishte në rrugë të drejtë. Me pezullimin e funksionimit legal të kësaj organizate politike, faktikisht shqiptarëve ju mohua e drejta e përfaqësimit të tyre në organet e atëhershme legjislative të Mbretërisë SKS. Kjo mungesë, i detyroi krerët e atëhershëm shqiptarë, që organizimin e tyre politik ta bëjnë përmes Bashkësisë Fetare Islame, përkatësisht Mexhlisit të Ulemasë në Shkup, i cili përfshinte tërë territoret shqiptare nën pushtimin e asaj mbretërie.

Bartës i kësaj lëvizje ishte Ferahat bej Draga, i cili nga qarqet e atëhershme të proveniencës policore serbe konsiderohej si lideri suprem i shqiptarëve në Jugosllavi.

⁴⁰¹ B.Emini, 114-116.

Burimet dhe literatura e konsultuar:

- ДАРМ. 1. 885. Кут. 2, Досја Кумбараџи Емин Јашар бе, 1952 година.
- ДАРМ. 1. 885. К. 18. Д. Драга Ферат Фахирете.
- ДАРМ. 1. 885. Кут. 2, Dosja, lista e të dhënave për ish deputetët e Jugosllavisë, 8. IV. 1952, Shkup, referent – kapiten Kiro Zendelski.
- ДАРМ. Ф. 885. К. 8., Записник од саслушањето на окривениот Емин Јашаер, службеник од Скопје, работено во УДБ за Македонија, 2–IX. 1948 године, Скопје.
- Arkivi Shtetërorë i Republikës së Maqedonisë, Politika e Mbretërisë Jugosllave Ndaj Shqiptarëve dhe Shqipërisë 1929 – 1941, Përg. Qerim Lita, Shkup, 2012.
- Lita Qerim, Territoret Lindore Shqiptare 1912–1960 (Punime Studimore), Vatra, Shkup 2016.
- Shkupi ndërmjet dy luftërave botërore (dokumente), përg. Skender Asani, Vëll, I, Logos–A, Shkup 2015.
- Tokat e liruar 1941–1944 (përmbledhje dokumentesh), përg. Qerim Lita, Vëll III, Logos–A, Shkup, 2016.
- Emni Besnik, E kaluara tani, Shoqata e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni, Shkup, 2016.
- Mycarty Jastin, Vdekje dhe dëbim – spastrimi etnik i myslimanëve osmanë 1821–1922, ALSAR, Tiranë, 2015.
- Salihu Arbër, Reforma Agrare në SKS (ndikimi i saj në pjesët e ndryshme të vendit), (?).
- Obradovoiq Milovan, Reforma agrare dhe kolonizimi në Kosovë (1918–1941), Instituti i Historisë, Prishtinë, 2005.

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

SCUPI, vëllimi 20 – 2018

“Organizata Xhemijeti dhe rezistenca e saj kundër kolonizimit”

Kryeredaktor:
Dr. Skender Asani

Redaktor gjuhësor:
Shkëlzen Halimi

Redaktor teknik:
Naser Fera

Shtypi: Focus Print – Shkup
Tirazhi: 500 copë

Ky material botohet me vendimin e Këshillit të ITSHKSH-së
nr. 0201–44/5, të datës 12.2.2018, Shkup.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

930.85(=18:497.7)(062)

ORGANIZATA xhemijeti dhe rezistenca e saj kundër kolonizimit : (konferencë shkencore mbajtur më 17.12.2017, Shkup) / [kryeredaktor Skender Asani].
- Shkup : Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve, 2018. -
226 стр. ; 20 см. - (Biblioteka Scupi ; v. 20)
Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4653-68-4

а) Албанци во Македонија - Културна историја - Собири
COBISS.MK-ID 107121162